

EDUKATA ISLAME

REVISTË SHKENCORE, KULTURORE, ISLAME



VITI XXXI NR. 67

PRISHTINË
2002

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXI nr. 67 / 2002

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXI nr. 67 – 2002

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, i,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Isa Bajçinca

Korrektor: Skender Rashiti

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

*Shtyp: **Koha** - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXI nr. 67 / 2002

Prishtinë
2002

Qemajl Morina

Arsimimi kosovar në udhëkryq

Edukimi dhe arsimimi i rinisë është ndër prioritetet më të mëdha të çdo shoqërie. Përparimi dhe prosperiteti i një shoqërie vlerësohet më së miri nga fakti sa është i edukuar dhe i arsimuar ai popull. Mu për këtë të gjitha ato shtete, që dëshirojnë përparimin e popullit të vet, çështjes së edukimit dhe arsimimit i kushtojnë vëmendje dhe kujdes të veçantë. Në shumë vende të botës ekzistojnë edhe nga dy ministri për edukim dhe arsim. Njëra merret me arsimin e ulët, ndërsa tjetra me arsimin e lartë. Shteti nga popullata merr kontribute të konsiderueshme për ndërtimin e shkollave, universiteteve si dhe institucioneve tjera kërkimore-shkencore. Kjo është mënyra e vetme për realizimin e prosperitetit dhe ardhmërisë më të mirë të një populli.

Populli ynë hyn në mesin e atyre popujve që ka një respekt të veçantë ndaj arsimit. Ai mund të quhet ndër popujt më arsimdashës në botë. Kjo vetijë e tij ka mbështetje në traditën e tij fetare dhe kombëtare. Këtë më së miri ai e vërtetoi gjatë dekadës së fundit të shekullit njëzet, kur okupatori serb ia mbylli atij të gjitha shtigjet e diturisë që ai të mbetej analfabet. Megjithatë, ai bëri çmos dhe nuk u dorëzua. Shtëpitë i ktheu në shkolla dhe fakultete. E vetëfinancoi arsimin dhe kështu e dha një ndër provimet më të vështira në historinë e tij. Ajo

periudhë do të mbahet në mend si një nga periudhat më të ndritura në historinë e popullit tonë.

Ne jemi dëshmitarë se koha që po jetojmë, është kohë e ndryshimeve të mëdha. Është koha e kompjuterizimit, satelitit dhe internetit. E tërë bota është kthyer në një fshat shumë të vogël. Globalizimi është fjala, që përdoret më së shumti këto ditë. Është fjala për globalizimin në shkencë, kulturë, ekonomi, politikë, tregti etj. Popujt më të vegjël dhe më të varfër ekonomikisht, me të drejtë kanë frikë nga globalizimi.

Kjo vlen edhe për ne shqiptarët, ajo që e vështirëson pozitën tonë edhe më tepër si kosovarë, është një prani shumë e madhe e vendeve të ndryshme në Kosovë, për shkak të rrethanave të njohura si dhe mosdefinimi i statusit final të Kosovës, deri më sot. Kur t'i shtohet kësaj se Kosova në këto rrethana po kalon periudhën e transicionit, nga një ish-sistem totalitar në një sistem të ri ku faktori vendor nuk e ka fjalën kryesore, por ai i jashtëmi, siç qe funksioni i Daksnerit, i cili kishte në dorë të gjitha kompetencat për arsimin kosovar, prej atij fillorë deri tek ai universitar, atëherë ky problem në Kosovë na del më i ndërlikuar si në vendet tjera.

Me gjithë respektin për angazhimin e tij në ngritjen e nivelit të arsimit kosovar, si një austriak e ka pasur vështirë të bëjë reformat e duhura. Për arsye se çdo vend i ka specifikat e veta të veçanta, të cilat duhet të merren parasysh, para se të bëhen reformat e duhura. Ndoshta ky është shkaku që pas shkuarjes së tij nga Kosova, në adresë të tij janë thënë shumë kritika.

Kur është fjala për edukimin dhe arsimin, shqiptarët sot në përmasa të globalizmit botëror ballafaqohen me sfida të shumta. Ata në një anë jetojnë me ndjenjën kultivimit të kulturës, traditës dhe arsimit të tyre tradicional si dhe ballafaqimit të tyre me të arriturat civilizuese e teknologjike perëndimore, në anën tjetër. Shikuar në një perspektivë afatgjatë, në kuadër të zhvillimeve bashkëkohore është vështirë të ketë ndarje parçiale. Të gjithë jemi në të njëjtën anije. Tash e tutje, edhe po të dëshirojë dikush, e ka shumë vështirë të dalë nga kjo anije. Na mbetet vetëm mundësia që njëri-tjetrin, vetëm me anën e argumenteve, njohurive dhe dijes, ta bindim për kahjen që besojmë se është më e drejtë.

Shtrohet pyetja: Si t'u përgjigjemi këtyre sfidave? Kjo nuk është çështje e lehtë dhe as e thjeshtë. Kur është fjala për edukimin dhe arsimin, shqiptarët gjenden para sfidave specifike. Hyrja në integrimet evropërendimore do të thotë hyrje në sistemin e vlerave të reja, hyrje në botën e re. Për këtë është obligim i të gjitha institucioneve tona edukativo-arsimore që ky transicion të kalojë pa pasoja të mëdha për shoqërinë tonë dhe pjesën më të ndjeshme të saj, që është rinia. Proceset më të ndjeshme dhe më të ndërlikuara do të jenë ato në sistemin edukativo-arsimor, dhe se për rindërtimin e Kosovës rol vendimtar do të ketë edukimi dhe arsimi.

Edukimi dhe arsimimi fetar në ndryshimet e reja shoqërore, politike dhe në rrethanat e reja, Bashkësinë Islame do ta sjellë para mundësive dhe sfidave të reja.

Për këtë arsye duke u mbështetur në vetë emrin e EDUKATËS ISLAME, ajo do të marrë përsipër çështjen e edukimit dhe arsimimit islam, si një prej prioriteteve të saj. Prandaj u bëjmë apel të gjithë bashkëpunëtorëve tanë që kjo temë dhe temat që kanë të bëjnë me të të jenë preokupim i vazhdueshëm i tyre, sepse vetëm në këtë mënyrë EDUKATA ISLAME do të jetë në gjendje ta kryej misionin e saj.

Tri dekada të revistës “Edukatës Islame”

Më 2 maj 2002 në sallën e Bibliotekës Universitare të Kosovës në Prishtinë u organizua një manifestim me rastin e tridhjetëvjetorit të daljes së revistës “Eduakta Islame”. Në manifestim morën pjesë një numër i madh i intelektualëve të sferave të ndryshme, të institucioneve arsimore të Kosovës si dhe shumë të rinj e të reja të Universitetit të Prishtinës, shumë dashamirët e fjalës së shkruar si dhe përfaqësues të mjeteve të informacionit, të atyre elektronike dhe të shkruara.

Me këtë rast me kumtesa u paraqitën katër anëtarë të redaksisë, kurse fjalën e rastit në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës Dr. Rexhep ef. Boja e lexoi Sabri ef. Bajgora, kryeimam i Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ndërsa me kumtesa të veçanta rreth rritës dhe zhvillimit të revistës “Edukata Islame” u paraqitën z. Qemajl Morina, kryeredaktor me temën: *“Rrita dhe zhvillimi i revistës Edukata Islame 1971-2001”*; akademik Jashar Rexhepagiqi, anëtar i redaksisë me temën: *“Vlera arsimore dhe edukative e revistës Edukata Islame”*; akademik Pajazit Nushi, anëtar i redaksisë, me temën: *“Teknologjia islame në gjuhën shqipe dhe revista “Edukata Islame”* dhe Hajrullah ef. Hoxha, anëtar i redaksisë me temën: *“Roli i Edukatës Islame në aspektin fetar”*.

Të gjitha kumtesat po i botojmë në vazhdim.

Edukata Islame e kreu me sukses misionin e saj

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës me rastin e shënimit të 30-vjetorit të revistës “Edukata Islame”, mbajtur në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës më dt. 02.05.2002

ن. و القلم و ما يسطرون

“Nun, betohem në penën dhe në atë çka shkruajnë”.

Vëllezër të nderuar, zonja dhe zotërinj !

Jemi tubuar sot për të shënuar 30-vjetorin e daljes së revistës së parë të botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës – “Edukata Islame”. Ndoshta 30 vjet nuk janë edhe aq shumë, sa të meritojnë të shënohen, por kur të kihet parasysh koha nëpër të cilën kaloi kjo revistë si dhe rëndësia që ka fjala e shkruar në ngritjen e vetëdijes në përgjithësi, mendojmë se *Edukata Islame* këtë e meriton. Prandaj, kam kënaqësi të veçantë që, në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe në emrin tim t’ju përshëndes dhe t’ju falënderoj për pjesëmarrje.

Ç’është e drejta, gjendja robëruese nëpër të cilën kaloi Kosova gjatë shekullit të fundit dhe sistemit komunisto-ateist, i cili asgjësonte gjithçka që ishte islame, ndikuan në masë të madhe në krijimin e një boshllëku në rrjedhat e gjithmbarshme shoqërore e në veçanti të kulturës dhe arsimit fetar. Këtë boshllëk e bënë edhe më të madh ndalimi i fesë në Shqipërinë komuniste, e cila deri atëherë kishte krijuar një traditë në rrafshin e fjalës së shkruar të proveniencës islame. Në vetëdijen e popullatës shqiptare me vite të tëra, në vazhdimësi e

kontinuitet, u imponua doktrina ateiste, e cila kishte një qëllim të vetëm – zhdukjen e ndjenjës fetare islame të pjesës më të madhe të kombit tonë. Megjithatë, pavarësisht nga vështirësitë, ylemaja jonë arritën t'i bëjnë ballë deri diku sfidës ateiste. Madje, ylemaja jonë, duke pasur besim të plotë në kuadrin ekzistues dhe duke e vlerësuar lart rëndësinë e fjalës së shkruar, të tubuar pranë Shoqatës së Ylemave, në vitin 1971, morën një iniciativë mjaft të qëlluar, botimin e revistës “Edukata Islame”, e cila gjatë shtegimit të saj për tridhjetë vjet, krahas medresesë së mesme “Alauddin”, do të luajë një rol mjaft me rëndësi në ngritjen e vetëdijes fetare e kombëtare. “Edukata Islame” ia doli që mendimin e saj islam dhe shkencorë ta plasojë edhe më larg përmes fjalës së shkruar dhe duke qenë një revistë e hapur dhe transparente, vazhdimisht ishte e admirueshme për lexuesit e saj.

Në vitin e tridhjetë jubilar të “Edukatës Islame”, si të vetmën revistë që e patëm deri më 1986, kur filloi të botohej edhe simotra e saj *Dituria Islame*, jemi të kënaqur që kemi arritur të afirmojmë këtë revistë serioze, këtë tribunë të vërtetë.

Me këtë rast, me kënaqësi do të theksoja punën e palodhshme të të gjithë bashkëpunorëve, pa kontributin e të cilëve Edukata nuk do ta kishte fizionominë që ka. Për përmbajtjen dhe jetën e Edukatës, kontribut të pazëvendësueshëm kanë dhënë sidomos kryeredaktorët e saj, e me këtë rast do ta veçoja sidomos h.Sherif Ahmetin, i cili mbi supet e veta për një kohë të gjatë barti barrën e revistës dhe e udhëhoqi me mjaft sukses – Allahu e shpërbëleftë!

Vëllezër të nderuar, dashamirë të fjalës së shkruar !

Kryesia e BI të Kosovës shpreson se edhe në të ardhmen përmes revistës suaj dhe tonës, do të shprehim besnikërisht shpirtin e Islamit burimor, do të ngjallim ndër lexuesit ndjenjat e larta fetare, shoqërore, vllazërore dhe atdhetare. Shpresojmë se, me ndihmën e Allahut, me përkrahjen e parezervë të bashkëpunëtorëve dhe lexuesve, ne do të vazhdojmë të jemi besnikë të çështjes fetare e kombëtare. Allahu i Gjithëmëshirshëm na ndihmoftë që amanetin tonë ta kryejmë me nder e përgjegjësi.

Duke Ju falënderuar edhe një herë për kohën që keni rezervuar, Ju përshëndes vëllazërisht.

Ju falemnderit!

Qemajl Morina

Rrita dhe zhvillimi i revistës Edukata Islame 1971-2001*

Feja islame është fe e diturisë, shkencës, fe e arsyes dhe e dialogut. Kur’ani, libri i shenjtë i muslimanëve, në përmbajtjen e tij, përveç të tjerash ka dy komponente tejet të vlefshme, të cilat janë shumë të rëndësishme jo vetëm për muslimanët, por edhe për mbarë njerëzimin. Ajeti i parë i Kur’anit na urdhëron me fjalën: اقرأ që në gjuhën shqipe do të thotë: “Lexo”! “Mëso”, “Studio”, “Hulumto”, etj.

Në anën tjetër, po në Kur’anin famëlartë kemi një kaptinë të tërë me emrin القلم “Lapsi”. Por, edhe më tepër, Allahu i madhërishtëm u betua në lapsin, në ajetin e parë të kësaj kaptine me fjalët:

ن. والقلم وما يسطرون “*Nun. Betohe me në lapsin dhe në atë çka shkruajnë*”. (68: 1).

Me këtë kuptojmë se feja Islame e respekton diturinë së bashku me dijetarët aq shumë, sa që e ka vendosur në një nivel të njëjtë me adhurimin. Islami është i interesuar për çdo lloj edukimi, veçanërisht për atë shpirtëror dhe moral. Ai kërkon mundësinë e edukimit të varfrit dhe të pasurit, pa ndonjë dallim klasor.

Ai e obligon çdo musliman, qoftë mashkull ose femër, të kërkojë diturinë dhe të fitojë një edukatë të lartë. Se muslimani dhe muslimani duhet të dinë shkrim-leximin, shembulli më i mirë është kur Pejgam-

beri a.s., pas betejës së Bedrit, i liroi nga robëria të gjithë ata idhujtarë, të cilët ua mësonin shkrim-leximin dhjetë muslimanëve.

Shkollat, xhamitë, institucionet edukative, bibliotekat, si për letërsi ashtu edhe për shkencë, kanë qenë të hapura për ata që e donin diturinë, studimin dhe hulumtimin. Shteti islam kishte marrë përsipër furnizimin me ushqim të nevojshëm, banesa, shërim mjekësor, ndihma financiare si dhe sigurimin e librave falas për t'i aftësuar studentët në kërkonin dituri.

Nuk e teprojmë nëse themi se principet e edukimit modern, të cilat janë proklamuar nga mesi i shekullit XX, asnjë shtet i përparuar nuk i ka zbatuar, ato kanë qenë të observuara dhe të praktikuar në edukimin islam gjatë periudhës së tij të artë, qindra vjet më parë se të formohej edukimi modern.¹

Ndër idealet e edukimit islam kanë qenë ushtrimi për pavarësinë dhe vetëbesimin, si dhe liria e barabarësia.

Për këtë Perëndimi dhe banorët e tij u kanë shumë borxh arabëve dhe muslimanëve. Shkencat e arabëve dhe të muslimanëve, si dhe civilizimi, kanë patur një ndikim të madh mbi renesansën evropiane moderne. Mësimi dhe kultura arabe, civilizimi islam dhe artet e Lindjes kanë depërtuar në Evropë gjatë periudhës së errët.²

Duke u mbështetur në burimet e sipërpërmendura, muslimanët, në të gjitha periudhat e jetës së tyre, i kushtuan rëndësi të veçantë arsimit në përgjithësi dhe njohjes së normave të fesë së tyre në veçanti.

Këtë e bënë edhe të parët tanë prej momentit kur ata përqafuan fenë islame. Këtë më së miri e vërtetojnë veprat e shumta që ata jo vetëm në gjuhën e tyre amtare, por edhe në gjuhë të tjera.

Nevoja e thellimit të njohurive fetare të besimtarëve shqiptarë e kishte shtyrë Këshillin redaktues t'i hynte kësaj pune sa me përgjegjësi, po aq të vështirë. Kështu vërejmë se në numrin e parë³ të "Edukatës Islame" në faqen e fundit të saj në artikullin me titull: "Thirrje për bashkëpunim", pëveç të tjerash thuhej: "Të dashur lexues!

Sigurisht e dini se sa ndihet nevoja për botimin e një reviste të thjeshtë në gjuhën shqipe, e cila do të parashtroj mësimet, edukatën

¹ Muhamed Atije El-Ibrishi, *Edukata në Islam*, f. 5.

² *Ibid*, f. 7.

³ *Edukata Islame*, nr. 1, viti i parë 1971, f. 56.

dhe kulturën islame. Hoxhët – mësuesit shqiptarë asnjëherë më parë nuk patën fat për të mësuar në gjuhën e vet amtare. Ata, mësuan dhe shprehën predikimin e tyre në gjuhët e huaja. Disa prej tyre edhe shkruan por në gjuhë joamtare. Tani arsimimi në gjuhën amtare na e bëri të mundshme që të shkruajmë mbi besimin Islam në gjuhën amtare”.

Këshilli redaktues më tutje shpjegon nevojën për revistë të tillë me këto fjalë: “Megjithëse gjer më tani në gjuhën shqipe është botuar me makinë shtypëse, revista me emrin “Buletin”, por se duke marrë parasysh thjeshtësinë e saj të tepërt, e cila nuk i përgjigjet kushteve dhe kërkesave të jetës bashkëkohore; Këshilli ekzekutiv i shoqatës Ilmije në mbledhjen e vet të datës 02.03.1971 vendosi që këtë revistë ta pagëzojë me emrin “Edukata Islame” dhe ta botojë në shtyp duke ia ndërruar formën dhe përmbajtjen e mëparshme”.

Këshilli redaktues po ashtu bënte apel për ndihmë: “Pra, për hir të atyre besimtarëve, të cilët kanë nevojë me u njoftë me parimet esenci-ale të besimit Islam, Këshilli redaktues thërret të gjithë ata që kanë mundësi të na ndihmojnë; të na ndihmojnë për pasurimin e kësaj reviste me materiale sa më të mira, e cila është e vetmja që botohet në gjuhën shqipe për të gjithë shqiptarët në Jugosllavinë Socialiste, të cilat i takojnë besimit islam.

Bashkëpunëtorët tanë do të na dërgojnë material me karakter fetar, të cilin munden me marrë edhe nga “Gllasniku”, “Preporodi” e “Zem-zemi”, duke përkthyer në shqipet dhe të shtypur me makinë. Brenda mundësive është mirë që materiali të bëhet në gjuhën e unisuar”.

Në fund, Këshilli redaktues u drejtohej lexuesve me këto fjalë:

“Lexues të ndershëm! Gjithashtu, ju lutemi që të na ndihmoni për afirmimin dhe popullarizimin e kësaj reviste fetare sa më tepër ndër besimtarët, duke përfutur një numër sa më të madh lexues dhe parapagues. Për arsye se ky është i vetmi kusht, i cili e garanton vazhdimin e botimit të kësaj reviste modeste në të ardhmen”.

Kështu para plot tridhjetë vjetësh (më 1971) zuri të botohej revista “Edukata Islame”, si revistë e parë islame në Kosovë, me iniciativën e mulla Sherif Ahmetit, si organ i Shoqatës së Ulemave, me të cilën edhe iu vu themeli i periodikut dhe publicistikës islame kosovare.

“Edukata Islame” tribunë e mendimit islam

Është e madhe, prandaj, rëndësia kulturore-arsimore e posaçërisht ajo edukative e kësaj reviste, natyrisht po qe se vështrohet në kontekst të rrethanave të kohës, të fillimit të viteve shtatëdhjetë, kur qe marrë vendimi për botimin e revistës. Vetë ideja për botimin e revistës ishte më shumë dashje dhe vullnet i mirë sesa mundësi me ndonjë mbështetje reale në potencialet dhe kuadrot e asaj kohe. Megjithatë, fillimi i daljes së revistës “Edukata Islame” do të shënojë fillimin e një epoke të re të publicistikës islame në Kosovë. Me gjithë vështirësitë dhe sfidat me të cilat u ballafaqua gjatë këtyre tridhjetë vjetve të kaluar, ajo arriti jo vetëm të mbijetonte, por edhe të trasonte rrugën e saj duke tubuar rreth vetes një numër të konsiderueshëm dashamirësh të fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe jo vetëm në Kosovë, por edhe në trojet e tjera shqiptare. Ajo ishte tribunë e shprehjes së mendimit islam. Prandaj, me plot të drejtë, sot mund të thuhet se “Edukata Islame” gjatë këtyre tridhjetë vjetve ishte histori e gjallë e kulturës sonë islame. Ajo është kronikë e jetës sonë shpirtërore. Për këtë arsye, çdo hulumtues e studiues i zhvillimit të jetës islame në këto troje, e ka vështirë ta bëjë atë pa iu referuar “Edukatës Islame”.⁴

Revista “Edukata Islame” kontriboi që fjala e shkruar islame në Kosovë të mos mbetet monopol vetëm i saj, por me kalimin e kohës filluan të shihnin dritën dhe botime të tjera të veçanta, ndërsa në vitin 1986 zunë të botoheshin edhe revista e përmuajshme “Dituria Islame”, “Drita e Kur’anit”, “Zgjimi islam” etj.

Me kalimin e kohës, rritej edhe numri i bashkëpunëtorëve të rinj. Sa për ilustrim, po përmendim se në numrin e parë të “Edukatës Islame”, autorët të shkrimeve ishin nxënës të medresës së mesme “Alauddin” në Prishtinë.⁵

Kjo dëshmon për vizionin e kryeredaktorit të atëhershëm të revistës, i cili dëshironte që në shkrimet e revistës të merrnin pjesë edhe penat e reja.

⁴ Edukata Islame, nr. 65, f. 6.

⁵ Abdulfetah Kadriu, Butësia dhe mëshira e Ymerit të Hatabit (f. 48), dhe Qemajl Morina, Kushtuar ditëlindjes së Muhamedit a.s. – poezi, f. 32.

Edhe pse në fillim zotëronin kryesisht përkthimet nga gjuhë të huaja e në mënyrë të veçantë nga boshnjakishtja, siç ishin revistat “Gllasnik”, “Preporod” etj., pati edhe përkthime nga gjuha arabe e më vonë dhe nga anglishtja. Por, nuk ishin të pakta temat origjinale nga autorë shqiptarë. Kështu revista nga numri në numër zgjeronte tematikën, shtonte bashkëpunëtorët, ngrinte cilësinë e materialeve, shtonte vëllimin e përgatitjen teknike, gjuhësore e estetike.

Meritë kryesore për këtë ka pasur redaksia me redaktorin përgjegjës mulla Sherif Ahmetin në krye, për dy dekada të tëra (deri në vitin 1987) (nr. 49).

Përmbajtja kryesore ka qenë ajo fetare, duke pasur për bosht komentimin e librit të shenjtë, Kur’anit, jetën e të dërguarit Muhamed (a.s.) dhe historinë islame. Dhe kjo me studime origjinale dhe përkthime.

Angazhimi i bashkëpunëtorëve ka qenë i përkushtueshëm. Ata kanë qenë autoritete fetare, pedagogë në medrese, intelektualë, nxënës të medresesë, studentë në universitete të ndryshme islame.

Revista nuk kishte rubrika të veçanta që udhëhiqeshin nga njerëz të caktuar, por ato plotësoheshin sipas materialeve. Kishte raste kur një autor paraqitej në disa rubrika.

Cilësia dhe brendia e revistës vazhdimisht vinte e përmirësohej. Shtoheshin numri i faqeve dhe i bashkëpunëtorëve. Ajo u bë një tribunë e edukimit shpirtëror, e pasqyrit të veprimtarive fetare islame në vendin tonë dhe në botë. Në faqet e saj pasqyrohej ideja e tolerancës dhe e mirëkuptimit, interesat kombëtare vireshin gjithnjë në plan të parë dhe lidheshin ngushtë me luftën për gjuhën, kulturën, traditat e identitetin kombëtar. Në numrat e revistës ka pasur shkrime origjinale, përkthime e përshtatje, studime e artikuj të karakterit fetar, filozofik, moral, shoqëror, kulturor e historik, portrete personalitetesh, përkujtime ngjarjesh, kronikë veprimtarish.

Lexuesit tanë të nderuar të fjalës së shkruar islame, vitet e fundit e kanë ndier mungesën e “Edukatës Islame”, për shkak të organizimit të ri në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Mirëpo, nuk ishte e udhës që kjo të reflektonte në dëm të revistës sonë të vetme islame me një traditë tridhjetë vjeçare. Ky do të ishte një mëkat shumë i madh që do të bënte ky brez në hak të saj dhe përgjithësisht të fjalës së shkruar

islame. E sotmja dhe e ardhmja nuk mund të ndërtohen pa u mbështetur në të kaluarën.

“Edukata Islame” e pa dritën dhe rritën e saj në kohën më të vështirë, atëherë kur komunizmi ishte në kulmin e fuqisë dhe ajo mbijetoi, siç thamë, falë vullnetit dhe përpjekjeve të atij grupi të vogël, por që kishin besim të plotë se fjala islame e shkruar shqip megjithatë do të triumfoje. Vetëmse duhej prituri. Dhe koha e dëshmoi se ata patën të drejtë.

Duke u nisur nga këto parime, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në një nga mbledhjet e saj të fundit vendosi të marrë përsipër botimin e “Edukatës Islame” për çdo tre muaj. Me këtë ajo dëshiron që fjala e shkruar islame të ketë peshën e saj, sepse ky është misioni i saj dhe përgjegjësia ndaj besimtarëve dhe dashamirëve të fjalës së shkruar islame në Kosovë dhe më gjerë në hapësirën shqiptare.

Duke u nisur nga kjo përgjegjësi, Kryesia e Bashkësisë Islame, që nga numri jubilar i “Edukatës Islame” me rastin e tridhjetëvjetorit të daljes së saj, emëroi redaksinë e re. Në të ka akademikë, profesorë universiteti dhe përgjegjës të institucioneve tona me rëndësi kombëtare. Kjo është një nismë e mbarë, që do të thotë se Bashkësia Islame është e hapur dhe se ajo u takon të gjithë atyre që dëshirojnë dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë me të. Aty ka vend për të gjithë dhe secili duhet ta japë kontributin e vet. Prandaj, shfrytëzojmë nga rasti që t’u bëjmë apel të gjithë atyre që kanë mundësi të japin kontributin e tyre, të na shkruajnë që revista “Edukata Islame” të bëhet vërtet tribunë e të gjithëve, tribunë e fjalës së shkruar të shkencës, kulturës dhe edukatës islame.

Njerëzit vdesin, ngjarjet harrohen, objektet sado të mëdha qofshin, i shkatërron dhëmbi i kohës. Mbetet vetëm fjala e shkruar si dëshmi e kontributit dhe përpjekjeve të njeriut për kryerjen e misionit të tij në këtë botë kalimtare.

Duke shënuar përveçtorin e tridhjetë të “Edukatës Islame”, kemi nderin që lexuesve dhe studiuesve tanë t’u prezantojmë bibliografinë e saj. Në të është publikuar e gjithë lënda e botuar në revistë për këtë tridhjetë vjet (1971-2001) sipas standardeve bahkëkohore, kështu që të jetë sa më e lehtë për t’u përdorur nga të gjithë si burim informacionesh e të dhënash konsistente.

Me rastin e këtij përvjetori të botimit të revistës “Edukata Islame”, ne shprehim nderimin, vlerësimin e mirënjohjen për drejtuesit e bashkëpunëtorët, për të gjithë ata që kanë kontribuar për krijimin, përhapjen e zhvillimin e publicistikës islame si dhe urojmë që organet e tanishme në gjuhën shqipe kudo që botohen të ndjekin traditën e krijuar e ta pasurojnë atë me arritje të reja për të mirën e kulturës islame, të Kosovës e të kombit shqiptar.

Ndërsa në redaksinë e re bie përgjegjësia për ta pasuruar edhe më shumë në aspektin përmbajtësor dhe për ta ngritur në nivelin teknik, që ta arsyetojë emrin që mban dhe që lexuesit të gjejnë në tërë atë që dëshirojnë.

Zoti i madhërishëm na ndihmoftë në misionin tonë të shenjtë.

Akad. Jashar Rexhepagiq

Vlera arsimore dhe edukative e revistës “Edukata Islame”

Nga vetë titulli, në veçanti nga përmbajtja e kësaj reviste shkencore e kulturore islame, rrjedhin vlerat dhe rëndësia e saj pedagogjike, respektivisht edukativo-arsimore.

Duke analizuar gjithë ata numra të revistës, nga viti 1971 gjer më tani, dallojmë disa përmasa dhe veçori të “Edukatës Islame”.

Veçoria e parë e revistës është se këtu janë përfshirë tema fetare islame, të cilat gjer në vitin 1992 ishin kryekëput të këtij karakteri, që e dëshmon edhe titulli i revistës, i shoqëruar me këto fjalë: *Edukata islame*, revistë fetare tremujore. Nga viti 1992 deri më 1998 kjo qe “revistë fetare, shkencore e kulturore”. Edhe gjatë kësaj periudhe kishte epërsi problematika e fesë, ndërsa në vitin 2001 (nr. 65) dhe 2002 (nr. 66) titullohet “revistë shkencore, kulturore, islame”. Po t’i krahasojmë këto tri etapa, në të parën (revistë fetare), në të dytën (revistë fetare, shkencore e kulturore) dhe në të tretën (revistë shkencore, kulturore islame), do të vërejmë dallime thelbësore. Cilësi e përbashkët e revistës, gjatë këtyre tridhjetë vjetve, është se ajo u përqendrua, në fillim totalisht, pastaj në pjesën më të madhe, dhe në këta dy vjetët e fundit pjesërisht, në caqet e fesë islame. Arsyet janë të shumta, mirëpo ato më kryesoret ishin – se tek ne, burimet themelore dhe disiplinat islame, si *Kur’ani*, sidomos *Kiraeti* (leximi i drejtë i Kur’anit) e *Tefsiri* (komentimi i Kur’anit), po ashtu *Akaidi* (shkenca mbi besimin),

mandej *Hadithi* (burim i dytë kryesor fetar e juridik i Islamit, që përfshin thëniet dhe propozimet e Muhamedit dhe punën e tij), si dhe *Fikhu* (e drejta e Sheriatit) dhe *kultura e qytetërimit islam*, nuk ishin të zhvilluara në nivelin e duhur, po edhe shumë kohë, gati fare pak të studiuara. Në gjuhën shqipe mungonte edhe terminologjia adekuatë në fushën e të mësuarit islam.

Në veçanti, trashëgimia jonë pozitive islame, për dekada të tëra, që lënë pas dore, por shpeshherë edhe që ndaluar nga organet zyrtare. Një qëndrim ekskluziv, mohues, mbizotëronte shumë kohë edhe ndaj historisë, filozofisë e shkencës së botës lindore islamike. Përkitazi me këtë, dr. Safvet-beg Bashagiq (1870-1934), orientalist, letrar, historian dhe përkthyes, në disertacionin e tij ("Boshnjakët dhe Hercegovasit në letërsinë islame", Sarajevë 1912), në fq. 172, pos të tjerash thotë: "Në shekullin njëzet feja nuk duhet të bëjë dallime; arsimi është arsim, ngado që të vijë, nga Lindja ose nga Perëndimi".

Veçori e dytë e revistës janë *temat me karakter edukativo-arsimor*. Në "Edukatën Islame" gërshetohen gjithnjë e më shumë përmbajtjet fetare me ato filozofike, shkencore, letrare, historike, dhe sidomos me tekste të karakterit pedagogjik. Edhe ato tema që më tepër i takonin të mësuarit teorik islam, veçanërisht doktrinës fetare islame, po ashtu kanë domethënie edukativo-arsimore, etike etj. Vetëm analiza e shkri-meve nga Tefsiri (shkenca për shpjegimin dhe komentimin e Kur'an-it), siç janë komentimet e ndonjë ajeti dhe sureje, sidomos ato nga shkrimtari dhe alimi i dalluar h. Sherif Ahmeti (1920-1987), dëshmon se sa të dobishme janë ato kontribute, posaçërisht në aspektin edukativ. Në disa tema të tjera vërehet edhe më shumë lidhja e ngushtë në mes fesë dhe edukatës islame. Në numrin e fundit të revistës, i këtij karakteri është teksti me titull "Roli i fesë në edukimin e rinisë", ndërsa në numrat e mëparshëm përpunohen këto tema, në esencë pedagogjike dhe të karakterit etik: Problemi i prapambeturisë së përgjithshme: Detyra e prindërve ndaj fëmijëve; Mirësjellja ndaj prindërve; Lufta e Islamit kundër besimeve të kota dhe bestytnive...; Urdhri për të mirë dhe ndalimi nga e keqja; Bujaria; Shkollimi-arsimimi i femrës dhe Islami; Njeriu, Islami dhe detyrat e tij; Puna për të mirën e përgjithshme etj.

Vetë titulli i botimit periodik – "Edukata Islame", na detyron që çdo numër të përmbajë, para së gjithash, artikuj, studime e kontribute

të tjera nga fusha e edukatës. Ato punime nuk janë të ndara nga shkencat, filozofia e kultura islame, as nga njohuritë dhe rezultatet e shkencave të ndryshme dhe të mbërrimet pedagogjike në botë. Gjer më tani në literaturën pedagogjike dhe në shkencën për edukatën, në veçanti për shkak të devijimeve ideologjike, ishte e pamundur të shfrytëzoheshin dhe të inkorporoheshin edhe përvojat shekullore nga bota lindore dhe mësimet islame. Madje në literaturën evropiane pedagogjike pothuajse nuk përmenden as të dhëna, as shpjegime, as këshilla të shumta, që janë edhe shkencërisht të vërtetuara dhe pa dyshim të rëndësishme në veprimtarinë edukative.

Revista “Edukata Islame”, si revistë shkencore, merret edhe me temat pedagogjike-andragogjike, që mund të inkorporohen plotësisht edhe në cilëndo revistë tjetër pedagogjike. Ja disa tituj të tillë: *Si duhet ligjëruar: Shkollat fetaro-filozofike në fenë Islame; Lexo, është çelës i kulturës së lindjes dhe perëndimit, nuk është helm për njerëzimin*. Në numrin e fundit të vitit 2002 u botua edhe studimi: *Arsimi për paqe, tolerancë dhe bashkëpunim ndërkombëtar*, me siguri një tematikë që është hulumtuar fare pak në shkencën e pedagogjisë. Me interes është punimi, i botuar po në këtë revistë më 1992, me titull: *Arsimi dhe shkollat islame në kohën e Halifetit*. Do të përmendim edhe punimin në dy vazhdimë, me titull: *Medreseja “Gazi Isa beg” – institucion arsimor me seli në Shkup prej 1939-1941*. U botua më 1979. Dallohet edhe një vështrim pedagogjik, të cilin revista e botoi më 1978. Titulli i tekstit është: *Mendimi i imam Gazaliut lidhur me edukatën dhe arsimin*. “Edukata Islame” në vitin 1976 kishte një vështrim të vëllimshëm për veprimtarinë e Medresesë së Prishtinës (me rastin e 20-vjetorit), tematikë me shënime për historikun e kësaj shkolle. Për medresenë e mesme “Alauddin” revista edhe më vonë do të botonte të dhëna konkrete dhe disa vështrime me vlerë historiko-pedagogjike. Në vitin 1998 revista publikoi edhe *Bibliografinë e botimeve të medresesë së mesme “Alauddin” të Prishtinës (1969-1998)*.

Revista ka edhe një përkthim kushtuar Universitetit më të vjetër në botë Al-Az-har, i cili u themelua më 972 në Kajro dhe u takon universiteteve më të mëdha dhe më të njohura në Botën Islame.

Vlerë arsimore dhe shkencore në veçanti kanë edhe titujt kushtuar *tematikës historike*, posaçërisht dokumentet origjinale dhe shqyrtime

për historinë e Kosovës, të popujve të Ballkanit e më gjerë. Dallohet në këtë pikëpamje *Kronika e Tahir efendiut* si burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren, gjatë periudhës osmane. Kjo kronikë me mbi 50 fq. u botua më 1995. Me interes shkencor dhe historiko-kombëtar janë edhe disa tema historike, si ajo për aktivitetin e Komitetit të Stambollit (më 1990), për projektin e Sami Frashërit, kushtuar riorganizimit të vilajeteve në Perandorinë Osmane (më 1995). Në një numër të vitit 1990 dallohet teksti për rëndësinë e historisë së Mehmed Neshriut dhe Idriz Bitlisit për historiografinë ballkanase. Me shumë shënime të sakta karakterizohet edhe artikulli për Shejh Abdul malik ef. Hilmin, do të thotë për Hilmi Malen. Teksti u botua më 1979. Vlerë historike-kulturore ka sidomos një tekst i botuar në nr. 66/2002 me titull: “Kultura islame në Spanjë ishte burim i dritës për Evropën mesjetare”. Në të njëjtin numër është edhe shqyrtimi historik i Betejës së Kosovës (1389), si dhe një studim solid që merret me rolin e Sari Salltëkut, në përhapjen e Islamit në trojet iliro-shqiptare e ballkanike para shekullit XIV (Po aty, nr. 66/2002). Ndër tema historike shquhet për nga karakteri origjinal, thellësia e interpretimit dhe njohuria shkencore, studimi: *Prejardhja dhe vendosja e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan...*, që u botua më 2001.

“Edukata Islame” ka material të pasur për jetën e punën e profetit Muhamed, një artikull për shiinjte, një për Tesawwufin, shkruar në baza solide teorike. Ka edhe vlerësime kritike e objektive për kontributin e ndonjë shkencëtari ose mendimtari të vjetër islam. Edhe nga disiplina të tjera shkencore (p.sh. gjeografia, sociologjia, etika), nga teknologjia etj., në këtë botim periodik shtrohen çështje të ndryshme, sidomos që janë më pak të njohura dhe aktuale, siç janë: *Tesawwufi në vendin tonë* (1979, autor Sherif Ahmeti), *Femra në Kushtetutën islame* (1981), *Jeta fetare në Kosovë* (1972), *Studime historike islame* (1981, autor dr. Muhammed Umer), *Kur’ani dhe shkenca* (1979), *Kur’ani – kryevepër e letërsisë arabe* (1980-81), autor dr. Hasan Kaleshi), *Bibla, Kur’ani dhe shkenca* (1979), *Mësim-besimi në Kosovë dhe shembuj të tjerë*. Disa nga këto mund të shtrohen edhe më gjerë në formë veprash monografike, disertacionesh e të tjera.

Pos studimeve, artikujve, përktihimeve dhe kontributeve më të vogla, me të cilat “Edukata Islame”, jepte guxim për njohri të reja shke-

ncore dhe vlere universale, të domosdoshme, sidomos njeriut të sotëm, në revistë disa autorë janë marrë edhe me probleme më të ngushta, më konkrete dhe me tematikë nga vende të ndryshme. Ja disa shembuj të këtillë: *Jeta fetare në Dobrosin të Bujanovcit* (1977), *Mevludi në Petnicë të Ivangradit* (1978), *Mësuesja-Mualimja e sjellshme Hava Ismaili* (1979), *Jeta fetare në Lubinë të epërme* (1972) etj.

Deri tash në Kosovë, po edhe në Shqipëri, nuk patëm shumë revista dhe gazeta edukative, shkencore e kulturore islame. Në gjuhën shqipe e para ishte “Kultura islame”, që botohej në Tiranë, në vitet 1940-1944. Pas “Edukatës Islame” (që filloi të dalë më 1971), filluan të botoheshin: Dituria Islame, në Prishtinë, nga viti 1986, *Hëna e re*, në Shkup, nga viti 1987, *Elif*, në Podgoricë më 1990, *Drita islame*, në Tiranë, në vitet 1993-1996, revista *Perla*, në Tiranë, nga viti 1996 dhe një buletin lajmesh *Qytetërimi islam*, i cili sheh dritë nga viti 1997 në Tiranë.

Duke analizuar sidomos përmbajtjet e saja edukativo-arsimore, mund të thuhet se në “Edukatën Islame” shqyrtohen, gjithnjë më me përkushtim, ide, synime dhe tema të reja, më pak të njohura dhe të studiuara në mësimet islame dhe në fusha të tjera të shkencës e kulturës njerëzore, por që kanë rëndësi dhe vlerën pedagogjike, etike, historike, filozofike, etnike, e ashtu fetare, letrare, kulturore dhe universale, pra multidimensionale.

Pos temave fetare, edukative, filozofiko-etike, kulturore-historike, aty-këtu nga letërsia, psikologjia, gjuha dhe nga fusha të tjera të shkencës, kemi shpresë se “Edukata Islame”, në radhë të parë për arsye të cilësisë së lartë të revistës, por duke u mbështetur në qëllimet arsimore e kulturore, do të kultivojë edhe disa rubrika të reja dhe, do të thosha, të domosdoshme, që janë:

- Medresetë dhe universitetet më të njohura islame (nga një institucion në çdo numër),

- *Shtetet muslimane, shkenca dhe kultura e tyre* (nga një shtet),

- *Institucionet më të vjetra islame në Kosovë, në Ballkan e në botë – xhamitë, teqetë, tyrbet etj.* (minimum nga një institucion në çdo numër), si dhe rubrika

- *Kronika e librave të rinj.*

Urojmë që “Edukata Islame”, në të ardhmen, të ketë edhe më shumë rezultate, si fetare, ashtu edhe edukative, shkencore e kulturore.

Prof. dr. Pajazit Nushi

Teknologjia islame në gjuhën shqipe dhe revista “Edukata Islame”

Literatura islame në gjuhën shqipe ka përmasa shtrirëse të hershme. Qysh nga fillet e botimit të saj në periudhën osmano-shqiptare deri në kohën më të re, literatura islame në shqipe ka shënuar zhvillim dhe ngritje të vazhdueshme të cilësisë së saj, ndonëse ritmet e këtij zhvillimi dhe të ngritjes cilësore të saj kanë ndryshuar gjatë procesit zhvillimor të shqiptarëve dhe të fesë islame të tyre. Në këtë proces zhvillimor të literaturës islame, u zhvilluan të gjitha gjinitë e literaturës. Kjo literaturë ka strukturë të ndërlikuar formësuese. Këtu dallojmë publicistikën (gazeta), periodikun (revista) dhe literaturën në kuptimin e ngushtë, të cilën e përbëjnë librat islamë dhe gjuha librore e tyre. Literatura islame dhe struktura e këtillë e saj në rrjedhat zhvillimore të tyre ka qenë pjesë përbërëse e literaturës së përgjithshme shqipe dhe kryesisht ka ndjekur rrugën e zhvillimit të saj.

Mirëpo, në këtë pikëpamje ka përvijuar edhe një rrugë specifike të zhvillimit, e cila meriton një studim kompleks të veçantë. Rezultatet e disa gjurmimeve të literaturës islame dhe të rrugës e të faktorëve të zhvillimit të saj, sikurse janë rezultatet e gjurmimeve të Faik Lulit, Islam Dizdarit, Viron Kokës, dr. Ramiz Zekajt, Sherafedin Hoxhës, dr. Feti Mehdiut, dr. Ismail Ahmedit etj., tregojnë se gjurmimit të

zhvillimit të literaturës islame i duhet qasur në tërësinë e saj, pavarësisht se ku të jetë botuar, në Tiranë a Shkodër, në Prishtinë a Prizren, në Shkup a Tetovë, në Podgoricë a Ulqin, në Nju- Jork a Detroit.

Literatura islame shqiptare përbën një tërësi dhe kjo tërësi, mendoj, i ka mbajtur të lidhur dhe të bashkuar shqiptarët e Shqipërisë, të trojeve të ndara dhe të Diasporës, madje jo vetëm muslimanët, por edhe besimtarët shqiptarë të feve të tjera. Literatura fetare, sidomos literatura islame në gjuhën shqipe, ka pasur fuqi bashkuese më të madhe se literatura jofetare, posaçërisht ajo didaktike, shkencore dhe letrare e politizuar e fazave zhvillimore të shqiptarëve në shekullin njëzet, sidomos ajo e gjysmës së dytë të këtij shekulli. Për këto shkaqe pohojmë se literatura e përbashkët islame në gjuhën shqipe është thesar i përbashkët i kulturës kombëtare, mbi të cilin mund të studiohet zhvillimi i mendimit kombëtar, përgjithësisht, dhe i mendimit filozofik islamizmit ndër shqiptarët dhe më gjerë, veçanërisht. Kjo literaturë është bazë burimore për studime të zhvillimit të islamizmit ndër shqiptarët dhe të lidhjes e të raporteve kulturore e fetare të tyre me popujt e tjerë.

Nga këndvështrimi i kësaj tërësie mund të konstituohet edhe tekstologjia islame në gjuhën shqipe, e mbështetur në metodën e gjurmimit të tërësisë së dokumenteve dhe të monumenteve islame, të publikuara në publicistikën, në periodikun dhe në libra islamë të shqiptarëve. Kjo metodë mundëson hulumtimin e teksteve të botuara në gjuhën shqipe duke filluar prej teksteve të pesë detyrave shtyllore të secilit pjesëtar të fesë islame dhe duke ardhur deri në tekste mesazhesh të larta të Kur'anit e të Haditheve, të Fikhut dhe të diskursit shkencor të ri. Botimi i teksteve të këtilla të islamizmit në gjuhën shqipe ka hapur rrugën e zhvillimit të tekstologjisë islame në këtë gjuhë.

Tekstologjia islame në gjuhën shqipe nuk është vetëm bibliografi dhe kritikë letrare, ndonëse edhe këto kontribuojnë për zhvillimin e tekstologjisë islame. Tekstologjia islame është studim autentik i konceptuar dhe i shkruar në gjuhën shqipe, i formësuar në trajtë komentimi, dokumentimi dhe krijimi të pikëpamjeve dhe të qëndrimeve origjinale mbi çështjet e fesë islame. Tekstologjia islame në shqipe ka detyrë të gjurmojë saktësinë e përshkrimit të përmbajtjes fetare të botuar, të rrjedhës së mendimit islam të botuar në formë të përshkri-

mit, të gjurmojë shpjegimin e mendimeve të paraqitura në libra islame, përfshirë edhe shpjegimet plotësuese, të përcaktojë elementet origjinale të përshkrimeve dhe të shpjegimeve, saktësinë gjuhësore të përmbajtjeve të përkthyer dhe të mendimeve origjinale të formësuara dhe të shprehura në gjuhën shqipe, etj. Kontribute të këtilla hasim pak a shumë në, të thuash, të gjitha botimet islame në shqipe. Bazën e tyre e përbëjnë paraqitja në shqipe e teksteve të Kur'anit të madhërisëm dhe shpjegimi i tyre, mendimet e fjalët, shpjegimet, sjelljet, porositë dhe ndalesat e të madhit Muhamet a.s., që paraqiten në përkthimin e Haditheve në shqipe. Shkrime mbi këtë bazë hasim në rend të parë në përkthimin e Kur'anit e të Haditheve në libra të veçantë, po edhe në periodikun islam.

Shkrime të këtilla ka edhe në revistën shkencore kulturore “Edukata Islame”. Të gjitha këto botime islame dhe rrjedha gjithnjë më e madhe e më cilësore e tyre sot, përbëjnë atë që mund ta quanim “Biblioteka Islame e Gjallë e Shqiptarëve” në kuptimin e institucionit të veçantë libror, që ka të bëjë drejtpërdrejt me jetën, me mendimin, me ndjenjat dhe me motivet e njerëzve të nacionalitetit shqiptar.

Çfarë është vendi i revistës “Edukata Islame” në “Bibliotekën Islame të Gjallë të Shqiptarëve” dhe në formësimin e tekstologjisë islame në gjuhën shqipe?

Mendimi islam në periodikun e shqiptarëve dhe revista “Edukata Islame”

Periodiku islam shqiptar ka të kaluar relativisht të lashtë. Mendimtarët islamikë shqiptarë i kanë shfaqur mendimet dhe pikëpamjet e tyre në gazeta, në revista dhe në libra qysh nga mesjeta në gjuhën osmane, turke dhe në gjuhë të tjera. Të kujtojmë me këtë rast rilindësit e mëdhenj, si Sami Frashëri, Hoxha Hasan Tahsini, Naim Frashëri e shumë krijues të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si edhe kontributin e tyre në zhvillimin e vetëdijes kombëtare, në zhvillimin e pavarur të shqiptarëve dhe rolin e tyre në zhvillimin e kulturës e të arsimit në gjuhën amtare. Angazhimi i përbashkët i tyre ngërthente edhe të drejtën e besimit fetar të shqiptarëve dhe lirinë e tyre qytetare për të gëzuar këtë të drejtë në gjuhën e tyre, në gjuhën shqipe. Mendimtarët islamikë i kanë shfaqur mendimet dhe pikëpamjet e tyre jo vetëm në

arabishte, greqishte, latinishte, osmanishte e turqishte, por edhe në botime të ndryshme të shtypura me shkronja alfabetesh ende të padefinuara në një alfabet të përbashkët - shumë kohë para Kongresit të Manastirit të vitit 1908.

Historia e periodikut islam shqip është e kohës më të re se periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Por Rilindja Kombëtare Shqiptare i ka dhënë shtytje të fortë dhe drejtim të rëndësishëm zhvillimit të mendimit fetar islam pa e ndarë këtë zhvillim nga zhvillimi i përgjithshëm intelektual dhe çlirimtar i kombit. Mirëpo, ditëlindja e periodikut të mirëfilltë islam shqiptar ende nuk ka mbushur një shekull, ndonëse besimi islam ndër shqiptarët është shumë më i hershëm. Sipas rezultatit të disa studimeve, islamizimi i popullsisë shqiptare filloi në mbarim të shekullit XV dhe në fillim të shekullit XVI l¹.

Ndërkaq, revistat e para islame në shqipe filluan të botoheshin gati pesë shekuj pas fillimit të procesit të islamizimit të popullsisë shqiptare. Gazetat e para pas vënies së kufijve në treva shqiptare dhe pas ndarjes së tyre, filluan të botoheshin si gazeta e revista kombëtare e fetare në Shkodër, Gjirokastër e Tiranë, si edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe kjo qysh nga viti 1913. Por, ndër të përkohshmet e konsoliduara u dalluan dy revista. Këto ishin të përkohshmet e vitit 1923 "Udha e s'vërtetës" me kryeredaktor Hoxha Kadri Prishtinë, që u botua në Shkodër, dhe "Zani i Naltë" me drejtor Ismail Maçin.² Revista "Zani i Naltë" arriti të afirmohej dhe të ushtronte ndikim të rëndësishëm në edukimin kombëtar dhe islam të shqiptarëve, në radhë të parë të shqiptarëve të Shqipërisë. Kjo revistë fetare, sikurse dihet, merrej edhe me "filozofi, me moral, me literaturë kombëtare e me sociologji"³. Numri i parë i kësaj reviste doli në tetor 1923, pra, para jo plot tetëdhjetë vjetësh. "Zani i Naltë" ishte revista e gjashtë që u botua në vitet '20 të shekullit njëzet në Shqipëri. Tërë përmbajtja e të gjithë numrave të revistës, të botuar deri në maj 1939, ishte aktuale dhe e rëndësishme për ngritjen e përgjithshme të kulturës, veçmas të

¹ Ferit Duka, Momente të kalimit në islam të popullsisë shqiptare në shek. XV-XVII, kumtesë në Simpoziumin ndërkombëtar Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995, fq.119-126)

² Dr. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, Tiranë, 1997, fq.165

³ *Zani i Naltë* (Përmbledhje kumtesash), Shkodër, 1999, fq.10

kulturës islame ndër shqiptarët. Kjo ishte dhe ngeli tribunë e vërtetë e mendimit islam të shqiptarëve me vlera të pazëvendësueshme fetare, kombëtare, etike, kulturore dhe shoqërore. Njohësit dhe studiuesit e saj kanë cilësuar se "...Revista ishte përqendruar në drejtim të formimit të njeriut intelektual mysliman⁴. Në këtë revistë kanë bashkëpunuar shumë mendje të mprehta shqiptare, nga të cilët ka pasur edhe nga trojet e tjera shqiptare. Por, revista arrinte me vështirësi të mëdha në duart e intelektualëve të paktë shqiptarë jashtë kufijve të shtetit ose nuk mund të depërtonte fare në viset shqiptare jashtë kufijve të Shtetit Shqiptar.

Sot shqiptarët e të gjitha viseve, kur shfletojnë faqet e kësaj reviste, kanë përse të krenohen dhe njëkohësisht shfaqin respekt ndaj drejtuesve dhe bashkëpunëtorëve të saj. "Edukata Islame" e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, e gjysmës së dytë të shekullit njëzet është motër dhe vëlla i parë i "Zanit të Naltë" të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të gjysmës së parë të shekullit njëzet. Këto dy revista tona filluan të dalin dhe të veprojnë atëherë dhe në ato vende të shqiptarëve, ku librat shqip, sidomos ata fetarë, ishin të paktë. Prandaj, mund të thuhet se këto revista, me përmbajtjen e tyre, bënë orvatje serioze për ngritje të vetëdijes kombëtare dhe islame të shqiptarëve gjatë shekullit të kaluar, kur shqiptarët u ballafaquan me luftëra ballkanike, morën pjesë në dy luftëra botërore, kaluan nëpër katër ndryshime sistemesh politiko-shoqërore, pësuan procese të pandërprera dyndjesh, konfliktesh dhe varfërish skajore, madje edhe ndalime partiake e ligjore të besimit fetar dhe të zhvillimit të vetëdijes dhe të ndjenjës fetare islame. Pikërisht përmbajtjet e këtyre revistave janë ndër bartësit e rëndësishëm të zhvillimit të vetëdijes kombëtare dhe fetare të shqiptarëve. Kundruall rrëmujave dhe rrymimeve ideologjike e partiake me lloj-lloj përmbajtjesh, drejtimi e ngjyre, shqiptarët qëndruan besnikë ndaj kombit e fesë së tyre. Proceset zhvillimore sot i organizojnë, por me vështirësi të mëdha nga pasojat e kufizimeve të së kaluarës dhe nga ngecja e tyre në edukatën kombëtare, fetare, ekonomike dhe kulturore.

⁴ Ismail Ahmedi, *Mbi historikun dhe gjendjen aktuale të publicistikës shqiptare*, "Elif", Podgoricë, Nr.2, Nëntor-dhjetor 1990, fq.11

Misioni tekstologjik i përmbajtjes së revistës “Edukata Islame”

Lexuesi i kujdesshëm i përmbajtjeve të revistës “Edukata Islame” mund të vërejë qëllimin e përbashkët të përmbajtjeve të kësaj reviste tridhjetëvjeçare. Qëllimi kryesor i revistës dhe i institucionit të saj të tërësishëm ishte dhe është vetëdijësimi i shqiptarëve për vlerat dhe rëndësinë e fesë islame në procesin e zhvillimit të ndershëm të shqiptarëve, për kushtet dhe mundësitë e zbatimit të qëllimit dhe të detyrave të saj ndër shqiptarët. Ndërkaq, detyra kryesore e përmbajtjeve të revistës ishte dhe ngeli angazhimi i secilit mysliman për krijimin e mundësive, të kushteve dhe raporteve ekonomike, sociale, politike dhe kulturore për zbatimin e kërkesave të fesë islame në mjediset shqiptare. Këtij qëllimi dhe kësaj detyre të revistës i janë kushtuar bashkëpunëtorët e revistës gjatë gjithë kohës së botimit të saj. Por, detyra e përmendur prek më tepër anën praktike të revistës. Përmbajtja e revistës ka edhe detyra teorike, të cilat nuk mund të ndahen nga detyrat praktike. Në grupin e detyrave teorike të revistës bëjnë pjesë edhe metoda e komentimit dhe e interpretimit të ajeteve kuranore dhe të haditheve të hazreti Muhamedit a.s., fuqia kuptimore e tekstit buri-mor dhe e tekstit të përkthyer, shqipërimi i tyre, terminologjia islame në gjuhën shqipe, etj. Në këtë pikëpamje, përmbajtja e revistës mund të konsiderohet lëndë ose objekt i tekstologjisë islame në shqipe dhe hulumtuese ose gjurmuese tekstologjike e Islamit në shqipe.

Lënda tekstologjike e revistës “Edukata Islame”

E tërë lënda e botuar në gjashtëdhjetë e gjashtë numrat e revistës është lëndë me përmasa tekstologjike në kuptimin e nevojës së studimit të tyre dhe të lidhjeve që ka lënda e këtillë me lëndën identike ose të ngjashme të botuar më herët ose më vonë në revista dhe në botime të tjera. Lëndë e këtillë mund të konsiderohen përmbajtja e vështirësive, që u janë bërë temave të ndryshme të revistës nga ana e studiuesve, lënda e përkthimeve të teksteve të literaturës islame në shqipe, lënda historike, krijimet letrare, etj. Mendoj se lënda kryesore me karakter tekstologjik është përkthimi i Kur’anit dhe i Haditheve dhe

vëzhgimet e studimet mbi përkthimin e këtyre veprave, që janë paraqitur në revistë.

Pas tyre radhitet lënda e përkthyer që është paraqitur në revistë; kjo është lëndë me frekuencë më të madhe dhe me rëndësi të veçantë për hulumtim. U përkthye nga anglishtja, arabishtja, boshnjakishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja, etj. Ndër këto përkthime mund të përmenden: “Rrymat e filozofisë islame dhe mënyra e konfrontimit të mendimeve bashkëkohore në shoqërinë islame”⁵, “Bibla, Kur’ani dhe shkenca”⁶, “Traktat mbi besimin islam”⁷, “Dualizmi i pesë rregullave themelore”⁸, “Kur’ani kryevepër e letërsisë arabe”⁹, “Metafora Kur’anore”¹⁰, “Mësimet e Kur’anit në fushën e politikës”¹¹, “Toleranca dhe tradita paqësore në fenë islame”¹² dhe shumë tema të tjera, që përshkojnë të gjithë numrat e “Edukatës Islame”.

Përkthimet përbëjnë rreth një të tretën e përmbajtjes së revistës “Edukata Islame”. Kjo e dhënë tregon dimensionin e hapur të kësaj reviste për të gjithë ata që, me mendimet e tyre, kontribuan për ngritjen e kulturës islame ndër shqiptarët, sidomos ndër shqiptarët e Kosovës. Këto janë përkthime temash aktuale dhe të rëndësishme fetare, kulturore dhe politike. Këto përkthime, përpos vlerave praktike për organizimin e sjelljeve të islamikëve dhe për gjindshmëri të suksesshme të tyre në rrethana, në kushte dhe në raporte të ndërlikuara të jetës bashkëkohore, kanë vlera të pamohueshme kulturore, arsimore e fetare. Por, ndër këto vlera duhet përmendur edhe vlerat tekstologjike të tyre. Mendimi e fjala e avancuar e mendimtarëve të fesë islame të afirmuar në Botën Islame, hapin dritare të reja për t’iu qasur mendimit, këshillave dhe porosive të profetit Muhamed a.s. Por, vepra e përkthyer në shqipe me rëndësi të posaçme për kulturën islame ndër shqiptarët pas Kur’anit, për formimin moral, shoqëror dhe filozofik të

⁵ Edukata Islame, nr.17/1976, fq.26-34

⁶ Edukata Islame, nr.23/1979, fq.38-41

⁷ Edukata Islame, nr.44-45,46-47/1986, fq.29-45

⁸ Edukata Islame, nr.56/1995, fq.51-64

⁹ Edukata Islame, nr.27/1980, fq.54-75, nr. 30/1980, fq.66-72 dhe nr.31-32/1981, fq.49-55

¹⁰ Edukata Islame, nr.51-52/1990, fq.16-18

¹¹ Edukata Islame, nr.61-62/1997, fq.31-47

¹² Edukata Islame, nr.58-59/1996, fq.33-46 dhe nr.60/1996, fq.43-60

njeriut janë Hadithet. Përkthimi komplet i Sahihu-l-Buhariut në gjuhën shqipe në tetë vëllime është ndër ndërmarrjet më serioze dhe më të rëndësishme, që meriton studim të veçantë.¹³

Dimensioni hulumtues i tekstologjisë së revistës “Edukata Islame”

Mendimtarët e thellë shqiptarë të islamizmit, sikurse janë Ali Riza Ulqinaku, Haxhi Voka, Haxhi Vehbi Dibra, Ibrahim Dalliu, Haki Sharovi, Vehbi Buharaja, Haxhi Vehbi Ismaili, etj. kanë lënë vepra të rëndësishme nga dijenia e Kur’anit dhe e Haditheve. Rugën e tyre e vazhdojnë edhe gjeneratat pas tyre. Nga islamologët shqiptarë pohohet se hadithologët shqiptarë janë me zë botëror. Veprimtarinë e tyre të parë në shqipe e kanë filluar kryesisht me botime në periodikun shqiptar. Gjurmata e tyre i ndjekin edhe më të rinjtë. Të gjithë së bashku, me shkrimet e tyre, kanë dhënë kontributin e tyre në mënyra të veçanta për tekstologjinë islame shqipe dhe zhvillimin e saj.

Revista “Edukata Islame” ka botuar artikuj e kryeartikuj nga Tefsiri, Hadithet, historia e islamit dhe studime të veçanta. Këta artikuj e kryeartikuj janë orvatje serioze të natyrës analitike. Si të këtillë i takojnë shkallës më të lartë të mendimit produktiv islam dhe përkojnë drejtpërdrejt me tekstologjinë islame në gjuhën shqipe. Nga këta artikuj dhe kryeartikuj veçojmë:

a) nga Tefsiri – disiplinë e veçantë e islamizmit, që studion shpjegimin e përmbajtjes së Kur’anit të madhërishëm – dallojmë punimet e të ndjerit Haxhi Sherif Ahmeti, të Haki Sharovit, etj. Punimet e tyre kanë të bëjnë kryesisht me komentet e sureve dhe të ajeteve të Kur’anit¹⁴, të ajeteve “Elif, lamë, mimë”¹⁵, Komentimi i sures “el-Kadër”¹⁶, etj. Haki Sharovi ka shkruar drejtpërdrejt punimin me titull “Tefsiri i Kur’anit”¹⁷.

b) Nga Hadithet në revistë u botuan dhjetë artikuj kryesisht në revistën e botuar gjatë viteve 1975 e 1976. Nga këta dallojmë: “Pejga-

¹³ *Sahihu-l- Buhari në gjuhën shqipe*, vepra I, Prishtinë 1994, fq.14

¹⁴ Komentim i sures “Vel Asri”, *Edukata Islame*, nr.2/1971, fq.3-9

¹⁵ *Edukata Islame*, nr. 19/1977, fq.3-8

¹⁶ *Edukata Islame*, nr. 27/1980, fq.3-10

¹⁷ *Edukata Islame*, nr. 55/1992, fq.5-11

mberi ka thënë”¹⁸, “Resuli thotë”¹⁹, “Hadith i transmetuar prej Eba Hyrejres dhe prej Aishes r.a.”²⁰, etj.

c) Nga Historia Islame në revistë u botuan 98 artikuj. Këta artikuj dhe përmbajtja e tyre u shtrinë prej fillimit të botimit të revistës deri në kohën më të re. Nga kjo pjesë e shkrimeve nga historia e islamit dallohet shkrimi i Hajrullah Hoxhës, që mban titullin: “Muhamedi a.s. dhe përhapja e fesë islame”, që u botua në tridhjetë e shtatë numra të revistës duke filluar nga janari 1971 për të vazhduar deri në vitin 1996²¹. Pason tema historike “Përfaqesuesit e shkollave juridike islame”²², “Termidhiu”²³, etj.

ç) “Studime” mban titullin kaptina që ka rëndësi të veçantë për tekstologjinë islame në shqipe. Këtu janë përfshirë 22 shkrime të karakterit studiues. Ndër këto përmendim: “Shkolla Juridike Hanefite” (skicë për një studim), që autori Nexhat Ibrahimimi e shtroi në pesë numra të revistës “Edukata Islame”²⁴; “Arsimi dhe shkollat islame në kohën e Hilafetit” u botua më 1992²⁵; “Dimensioni sociologjik i mendimit islam në dritën e Kur’anit” u botua në revistë më 1995²⁶.

Zhvillimi i mendimit islam ndër shqiptarët e Kosovës

Nga vështrimi tekstologjik i temave të trajtuara në revistën “Edukata Islame” dhe në libra e botime të veçanta, dallohet një spirale e veçantë e zhvillimit të mendimit islam ndër shqiptarët përgjithësisht, posaçërisht ndër shqiptarët e Kosovës. Mendimi islam tek ne filloi të zhvillohej qysh gjatë periudhës osmane. Pas çlirimit nga Perandoria Osmane dhe filleve të pushtimit e të sundimit sllav të Kosovës, mendimi islam u zhvillua në nivel të besimit tradicional fetar. Ky ishte nivel i zhvillimit elementar të mendimit islam në shqipe. Zhvillimi

¹⁸ *Edukata Islame*, nr. 14/1975, fq.52

¹⁹ *Edukata Islame*, nr. 14/1975, fq.33

²⁰ *Edukata Islame*, nr. 14/1975, fq.42

²¹ *Edukata Islame*, nr. 1/1971, fq.19-23 deri në nr. 60/1996 të *Edukatës Islame*, fq.61-65

²² *Edukata Islame*, nr. 26/1980, fq.32-44

²³ *Edukata Islame*, nr. 37-38/1983, fq.65/67

²⁴ *Edukata Islame*, nr. 43/1985, fq.63-76 deri në numrin 50/1988, fq.68-84 për të vazhduar më pas në numrin 63-64/1998, fq.52-64

²⁵ *Edukata Islame*, nr. 55/1992, fq.67-89

²⁶ *Edukata Islame*, nr. 56/1995, fq.39-50

elementar i tij në Kosovë zgjati relativisht shumë kohë dhe mund të thuhet se kufizohet me periudhën e zhvillimit pas vitit 1940.

Ndërkaq, pas përfundimit të Luftës II Botërore mendimi islam në shqipe filloi të zhvillohej në trajtën e mësimit të fesë. Por relativisht vonë, më 1957, u botua shqip “Ilmihali i vogël për shkencat fillestare të fesë islame”. Ky konsiderohet botimi i parë në gjuhën shqipe në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore²⁷. Nga ky nivel i zhvillimit të mendimit islam në shqipe filloi të konstituohet të kuptuarit e diturisë mbi fenë islame dhe dijenia e disiplinave të dijenive islame. Dijenja e këtillë dhe përhapja e saj u shoqërua me botime të periodikut dhe të librave fetarë, sidomos me përkthimin e tyre nga boshnjakishtja dhe nga gjuhë të tjera. Revista “Edukata Islame” dhe institucioni i Medresesë në Prishtinë, që u themeluan, më 1972 përkatësisht më 1952, janë institucione të rëndësishme, që shënojnë data të rëndësishme të zhvillimit të mendimit islam ndër shqiptarët e Kosovës dhe më gjerë.

Por, me themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës në mbarim të shekullit njëzet, mund të thuhet se zhvillimi i mendimit islam ndër shqiptarët e Kosovës u ngrit në nivelin më të lartë deri tash. Me mbarimin e shekullit njëzet fillon zhvillimi i mendimit të lartë islam institucional dhe etapa e hulumtimit të zhvillimit të këtij mendimi. Ky zhvillim spiral i mendimit islam ndër shqiptarët e Kosovës u pasqyrua edhe në tekstologjinë islame shqipe. Prandaj, themi se zhvillimi i mendimit islam ndër shqiptarët e Kosovës kaloi nëpër tri faza të ndërlidhura ndërmjet tyre. Këto faza janë: faza e besimit tradicional islam, e mësimit islam elementar, e mendimit të drejtuar në të kuptuar të thellësisë së mendimit islam dhe faza e mendimit produktiv islam në gjuhën shqipe.

Prishtinë, më 2 maj 2002.

²⁷ R. Shkodra-A. Pireva, Bibliografi e botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë 1957-1997, Prishtinë, 1998, fq.17

Hajrullah Hoxha

Në emër të Zotit të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit

Roli i “Edukatës Islame” në aspektin fetar

Islami është fe që bazohet në diturinë. Urdhri i parë me të cilin Allahu i Madhërueshëm i drejtohet Muhamedit a.s. në fillim të shpalljes së Kur’anit, është: **“Lexo në emër të Zotit tënd...”**. Një kaptinë tjetër kuranore, Ai e fillon me fjalët: **“Nun”**. **Betohem në penën dhe atë që shkruan ajo**. Ndërsa Muhamedi a.s., lidhur me vlerën e veprave të shkruara, ka thënë: *“Ditën e Gjykimit do të peshohet ngjyra e penës së dijetarëve me gjakun e dëshmorëve”*.

Një numër i konsiderueshëm i dijetarëve shqiptarë, duke qenë të frymëzuar nga parimet e lartpërmendura islame, kanë shkruar vepra me vlerë, si në gjuhët orientale, ashtu në gjuhën shqipe, me të cilat pasuruan jo vetëm kulturën shqiptare, po edhe atë botërore. Pas formimit të shtetit shqiptar në vitin 1912, deri në vitin 1945, në Shqipëri u botuan revista, broshura dhe libra të ndryshëm shkencorë dhe fetarë, ndërsa në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, të cilat mbetën nën okupimin serbosllav, popullit shqiptar iu ndalua shkollimi në gjuhën amtare dhe shtypi, madje edhe ai fetar.

Pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, në fillim u ndalua shtypi fetar, ndërsa më vonë me ligj edhe feja në përgjithësi. Në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare nën sundimin jugosllav, edhe pse

feja ishte formalisht e lirë, për një kohë të gjatë rrethanat politiko-shoqërore nuk lejonin botimin e ndonjë reviste fetare.

Falë demokratizimit të pjesërishtëm politiko-shoqëror në fillim të viteve shtatëdhjetë, Kryesia e Shoqatës së Ylemave, si organ i Bashkësisë Islame në Prishtinë, duke pasur parasysh rëndësinë e fjalës së shkruar fetare në gjuhën shqipe dhe nevojën gjithnjë më të madhe, sidomos të rinisë, për njohjen e vërtetë të Islamit, mori vendim për botimin e revistës “Edukata Islame”.

Kjo qe revista e parë fetare në gjuhën shqipe pas Luftës së Dytë Botërore jo vetëm në Kosovë, po në mbarë trojet shqiptare, dalja e së cilës na gëzoi pa masë.

Sot kur po shënojmë tridhjetëvjetorin e daljes së revistës “Edukata Islame”, duke qenë një ndër bashkëpunëtorët e përhershëm dhe më të vjetër të saj, kam nderin t’ju informoj shkurtimisht për kushtet dhe rrethanat në të cilat u botua kjo revistë, dhe për rëndësinë e saj në aspektin fetar.

Me plot të drejtë mund të them se “Edukata Islame” gjatë këtyre tre dhjetëvjetëshave të daljes së saj, u ballafaqua me probleme të natyrës profesionale, politike dhe ekonomike. Kuadri i vjetër i ylemave, edhe pse posedonte aftësi profesionale, me përjashtim të një numri shumë të vogël nuk e njihte gjuhën letrare dhe as metodën e shkrimit, ndërsa ai i riu, i porsadiplomuar, nuk kishte përvojë të nevojshme as literaturë në gjuhën shqipe nga e kaluara, të cilën ta përdorte. Megjithatë, me angazhimin vetëmohues të të dy palëve, “Eduakta Islame” vazhdoi me sukses rrugën e daljes së saj.

Atëbotë, aq shumë kishte ndikim ideologjia komuniste në jetën shoqërore dhe individuale, saqë udhëheqësit e shtypshkronjave refuzonin shtypjen e saj vetëm pse kishte karakter fetar. Andaj, vetëm falë guximit qytetar të drejtorit të shtypshkronjës “Progres” në Mitrovicë, Burhan Gashi, kjo revistë e pa dritën e botimit. Në anën tjetër, censura e shtypit, sidomos e atij fetar, ishte tejet rigoroze, kështu që kërkohej kujdes dhe syçeltësi e veçantë, ngase shumë lehtë mund të sillej në pikëpyetje botimi i mëtejme i revistës.

Botimi i kësaj reviste në periudhën kur në Kosovë me të gjitha mjetet luftohej feja dhe institucionet e saj, ishte një sukses i madh si për Shoqatën e Ylemave, ashtu edhe për Bashkësinë Islame në për-

gjithësi. Në shtypin ditor dhe në atë periodik në mënyrë primitive dhe pa kurrfarë argumenti akuzohej vazhdimisht feja, me theks të veçantë ajo islame, institucionet dhe prijësit e saj. Lidhur me këtë nuk kishte dallim nëse intelektualët i takonin ideologjisë së komunizmit titist apo të atij enverist. Duke vepruar në këtë mënyrë, të parët për hir të interesit dhe pozitës së tyre, tregonin lojalitetin ndaj padronëve të tyre sllavokomunistë, kurse këta të fundit, duke preferuar sistemin ateist të shtetit, demonstرونin patriotizmin e tyre kombëtar.

Botimi i “Edukatës Islame” në një periudhë të tillë ka qenë më se i nevojshëm, sidomos për gjeneratat e reja, të cilat gjatë shkollimit jo vetëm nuk mund të njiheshin me parimet e vërteta të fesë islame, por nga propaganda antifetare shumica e tyre kishin formuar botëkuptim të gabuar për të.

Në vitet nëntëdhjetë, kur Serbia okupoj Kosovën në mënyrë klasike, në kohën kur isha kryeredaktor i kësaj reviste, pati tentime serioze nga Komisioni për Çështje Fetare, që “Edukata Islame” të botohej edhe në gjuhën serbokroate, kinse për myslimanët e Sanxhakut. Një propozim të tillë vendosmërisht e refuzova, duke u arsyetuar se myslimanët e Sanxhakut kishin literaturë të mjaftueshme e cila botohej në gjuhën e tyre në Sarajevë.

“Edukata Islame” filloi të botohej me një tirazh të kufizuar prej 1000 ekzemplarësh, mirëpo falë punës së palodhshme të bashkëpunëtorëve të saj dhe interesimit të lexuesve për të, me gjithë vështirësitë e lartpërmendura, përmbajtja e saj gjithnjë e më tepër pasurohej, ndërsa tirazhi i saj arriti deri në 5000 ekzemplarë.

Gjatë kësaj periudhe tridhjetëvjeçare në “Edukatën Islame” u botuan artikuj dhe punime të ndryshme me karakter fetar, kulturor, shkencor dhe kombëtar. Në të shtjelloheshin tema nga Akaidi – Apologjetika Islame, Fikhu – Jurisprudenca Islame, Ahlaku – morali dhe etika, Tefsiri – komentimi i ajeteve kuranore, Hadithi – tradita e Muhamedit a.s., Historia Islame etj. Këto tema dhe shumë të tjera, të cilat për shkak të hapësirës së kufizuar, nuk mund t’i theksojmë, i përshkon fryma e shpjegimit shkencor të mësimëve islame. Në këto punime mund të vërehet gjithashtu metoda e interpretimit bashkëkohor të botëkuptimit për fenë, njeriun dhe botën, duke iu shmangur mistifikimit të fesë dhe shpjegimit dogmatik të saj.

Gjatë tërë kësaj periudhe tridhjetëvjeçare “Edukata Islame” dha kontribut të çmueshëm për kultivimin dhe ngritjen e vetëdijes fetare dhe kombëtare tek populli shqiptar në Kosovë e më gjerë. Besoj se si e tillë ajo ka arsyetuar emrin dhe misionin e saj të shenjtë dhe, së bashku me “Diturinë Islame”, të cilën nga viti 1986 e boton Kryesia e Bashkësisë Islame, dhe Takvimin - kalendarin vjetor, ka plotësuar nevojat e lexuesve dhe deri diku zbrazëtinë e fjalës së shkruar fetare në gjuhën shqipe.

Me këtë shënim të tridhjetëvjetorit të daljes së revistës, “Edukata Islame” u shprehet mirënjohje të gjithë atyre që me përkushtim kontribuan për themelimin dhe daljen e rregullt të saj për plot tridhjetë vjet dhe sidomos h. Sherif ef. Ahmetit, i cili me aftësitë e tij intelektuale të bazuara në metoda bashkëkohore, për njëzet vjet atë e redaktoi dhe e begatoi me tema aktuale. Andaj, me plot të drejtë mund të themi se ai ishte iniciatori kryesor i themelimit të kësaj reviste dhe shtylla kryesore, pa të cilin nuk mund të mendohej vazhdimi i botimit të saj. Andaj, e lusim Zotin e Madhërueshëm ta shpërblejë me Xhenet.

Të përkujtohet tridhjetëvjetorin e daljes së “Edukatës Islame” sot kur sistemi antinjerëzor komunist në të dy anët e kufirit shqiptaro-shiqptar është shpërbërë dhe kur sundimi gjenocidial serbosllav, falë ndihmës së Zotit të Madhërishëm, Luftës heroike të UÇK-së dhe intervenimit të paktit NATO, më nuk ekziston në Kosovë, është një kënaqësi e veçantë dhe gëzim i papërshkruar.

Mbesim me shpresën se “Edukata Islame” në të ardhmen, në kushte të reja demokratike, do të jetë më e begatshme dhe më atraktive për lexuesit.

Ju falemnderit!

Dr. Abdullah Hamiti

Nezim Frakulla - jeta dhe divanet e tij

Poezia e bejtexhinjve ka qenë poezi e qarqeve të caktuara intelektualë, por që përhapej shpejt, sepse atëherë nëpër të gjitha qendrat e mëdha kishte një numër të konsideruar intelektualësh, të formuar në medresetë e shumta në qytetet shqiptare, po edhe në Stamboll e në qendra të tjera të Perandorisë Osmane, të cilët pëlqenin artin poetik dhe merreshin me përkthimin e përshkrimin e veprave të njohura poetike persiane sidomos, po edhe të atyre arabe e turke. Edhe ata vetë, duke marrë për model krijimet poetike të atyre filluan të krijonin në gjuhët orientale. Por, meqenëse shumica e shqiptarëve që dinin shkrim-leximin osman, nuk i kuptonin këto vepra, intelektualët shqiptarë nisën të shkruanin në gjuhën shqipe me qëllim që veprat e tyre të ishin më të kuptueshme për masën, me të cilën ishin në kontakt të përditshëm. Kështu pra, këta krijues filluan të shkruanin për popullin e tyre dhe, me qëllim që krijimet e tyre të ishin tërheqëse e të kapshme për ta, filluan të përdornin tetërrokëshin popullor (kështu veproi Nezim Frakulla e të tjerë) dhe të shkruajnë, me ngjyrimet lokale.

Pra, mund të thuhet se poezia e bejtexhinjve lindi nga gjiri i popullit, respektivisht për nevojat e popullit. Atë e shkruanin njerëz të arsimuar mirë, sidomos njohës e adhurues të shkëlqyer të letërsisë orientale, e në radhë të parë të asaj të misticizmit islam, ngase edhe ndër

shqiptarët tashmë tarikatet (rendet dervishe) kishin lëshuar rrënjë¹. Kështu, në shek. XVIII kemi poetët e parë që sot i njohim si bejtexhinj, të cilët bënë provat e para që të shkruhej poezia shqipe me vlera të konsiderueshme artistike. Pra, kështu lindi poezia shqipe e shkruar me grafi arabe, e cila do të krijohej për plot dy shekuj, dhe do të linte trashëgim vepra të bukura poetike me vlera të çmueshme artistike të autorëve të njohur si: Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Kyçyk Çami, Zenel Bastari, Dalip Frashëri e të tjerë. Ata letërsinë shqipe e pasuruan si me tema të reja që trajtuan, ashtu edhe me gjini të reja letrare, si mesnevi (poema), ilahi (kënga fetare) e deri te lirika, satira, panegjериku etj., të cilat nuk ishin të kultivuara në poezi në shqipe dhe që u përhapën shpejt. Dhe, duke u nisur nga këto risi që sollën bejtexhinjtë në letërsinë shqipe, shumë studiues konstatojnë se me këta krijues, respektivisht me krijimet e tyre, nisi të zhvillohej letërsia artistike shqipe, e cila dilte nga rrethi i ngushtë i një letërsie fetare dhe didaktike e filloi të ngrihej në nivel të një letërsie artistike.² Nga fakti se këto poezi kanë mbetur të pabotuara, dhe për shekuj janë përshkruar e lexuar nëpër medrese, teqe e ndenje të ndryshme, sot gjenden kopje të poezive të tyre.

Arsyeja që poezia e bejtexhinjve u pëlqye e u mirëprit që nga ditët e para kur filloi të shkruhej, mendoj se qëndron në faktin se kultura islame ishte përhapur në popull dhe se ajo më nuk ishte e huaja për ta, sepse tashmë shqiptarët me shumicë i përkisnin fesë islame dhe rrjedhimisht edhe kësaj kulture, ngase në trojet shqiptare, sidomos nëpër qytete, bëhej një jetë islame me të gjitha veçoritë që e karakterizojnë atë. Po ashtu, do theksuar se kjo poezi ishte produkt i krijuesve shqip-

¹ Jashar Rexhepagiqi, **Dervishët, rendet dhe teqetë në Kosovë, në Sanxhak e rajonet e tjera përreth, në të kaluarën dhe sot**, Dukagjini - Pejë 1999, f. 282; Baba Rexhepi, *Misticizma islame dhe bektashizma*, Nju-Jork, 1970, dhe në Tiranë 1995; Metin Izeti, **Tarikati Bektashian**, Tetovë, 2001, f. 184.

² Osman Myderrizi, *Tekstet e vjetra shqip me alfabetin arab*, në: **Konferenca e parë e studimeve albanologjike 1962**, Tiranë, 1965 (fq. 287 - 291); Hasan Kaleshi, *Albanska aljamijado knjizevnost*, në: **Prilozhi za orijentalnu filologiju**, XVI- XVII / 1966-67, Sarajevo, 1970, (fq. 55); Gazmend Shpuza, *Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri*, në: **Perla**, 2001, nr. 1 - 4, Tiranë, fq. 23; Dr. Jorgo Bullo, *Një aspekt i ndikimit të kulturës islame ndër shqiptarët - poezia e bejtexhinjëve*, në: **Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët**, Simpoziumi ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992, botim i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, fq. 245, etj.

tarë dhe për popullin shqiptar, si rezultat i nevojës në rrethanat historike, kulturore e shoqërore të kohës. E dihet qartë se paraqitja e krijimtarisë letrare shqipe me grafi arabe, pa marrë parasysh karakterin fetar të saj, për pushtetarët turq ishte e padëshiruar dhe ajo e krijuarit e saj luftoheshin si nxitës të pakënaqësive popullore dhe prishës të rendit e qetësisë. Dhe për këtë arsye, dihet se shumë krijues bejtexhinj e kanë pësuar keq, ndër ta edhe Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Zenel Bastari etj. Një nga arsyet që kjo poezi tek ne nuk është trajtuar drejt dhe siç e meriton, është edhe karakteri islam – mistik i saj.

Sado që studiuesit janë marrë edhe me poezinë e bejtexhinjve, kjo poezi është studiuar e botuar vetëm pjesërisht, me ndonjë studim jo të gjithanshëm, më shumë me shkrime të karakterit informativ, ku është dhënë një a dy poezi të ndonjë poeti, por nuk kemi botime të veçanta për asnjë poet të periudhës së bejtexhinjve, ku të përfshihej e tërë krijimtaria e tij me ndonjë studim e shpjegime të duhura, dhe kështu të mund të evitoheshin paragjykimet e ndryshme që studiuesit tanë kanë shprehur ndaj kësaj krijimtarie. Dhe këtë gabim tash po e vërejnë edhe studiuesit tanë. Kështu J. Bullo konstaton: "Në historiografinë tonë letrare, letërsia e bejtexhinjve shpesh është marrë e është parë me paragjykimet nga mungesa e njohjes së plotë, ose nga një kompleks evropcentrik i shprehur a i nënkuptuar. Së këndejmi kjo trashëgimi letrare shqiptare duhet të publikohet dhe të studiohet shkencërisht në tërësinë e saj si një dukuri komplekse. Ajo meriton të bëhet objekt i një shqyrtimi tërësor dhe si një krijimtari që me lidhjet e saj të brendshme me kulturat e Orientit e me filozofinë islame i dha një dimension të ri letërsisë e kulturës shqiptare."³ Po që të mund t'i studiojnë këto krijime të bejtexhinjv, studiuesit tanë duhet të njohin mirë kulturën islame, misticizmin islam, pra letërsinë orientale islame në përgjithësi, nga e cila janë ndikuar krijuesit e tillë shqiptarë si në teknikën poetike të shkrimit, ashtu edhe në përmbajtjen tematike. Po ashtu, duhet të njihet mirë edhe leksiku oriental-islam, me të cilin janë të stërngranguara poezitë e bejtexhinjve.

³ Jorgo Bullo, punimi i cituar, fq. 246.

Nezim Frakulla - jeta dhe divanet e tij

Një nga ndikimet e letërsisë orientale-islame në atë të bejtexhinjve shqiptarë, është edhe fakti që shkrimtarët bejtexhinj, gati përgjithësisht, në poezitë e tyre, zakonisht në fund, përmendin emrin e vet, e në raste të tjera edhe vitin kur e shkruanin poezinë, ose vitin kur ndodhte ngjarja për të cilën shkruanin. Kjo është me rëndësi të veçantë, ngase për shumë sosh nuk kemi të dhëna për biografitë e tyre, andaj edhe këto elemente që figurojnë në poezitë e tyre, janë të rëndësishme e na ndihmojnë të ndërtojmë biografinë e poetëve, pra nga poezitë e tyre mund të ndërtohet rruga jetësore e tyre dhe ngjarje të ndryshme politiko-shoqërore, të cilat kanë ndodhur në kohën kur poeti i shkruan poezitë, sado që këto të dhëna nuk janë të mjaftueshme për një gjë të tillë. Ndërkaq, dihet se biografia e bejtexhinjve, në përgjithësi, për ne mbetet e panjohur, së paku jo në detaje, ngase shumë rrethana të jetës së tyre mbeten të pandriçuara, sidomos ato për përfundimin e jetës së tyre, që për shumicën ishte tragjik, pikërisht si pasojë e vetëdijes së tyre kombëtare dhe e krijimtarisë së tyre në gjuhën amtare, por ja që ky fakt më së paku është ndriçuar në historiografinë tonë.

Megjithatë, biografia e Nezim Frakullës nuk është aq e panjohur, kjo për faktin se për të u interesuan më shumë studiuesit dhe për faktin se krijimtaria e tij, për shkak të popullaritetit të tij që kishte arritur, e përshkruar, ishte shpërndarë në vende të ndryshme. Kështu del se Hahni që i pari që zuri të interesohej për të. Ai në Elbasan kishte gjetur tetë këngë të Nezimit dhe i kishte rënë në gjurmë një divani të tij, por nuk arrit ta zbulonte dot. Këngët e zbuluara i vuri në komunikim shkencor në veprën e vet "Albanesischen Studien" (1853-54)⁴. Poezitë e botuara nga Hahni zgjuan interesimin e albanologëve të huaj të shquar të kohës, por edhe shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare u interesuan dhe përmendnin emrin e tij, ndër ta edhe Naim e Sami Frashëri, dy njohës të mirë të poezisë së bejtexhinjve, dhe të letërsisë orientale-islame, nga e cila ishte ndikuar shumë poezia shqipe e bejtexhinjve. Pastaj, të dhëna të rëndësishme për biografinë e veprën e Ne-

⁴ Cit. sipas: Osman Myderrizi, *Nezim Frakulla - jeta*, në: Buletini i SH. SH, Tiranë, 1954, nr. 4, fq. 56.

zim Frakullës jep Abedin Ferati në revistën "Zani i naltë"⁵. Po ashtu, për Nezimin shkruan edhe revista "Kultura islame"⁶, ndërsa studimet e mirëfillta si për Nezimin e krijimtarinë e tij, si për mbarë letërsinë shqipe të shkruar me grafi arabe, bëri Osman Myderrizi, i cili si njohës i mirë i kësaj krijimtarie, vuri themelet e studimit me kritere shkencore të kësaj pjese të letërsisë shqiptare.⁷ Kontributin më të madh për njohjen e Nezimit dhe të poezisë së tij pra e dha O. Myderrizi, i cili edhe i kishte konsultuar tre divanet e poezive të Nezimit që gjenden në Arkivin e Shtetit të Shqipërisë në Tiranë, dhe punimet e tij, me gjasë, u bënë mbështetje kryesore për studiuesit e tjerë që u morën me krijimtarinë e tij.⁸

Nezim Frakulla, siç shihet nga kronogrami i Fejziut, shokut të tij poet, që e shkroi me rastin e vdekjes së Nezimit, u lind në Frakullë të Fierit. Shumë studiues për vit të lindjes së tij përmendin fundin e shekullit shtatëmbëdhjetë, diku në vitet 1680-1685, por për këtë nuk kemi ndonjë të dhënë të saktë. Mbase rrjedh nga familje feudalësh shqiptarë të fshatit Frakullë të Beratit, kjo për faktin se kishte arritur t'i vijonte mësimet nga mektepi, idadia, medreseja e deri tek shkolla e lartë e studimeve islame në Stamboll. E siç dihet, shkollimi jashtë vendlindjes kërkonte bazë të mirë materiale. Mendohet se në rini ka qëndruar gjatë në Berat, ku do të ketë kryer medresenë. Pas kryerjes së medresesë në Berat, Nezimi, i etur për dituri, nga një anë, dhe falë gjendjes së mirë ekonomike në sajë të pasurisë që i kishte lënë babai i tij, nga ana tjetër, vazhdoi studimet islame në Stamboll. Ne nuk dimë sa kohë do të ketë qëndruar në Stamboll, ndonëse mendohet se kishte qëndruar pak më gjatë. Në Stamboll, Nezimi u shqua si njohës e studiues i shkëlqyer i Islamit, i kulturës dhe i rrymave të mendimit islam, dhe veçmas si njohës i shkëlqyer i krijuesve letrarë e filozofëve arabë, persianë e turq, mendimet dhe pikëpamjet e të cilëve do të reflektoheshin edhe në krijimtarinë e tij letrare. Dhe pikërisht njohja e tij e mrekullueshme e thesarit të pasur të letërsisë orientale-islame

⁵ "Zani i naltë", Tiranë, nr. 1 dhe nr. 10, 1938.

⁶ "Kultura islame", Tiranë, nr. 3, fq. 10, 1942.

⁷ Osman Myderrizi, *Nezim Frakulla - jeta*, në: Buletini i SH. SH, Tiranë, 1954.

⁸ Shih: Mahmud Hysa, **Alamiada shqiptare, Studime letrare**, "Logos-A", Shkup, 1997, fq. 45-77, e të tjerë.

(arabe, perse e turke), bënë që Nezimi të formohej e të kompletohej si një poet i mirë i kohës, dhe kjo jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe në atë turke, ngase në turqishte Nezimi kishte filluar të shkruante qysh gjatë qëndrimit të tij në Stamboll. Sot kemi një divan⁹ të gjatë të tij me poezi në gjuhën turke.

Nezimi, tashmë i formuar si intelektual i fortë dhe si poet i talentuar, aty nga viti 1731 kthehet në Berat me shpresën se do të kalonte një jetë më të mirë në atdheun e tij dhe të ndihmonte bashkatdhetarët e tij, pasi më 1731, siç del nga një varg i poezisë së tij ai fillon të shkruajë poezi, por tash në gjuhën amtare, në gjuhën shqipe. Ky moment është i rëndësishëm edhe për vetë historinë e letërsisë shqipe, sepse do të fillonte të krijonte një poet i talentuar, një mistik i rryer, një njohës i shkëlqyer i letërsisë islame-mistike, një njohës i mirë i Sadiut, Shirazit, Attarit, Rumiut, Hajamit - këtyre klasikëve të njohur persianë. Kur kthehet në Berat, Nezimi gjen një elitë kulturore, intelektualë që njihnin shpirtin e poezisë, dhe, i nxitur nga kjo atmosferë dhe nga nevoja që edhe në shqipe të shprehte elanin e tij poetik me përvojën krijuese që kishte fituar në Stamboll, filloi të krijonte poezi në gjuhën shqipe, duke vënë kështu themelet e një rryme të re, me tematikë, me motive e strukturë të re metrike. Pra, Nezimi sjell një frymë të re poetike që megjithatë në Berat nuk ishte e panjohur, sepse në Berat, në mos shqip, turqisht krijohej edhe para tij dhe aty kishte një traditë të poezisë. Kështu, Nezimi në Berat gjen një atmosferë krijuese të këndshme, ku zhvillohej një rivalitet i ashpër poetik. Natyrisht se ky ishte një rast i mirë që Nezimi ta shfrytëzonte këtë nxitje, dhe si njeri me përvojë të mirë poetike, të dëshmonte edhe njohjen e mirë të poezisë popullore. Dhe Nezimi menjëherë u tregua si një poet me përvojë, një poet i kalitur, i cili njihte shumë mirë artin poetik dhe si poet që dinte të zgjidhte motivin e dashur për masat dhe të kishte qëndrim kritik ndaj disa dukurive të papëlqyera dhe në kritikën e tij nuk kursente as strukturat e larta të shoqërisë.

⁹ Divani është një përmbledhje poezishë me një radhitje të veçantë. Zakonisht nis me një lutje Allahut, vazhdon me vargje për dashurinë dhe kënaqësitë tokësore ose për çështje të fesë e të filozofisë dhe mbyllet me ode panagjirike për Sulltanin ose sundimtarët e padronët vendorë

Kështu polemizon me poetë të Beratit e të qyteteve të tjera dhe me autoritete të qytetit, ndër ta edhe me Mulla Aliun, myftiun e Beratit, dhe, siç duket, edhe kjo do t'i hakmerrej më vonë.

Me gjasë, pas polemikave të gjata disavjeçare, Nezimi në Berat fillon t'i ndiejë pasojat, ngase tërë pasurinë e trashëguar familjare pothuaj e kishte shpenzuar gjatë qëndrimit të tij në Stamboll, dhe kështu gjendja e tij ekonomike nuk i mundësonte jetë të rehatshme familjare. Për të siguruar një ekzistencë minimale, pasi kthehet nga Stambolli, "hyn si qehajë (kujdestar) i pasurisë së një feudali shqiptar haxhi Hasan Ismail"¹⁰. Por, s'do mend se këtë intelektual të madh, kjo pozitë shoqërore e ekzistenciale nuk e kënaqte, në veçanti situata e krijuar pas polemikave të shumta letrare, pas vitit 1738. Për këtë arsye, mbase për të zgjidhur problemin e ekzistencës materiale, më 1747 shkoi në Stamboll. Në Stamboll kishte kaluar disa vjet dhe aty kishte shokë e miq të shumtë. Por, pas qëndrimit për disa vjet në Berat, Nezimi në Stamboll shkon si intelektual edhe më i pjekur dhe Stambollin e shikon me sy tjetër dhe nga një kënd tjetër. Sado që thuhet se i kishin ofruar punë të mirë si kadi e myderriz, Nezimi nuk i kishte pranuar këto poste i vetëdijshëm se atëherë do të duhej të punonte sipas urdhrave të pushtetarëve të lartë, e jo sipas vetëdijes e ndërgjegjes së tij të lirë intelektuale. Prandaj edhe preferon gjendjen e tij të rëndë materiale, me vuajtje, por me ndërgjegje e karakter të pastër, dhe bile, siç del edhe nga poezitë e tij, qe dëshpëruar edhe nga miqtë e shokët e tij, që kishte krijuar më herët në Stamboll. Tash na del se edhe shokët e jaranët që kishte pasur, ia kthyen shpinën dhe nuk e përfillën fare, sepse Nezimi nuk ishte ai i mëparshmi, çfarë e kishin njohur. Tash Nezimi e kupton hipokrizinë e tyre dhe duket se bie në dëshpërim të thellë, por nuk nënshtrohet. Ky dëshpërim i thellë që kishte kapluar Nezimin, qe edhe motiv e shkas për të krijuar poezi të bukura në turqisht e shqip; ato në shqipe mund t'i hetojë edhe lexuesi në divanin e Nezimit. Natyrisht, Nezimi, i revoltuar e i dëshpëruar tashti në Stamboll nga qëndrimi indiferent e hipokrit, me gjasë merr rrugën për në Hotin të Besarabisë (sot Ukrainë), e ky fakt nxirret nga një poezi e Nezimit në Divan. Por, nga poezitë e tij nuk mund të mësojmë se si

¹⁰ Mahmud Hysa, vepra e cituar, fq. 52.

shkoi atje, nëse kishte shkuar me dëshirë me shërbim apo ndoshta edhe kemi të bëjmë me ndonjë formë internimi, sepse kjo ishte një praktikë e pushtetit osman, për t'i larguar nga kryeqyteti figurat e mëdha intelektuale. Por, kjo gjë dihet, qëndrimin në Besarabi nuk e përmend ta kishte mirëpritur, dhe nga poezitë që shkroi, del se ishte gëzuar shumë kur duhej të kthehej përsëri në vendlindje. Kështu në vjershën që i kushton dilberit të tij famëlartë, duke iu drejtuar mbretit të të mirave, të cilin do ta përfitojë dhe zotohet se nuk do t'i ndahet kurrë atij, shkruan:

*O dilber kësi seferi**
Në shpëtofsha unë i mjeri,
*Dër sy më rrintë neshteri***
Veç ty tjetër në shikofsha.

Me ty shpirt kam shumë kond
O xhevahir, o shtat argjend,
Inshaallah bije në vend
Prej Hotinit, në shpëtofsha.

Në një kaside tjetër i këndon edhe shkresës mbretërore (hati humajjun) që i jepte leje për t'u kthyer në atdhe.

Nuk ka të dhëna sa kishte zgjatur udhëtimi dhe kur kishte ardhur në Berat. Ai në Berat gjente një situatë tjetër, ku si sanxhakbej i Vlorës, Ohrit dhe Beratit ishte emëruar Ismail pashë Velebishti, që njihet edhe si poet bejtexhi. Tashti Nezimi, mbase për t'u rehatuar pak, shkroi disa kaside të bukura që ia kushtoi Ismail pashës, duke lavdëruar jetën ekonomike, politike e fetare që kishte organizuar ky pasha në Berat. Kështu, duke e lutur Zotin që t'i jepte jetë të gjatë e të lumtur Ismail pashës, pasi që e përshkruan si person të njohur për veprim me drejtësi, shkruan se për të luten gjithë bota, zotërinjtë e të varfrit, e veçmas dijetarët dhe se gjithmonë e përkujtojnë:

Duaxhi gjithë dynjaja,
Zotërinjë e fukaraja,
Alel husus ulemaja

* kësi seferi = kësaj here,

** neshter = skalper, brisk i mprehtë.

Daim për të bëjnë izqar

Këto kaside mbase janë panegjiret e para të një bejtexhiu, dhe në këtë gjini letrare Nezimi u shqua si talent e njohës i mirë, që në poezinë orientale-islame zhvillohej që nga shekujt e hershëm të epokës sonë. Por kërshëria e tij prej poeti që t'i përshkruante gjërat ashtu siç i shihte e i ndiente mendja e tij e zgjuar, gjuha e tij e mprehtë përsëri ia prishi rehatinë me një kaside satirike ku paraqiti problemet shoqërore me të cilat ballafaqohej Berati. Kjo satirë, mbase edhe atmosfera e acaruar për shkak të polemikave të ashpra letrare, e kishte mllefosur sundimtarin e Beratit, i cili tentoi ta arrestonte, por Nezimi iku në Elbasan, ku u strehua për një kohë te miqtë e tij. Edhe nga koha e qëndrimit të tij në Elbasan kemi disa poezi të bukura, ku përshkruan ndër të tjera edhe jetën kulturore në Elbasan. Pas disa vjetësh qëndrimi në Elbasan, Nezimi kthehet në Berat. Aty e burgosën një kohë dhe prapë e liruan, mbase edhe vetëm për ta denoncuar si njeri të rrezikshëm e të papërshtatshëm. Tani Nezimi në Berat ndihet mjaft i vetmuar dhe i harruar nga miqtë e nga rrethi që dikur e admironte shumë, dhe këtë e shprehu haptazi edhe në poezitë e tij. Por, as ky nënçmim dhe kjo hipokrizi e tillë e shokëve të dikurshëm, dhe as kërcënimet e kundërshtarëve, nuk e gjunjëzonin Nezimin.

Natyrisht, qëndrimet e botëkuptimet e mistikëve që në të menduar, si për çështje fetare, ashtu edhe për aso tokësore, ishin mjaft liberal, nuk u shkonte për shtati as autoriteteve fetare as atyre shtetërore. Kështu, të dy këto autoritete me qëndrimet e bindjet e Nezimit atakoheshin, sepse Nezimi, pa ngurruar fare, fliste për çështje fetare e shoqërore që sipas tij nuk shtroheshin mirë e mbarë. Kështu autoritetet dërgonin vazhdimisht akuza në Stamboll, në dëm të Nezimit. Dhe me urdhër të Sulltanit, Nezimi burgoset për çështje politike dhe dërgohet në Stamboll. Nëpër burgjet e Stambollit, ku kishte kaluar rininë e tij, u dergj shumë derisa edhe vdiq nga kolera, më 1760.

Vdekja e Nezimit, sado tragjike dhe në rrethana mizore, kishte bërë jehonën e vet. Ajo i pikëlloi thellë miqtë besnikë dhe adhuruesit e shumtë të poezive të Nezimit. Njëri prej tyre që edhe Fejziu, poet që shkroi një epigram që flet shumë për kulturën e autorit dhe për fundin e tij tragjik: "Kjo është data e vdekjes së të dashurit Nezim, shqiptar prej katundit Frakulla ... Dhe kryetar i shumë dijetarëve dhe i pari i

faltarëve. I quajtur me mbiemrin Nezimi i të dashurit Ibrahim. Ekspert me plot aftësi, i virytit e i njohurisë. Njohës i kuptimeve të fshehta. Dijetar me pozitë të lartë. (Kur) fati e burgosi në dhe të huaj pa ndonjë faj. U martirizua, i përbuzur u nis për parajsë. Mirësia e Zotit ju bëftë mbështetje atij dijetari të kohës. Qan Fejziu që ia ndreqi datën e vdekjes në formën e quajtur muaxhemi duke hartuar këtë frazë. Prej burgut të kësaj bote Nezimi jeton në parajsë, 1173¹¹.

Divanet e Nezim Frakullës

Në Arkivin e Shtetit të Shqipërisë, është një fond i begatshëm dorëshkrimesh të krijimtarisë letrare shqipe me grafi arabe nga autorë të ndryshëm shqiptarë, të cilët, vetëm pjesërisht njihen, janë studiuar, apo më mirë të themi janë prezantuar në mënyrë informative nga studiues tanë, por që ende presin dorën e studiuesve për t'iu bërë studim i mirëfilltë me kriterë shkencorë. Ndër ato dorëshkrime janë edhe tri divane të Nezim Frakullës, dy në gjuhën shqipe me signaturë F. 43, D. 2 dhe F. 43, D. 3, dhe një në gjuhën turke, i cili gjendet në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë me signaturë An IX/10F.¹²

Divani i parë i evidentuar me signaturën F. 43, D. 2 ka gjithsejt 44 fletë (88 faqe) me 94 vjersha.

Në fletën e parë kemi dy bejte që mbajnë titullin "Guftë-i fekîr dervish Xhemal efendi der hakki xhanân" (Fjalë (vjershë) të varfrit Xhemil efendiut që është i dashur i Zotit). Ne nuk e dimë kush ishte ky Xhemal efendi, në ishte ndonjë prijës i ndonjë rendi fetar, apo edhe ndonjë mësues i Nezimit. Këto dy bejte janë:

Jam fakir, jam sadik,*
*Huda bilir halimi**.*
*Jam rezil, jam amik***,*
*Huda bilir dermanimi****.*

¹¹ Cit. sipas: Osman Myderrizi, punimi i cituar, fq. 58.

¹² Këto tre divane unë i kam në dorë të fotokopjuara, të cilat nga origjinali i ka fotokopjuar Dr. Robert Elsi dhe mua m'i ka sjellë akademik Rexhep Ismajli, prandaj u jam mirënjohës të dyve që patën mirësinë të m'i japin këto materiale.

* Jam varfënjak (asket), jam i drejtë,

** Zoti e di gjendjen time shpirtërore,

*** Jam i pacipë, jam i thellë (i paarritshëm)

Mbase, këto katër vargje shërbejnë si invokacion i tërë Divanit për të vazhduar pastaj të radhiten vjershat deri në fund të përmbledhjes

Ndërkaq, Divani i dytë i evidentuar me signaturën F. 43, D. 3, ka gjithsej 35 fletë (70 faqe), me 71 vjersha. Duhet të theksojmë se faqosja është bërë më vonë, sikur edhe vënia e numrave të vjershave. Kështu, në këtë divan i gjejmë të regjistruara me numra romakë I deri në XIV dhe nga vjersha 15 deri tek ajo 64 me numra arabë, dhe pastaj pasojnë edhe pesë sosh që nuk kanë numra. Si faqosja e fletëve, edhe regjistrimi i poezive me numra, sa mund të vërejmë, është bërë më vonë, mbase nga punëtorët e Arkivit të Shtetit, apo nga ndonjë studiues që i ka shfrytëzuar këto divane për nevoja të veta. Ky Divan fillon me vjershën për Teferixhin në Bilçe dhe përfundon me vjershën "Divani manzume Nezim Ibrahim beg rahmetullahi alejhi" (Divani në vargje i Nezim Ibrahim begut, Zoti e mëshiroftë atë), e cila ka gjashtë bejte (kuplete) në gjuhën turke, por është e pamundur të lexohen për shkak të fotokopjes së dobët, dhe pastaj janë edhe dymbëdhjetë vargje shqip (që mund të jenë përkthim i bejteve turqisht), ku shohim se Nezimi Divanin e kishte nisur në emër të Zotit dhe dashurisë ndaj Tij, si dhe që zemra i rreh për profetin Muhammed:

Bismil-lahi nisa divanë

Me sevda tënde ja Mevla,

Për Muhammed Mustafanë

Zemra rrate ja Mevla.

dhe në frymë të misticizmit islam e përfundon me dy vargjet, ku thotë se Nezimi nuk e do kënaqësinë, prandaj kërkon nga Zoti t'i japë mundime, vuajtje:

Nezimi s'e do sefanë,

Jepi xhefanë, ja Mevla.

Duhet të theksojmë se në divanin e dytë janë 14 vjersha që përsëriten nga divani i parë, ndërmjet të cilave nuk ka ndryshime të theksuara, pos ndonjë fjale a vargu. Po ashtu duhet të përmendim se në të dy divanet kemi nga një poezi të shkruar me radhitje sipas alfabetit arab, ku çdo varg fillon me germën sipas radhitjes në alfabetin arab, dhe dy vjersha në divanin e parë janë të shkruara në dy gjuhë, ku

**** Zoti e di ilaçin tim.

vargu i parë është në turqishte, ndërsa i dyti në gjuhën shqipe. Mendoj se këto poezi janë të nivelit të lartë artistik (vargu në turqishte është tetërrokësh, ndërsa ai shqip pesërrokësh) të paralelizmit gjuhësor, të dedikuara për një rreth të caktuar intelektualësh e njohësish të mirë të gjuhës turke, por edhe perse e arabe dhe të letërsive të shkruara në këto gjuhë. Gjithashtu, do pasur parasysh se kjo në këtë fazë ishte e kuptueshme, sepse intelektualët shqiptarë të formuar në Stamboll e qendra të tjera të kulturës, fillimisht nisin të krijojnë në gjuhët orientale, ndërsa kjo metodë e Nezimit mund të ishte nxitje për ata dhe për të tjerët se edhe shqipja ishte gjuhë e bukur me të cilën mund dhe duhej të shkruhej poezi (siç kishin vepruar në fillim edhe disa poetë turq), dhe në këtë mënyrë Nezimi me krijimin e këtyre dy poezive në dy gjuhë, por edhe me ato në gjuhën shqipe, ka kontribuar bukur shumë për krijimin e gjuhës letrare, respektivisht gjuhës poetike, në kohën e tij, sado që gjuha e tij ishte e stërngarkuar me orientalizma, që mendojmë se shfaqnin ambientin kulturor të atëhershëm të popullit tonë, sidomos të rrethit e të ambientit të qytetit shqiptar, çfarë ishin Berati, Vlora, Elbasani etj., qytete këto që edhe përmenden në poezitë e Nezimit.

Dhe me këto dy poezi të krijuara në dy gjuhë, Nezimi tregon talentin e tij poetik dhe dëshmon se kishte shije për krijim duke përfillur vlerat metrike të të dy gjuhëve, dhe këto zbulojnë bukurinë e tekstit poetik të këtij shkrimtari të madh shqiptar, i cili shpresojmë se do të zërë vendin që duhet ta ketë në historinë e letërsisë shqipe.

Dy divanet shqip të Nezimit, mbase nuk janë dorëshkrim i të njëjtit person. Divani i parë është i shkruar pa vokalizim, kurse tjetri me vokalizim. Fjala është për vokalet e shkurtra që arabishtja nuk i shënon me shenja të veçanta, por vetëm në raste shumë të veçanta i shënon me shenja diakritike, që vihen mbi ose nën bashkëtingëlloren përkatëse¹³. Prandaj është vështirë të besohet se këto dorëshkrime mund të jenë autografe, ndonëse mund të mendohet që divani i shkruar pa vokalizim të mund të jetë edhe autograf, por për një konstatim të tillë nuk kemi prova bindëse. Poezitë e Nezimit qysh gjatë jetës së tij ishin popullarizuar, dhe veçmas pas vdekjes së tij,

¹³ Për zanoret dhe shënimin e tyre grafik në gjuhën arabe, shih: Srdjan Janković, **Arapski izgovor s osnovama arapskog pisma**, "Svjetlost", Sarajevo, 1987, fq. 57-58.

kanë qarkulluar shumë poezi të tij të përshkruara nëpër teqe të ndryshme anëmbanë trojeve shqiptare.

Poeti në poezitë e tij, në disa vende na prezantohet si Ibrahim Nezim. Kjo na jep dorë të provojmë se Nezim është emri i tij poetik (mahlas), siç ishte shprehi e poetëve orientalë që të kishin emra poetikë. Pastaj ai edhe vetë në poezi përmend se Nezim është mahlas i tij:

Benim mahlasëm Nezimdir

Emrin e kam Ibrahim.

Të gjitha vjershat e përfshira në këto dy divane shqip, janë të shkruara në gjuhën shqipe, me përjashtim të dy poezive të shkruara në gjuhën turke. Pastaj, titujt e poezive, të gjithë janë të shkruar në gjuhën turke e persiane. Një numër i konsideruar i tyre janë titulluar sipas rimës, përkatësisht germës me të cilën rimon çdo strofë e vjershës. Prandaj, ato vjersha që studiuesit tanë i kanë botuar nëpër historitë e letërsisë shqipe apo në revistat e ndryshme, janë të titulluara nga vetë ata që i kanë transkriptuar, që zakonisht kanë marrë vargun e parë të bejtit të parë që është bartës i mesazhit të vjershës. Titujt e vjershave të divanit të Nezimit, me gjasë janë shkruar me ngjyrë të kuqe, andaj në fotokopjen që ne kemi shfrytëzuar, kanë dalë shumë dobët. Për këtë arsye, disa prej tyre nuk mund të lexohen, e disa mund të lexohen pjesërisht.

Për karakteristikat e grafisë arabe që Nezimi ka përdorur për të shkruar shqip, mund të themi se ai ka përdorur metodën e turqishtes së atëhershme, e cila shkruhej me grafi arabe, pa bërë ndonjë përpjekje për të gjetur ndonjë shenjë grafike për tingujt specifikë të gjuhës shqipe. Kështu pra Nezimi mjaftohet me ato përshtatje e modifikime që i kanë bërë grafisë arabe persianët dhe turqit.¹⁴

Mbi poezitë e Nezimit

Si krijues i divanit të parë në letërsinë shqipe konsiderohet Nezimi, dhe kjo ishte një risi në letërsinë tonë. Dihet se divani në letërsinë

¹⁴ Për përshtatjet grafike të bejtexhinjtë shih: Abdullah Hamiti, *Vështirësitë e leximit të teksteve shqipe me grafi arabe*, në: Seminar i Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 19, Prishtinë, 2001, fq. 143 - 157.

orientale është përmbledhje poezish me një strukturë të caktuar nga përmbajtja dhe forma. Divani, pra, është një përmbledhje poezish me renditje të veçantë. Kemi divane ku janë përmbledhur poezi lirike të një ose të shumë poetëve. Divani zakonisht fillon me lutje Allahut, vazhdon me gazele (lirika të dashurisë dhe të kënaqësisë tokësore ose për çështje të fesë e të filozofisë) dhe vazhdon me kaside (vjersha të gjata (ode) me përmbajtje të ndryshme, përshkruese, satirike) e mbyllet me kasidet panegjirike për sulltanin ose sundimtarë e padronët vendës. Ka gjasë që Nezimi të mos i jetë përmbajtur me përpikëri strukturës klasike të divanit. Nga pikëpamja e përmbajtjes do theksuar se nuk kemi ndonjë renditje të qëndrueshme. Në renditjen që shohim, ka gazele, pasojnë kasidet, prapë gazelet pa ndonjë renditje të përpiktë. Gjithashtu kemi një përzierje edhe sa i përket përmbajtjes tematike të poezive. Pra, format poetike që ka përfshirë Nezimi në divanin e tij, janë kasidja, e cila zakonisht përbëhet prej njëzet deri 100-120 bejtesh. Për nga forma, dy vargjet e para kanë rimë, ndërsa dy të tjerat kanë rimë të kryqëzuar. Ndërkaq gazeli është një formë poetike e përmbajtësore lirike që përbëhet nga një numër më i vogël bejtesh, prej dy deri në 12, me rimë të njëjtë. Në bejtin e parë të quajtur "matla", të dy gjysmëvargjet rimohen njësoj. Vargu i fundit ose "makta" përmban pseudonimin (mahlasin) e poetit. Gazeli është vjershë për dashurinë, verën, pranverën, dhe për të shfaqur edhe emocionin fetar.

Letërsia turke, sidomos poezia, ishte nën ndikim të fuqishëm të shkollës letrare persiane, e cila shquhej nga afiniteti për artizëm, i cili në shek. XV arrin kulmin me poetët e dalluar Abdurrahman Xhami, Mevlana Xhelaluddin Rumi etj. Fryma e shpirti i shkollës së misticismit dhe tendenca nga të shprehurit alegorik - tash tërësisht kishte përfshirë poezinë osmane, si atë lirike, ashtu edhe atë epiko romantike. Romancat e dashurisë dhe heronjtë e tyre, Mexhnuni dhe Lejla, Husrev dhe Shirin, kishin humbur veçorinë e tyre profane dhe ishin bërë shprehje e dashurisë ndaj Zotit dhe njësimi me të.

Është e natyrshme që edhe letërsia në gjuhët orientale, po edhe ajo në gjuhën shqipe, në tokat shqiptare, t'i ketë ndjekur principet e poetikës orientale kur është fjala për formën, zhanrin, idealin e jetës, dhe përfundimisht edhe për idealin artistik. Mirëpo, duhet të theksojmë

faktin se poetët e viseve tona, krahas përvetësimit të punimeve të poetikës dhe të letërsisë arabo-persiane, njëkohësisht janë ushqyer me shprehjen dhe format e poezisë sonë popullore, kanë treguar më shumë realizëm dhe kanë shprehur më thellë ambientin lokal.

Nezimi në krijimtarinë e tij poetike (turqisht dhe shqip) është shquar për shprehje origjinale dhe është përpjekur që poezisë t'i jepte ngjyrë lokale, karakter praktik, që ta kthente në jetë. Por përpos kësaj, si poetët e dalluar turq-Baki (v. 1600), Nefi (v. 1635), Nabi (v. 1712), Nedimi (v. 1730), edhe Nezimi ka mbetur nën ndikim dhe në kuadër të shkollës neopersiane, kur kemi të bëjmë me format, zhanrin dhe leksikun poetik. Tekefundit, ndikimi i literaturës klasike persiane ishte shembull e model për shkrimtarët e poetët turq, por edhe për ata shqiptarë që shkruan me grafi arabe, si në aspektin estetik-formal, ashtu edhe në atë ideor deri në fund të shekullit 19.

Kështu, duke shfletuar divanet e Nezimit, nuk është vështirë të vihet re se ai nga çdo aspekt është nën ndikim të poezisë orientale-islame; fundja, edhe te popujt e tjerë të islamizuar ishte vështirë të gjeje ndonjë poet krejt origjinal. Si shumë poetë turq, edhe Nezimi ishte i ndikuar shumë nga poetët klasikë të famshëm persianë, duke u përpjekur që mangësinë e ideve ta kompensonte me virtuozitete gjuhësore e poetike. Duke pasur parasysh këtë, për Ibrahim Nezimin mund të themi se nuk mbetej shumë prapa bashkëkohësve të tij që krijojnë në gjuhët orientale. Madje ai veten e konsideron poet të kalibrit të lartë, duke e krahasuar me poetët e njohur turq, dhe, mbase për të treguar talentin dhe mjeshtërinë e tij artistike, ai pati shkruar në gjuhën turke. Studiuesi R. Elsi, duke shkruar se Nezimi mbahej si Sadiu dhe Hafizi i kohës së tij, dhe se kasidet e tij në shqipe i krahasonte me ato të Urfiut në persishte dhe të Nefiut në turqishte, thotë se për shumë specialistë krahasime të tilla janë të tepruara¹⁵.

Nga poezitë e përfshira në dy divanet e tij shqip, mund të shihet se Nezimi i njihte thellë disiplinat e dijes islame, problematikën e mendimit islam, sidomos thellimin e tij në çështjen e transhendencës së Zotit, të përfytyruarit e të njohurit e Zotit, që ishte bërë bosht i poezisë së misticizmit islam, ngase Islami burimor ndalonte të menduarit

¹⁵ Robert Elsie, **Histori e letërsisë shqiptare**, Dukagjini, Tiranë - Pejë, 1997, fq. 75.

e thellë rreth kësaj çështjeje duke u mjaftuar me ato që për veten thoshte Allahu. Sidomos vërehet ndikimi i klasikëve të njohur iraniane, si Xhami, Attari, Hajami, Firdevsi, Shirazi, Rrumiu etj., si edhe i teknikës letrare të kohës, respektivisht i letërsisë orientale islame. Madje, jo vetëm që vërehen lehtë reflektimet dhe ndikimet e poezisë orientale, porse ajo është e shkruar si poezi shqipe e asaj shkolle, sepse lidhjet poetike të Nezimit me poezinë orientale-islame janë të natyrshme, madje edhe të pashmangshme, pasi ai u shkollua e u formua në ato shkolla dhe në atë frymë. Kështu, jo vetëm që kompozicioni dhe forma në shumë poezi të Nezimit u përgjigjen plotësisht atyre të natyrës së këtillë të poetëve të tjerë mistikë - orientalë, por edhe pjesë të caktuara të poezive të tij mistike na dalin shumë të ngjashme me pjesë të poezive mistike turke, persiane e arabe. Prandaj integrimi i gjithanshëm i ndikimeve të përmendur, që mund të argumentohen qysh te krijimtaria e Nezimit, krijuesit më të hershëm nga bejtexhinjtë, që njohim sot, do të vërehen në tërë krijimtarinë e bejtexhinjve, që është pjesë përbërëse e letërsisë shqipe, dhe gjithsesi këto ndikime duhet të merren edhe si tregues të nivelit të depërtimit të kulturës islame te intelektualët dhe te shtresat e gjera popullore shqiptare.

Nuk ka dyshim që numri më i madh i poezive të Nezimit janë të karakterit fetar, pra poezi mistike islame. Misticizmi islam ishte karakteristikë dalluese jo vetëm për Nezimin, po edhe për shumë shkrimtarë shqiptarë që shkruan me grafë arabe. Tekefundit, ata ishin formuar në këtë frymë, andaj edhe morali i tyre, dhe përgjithësisht mendimi që kanë për jetën dhe botën, është i karakterit fetar - mistik islam. Si Nezimi, edhe dijetarët e tjerë islamë të pajisur me moral e dituri islame, gjatë jetës janë marrë me përhapjen e këtij morali dhe të këtyre diturive islame, dhe nga masa ata konsideroheshin si persona të shquar në jetën fetare. Sidomos të tillët si Nezimi, që merreshin me doktrinën e misticizmit islam. Natyrisht, kjo nuk përjashton vetëdijen, mbase edhe angazhimin e tyre jashtë vetëdijes fetare, si ai iluminist, patriotik e shoqëror. Mirëpo, kjo nuk na jep të drejtë që të theksojmë e të vëmë në pah vetëm ato poezi të Nezimit, ku gjejmë përmbajtje iluministe, patriotike a shoqërore e sociale. Sepse, do të bëhej padrejtësi e madhe ndaj autorit, pasi ai në poezitë e tij, në radhë të parë nxjerr në shesh vetëdijen dhe kënaqësinë fetare dhe jetën, vlerat

tokësore (mendimin e moralin) ai i sheh në prizëm të misticizmit islam. Dhe krejt talenti e afshi poetik i Nezimit të madh vihet në pah pikërisht me poezitë e tij mistike artistikisht të realizuara shumë bukur, në figuracionin dhe simbolikën e tyre, dhe kjo duhet thënë pa ngurrim e të trajtohet pa paragjykime. Kjo poezi që flet për moralin islam, për përsosjen shpirtërore, tekefundit, reflekton edhe rrjedhat shoqërore që në atë kohë zhvilloheshin edhe nëpërmjet vetëdijes fetare. Dhe duke pasqyruar kështu edhe preokupimet e pakënaqësitë shpirtërore e tokësore të masave fetare islame të cilave u dedikohej, ai shprehte në këtë mënyrë edhe nivelin e përgjithshëm shoqëror-kulturor të kohës kur jetoi e veproi poeti. Fundja, kjo ishte poezia që i përshantaj nivelit të vetëdijes fetare e kulturore të masës.

Misticizmi islam është një temë shumë e gjerë dhe komplekse. Do të mundohemi të japim vetëm ca njohuri të përgjithshme për të, duke veçuar disa nga karakteristikat themelore të kësaj teme, sepse "Misticizmi islam nuk mund të vështrohet i izoluar, si veprimtari e veçantë spirituale, por duhet të merret në kompleks të asaj çështjeje e cila quhet Islam dhe civilizimi i tij"¹⁶

Kështu misticizmi islam pra është zhvilluar nga meditim i kuranor. Duke medituuar dhe interpretuar temat e ndryshme kuranore, sidomos duke u thelluar në kuptimet e fshehta spirituale, që ndryshojnë nga kuptimet e dukshme, kemi edhe kuptimet themelore të zhvillimit të misticizmit islam. Tema që më së shumti meditohej në misticizëm, padyshim ishte përsiatja e njohja e Zotit të gjithëfuqishëm, i cili bën ç'do, i cili është krijues i gjithçkaje dhe i cili është i përherëshëm, përdërisa të gjitha ato gjallesa e krijesa të Tij do të mbarojnë e të shkatërrohen.

Dy janë aspektet në bazë të të cilave mund t'i qasemi Islamit: aspekti ekzoterik dhe aspekti ezoterik, dhe këto dy aspekte gjejnë shprehjen që në fazën e parë të zhvillimit të Islamit. Që të dy këto aspekte të qasjes ndaj Islamit pretendojnë të kenë mbështetjen e vet në Kur'an dhe në traditën e profetit Muhammed (synet). Si bartës të Islamit ekzoterik paraqiten dijetarë-teologët që konsiderojnë që detyra themelore e çdo muslimani është t'i plotësoj normat religjioze dhe morale të

¹⁶ Nedim Filipoviç, *Tasaëüf - islamski misticizam*, Prilozi za orijentalnu filologiju, XXIV / 1974, Sarajevo, 1976, fq. 13.

përcaktuara në bazë të ligjit hyjnor, përkatësisht anës së jashtme të ligjit - Sheriatit.

Mistikët mendojnë se me respektimin e udhëzimeve praktike të Sheriatit mund të jetosh në harmoni me hakikatin, por nuk mund të arrish njohjen e tij që quhet ma'rifa. Vetë ma'rifa (njohja) nuk është e kapshme për çdokënd. Ma'rifa është njohje mendore e së vërtetës absolute (hakikat). Kjo është njohje që ekzistencialisht ndërron të qenit (ekzistimin) e njohësit. Të njohësh të vërtetën, domethënë të njësoshesh me të, të jesh një me Allahun.

Kështu, tesavufi (misticizmi islam) ekzistimin e vet e bazonte në interpretimin ezoterik të Islamit. Pra tesavufi nisët nga ekzegjeza ezoterike e Kur'anit dhe e traditës së profetit Muhamed (syneti) dhe vazhdon hermenautikën e njëjtë. Kështu tash mendohet se me rrymën e misticizmit i jepet theks i veçantë kërkesës për mendim të thellë, të hapur e të lirë. Andaj, tash pretendohet një jetë aktive brenda besimit, dhe kjo emërtohet me ilmi batin, pra mësim i brendshëm i fesë. Pra-ndaj tash tesavufi, pos anës formale të fesë, merret me esencën e saj, me idetë, mendimet dhe kuptimet, me hulumtimin e së padukshmes, të fshehtës, e kjo pra të tillët i bënë aktivë në mendim. Dhe kështu fillon përhapja e kësaj rryme, pra e rrymës së Tesavufit që si fazë të hershme ka atë të shek. VIII e pastaj fazë të zhvillimit të vet të theksuar atë të shekujve X –XII, kur do të zinin të lindnin rendet (tarikatat)¹⁷ islame dhe tashmë pos Sirisë e Bagdadit, kjo frymë e të menduarit mistik islam kalonte në Iran, Turqi e Indi dhe pastaj edhe në vise të tjera. Dhe në këtë mënyrë do të zhvillohej letërsia shumë e pasur tesavufe e jotesavufe, në të cilën ideologjia e tesavufit edhe tematikisht edhe artistikisht do të ndikonte thellë.

¹⁷ Tarikat është shumës i fjalës Tarik që do të thotë rrugë për të njohur Zotin, respektivisht zhvillimi praktik i jetës i plotësuar sipas rregullave dhe principeve të përcaktuara të asaj rruge. Çdo tarikat / rend ka themeluesin e tij sipas të cilit edhe është emërtuar. Për tarikatat shih: Dr. Selçuk ERAYDIN, **Tesavufi dhe tarikatat**, (përktheu Metin Ize-ti), Tetovë, 2001, f. 428; Prof. Dr. Süleyman Uludağ, **Tasavvuf terimleri sözlüğü**, İstanbul, 1995, s. 510-511; Jashar Rexhepagiqi, **DERVISHËT, RENDET DHE TEQETË në Kosovë, në Sanxhak e në rajonet e tjera përreth, në të kaluarën dhe sot**, Dukagjini - Pejë, 1999; Hans Joahim Kisling, **DERVISKI REDOVI I PUČKI ISLAM**, në: **SUFIZAM**, Izdanje "Vuk Karadžić", Beograd, 1981, s. 118-126; Metin Izeti, **Tarikati bektashian**, Tetovë, 2001, f. 184. etj.

Tesavufi pra përqendrohet në mendimin për Zotin, në dëshirën që të arrihet afria e Zotit dhe mëshira e Zotit, pra që të njihet Ai. Ndërkaq, Zoti mund të njihet vetëm atëhere kur egoja njerëzore shlyhet krahas pambarueshmërisë së Zotit, në përputhje me fjalët "Nuk ka hyjni pos Zotit". Sipas mësimit sufist, organi me të cilin njeriu njeh praninë e Zotit nuk është mendja, por zemra. Tash si mjet për t'iu afruar Zotit është dashuria ndaj Zotit (mahabba /ashk). Në këtë dashuri kemi procesin metafizik të dashurisë së njeriut ndaj Zotit. Dhe dashuria e zjarrtë e mistikëve ndaj Zotit e aventurat e tyre shpirtërore të vuajtjes si metoda të afrimit ndaj Zotit, kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve. Kjo mënyrë e afrimit ndaj Zotit dhe të njohurit e Tij bëhet me përjetimet e brendshme në tubimet e sufinjve me ritualin e quajtur "dhikër", të përmendurit e emrit të Zotit që ka për qëllim ta ndajë përkohësisht shpirtin nga trupi, duke e lodhur këtë të fundit deri në rraskapitje të plotë, pra simbolikisht domethënë akt spiritual në rrugë të privimit të vetes, të "Unit" individual trupor e shpirtëror, refuzimi i çdo gjëje pos esencës themelore të botës, Zotit; pra ky është synimi i mistikut të dashuruar në dashurinë e tij ndaj Zotit. Ritual i tjetër (sema) është ai që krahas muzikës dhe vallëzimit (rrotullimit që simbolizon rrotullimin e yjeve e të engjëjve në qiell), të krijohet atmosfera e ekstazës mistike e cila sufinjtë i shpie në rrugën e vetëshkatërrimit, pra në ndarjen e shpirtit nga trupi për të arritur gjendjen e njësimi me Zotin, përkatësisht njohjen e Zotit. Dhe pjesëmarrja në këto rituale fetare sufinjve u lejohet vetëm pasi të kalohet prova përgatitore asketike, ku muridi (kandidati për tarikat) duhet t'i nënshtrohet vullnetit të Zotit dhe të veprojë sipas urdhrave të shehut – mësuesit, i cili e përgatit për rrugën në kërkim të njohjes së Zotit.

Por duhet theksuar se me zhvillimin e tyre, rendet / tarikatat dervishe largohen gradualisht nga Islami burimor, duke lënë anash obligimet themelore islame e duke iu përkushtuar sa më shumë ritualeve të tyre, saqë mund të flitet edhe për devijim nga parimet islame e prishje të moralit islam. Po ashtu tek shumë rende dervishe ka zbatim të kultit të shenjtorëve ndaj personave të caktuar, sidomos ndaj themeluesve të rendeve dervishe (si vizita te varret e tyre e manifestime të ndryshme), por edhe ndaj shehlerëve-prijësve aktualë, e siç dihet, në Islam burimor kulti është i papranueshëm.

Numri më i madh i poezive të Nezimit ka karakter fetar, pra ato janë thjesht poezi të natyrës së misticizmit islam, nga të cilat shtrohet kërkesa për formimin e njeriut shpirtërisht dhe moralisht të përsosur. Dhe mbase këto janë poezitë më të realizuara artistikisht, për krijimin e të cilave Nezimi ka shfaqur prirje dhe përgatitje të lartë poetike. Në këto poezi të Nezimit është theksuar shumë filozofia dhe mendimi fetar-mistik, i cili ishte i zhvilluar shumë në letërsinë orientale-islame në kohën e tij.

Arsyeja pse Nezimi shkruan poezi fetare, do parë në përgatitjen e tij fetare si dhe tek masa me të cilën komunikon ai me poezinë e tij, në një anë, dhe, në anën tjetër, sepse në botën islame, në kohën e tij, poezia më e realizuar dhe më e kërkuar për masat e gjera popullore ishte poezia mistike me poetët e njohur të misticizmit, që shërbenin si frymëzim për poetët e ardhshëm të të gjithë popujt islamë.

Tashmë thamë se pjesa dërrmuese e poezive të Nezimit janë me tematikë fetare, pra poezi moralo-didaktike të mbështetura mbi konceptin dhe filozofinë e misticizmit islam. Dhe natyrisht se strumbullar i gjithë poezisë islame është Kur'ani, respektivisht burimi themelor për të njohur Krijuesin dhe Islamin. Në rrugën e tij të njohjes së Islamit dhe të Krijuesit të gjithësisë, Nezimi është nën ndikim të mistikëve të njohur të botës islame dhe të mësimëve të tyre, e kjo edhe do të ndikojë shumë në strukturën e poezisë së tij. Nezimi në poezinë e tij fetare moto ka krijimin e njeriut të përsosur- insani kamil, njeriut me virtyte të larta morale, me kulturë e vetëdije të theksuar fetare islame, dhe beson se në këtë mënyrë do të mënjanoreshin dukuritë e veçoritë e këqija tek njerëzit. Ai pra synon një shoqëri ideale, një shoqëri të devotshme fetarisht e të pastër moralisht, koncepte të përgjithshme këto të misticizmit e të filozofisë islame.

Natyrisht, ngjashmëritë midis poezive të Nezimit dhe letërsisë orientale janë të shumta dhe të gjithanshme, në përmbajtje, ide, përshkrime, simbole e të tjera. Poezitë e këtij krijuesi jo vetëm që janë me karakter fetar, por thjeshtë kanë të gjitha karakteristikat e poezisë së misticizmit islam, të shkruara sipas modelit të poezive mistike të kohës në botën islame. Në mesin e atyre poezive mistike, ka asosh me të cilat donte të formonte e të mbillte tek masat mendimin fetar dhe t'i njihnte ata me rregullat fetare, mbi të gjitha me ato të tarikatis që

mëtonte afrimin e krijesës njerëzore sa më afër pranisë së Perëndisë, duke u përshkruar atyre (dervishëve) mënyrën dhe rrugën - shkallët psikologjike që dervishët duhet t'i kalojnë me devotshmërinë dhe adhurimin e tyre ndaj Zotit, për të arritur në shkallën e pjekurisë së njeriut të përsosur, të pastër e të patëmeta (insani kamil) dhe kështu të arrijë ta njohë krijuesin e tij, Allahun, dhe të fitojë bekimin dhe kënaqësinë e Tij; pastaj asosh në të cilat në veçanti trajtohet dashuria ndaj Zotit, o në të cilat përshkruhet mënyra e kryerjes së ritualeve mistike, aso në të cilat përshkruhet rruga e ngritjes së dervishëve në gradat mistike, si: dervish ose fakir, salik, sheh, baba. Terminologjia e misticizmit përdorej dendur dhe kjo dëshmon për karakterin mistik të poezive të Nezimit. Prandaj, për t'i kuptuar këto poezi, duhet pajisje e gjerë intelektuale islame, dhe sidomos njohje e zhvillimeve të misticizmit islam dhe të tarikateve në botën islame, po edhe në trojet shqiptare, dhe sidomos të njihen e të kuptohen nocionet dhe termat e shumtë, që janë të lidhur ngushtë me misticizmin, përkatësisht me tarikatet. Pra, ato nuk duhen marrë thjesht si fjalë leksikore, por më tepër si terma, nocione me kuptim të caktuar teorik e filozofik. Sepse këta terma si dhe vetë praktika e ritualeve, kanë të bëjnë me psikologjinë, etikën, filozofinë e religjionit, kulturologjinë, letërsinë dhe jetën e situatat shpirtërore.

Siç kemi përmendur, si metodë për t'iu afruar Zotit, shërbejnë dashuria e zjarrtë e mistikëve ndaj Zotit dhe aventurat e tyre shpirtërore të vuajtjes. Natyrisht që mistiku me Zotin nuk njehet substancialisht, por me anë të dashurisë, duke hequr dorë nga "Unë" - individualiteti i vet, nëpërmjet dialogut të zemrës dhe Zotit. Kështu poezitë fetare të Nezimit, të shumtën flasin për ashkun, dashurinë ndaj Zotit, e Nezimi ishte mjeshtër për të thurur poezi të tilla që përshkruajnë dashurinë që duhet të ushqejnë muslimanët ndaj Zotit; në to përshkruhet mënyra si të kultivohet ajo dashuri, si të arrihet ajo, pra rruga si fillon e si arrin kulmin ajo dashuri ndaj Zotit. Nezimi, i cili me ëndje të madhe e me përjetim shpirtëror shkruante poezi të tilla, e konsideron veten myderriz (profesor) të ashkut dhe në këtë disiplinë i jep درس gjithë dynjasë, një vetëbindje e madhe e autorit. Do të thoshim se me të vërtetë poezitë e tij të kësaj natyre janë shumë të mira dhe se në to refle-

ktohet mjeshtëria e mistikëve më të mëdhenj, të cilët gjithsesi do t'i kishte lexuar Nezimi, prandaj veten do ta quante mësues të ashkut:

Në ashk u bëshë muderris

Derse u jap gjith dynjasë,

Ai zot i bëftë muflis

Hileqarët e sevdasë.

Në shumë vjersha të Nezimit ka elemente të asketizmit, pra mësimi për asketët, sidomos për atë që niset në udhë të njohjes së Zotit, porositi që të sakrifikojë çdo gjë dhe ai që nuk e ka bindjen, nënshtrimin, bëhet maskara në jetë. Në misticizëm vuajtjet, dhimbjet, mundimet konsiderohen të natyrshme dhe të preferueshme, ngase ato vijnë nga Zoti, të cilin e kërkojnë ta njohin e me të cilin të njësohen, e rruga më e mirë për t'i arritur këto synime, është dashuria që mistiku ushqen e kultivon ndaj Zotit, prandaj e Nezimi shkruan:

*Le të vinjë xhefaja**

*Të më shuhetë sevdaja**.*

Në poezinë e fundit të divanit të dytë me titull "Divan-i manzume Nezim Ibrahim beg rahmetullahi alejhi" (Divani në vargje i Nezim Ibrahim beut, Zoti e mëshiroftë) shohim qartë frymën mistike të Nezimit, ku ai thotë se zemra i rreh për dashurinë ndaj Zotit e për Muhammed Mustafanë, dhe se të gjithë dertlinjtë mendtë në një nur (dritë - Zot) i kanë që t'i luten Atij për t'u dhënë jetë të gjatë dhe aty mësojmë se ai dashurinë ndaj Zotit e konsideron të drejtë, rrugë të vërtetë për të njohur Zotin dhe përfundon duke kërkuar nga Zoti t'i japë mundime, sepse, siç e dimë, asketët dëshirojnë të përjetojnë sa më shumë mundime e vuajtje në këtë botë, me qëllim që të pastrohet shpirti i tyre. Ai thotë se nuk e do sefanë:

Bismil-lahi nisa divanë

Me sevdë tënde ja Mevla,

Për Muhammed Mustafanë

Zemra rrate ja Mevla.

Hakikat e zë sevdanë

Mexhazenë e lë më një anë,

Nezimi s'e do sefanë

* xhefaja = mundimi.

** sevdaja = dashuria.

Jepi xhefanë ja Mevla.

Në mbarë poezitë e Nezimit është i pranishëm mendimi mistik, si vetëdije aktive, si vetëdije dhe filozofi e të kuptuarit të jetës dhe botës përreth. Pra, qëndrimi aktiv dhe i njohjes ndaj fesë është i pranishëm në tërë korpusin poetik të Nezimit, dhe, siç dihet, ky është shkrimtari më i hershëm bejtexhi që është zbuluar dhe që njihet sot¹⁸. Mund të thuhet se të gjitha poezitë e tij janë të realizuara me sukses në këtë aspekt, dhe se me gjykimet e thella filozofike - mistike, me shtruarjen e shkathët të lëndës poetike, si dhe me idetë themelore që dalin, këto poezi mbase mund të konsiderohen ndihmesë e madhe për ta kuptuar mirë e drejt poezinë e misticizmit islam, e cila tek shqiptarët me ëndje do të krijohet edhe dy shekuj pas Nezimit.

Nga poezitë e Nezimit del se në shoqërinë e kohës së tij feja mbi-zotëronte dhe përcaktonte kriteret me normat morale, pra ajo jepte porositë për veprime e sjellje morale dhe i argumentonte ato.

Sjelljet dhe qëndrimet, respektivisht ndjenjat e njerëzve që duhen çmuar si vlera Nezimi i shikon përmes së mirës dhe së keqes, dhe si vlera morale paraqet të mirën, nderin, besnikërinë, drejtësinë, urtësinë, bindjen - të cilat i preferon si vlera që njeriu besimtar duhet t'i përvetësojë dhe t'i praktikojë në jetë. Po ashtu, nga poezitë e tij moralizuese mësojmë se të ligat, hipokrizia, zilia, të këqijat, janë shkatërrim i vlerave morale, ato shkatërrojnë shpirtin e njeriut, prishin qenien e tij, karakterin e tij dhe njeriun e bëjnë të konsiderohet si kafshë. Pasojat e të këqijave që për njeriun i shpreh me një porosi të qartë në këto vargje:

*Hasedçiu e munafiku**
Të gjithë shejtanë janë.
ose

*Munafiku është hain**,*
*Munafiku është lain***,*

¹⁸ Si poet më i hershëm se Nezimi merret Muçi Zade, nga i cili ekziston një lutje e bukur e një kafemani "Imzot, mos më lerë pa kave!" e përbërë prej 17 strofash katërshe, e shkruar më 1725.

* Hasetçiu e munafiku = Ziliqari e hipokriti

** hain = hajn.

*** lain = i mallkuar, i urrejtur.

Kush e di vet-henë mu'min ****

I lutem t'e bënj hadher *****.

Poezia e tij pra është moralizuese dhe ideja kryesore që karakterizon moralin e Nezimit, është se njeriu është qenia më e përsosur që ka krijuar Zoti në natyrë, prandaj si e tillë duhet të çmohet e të respektohet. Natyrisht që këtë ide të tijën Nezimi e mbështet mbi parimet fetare të shpallura me Kur'an dhe e shpreh me figurën fetare plot nuanca mistike islame. Figurat me të cilat shpreh idetë dhe idealet e tij, siç është respektimi dhe ngritja e njeriut, i mbështet në parimet islame, të cilat mëtojnë njeriun e pastër, si qenie të përkryer, të fuqishme dhe më të vetëdijshmen që ka krijuar Allahu, por qenie e cila duhet t'i nënshetrohet Allahut. Dhe, natyrisht, Nezimi më pastaj përshkruan rëndësinë e jetës që do ta jetojë njeriu. Por, si mistik, sado që përshkruan edhe bukuritë e kësaj bote-dynjasë dhe vlerën e saj, ai lexuesin, respektivisht, besimtarin do ta përgatitë shpirtërisht për kënaqësinë e njohjes së Perëndisë, që të mos jepet shumë për këtë botë por të përgatitet për parajsë, ku do ta presë jeta e amshueshme e botës tjetër-Ahiretit:

Kush e ka xhenetnë laik

Këtë dynja nuk e bën mik.

Nezimi, si besimtar islam, ndjek bindjet islame se të gjithë njerëzit do të vdesin, prandaj porositi që njerëzit të kujdesen se ç'punojnë dhe të mos jenë të pakujdesshëm në këtë jetë. Ai ankohet se njerëzit nuk e mendojnë jetën tjetër Ahiretin:

Gjithë atje do të vemi

Mjerë ne se ç'mendojmë,

Gafilë në jetë jemi

Ahiretnë s'e mendojmë.

- vijon -

**** mu'min = besimtar.

***** hadher = kujdes.

Dr. Qazim Qazimi

Një vepër e pabotuar e Muhamed Çamit

Në përpjekjet e pareshtura të intelektualëve shqiptarë për ta shkruar shqipen, në themelet e abëcësë sonë një gur themeltar vuri edhe Muhamed Çami. Dihet se lëvizja për abëcënë shqipe ka historinë e vet të gjatë dhe shumë të mundimshme. Lufta për abëcënë dhe shkrimin shqip ka pasur një rëndësi vendimtare për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.¹

Që në krye duhet thënë se Muhamed Çami, përveçqë ka qenë poet, ai shërbeu si myderriz, po edhe si hoxhë-imam në fshatin e tij, ku, përveç shërbesave të tjera, mbante edhe “*hudbet*”-(ligjëratat e së premtës dhe të bajrameve), që rëndom, sipas traditës, i fillonte në gjuhën arabe dhe më pastaj i zgjeronte dhe i shtjellonte në gjuhën shqipe.

Duke pasur parasysh nivelin arsimor të pjesës dërrmuase të popullatës në një anë, besimin e paluhatshëm të asaj mase në atë kohë, në anën tjetër, pastaj përgatitjen e lartë shkollore dhe profesionin e Muhamed Çamit, duhet kuptuar se pse ai në veprat letrare të tij, qëndrimet, mendimet, dhe botëkuptimet ndaj ngjarjeve dhe situatave historike, i shtron, i analizon dhe i zgjidh në frymën fetare, në përputhje me konceptet kuranore, mbi parimet e filozofisë islame dhe me dispo-

¹ Ibrahim D. Hoxha, “*Nepër Udhën e Penës Shqiptare*”, “Shtëpia Botuese e Librit Shkollor” Tiranë, 1986, f.84-85.

zitat e normat e Sheriatit islam. Prandaj, mund të thuhet lirisht se gati të gjitha veprat letrare të Muhamed Çamit i përshkon fryma islame.

Edhe poemat *”Erveheja”* dhe *”Jusufi e Zulejhaja”*, që janë vlerësuar si poema erotike, përshkohen nga fryma fetare islame. *”Erveheja”*, është poemë moralizuese fetare që ka mbështetje në Sheriatin islam, po edhe poema tjetër, *”Jusufi e Zulejhaja”*, është po ashtu poemë moralizuese, e motivuar nga Kur’ani.

“Risale-i Bergjevi”

Një vepër me shumë rëndësi ndër veprat e pabotuara të Muhamed Çamit është përmbledhja **“Risale-i Bergjevi”**, një tufë poezish prej 37 vjershash moralizuese, iluministe e fetare.

Këtë përmbledhje vjershash Muhamed Çami, sipas të gjitha gjasëve, e përshtati nga një vepër në turqishte, e emërtuar me të njëjtin titull *“Risale-i Bergjevi”*, por e shkruar në prozë. Autor i kësaj vepre në gjuhën turke është Muhamed bin Pir Alij. Vepra e përmendur në turqisht ka 99 faqe të shkruara me alfabetin arab të përshtatur për turqishten.² Përkujdesin për shtypjen e kësaj vepre dhe shtypjen e saj e bëri Abdurrahman El-Muderris.³

Dhimitër S. Shuteriqi, në lidhje me *“Risale-i Bergjevi”* të shkruar nga Muhamed Çami, thotë:

“Mehmet Alushi, në Konispol, ruante, gjer aty para pak vitesh një radhua me germa arabe, të shkruar shumë bukur dhe që mbante vjersha të ndryshme të M. Kçykykut (Çamit). Radhoi ishte i vitit 1242 h./1827 m., dmth. i kohës kur poeti jetonte. Shkrimi mundet të ketë qenë i këtij (formati Q.Q.) 18 x 12 cm. Kanë qenë 144 fq. pa 29 fq. e para dhe fq.33-36 ishin grisur. 37 vjersha moralizuese fetare, mbi 3,700 vargje, në strofa ABAB, tetërrokësh.”⁴

Nga hulumtimet tona, vihemi në dijeni për një fletore në dorëshkrim me alfabet arab, të adaptuar për shqipen - (*Risale-i Bergjevi*) dhe të papublikuar asnjëherë deri më sot. Dorëshkrimi përbëhet prej 37

² Muhamed bin Pir Alij, *“Risale-i Bergjevi”*, Uskidar-Istanbul, 1220 h., f. 2.

³ Muhamed bin Pir Alij, *“Risale-i Bergjevi”*, Uskidar-Istanbul, 1220 h., f. 99

⁴ Dhimitër S. Shuteriqi, *“Shkrimet Shqipe, në vitët 1332-1850”*, “Rilindja”, Prishtinë, 1978, f. 191.

vjershash dhe i është dorëzuar Arkivit Shtetëror në Tiranë, nga ana e Ibrahim D. Hoxhës me porosinë e Mehmet Alushit. Jemi të bindur se kjo fletore ishte ai radhoi për të cilin flet Dhimitër S. Shuteriqi. Fletorja ishte e dëmtuar dhe ishte pa fillim dhe pa mbarim, por ishte ruajtur nga fq.28-144. Të humbura e të grisura janë edhe 4 faqe në mes, faqet 33-37 të kësaj fletoreje, pra edhe këtu mungojnë dy vjersha.⁵ Një kopje (fotokopjim të origjinalit) të kësaj fletoreje të shkruar me dorë të Muhamed Çamit me alfabet arab, të përshtatur për shqipen, e kam unë.

Ndër 37 poezitë e veprës “*Risale-i Berxhevi*” të Muhamed Çamit, është edhe vjersha:

Pesë vaktaet namaz dhe shartet islame

*Pas këtime isht iktiza
kundër i besuam të tëra,
turqëria (islami) shturi bina,
gjene përmbi pesë gjëra.*

*Dhe të pesa t'i besojmë
dhe t'u sjellim imanë,
emër kemi t'i punojmë
me gjithë sharte që kanë.*

*Protoparë shehadetnë,
të besojmë Perëndinë,
për atë bejmë ibadetnë
edhe gjithë robërinë.*

*Dhe e dita, në çdo ditë
pesë herë të falemi,
Zotit që s'ka shoq të ditë,
gra e burra borç e kemi.*

⁵ Shih dorëshkrimin e Muhamed Çamit “*Risale-i Bergjevi*”, Fondi nr.65, dosja 176, Arkivi Shtetëror, Tiranë.

*E treta isht Ramazani
edhe neve e besojmë,
farz na e bëri Rrahmani
prerazi të agjërojmë*

*E katërta isht zeqati
sa sërmë të mban kuleta'
farz na e bëri sherhati
të japç një grosh në të dizeta.*

*E pesta ishtë Qabeja,
që të veç ta bëj zijaret,
në isht që të ka qesjea
dhe All-llahu të dha shëndet.*

*Brënda dhe jasht në namaz
dimbëdhjetë sharte janë,
Al-llahu na e bëri farz,
gjithë vend' e tire kanë.*

*Perendija dha haberë,
po hap sit', mlith fiqirë,
gjashtë sharte t'i bëç ezber,
jashtë namazit pa hirë.*

*Vetëhenë fort t'e pastroç,
merr dhe abdes të bukurë,
avret jerinë ta mbuloç
si ndë njerëz dhe fshehurë;*

*Të diç dhe vaktinë kur hin,
kthehu dhe dogri Qabesë
dhe nijetnë ta bëç jekinë,
falu, lutu, mos të presë.*

*Dhe gjashtë brënda në namaz,
ruk'në janë kush t'i dijë,
Perendinë e bëjmë nijas,
gjith' kabull të na i bijë.*

*Ngreu në këmbë e rri në kijam,
bën dhe iftitah tekbirë,
namazë që ta bëç tamam,
mëso edhe Kur'anë mirë!*

*Ulu, bënë edhe ruqunë,
bën edhe të di sexhdetë,
më pastaj edhe ku'udnë,
namazi tamam bënëtet!*

*Katër farzë bëri bejan
zotri e Perendisë,
për abdest brënda në Kur'an
haberë u dha turqnisë (muslimanëve):*

*Laj duart njaram në brrul,
laj edhe gjithë surratnë,
ishtë ymith që ta bën kabull,
All-llahu digjonë duanë.*

*Laj edhe këmbët gjer në si,
bën mes'h edhe krietë,
lutju e thuaj: "Ja Rabbi,
të mi faliç gjynahët"!*

*Për guslë tre farzë janë,
që të tre preps t'i besojmë,
gra e burra borç i kanë
me iktiza t'i punojnë.*

*Mbush gojënë me ujë plot
dhe ndë hundë ujë vërë
dhe sa të mundesh hiqe fort,
laj dhe kurminë të tërë!*

*Tejemumi ishtë vaxhib
ujë kur mos të gjëndetë,
për gusul abdest munasib
edhe faarz të punonetë .*

*Protoparë bën nijtnë
sikundër ka iktizanë,
di herë shuplake dhenë,
fërko duart e surratnë!*

*Edhe vaxibët në namaz janë
në namaz që t'i punojmë,
kundër kanë iktizanë
edhe ne praps t'i digjojmë!*

*Në të di rekat' e parë,
si të mësoç fatihanë,
gjene për të mësuarë
tre ajete vaxhib janë.*

*Jahot një ajet të gjatë
që sa pët tre të jetë,
kur fal namas dit' e natë,
jahot ç'sure që të detë.*

*Gjene që të di sexhdetë
radhë-radhë që t'i bijë,
anamesa sa të thetë,
Subhanllah të rrijë.*

*Namaze tre e katër reqat',
si fal di reqat, ta dijë,
në gjuhë sa për tehijjatë,
iktiza bën që të rrijë.*

*Dhe më në bisht të qëndrojë,
namazë që ta bëjë tamam,
“Et-tehijjatu” të këndojë,
t’apë dhe di herë selam.*

*Akshami dhe jacinë
imamëtë ta digjojnë
vaxhib është që t’e dinë
kur’an fortë të mësojnë.*

*Ma, në qoftë që të jetë
vetëm ai që faletë,
atëherë si të detë,
më mirë fort le ta thetë.*

*Ma, iqindinë dhe ojlenë,
vetëm ai që faletë,
me kadalë le t’i thotë,
kush sa t’ë dëgjojë vetë.*

*Gjene edhe nafiletë
natënë, kur të faletë’
muhajer si që të detë,
më mirë fort le t’i thetë!*

Është për t’u theksuar se Muhamed Çami në shkrimet e veta, nuk ka përdorur kurrë mbiemrin “Çami” dhe as “Kyçyku”, po vetëm emrin e tij- Muhamed dhe të babait të tij-Hamza. Mbiemrin Çami ia dha mulla Hyda Asqeriu, ngase në poemën “Erveheja” që e kishte pasur ai në dorë, të stërkopjuar, shënohej vetëm emri i autorit dhe vendlindja e tij, por jo edhe mbiemri. Nga vetë fakti se Muhamedi ishte çam, mulla

Hydo Asqeriu, duke mos ditur mbiemrin e tij, e quajti Çami dhe me këtë mbiemër, ai do të njihej më pastaj botërisht prej Jani Vretos me rastin e botimit të veprës së tij "Erveheja" në Bukuresht më 1888.

Duhet thënë edhe kjo se, të shumtën e rasteve, Muhamed Çami shkrimet e tij i mbyllte me një apo dy strofa, ku shënonte identitetin e tij, emrin, emrin e babait dhe, nganjëherë fshatin dhe lagjen, po, siç u tha, jo edhe mbiemrin. Kështu veproi edhe me poemën e tij madhore "Erveheja", të cilën Muhamed Çami e përfundon me këto vargje e që nuk gjenden në botimin e Jani Vretos:

*Hiqaja u mbarua,
që kish gjithë këto derte,
Muhamedi u mundua,
shqip i foli dhe me bejte.*

*Shqip me bejte që i foli,
ta dëgjoj ata që s'dinë
brënda ngaha Konispoli,
në Çuçat e ka shtëpinë.⁶*

⁶ Marrë nga një dorëshkrim i Ibrahim D. Hoxhës, "Muhamed Çami paraardhës i Rilinda-seve të Mëdhënjë", i shkruar në gusht të vitit 1968.

Mr. Iljas Rexha

Koxha Sinan pasha dhe monumentet e tij në Kosovë gjatë shekullit XVI

KOXHA SINAN PASHA, me prejardhje shqiptare, ishte nga ka-tundi Topojan, që i takonte sanxhakut të Prizrenit deri në vitin 1912. Në administratën osmane, ai qeverisi më se gjysmë shekulli, arriti po-stet më të larta shtetërore dhe ushtarake, pesë herë ka qenë kryemi-nistër i Qeverisë Osmane dhe pesë herë kryekomandant i ushtrisë osmane. Ishte njëri ndër njerëzit më të pasur të shek. XVI. Tërë pasu-rinë e vet e shpenzoi për ndërtimin e objekteve bamirëse dhe humane në mbarë Perandorinë Osmane.

Depërtimi i osmanlinjve në Ballkan nga fundi i shekullit XIV dhe fillimi i shekullit XV, popullin shqiptar e gjeti në një dezintegrim të plotë, si në aspektin etnokulturor e fetar, ashtu edhe në aspektin tokësor. Shqiptarët në këtë periudhë dhe në këto rrethana historike, qenë të detyruar të shkolloheshin në gjuhë të huaja: greke, latine dhe sllave, varësisht se nën sundimin e kujt gjendeshin. Edhe pse disa pri-nca e bujarë shqiptarë të Arbanonit Qendror kishin arritur përkohësi-sht të pavarësosheshin nga Bizanti (në vitin 1043), në zyrat e bujarëve shqiptarë: Balshajve, Kastriotëve, Muzakajve, Topiajve, Dukagjinas-ve dhe Gropajve, administrata mbahej në gjuhët latine, greke dhe sllave. Pas vdekjes së mbretit Stefan Dushani (1355) Balshajt sundo-nin në Shqipërinë Veriore dhe në Dukël (Mali i Zi), ndërsa Gropajt në

Ohër me rrethinë. Mirëpo, pjesa dërrmuese e tokave shqiptare-Arbanonit Verilindor, kishte mbetur edhe më tutje nën sundimin e bujarëve serbë; ata shtriheshin deri në Shtip (Astibos), Kumanovë, Nish (Naisus), Jenipazar e Ras. Krahinën e Moravës dhe Toplicën e kishte marrë Lazar Hrebelanoviçi me qendër Krushevcin, Vuk Brankoviçi pjesën më të madhe të Kosovës deri përtej Shkupit, Jenipazarin e Rasin, ndërsa një pjesë të Maqedonisë Lindore e patën pushtuar bujarët serbë: Uglesha, Vukashini dhe vëllezërit Dejanoviç, të cilët së shpejti u bënë vasalë të parë të sulltan Muratit dhe në Betejën e Kosovës luftuan në anën e osmanlinjve. Duhet theksuar se pjesa dërrmuese e popullsisë së Kosovës, Toplicës-Sanxhakut të Nishit, Sanxhakut të Jenipazarit, Maqedonisë Perëndimore e Qendrore në pikëpamje etnike kanë qenë shqiptarë të besimit ortodoks, dhe një pjesë kanë qenë të besimit katolik. Kjo pjesë e dytë, nën presionin e administratës së mbretërve serbë (Nemanja, Milutin dhe Dushan) si edhe të Kishës pravosllave, qe kthyer në fenë ortodokse-pravosllave. Këto dëshmi të konvertimit të shqiptarëve shihen edhe nga dokumentet kishtare sllave të shekujve XIII-XIV, si dhe nga regjistrimet e popullsisë të administratës osmane gjatë shekullit XV, kur zakonisht bijtë-fëmijët kishin emra tipikë sllavë, ndërsa prindërit e tyre patronimet (mbiemrat) karakteristike e tradicionale shqiptarë, si p.sh. Bozhidar Berisha, Radosllav Berisha, Bogosllav Gjoni, Radonja Gjini etj.

Me vendosjen e administratës osmane në tokat e Arbërisë mesjetare, shqiptarët nga një amulli shumëshekullorë dolën në skenën politike. Ata nëpërmjet sistemit të Timarit osman, arritën të inkuadroheshin në administratën osmane dhe gradualisht duke punuar në integrimin etnokulturor e tokësor, arritën t'i rikthenin trojet e tyre etnike prej Nishit e Komanoven deri te Prizreni, të cilat i kishin pushtuar sllavët, pas Bizantit, në fund të shekullit XII, si edhe viset e Epirit e të Çamërisë, që i kishin pushtuar grekët. Kalimi në fenë islame i shqiptarëve dhe inkuadrimi i tyre në administratën osmane në këto rrethana historike, ishte i domosdoshëm dhe e vetmja rrugëdalje për të ruajtur qenien etnike dhe integritetin e tërësishëm tokësor. Duhet theksuar se në radhë të parë në fenë islame filluan të kalonin bujarë shqiptarë të Kosovës, të Sanxhakut, të Nishit e të Maqedonisë Perëndimore, që më parë ishin zhveshur nga pozitat shoqërore dhe i kishin humbur feudet

(pronat e tyre në kohën e sundimit mesjetar serb). Disa bujarë të tjerë kaluan në fenë islame me pretekst që të ruanin pozitën shoqërore dhe feudet që i kishin pasur deri në vendosjen e administratës osmane. Si duket edhe stërgjyshi i Sinan Pashës nga Topojani, që atëherë i takonte anës së Prizrenit, ishte bujar i krishterë, ndërsa i ati, Aliu, e pranoi Islamin dhe u inkluadrua në administratën osmane, ndërsa i biri i tij, Sinani, arriti pozitën dhe gradat më të larta shtetërore e ushtarake në Qeverinë e Perandorisë Osmane.

Meqë jemi duke folur për Koxha Sinan pashën dhe institucionet e tij bamirëse, duhet theksuar se për këtë personalitet e figurë historike të shquar, që luajti një rol të rëndësishëm në skenën politike të Qeverisë Osmane, është shkruar shumë nga autorë tanë dhe të huaj. Shkrimet e deritashme mund të shërbejnë si një bazë e mirë për të shkruar një monografi a disertacion për ta ndriçuar sa më mirë këtë figurë të madhe historike, meqë të gjitha sukseset që arriti Qeveria Osmane gjatë shekullit XVI, janë të lidhura ngushtë me meritat dhe me vetëmohimin e Sinan Pashës.

Meqë revista "Edukata Islame" ka hapsirë të kufizuar kësaj radhe po sjellim vetëm disa të dhëna më pak të njohura, që flasin për monumentet dhe institucionet e tij bamirës në Kosovë. Shumë autorë, si domos ata sllavë-serbë, janë munduar që Koxha Sinan pashën ta nxjerrin me prejardhje serbe, mirëpo burimet osmane dhe vakufnameja e tij dëshmojnë pa mëdyshje se ai ishte me prejardhje shqiptare.

Mehmed Tahir Efendiu, myfti i Prizrenit, është ndër autorët e parë që në kronikën e tij të viteve 70 të shekullit XIX e përmend Koxha Sinan pashën si pushtues të Jemenit (Fatih-i Yemen), dhe për të thotë se ishte nga fshati Topojan i nahijes së Lumës që atëherë i takonte sanxhakut të Prizrenit, pra i anës së Kosovës-Shqipërisë Veriore. Duke folur për të, ai thotë se Sinani ishte jashtëzakonisht i mençur, i edukuar dhe guximtar. Rrethanat dhe fati i jetës atë e sollën në radhët e ushtrisë osmane dhe më pastaj në oborrin e sulltanëve osmanë. Më vonë qe dërguar në një ekspeditë ushtarake në viset e Persisë si reformator me përvojë të madhe ushtarake, dhe atje kishte arritur suksese të mëdha në realizimin e detyrave të shtruar nga Porta e Lartë. Në vazhdim komandant i famshëm ushtarak në vilajetin e Karsit, pastaj emërohet vali në Kajro të Egjiptit, dhe në këtë pozitë ai fiton lëvdata

dhe avancohet për qeverisje të mirë me sukses. Prej Egjiptit ai nga Porta e Lartë, me gradën e gjeneralisimusit, dërgohet në Jemen për ta kthyer përsëri në qeverisjen e Perandorisë Osmane. Derisa qëndroi në Jemen, ai themeloi dhe ringjalli shumë institucione bamirëse dhe vakëfe, të cilat ishin lënë pas dore. Në një kohë të një agonie e të një krize ai arriti të forconte sundimin osman dhe të aftësonte brezat e ardhshëm për qeverisje të mirë në Jemen. Kundërshtarët e Sinan pashës, thotë Tahir Efendiu, që nuk ishin për reforma rrënjësore, frikësoheshin nga një personalitet i famshëm me prejardhje shqiptare. Pasi e qetësoi situatën politike në Jemen, u kthye përsëri në Egjipt si qeveritar për të vazhduar qeverisjen e tij për një kohë të caktuar. Nga kjo pozitë arriti ofiçin më të lartë - kryeministër (sadriazem) i Qeverisë Osmane. Gjatë shërbimit të tij në administratën osmane ai qe emëruar pesë herë kryeministër edhe kryekomandant i ushtrisë. Gjatë shekullit XVI nuk pati njeri tjetër që të kishte arritur një gradim të tillë përveç Koxha Sinan pashës, të cilin sulltanët osmanë e quanin shqiptar kokëfortë, por pa të cilin nuk mund të kornin fitore, sidomos në arenën e betejave të luftërave të shumta që po zhvillonin osmanët për zgjerimin e Perandorisë Osmane. Sipas kronistëve osmanë, Koxha Sinan pashën e çmonin dhe e respektonin të gjithë njerëzit e mëdhenj për aftësitë e tij, mirëpo në të njëjtën kohë edhe e urrenin për kryeneçësinë e tij dhe sidomos për shkak se kishte përkrahur shumë shqiptarët që të vinin në pozita të larta shtetërore. Sinan pasha gjatë qeverisjes së tij gjysmë-shekullore kishte përparuar shumë njerëz nga shqiptarët, ndër të tjerë edhe djalin e vet, që quhej Mehmet Pashë Kaçaniku e kishte emëruar në postin e vezirit. Edhe në burimet e tjera osmane si edhe në Enciklopedinë historiko-gjeografike-Kamus-al-alam-të Sami Frashërit, vëllimi IV, botuar në Stamboll në vitin 1894, gjejmë pothuaj të njëjtat të dhëna, ku thuhet se Sinan pasha ishte me prejardhje shqiptare dhe gjatë periudhës së sundimit të sulltan Muratit III dhe sulltan Mehmeti III ishte emëruar pesë herë në postin e kryeministrit. Kur qe emëruar për të pestën herë në postin e kryeministrit, sipas Sami Frashërit, kishte kaluar moshën 90 vjeç, dhe, sipas tij, ai kishte vdekur në vitin 1596. Sami Frashëri thotë se Sinan pasha është varrosur në tyrben që kishte ndërtuar vetë në lagjen Sedefçiler të Stambollit.

Përveç ndërtimit të shumë e shumë monumenteve sakrale-fetare e profane-publike e shoqërore dhe institucioneve bamirëse (hajrateve) anembanë Perandorisë Osmane, që në atë kohë shtrihej në tri kontinente, në Evropë, Azi e Afrikë, Sinan pasha ndërtoi disa monumente dhe institucione bamirëse edhe në Kosovë.

Koxha Sinan pasha dhe i biri i tij, Mehmet pasha, i quajtur Kaçanikli, janë shumë të lidhur për të kaluarën e Kaçanikut e të rrethinës, për arsye se ata të gjitha objektet sakrale e profane i ndërtuan kryesisht në vetë Kaçanikun dhe në rrethinën e tij. Pa marrë parasysh faktin se sipas disa të dhënave thuhet që Kaçaniku ishte i fortifikuar që nga koha e Bizantit dhe quhej Zigon, është vërtetuar se kështjellën (kalanë) e Kaçanikut e pati ndërtuar veziri i madh, Koxha Sinan pasha. Udhëpërshkruesi i njohur osman Evlia Çelebiu në udhëpërshkrimin e tij (Seyahatname), në pjesën ku përshkruan disa vendbanime shqiptare, na jep edhe disa të dhëna për Kaçanikun dhe Sinan pashën, të cilin e quan Pushtuesi i Jemenit (Fatih-i Yemen); për të thotë se në grykën e Kaçanikut dhe në buzë të lumit Lepenc kishte ndërtuar një kala të bukur katërkëndëshe prej materiali të fortë, e cila përfshinte një hapësirë-gjatësi e gjërësi prej 800 hapash. Kalaja, vazhdon ai, ka dizdarin e qytetit, 50 ushtarë, 2 topa dhe një portë (kapi), ndërsa brenda saj ka 40-50 shtëpi ushtarake. Të gjitha shtëpitë që gjenden jashtë kalasë, janë të mbuluara me tjegulla dhe janë të zbukuruara me hardhi rrushi e me kopshte të bukura. Poshtë Kaçanikut, buzë lumit Lepenc është një tyrbe, të cilën populli e quan Teqja e Musa Kesexhisë, ndërsa disa mendojnë se ajo tyrbe është e Musait, të birit të Bajazitit. Mirëpo, se kush e ka ndërtuar dhe në ç'kohë, si dhe se kush është varrosur në të, deri tash nuk dihet.

Është interesant të theksohet me këtë rast se askund në literaturën e historiografisë sllave-serbe nuk thuhet se kështjellën e Kaçanikut e ndërtoi në gjysmën e parë të shekullit XVI Koxha Sinan pasha me prejardhje shqiptare nga treva e Kosovës - Shqipëria Veriore. Kjo gjë është e kuptueshme për shkencën shqiptare, meqë sipas historiografisë borgjeze serbe, bile edhe të tashme, në atë kohë, gjatë shekullit XVI, gjoja nuk kishte shqiptarë as në Kaçanik, as në Kosovë. Edhe kjo kështjellë është një fakt i pamohueshëm historik që dëshmon se popullsi shqiptare kishte në këto vise që në kohët më të lashta. Edhe

monumentet e tjera sakrale dhe profane të mesjetës, që nga shekujt XI-XV të proviniençës jo vetëm bizantine-ortodokse, por edhe latine katolike, dëshmojnë se ato i kishin ndërtuar shqiptarët e krishterë. Në kohët e fundit, sipas dokumenteve që janë zbuluar në arkivat e Dubrovnikut, Vatikanit dhe Stambollit, shihet se shqiptarët kishin kishat e tyre në këto vende: në Ohër- Kisha e Shën Nikolla Arbanasit, e shekullit XIV dhe Kisha e Zonjës Shënmëri, më parë e Shën Klimentit, e ngritur në vitin 1295 nga ndërtuesi shqiptar progon Zguri; në Kratovë del të përmendet kisha shqiptare në (Kilise-i Arnavud); në Prizren ka ekzistuar kisha shqiptare qysh në shekulli XI (1019). Gjatë shekujve XIII-XIV ndeshim kisha katolike shqiptare në Prishtinë, në Trepçë, në Mitrovicë, në Vushtri, Novobërdë, Janjevë, Prokupe, Shkup e në vende të tjera.

Nga sa thamë, shihet qartë se popullsia shqiptare ka pasur kishat e veta në tërë territorin e Kosovës dhe në vise të tjera, ku ka jetuar në mesjetë.

Qysh në fillim të shekullit XV në Kaçanik dhe në rrethinat e tij gjejmë të regjistruar shqiptarë të krishterë në defterët e parë kadastralë të administratës osmane, ku fëmijët kanë emra tipikë sllavë, ndërsa prindërit kanë patronime (mbiemra) karakteristike dhe tradicionale shqiptare: Dobrosllav i biri i Berisha-s, Millosh i biri i Ukiqit, Jovan i biri i Progonit, Bogosllav i biri i Gjinit, Bogosllav i biri i Gjinoqit, Petko i biri i Gjonqes, Gjura Arbanas, etj. Këto të dhëna antroponimike na dëshmojnë bindshëm se popullata shqiptare ishte autoktone, por e kryqëzuar me emra sllavë gjatë sundimit mesjetar serb në Kosovë, Maqedoni, në sanxhakun e Jenipazarit e të Nishit, dhe se ajo, pa marrë parasysh emrat sllavë, në pikëpamje etnike ishte shqiptare. Përveç kështjellës, në Kaçanik Sinan Pasha në vitin 1494 kishte ndërtuar një xhami të bukur, e cila kishte luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës shqipe e të traditave të popullsisë shqiptare, meqë në këtë institucion fetar mësimi dhe dersi mbahej kryesisht në gjuhën shqipe. Gjithashtu ai ndërtoi një imaret (kuzhinë publike, popullore) në të cilin ushqeheshin mysafirë dhe udhëtarë të ndryshëm që kalonin nëpër Kaçanik. Më tutje ai kishte ndërtuar dy hane (bujtina) të mëdha, nga të cilat njëri quhej Kurshumli Han, meqë ishte i mbuluar me plumb; sot kanë mbetur vetëm themelet e tij. Gjithashtu kishte ndërtu-

ar një shkollë (mekteb) dhe një banjë publike (hamam), që nuk ekzistojnë më. Sinan pasha ka ndërtuar edhe një hamam të madh e të bukur në Prishtinë, i cili gjendej në afërsi të Xhamisë së Gurit-të Çarshisë, themelet e të cilit shihen edhe sot përmbi ndërtesën e këshillit Ekzekutiv të Kosovës në Prishtinë. Nuk kemi të dhëna se kur do të jetë rrënuar, por sipas disa shënimeve është dëmtuar pas viteve 1913-1914, me depërtimin e ushtrisë serbe në Prishtinë. Sinan pasha ndërtoi dy mullinj të mëdhenj në fshatin Kamenicë në kazanë e Novobërdës, pesë mullinj dhe një han në fshatin Jenixhë në kazanë e Shkupit, një han në fshatin Akbash, dhe tre mullinj në fshatin Ismixhë në kazanë e Shkupit. Në Prizren kishte ngritur një ndërtesë të madhe për medrese e bibliotekë dhe një urë, por jo edhe xhaminë, siç është menduar më herët, sepse ajo është ndërtuar nga Sofi Sinan pasha, i cili ishte me prejardhje nga fshati Vilë, që atëherë i takonte Sanxhakut të Prizrenit. Në vendlindje (Topojan) kishte ndërtuar ujësjellësin. Supozohet se edhe në Ulqin do të ketë ndërtuar një hamam, ndërsa në kazanë e Ulqinit kishte lënë si vakëf kullosa verore. Edhe i biri i tij, Mehmed pashë Kaçaniku, ka ndërtuar disa objekte në Kosovë, ndër të tjera një urë prej guri në Kaçanik dhe katër hane në lagjen e vjetër të Kaçanikut.

Përveç këtyre monumenteve të arkitekturës islame dhe objekteve bamirëse, (për të cilat në literaturën osmane thuhet se janë më se 100), që kishte ndërtuar nëpër vilajete të Perandorisë Osmane të asaj kohe, ai ka lënë edhe pasuri të mëdha përshpirtëse si vakëf (toka pjellore, male, bjeshkë, livadhe dhe kullosa të mëdha).

Përveç monumenteve sakrale-fetare, ai ndërtoi edhe shumë objekte profane-publike: fortifikata, ujësjellës, ura, kroje, shkolla, biblioteka, banja publike etj. Prej objekteve të tij bamirëse që ndërtoi në trevat tona, më së paku janë ruajtur hamamet e tij. Hamami i Koxha Sinan pashës në Prishtinë është ndërtuar në vitin 1586, tetë vjet para të Kaçanikut. Që të dyja këto hamame janë rrënuar nga pushtuesit serbë. Pas vitit 1912, ushtria famëkeqe serbe pushtoi Kosovën dhe me atë rast rrënoi e dëmtoi shumë objekte kulturore-historike të arkitekturës tradicionale shqiptare dhe të kulturës islame-orientale.

Hamami i Koxha Sinan pashës, që gjendej në kompleksin e Çarshisë së vjetër orientale të Prishtinës, që ishte e gërshetuar edhe me

elemente të arkitekturës tradicionale shqiptare, qe dëmtuar shumë, por rrënimi definitiv i hamamit në fjalë bashkë me Çarshinë vjetër u bë nga ana e pushtuesit monist, pas vitit 1945, dhe në vendin e tij u ndër-tua ndërtesa e ish-Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Është rrënuar gjith-ashtu xhamia e Llokaçit, dhe në vend saj është ngritur hotel "Ilira" (ish-Bozhur). Rrënimi i Çarshisë së vjetër, e cila konsiderohej si çar-shia më e bukur e Ballkanit, përbën një dëm të madh, sepse kësodore janë zhdukur gjurmët e kulturës shpirtërore dhe të arkitekturës popu-llore shqiptare, që ruheshin sidomos në objektet që kishin ndërtuar shqiptarët, qofshin të kulturës latine ose islame-orientale. Sipas buri-meve raguziane dhe osmane, në mesjetë (1300-1385-1455), në Prish-tinë kishte dy kisha katolike, dhe asnjë sllave. Ky gjenocid perfid i pushtuesve serbë mbi kulturën shpirtërore dhe arkitekturën popullore shqiptare kishte edhe një prapavijë tjetër, për të argumentuar gjoja para Evropës dhe botës se monumentet e kulturës së krishterë në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare janë vepra të serbëve ardhasakë, ndërsa monumentet e kulturës islame janë vepra të aziatikëve, kështu që, sipas tezës serbe, popullsia autoktone shqiptare nuk kishte ndërtu-ar asgjë nga monumentet mesjetare. Kjo hipotezë e propagandës së politikës dhe historiografisë serbe, nuk mund të qëndrojë dhe nuk ka të bëjë me shkencën dhe me të vërtetën historike.

Nga gjithë kjo që u tha, del se institucionet tona shoqërore, fetare dhe bamirëse, që merren me mbrojtjen e monumenteve kulturore e historike, duhet të punojnë në mënyrë të organizuar e të bashkërendu-ar që të bëhet evidentimi dhe hulumtimi i monumenteve-objekteve fe-tare e shoqërore dhe i tërë pasurisë së hajrateve-vakëfeve, që kanë lënë amanet stërgjiyshët tanë. Të gjitha ato monumente a objekte bamirëse shoqërore e fetare që sot janë lënë pas dore, në një gjendje të mjeruar, sa më parë duhet të restaurohen dhe të vihen në shërbim të popullit.

Dokumentet më të reja të zbuluara në kohët e fundit, dëshmojnë në mënyrë bindëse se popullsia autoktone shqiptare ka pasur monu-mente të vetat të kulturës romano-latine, po edhe të kulturës islame-orientale. Nga monumentet e kulturës së krishterë, shumicën i kanë ndërtuar shqiptarët, por administrata dhe Kisha sllave i përvetësuan. Në themelet e disa kishave gjenden gurë me shkrime latine. Po ashtu

shumicën e objekteve të kulturës islame të mesjetës së vonë i kanë ndërtuar shqiptarët autoktonë, që kaluan në fenë islame e jo njerëzit nga Orienti e Azia, një fakt i pamohueshëm historik, që tentojnë ta mohojnë autorët sllavë se kinse para ardhjes së Osmanlinjve në Kosovë nuk kishte popullsi shqiptare. Këtë fakti historik e dëshmojnë, përveç burimeve shkrimore, edhe monumentet e kulturës materiale, siç janë: banjot publike: Hamami i Gazi Ali beut në Vushtrri, Hamami i Ali Arnautit në Novobërdë si dhe objektet e tjera të shekujve XV-XVI në Kaçanik e në Prizren.

Literatura:

1. Sh. Sami Frashëri, *Kamus al-a'm*, IV, Istanbul, 1311/1984. Shih edhe në gjuhën shqipe, Sami Frashëri, *Vepra 9*, me titull: "Personalitetet shqiptare në *Kamus al-a'm*, përgatit dhe shqipëroi Mehdi Polisi, Logos, Shkup 1994.
2. Mehmet Tahir Efendi, *El-Menakib*, dorëshkrim në Bibliotekën e Xhamisë së Gazi Mehmet Pashës në Prizren.
3. *Tarih-i Ibrahim Peçevi*, Istanbul 1281/1864.
4. Dr. Hasan Kaleshi, *Najstari vakufski dokumenti u Jugosllaviji na arapskom jeziku*, Prishtinë, 1972.
5. *Salname-i Vilajet-i Kosova 1318/19000*, Uskup, Vilayet-i matba'asi-nda tab'olunmustur.
6. Evlija Çelebi, *Seyahatnamesi*, Istanbul, 1314/1896 – 1318-1900. Shih edhe Hazim Shabanoviq, *Putopis Evlije Çelebije*, Sarajevë 1979.
7. *Tarih-i Naima* – Istanbul, 1280-1863.
8. Osman Zade Ahmed, *Hadikat-ul Vuzera*, përgatitur për shtyp nga D. Robischon – Freiburg, 1969.

Sadik Mehmeti

Një dokument i vitit 1935 për nëpunësit fetarë islamë që nuk kishin kualifikime të duhura shkollore

Një çështje që na ka tërhequr vëmendjen gjatë hulumtimeve në Arkivin e Kosovës, përbënin kualifikimet shkollore të nëpunësve fetarë islamë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Për ata nëpunës që nuk kishin arritur të mbaronin medresenë e plotë, në dokumente të kohës shkruante se kishin mbaruar kaq vite të medresesë, por kjo nuk paraqiste asnjë pengesë, që ata të dekretoheshin nga organet kompetente islame të kohës për të shërbyer si imamë, mualimë, hatibë, etj. Dhe jo vetëm kaq! Por, sipas inspektimeve të bëra, asokohe, nga organet përgjegjëse, siç qe Ulema Mexhlisi, drejtoratet e vakëfeve - mearife të rrethit, etj., po ata, sipas dokumenteve që disponohen, vlerësoheshin me nota të larta, duke u renditur madje në kategoritë I e II.

Natyrisht, vlerësimet e organeve përgjegjëse për punën dhe aftësitë e nëpunësve fetarë do të qenë qenë mjaft objektive. Sepse, siç dihet mirëfilli, në medresetë ekzistuese të asaj kohe, klasat nuk kaloreshin sipas viteve shkollore, siç është sot, por sipas faktit nëse nxënësi kishte arritur t'i zotëronte dhe t'i përvetësonte njohuritë nga lëndët e caktuara apo jo, dhe vetëm atëherë ai mund të kalonte në klasa të tjera, pavarësisht sa vite kishte qëndruar në një klasë a në medrese.

Prandaj, assesi nuk mund t'u japim të drejtë konstatimeve tendencioze, të paargumentuara dhe të përcjella në mënyrë të verbët të disa studiuesve tanë, të cilët për afër pesëdhjetë vjetishin trumbetuar me përbuzje e nënçmim se ylematë tanë (imamët, mualimët, hatibët, myezinët, etj.), gjoja, sipas tyre, na paskëshin qenë njerëz të prapambetur e analfabetë, që paskëshin kryer ca vjet shkollë në medrese kinse në gjuhën turke dhe kaq!

Ky qe shkaku pse hulumtimet tona qenë përqendruar në këtë segment, derisa gjetëm një Rregullore 4 faqesh të vitit 1935,¹ e cila bënte fjalë pikërisht për këtë dhe heq qoftë edhe dyshimin më të vogël.

Këtë dokument - rregullore, e bazuar mbase edhe mbi të tjera, paraprake, e kishte hartuar Ulema -mexhlisi i Shkupit, dhe ua kishte dërguar të gjitha drejtorateve të vakëfeve - mearife që vareshin prej tij.

Aty bëhet fjalë për kushtet që duheshin plotësuar për dhënien e provimit profesional, për nëpunësit, që, për arsye të ndryshme, nuk e kishin mbaruar medresenë të tërën dhe që nuk kishin mundësi të dëshmonin me dokumente të vlefshme se për akëcilin titull a për akëcilin vend pune posedonin kualifikim adekuat.

Sipas asaj rregulloreje, provimin profesional ishin të detyruar ta jepnin të gjithë nëpunësit fetarë, përveç anëtarëve të Ulema-mexhllisit, myftinjve, sekretarit të Ulema-mexhllisit, sekretarëve të myftinive dhe myderrizëve. Qëllimi i provimit profesional, saktësohet aty, ishte që të provoheshin dhe të verifikoheshin njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të kandidatëve për kryerjen e shërbimeve fetare.

Nëpunësi, gjithnjë sipas dokumentit, fitonte të drejtën për të dhënë provimin profesional vetëm nëse kishte një vit përvojë pune të përkohshme. Kandidati kishte të drejtë konkurrimi për të dhënë provimin profesional më së shumi tri herë. Ai kandidat që nuk mund ta jepte provimin, kishte të drejtë ta paraqiste përsëri vetëm pasi të kishte kaluar një vit.

Nëpunësit që ishin të detyruar ta jepnin provimin profesional, sipas asaj rregulloreje, nuk arrinin të siguronin qëndrim të përhershëm në vendin e tyre të punës, gjithnjë derisa të mos e jepnin provimin profesional.

¹ Arkivi i Kosovës, Fondi Sresko Vakufsko Mearifsko Poverenstvo - Prizren, k. 7, dok 590, 1935.

Sipas llojit të shërbimit, përkatësisht profesionit fetar të nëpunësve, shkruan aty, provimi profesional ndahej si më poshtë:

- a. për imam
- b. për imam ofiqar
- c. për imam - mualim
- ç. për administratë

Programi i provimit për titullin imam përmbante gjithsej 6 lëndë, për imam ofiqar 12, për imam - mualim 10 dhe për administratë 8 lëndë të ndryshme, varësisht për cilin titull kandidohej.

Provimi profesional jepej para komisionit pyetës, të cilin e caktonte Ulema-mexhlisi dhe përbëhej nga kryetari dhe dy anëtarë.

Provimi për titullin imam – mualim, ndërkaq, jepej pranë drejtoratit të vakëf - mearifit të rrethit, para komisionit pyetës, të cilin, në selinë e myftinisë, e përbënin: myftiu (kryetar), një myderriz nga më të njohurit dhe kryetari i drejtoratit (anëtarë). Komisionin pyetës në drejtoratin e vakëf - mearifit të rrethit, jashtë selisë së myftinisë, e përbënin: kryetari i drejtoratit, në qoftë se ishte gjyqtar sheriat (kryetar i komisionit pyetës), një myderriz i njohur, të cilin e caktonte myftiu kompetent dhe një anëtar, të cilin e caktonte drejtorati i vakëf - mearifit të rrethit. Në qoftë se kryetari i drejtoratit... nuk ishte gjyqtar sheriat, kryetarin e komisionit pyetës e caktonte myftiu, sipas propozimit të drejtoratit të vakëf - mearifit të rrethit. Kjo vlente edhe kur myftiu dhe gjyqtari i sheriatit ishin të penguar të prezantonin në provim. Në vendet, ku nuk kishte myderriz ose ai ishte i penguar, për anëtar të komisionit pyetës mund të caktohej edhe një tjetër person i kualifikuar.

Suksesi në lëndët e caktuara vlerësohej me katër shkallë: dobët = 2, mirë = 3, shumëmirë = 4 dhe shkëlqyeshëm = 5.

Suksesi i përgjithshëm i kandidatit vlerësohej: "shkëlqyeshëm", "shumëmirë", "mirë" dhe "pamjaftueshëm". Notën e përgjithshme komisioni e konfirmonte me shifra, ndërsa konsiderohej se provimin e kishte dhënë vetëm kandidati i cili në të gjitha lëndët kishte arritur së paku notën (suksesin) "mirë".

Kandidatit, që merrte nota të dobëta në dy lëndë, i mundësohej që brenda tre muajsh të rimerrej në provim në ato dy lëndë, dhe në qoftë

se në riprovim merrte nota kaluese, konsiderohej se ai e kishte dhënë provimin profesional.

Dëftesa për provimin e dhënë, gjithnjë sipas asaj rregulloreje, kandidatit i lëshohej nga ana e Ulema-mexhllisit pa shënuar nëse provimi ishte i rregullt apo i përsëritur. Dëftesa i jepej jo më vonë se tetë ditë pas dhënies së provimit. Dëftesa i lëshohej secilit kandidat që arrinte të mbaronte provimet, dhe ajo përmbante këto shënime:

Drejtorati i Vakëf - mearifit të rrethit në ____, nr. ____, viti ____.

DËFTESË

Zotëri ____, i biri i ____, lindur më ____, në rrethin e ____, myftinia e ____, sipas Rregullores së Ulema-mexhllisit të Shkupit, nr. 2063/35, ka dhënë provimin për titullin ____ dhe ka treguar këtë sukses:

Lëndët - notat:

Sipas suksesit të treguar, kandidati ka dhënë provimin për titullin ____ me sukses ____.

Anëtarët e komisionit provues:

1.

Kryetari i komisionit provues

2.

V. V.

Nga më sipër, mund të përfundojmë se, pavarësisht se ndonjë nga nëpunësit fetarë të asaj kohe nuk e kishte kualifikimin e duhur shkollor, megjithatë, pasi testohej për njohuritë e tij teorike dhe aftësitë praktike para një komisioni mjaft kompetent e autoritativ, dhe pasi t'i jepej dëftesa nga organi më i lartë fetar islam në atë kohë – Ulema-mexhllisi i Shkupit, ai nëpunës pa asnjë dyshim ishte i aftë, si në aspektin teorik, ashtu edhe praktik, për kryerjen e shërbimeve fetare, për të cilat më pas edhe dekretohej. Kjo, sidomos, kuptohet nga emri dhe numri i lëndëve në të cilat kandidati merrej në provim.

Të theksojmë edhe se ky dokument dhe të tjera të ngjashme, mbase kishin qenë bazë që më vonë, Kryesia Supreme e Bashkësisë së Fesë Islame në Sarajevë të nxirret rregullore të reja plotësuese për sigurimin social të nëpunësve fetarë, siç qe ajo e vitit 1952, me të cilat

u njihej përvoja e punës edhe atyre nëpunësve që kishin mbaruar vetëm disa vite të medresesë, por që kishin dhënë provimin profesional.

Në vazhdim, po japim tekstin e përkthyer në mënyrë integrale të Rregullores së Ulema -mexhlisit të Shkupit, e cila kishte hyrë në fuqi më datën 15 tetor 1935, me shpresën se kështu do t'u ndihmojmë studiuesve tanë që nesër të shkruajnë drejt historikun e Bashkësisë së Fesë Islame të Kosovës:

Bashkësia e Fesë Islame

Mbretëria Jugosllave

Ulema Mexhlisi Shkup

Nr. 2661/35

Në bazë të nenit 6 të Pragmatikës zyrtare të nëpunësve fetarë të Bashkësisë së Fesë Islame në territorin e Drejtoratit të Vakëf -mearifit të Shkupit, Ulema -mexhlisi harton:

RREGULLOREN

**PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL TË NËPUNËSVE
FETARË NË TERRITORIN E ULEMA-MEXHLISIT TË SHKUPIT**

Neni 1

Provimin profesional janë të detyruar ta japin të gjithë nëpunësit fetarë, të cekur në nenin 15 alineja A të Pragmatikës zyrtare, përveç anëtarëve të Ulema-mexhlisit, myftiut, sekretarit të Ulema -mexhlisit, sekretarëve të myftinive dhe myderrizëve.

Neni 2

Qëllimi i provimit profesional është të verifikojë aftësitë praktike të kandidatëve për kryerjen e shërbimeve, si dhe njohuritë teorike në lëndët e provimit, të parapara me këtë rregullore.

Neni 3

E drejta për dhënie e provimit profesional arrihet pasi të jetë kryer një vit shërbimi-pune përkohësisht.

Provimi profesional mund të jepet më së shumti tri herë.

Nëpunësi që nuk e jep provimin, mund t'i shtrohet përsëri vetëm pasi të ketë kaluar një vit nga data e mbajtjes së provimit paraprak.

Nëpunësi i cili sipas kësaj rregulloreje është i detyruar ta japë provimin profesional, nuk arrinë të sigurojë vend pune të përhershëm në vështrim të nenit 8 të Pragmatikës zyrtare, gjithnjë derisa të mos japë provimin profesional.

Neni 4

Nëpunësit që janë vlerësuar me nota të dobëta dhe që gjenden nën masa disiplinore, që gjatë atij viti, përkatësisht derisa të mos përfundojnë hetimet, nuk mund të japin provimin profesional.

Nëpunësit, që janë dënuar për shkak të disiplinës, provimin mund ta japin vetëm me leje të veçantë të Ulema - mexhlisit.

Neni 5

Sipas llojit të shërbimit, përkatësisht profesionit fetar të nëpunësve, provimi profesional ndahet në katër grupe, pikërisht:

- a. për imam
- b. për imam ofiqar
- c. për imam - mualim
- ç. për administratë

I. Programi i provimit për titullin imam përmban këto lëndë:

1. Lexim i drejtë i Kur'ani kerimit
2. Akaid
3. Ibadat
4. Kitabun-nikah
5. Ahlak
6. Ligji dhe Kushtetuta e Bashkësisë së Fesë Islame, si dhe Pragmatika zyrtare e nëpunësve të Bashkësisë së Fesë Islame në territorin e Drejtoratit të Vakëf - mearifit të Shkupit.

II. Programi i provimeve për titullin imam ofiqar përmban lëndët e theksuara tek I dhe lëndët:

1. Qarkorja për administrimin e amzave të të lindurve, të të kuro-rëzuarve dhe të të vdekurve myslimanë me rregulloren për realizimin e saj.

2. Rendi zgjedhor për zgjedhjet e këshillit të xhematit dhe Rregullorja për punën e këtij këshilli.

3. Nenet për ligjin penal dhe ligjin për emrat personalë, që kanë të bëjnë me Qarkoren për udhëheqjen e amzave.

4. Rregullorja për martesën e oficerëve.

5. Rregullorja e Ligjit për taksat, të cilat kanë të bëjnë me udhëheqjen e amzave dhe dhënien e certifikatave.

6. Kushtetuta e Mbretërisë Jugosllave dhe ligji për ndarjen e Mbrëtërisë në njësi administrative

III. Programi për provimet për titullin imam - mualim përmban lëndët e theksuara tek I dhe këto lëndë:

1. Njohja e drejtshkrimit arab

2. Histori islame

3. Njohuri elementare të pedagogjisë dhe metodikës së arsimit fetar

4. Bazat e higjienës

IV. Programi i provimeve për titullin administrator (praktikantë për arkiv dhe administratë) përmban këto lëndë:

1. Ligji dhe Kushtetuta e Bashkësisë së Fesë Islame

2. Kushtetuta e Mbretërisë Jugosllave dhe Ligji për emrat dhe ndarjen administrative të Mbretërisë Jugosllave

3. Pragmatika zyrtare e nëpunësve të Bashkësisë së Fesë Islame në territorin e Drejtoratit të Vakëf - mearifit të Shkupit.

5. Shërbimi arkivor

6. Qarkorja për organizimin e financave, shërbimit llogaritës dhe kontrollit në territorin e Drejtoratit të Vakëf - Mearifit në Shkup

7. Ligji për taksat

8. Ligji penal (kreu 28).

Kandidati duhet të njihet patjetër me rregullat kryesore në lëndët e dhëna në këtë nen tek pikat 6/II, 2/IV dhe 6/IV.

Neni 6.

Provimi profesional jepet pranë Ulema - mexhlsit para komisionit që e cakton Ulema - mexhlsi.

Komisioni pyetës përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë.

Kryetari udhëheq punën e komisionit dhe ka të drejtë të bëjë pyetje në të gjitha lëndët.

Anëtarët e komisionit i zgjedhin nga mesi i tyre pyetësit për lëndët e caktuara. Detyra e tyre është t'i përgatitin pyetjet dhe të bëjnë pyetje në lëndët për të cilat janë caktuar.

Procesmbajtësi i komisionit pyetës caktohet nga Ulema - mexhlsi. Detyra e tij është të hartojë procesin e komisionit sipas rregulloreve të kryetarit të komisionit. Anëtarët e komisionit pyetës nuk gëzojnë të drejtën për mëditje.

Neni 7

Kërkesën për dhënien e provimit profesional kandidati ia paraqet Ulema - mexhlsit përmes personit të tij (të U- mexhlsit - S.M.) të autorizuar.

Në kërkesë kandidati duhet të theksojë për cilin provim paraqitet, cili provim është në radhë, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme.

Neni 8

Vendimin për të drejtën e kandidatit për të dhënë provimin profesional e merr Ulema - mexhlsi dhe ia paraqet kryetarit të komisionit pyetës, që të caktojë datën e provimit.

Kryetari i komisionit pyetës, në marrëveshje me anëtarët e tjerë, cakton ditën dhe orën e provimit, për se kandidatët lajmërohen përmes personave të autorizuar.

Neni 9

Gjatë provimit mbahet procesi në librin e veçantë, në të cilin pos të dhënave të nevojshme, regjistrohet:

1. Emri dhe mbiemri i kandidatit
2. Titulli dhe vendi i shërbimi të kandidatit
3. Notat në lëndët e caktuara

4. Vendimi i komisionit nëse kandidati ka dhënë apo jo provimin Ky proces regjistrohet në protokoll. Procesin e nënshkruajnë: kryetari, anëtarët dhe procesmbajtësi i komisionit pyetës.

Neni 10

Suksesi në lëndët e caktuara vlerësohet me notat: dobët = 2, mirë = 3, shumëmirë = 4 dhe shkëlqyeshëm = 5.

Suksesi i përgjithshëm i kandidatit në provim vlerësohet: "shkëlqyeshëm", "shumëmirë", "mirë", ose "pamjaftueshëm". Notën e përgjithshme komisioni e konfirmon me shifra, kurse konsiderohet se provimin e ka dhënë vetëm kandidati që në të gjitha lëndët ka arritur notën së paku "mirë".

Kandidati, që merr nota të dobëta në dy lëndë, brenda tre muajsh mund të japë provim në këto dy lëndë dhe, në qoftë se në riprovim merr nota kaluese, konsiderohet se e ka dhënë provimin profesional.

Rezultati i provimit komunikohet menjëherë, jo më vonë se një ditë pasi të ketë dhënë provimin.

Neni 11

Kandidati që nuk është sjellë mirë në provim, është përgjigjur jo-njerëzisht ose ka ofenduar ndonjë nga anëtarët e komisionit, do të largohet nga provimi. Po ashtu, do të largohet nga provimi edhe kandidati i cili, në çfarëdo forme qoftë, ka sabotuar punën e komisionit.

Kandidati i larguar e humb të drejtën për të dhënë provim për një vit.

Vendimin për këtë e merr komisioni pyetës.

Neni 12

Dëftesa për provimin e dhënë i jepet kandidatit nga ana e Ulemamexhllisit pa shënimin nëse provimi është i rregullt apo i përsëritur.

Dëftesa regjistrohet në listën zyrtare të kandidatit dhe në librin personal.

Neni 13

Provimet e parapara me këtë Rregullore jepen falas.

Neni 14

Nëpunësit fetarë, të cilëve neni 96 i Pragmatikës zyrtare ua garanton (vend të punës – S. M.) të përhershëm edhe ata që kjo u është njohur me vendim të veçantë të Ulema - mexhlisit, nuk e japin provimin profesional.

Për nëpunësit fetarë, të cilët janë caktuar para kësaj Rregulloreje, Ulema - mexhlisi do të vendosë se cilët nëpunës do të lirohen nga provimi dhe atyre do t'u njihet (kjo) përhershmëri në pajtim me nenin 6 të Pragmatikës zyrtare.

Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 tetor 1935.

Dr. Xhemaludin Latiq

Bazat e pedagogjisë kuranore

Në shumë vende dhe në mënyra të ndryshme Kur'ani thotë për veten se është Libër gjithëpërfshirës (p.sh.: "**asgjë në Libër Ne nuk e kemi anashkuar**" (6, 38); "**Tani përsosa për ju fenë tuaj, plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe jam i kënaqur që jua zgjodha Islamin fe**" (5, 3); "**Fjalët e Zotit tënd janë kulm i së vërtetës dhe drejtësisë**" (6, 115); "**All-llahu përfshin çdo gjë me dijen e Tij**". (4, 126; etj).

Kur'ani, pra, është një Libër që në kulturën dhe qytetërimin musliman është burim për çdo disiplinë shkencore: ai, me fjalën e tij gjithëpërfshirëse, inicon dhe, ç'është më e rëndësishmja, përcakton qëllime të pandryshueshme.

Përveç të tjerash, pra, Kur'ani është edhe libër pedagogjie dhe natyrisht shumë më tepër se kjo. T'i edukosh njerëzit që në çdo situatë jetësore të sillen në pajtim me vullnetin e All-llahut (xh. xh.)- është qëllimi i çdo ajeti dhe çdo sureje kuranore. Në të vërtetë, Kur'ani edukon me të gjitha llojet e ligjërimit të vet të larmishëm: me këshilla, paralajmërime, kërcënime, premtime, tregime, diskutime, shikime, ilustrime ... Nga ky bollëk nuk është vështirë të rikonstruktohet et-terbijetu'l – kur'anijje, pedagogjia kuranore, si pjesë themelore përbërëse e et-terbijtu'l- islamijje, pedagogjisë islame.

Pjesa e dytë përbërëse e kësaj pedagogjie është terbijetu'n-nebijj, pedagogjia e të Dërguarit (s.a.v.s.).

Këto dy pjesë të pedagogjisë islame janë të lidhura në mes vete në mënyrë të pandashme; Kur'ani është aspekti teorik në Islam, ndërsa suneti i Pejgamberit të All-llahut (s.a.v.s.), si Shpallje nga All-llahu për nga kuptimi (*bi ma'naha*), por jo edhe për nga shprehja (*dune lafdhiha*), është mbartja e atij aspekti në jetën e përditshme të individit dhe shoqërisë, zbatimi dhe "shpjegimi" praktik i pedagogjisë kuranore.

Lidhur me këtë, i Lartësuar i Pejgamberin e Vet e edukoi për besimtarët si etalon, në bazë të të cilit ata të harmonizojnë veprimet e tyre, ndërsa kultivimin e cilësive të mira në edukimin e njerëzve, Pejgamberi (s.a.v.s.) e bëri qëllim të misionit të tij.

"Ju keni shembull të shkëlqyer në të Dërguarin e All-llahut, natyrisht për atë që shpreson në mëshirën e All-llahut dhe shpërblimin në botën tjetër dhe për atë që e përmend shpesh All-llahun" (33, 21)

"Vërtet, ti je në shkallën më të lartë të moralit" (68, 4).

Pyetjes së Se'id ibni Hisham ibni 'Amrit për moralin e të Dërguarit të All-llahut, hazreti Aishja (r.a.) iu përgjigj se ahlaku i tij ishte Kur'ani, pastaj i tha Se'idit që ta këndonte fillimin e sures El-Mu'minun (1, 11) dhe, kur e përfundoi, tha: "Ky ishte ahlaku i të Dërguarit të All-llahut". (Muslimi).

"Innallahe be'atheni li utmmime mekarime'l-ahlak"

"Me të vërtetë All-llahu më ka dërguar që t'i përkryej cilësitë e mira të njerëzit," tha i dërguari i All-llahut (s.a.v.s.)

Gjuhësisht, *et-terbije* do të thote *et- tenmije* - rritje, midis këtyre dy sinonimeve të pjesërishme ka një dallim në domethëniet e përafërta. *Et - terbije* vjen nga rrënja e foljes me tri bashkëtingëllore r-b-j (a e gjatë) - *reba jerbi* - rris, kultivoj, eduko, arsimoj, zhvilloj...Njëri nga katër emrat e mëdhenj të All-llahut (xh.sh.) *Rabb*, vjen nga e njëjta rrënjë dhe sipas mufesir Bejdaviut, tregon Krijuesin, i cili çdo gjëje që ka krijuar, i jep furnizim fizik e shpirtëror dhe e shpie nga njëri stad në tjetrin derisa të arrijë pikën kulmore të plotësimit të tij tokësor (v. *Envaru'l - tenzil...*, komentimi i sures El-Fatiha). Prandaj, All-llahu (xh.sh.) është *El - Murebbi'l - E'adham*, më i madhi Ushqyes - Kultivues - Edukues në Gjithësi.

Dhe sikurse Kur'ani është i përkryer/ i kompletuar në çdo gjë, po ashtu edhe në pedagogji ka përfshirë të gjitha disiplinat e saj, që janë: *et-terbijetu' r-ruhijje* (edukimi i ruhut-shpirtit), *et-terbijetu'l-akhlakijje* (edukimi i karakterit), *et-terbijetu'l- aklijje* (edukimi i mendjes), *et-terbijetu'l-xhismijje* (edukimi i trupit), *et-terbijetu'l-xhemalijje* (edukimi i prirjeve estetike), *et-terbijetu'l-ixhtimaijje* (edukimi personallitetit shoqëror), dhe *et-terbijetu's-sijasijje* (edukimi i personalitetit politik).

Me këtë gjithëpërfshirje në konceptin e tij për edukatën, Kur'ani flak që të dy ekstremet në disiplinën pedagogjike, edhe atë ekstreme materialiste, që në variante të ndryshme dhe në të gjitha kohët, theksin e vë ekskluzivisht ose në pjesën më të madhe të tij në edukimin e trupit, edhe atë ekstrem shpirtëror, murgëror, i cili nuk përfill kërkesat trupore.

Islami qenien njerëzore e shikon në mënyrë integrale; njeriu në vete ka tri aftësi (fuqi): trupore, shpirtërore dhe mendore. Të gjitha këto kërkojnë përmbushjen e nevojave të tyre. Pedagogjia islame përpiket t'i kënaqë në mënyrë të barabartë që të tri ato aftësi, në mënyrë që të mos ndodhë çrregullimi i personalitetit njerëzor dhe edukimi i keq. Të gjitha ato së bashku përbëjnë natyrën njerëzore, *fitren*, në bazë të së cilës i Lartësuar ka krijuar të gjithë njerëzit (30, 30). Kjo do të thotë se trupi ka nevojat e veta për ushqim, pije, rroba, martesë, riprodhim... dhe ato mund të jenë të plotësuara vetëm në atë mënyrë që të mos i prishin nevojat e shpirtit dhe të mendjes, por edhe që të mos asfiksohen nga kërkesat e shpirtit apo të mendjes, si p. sh. nga asketizmi i tepruar apo nga ndonjë ideologji që kërkon martirizimin a pengimin e nevojave të natyrshme trupore; shpirti ka nevojë për udhëzim, butësi, qetësi... dhe Islami ia ka hapur dyert e ibadetit (riteve të veçanta fetare) me të cilat i kënaq nevojat e veta; mendja ka nevojë për mësim, dije dhe njohje, përsiatje, analizë, meditim, argumentim... dhe Islami urdhëron që të plotësohen edhe këto nevoja, ashtu që (me anë të mendjes) t'i hulumtojë botët dhe porositë e Librit të All-llahut (xh. sh.), `Gjithësinë që flet` në shpirt e në shoqëri dhe atë `Kur'an që hesht` në botën fenomenale të Gjithësisë.

Në këtë kuptim, mund të caktohet qëllimi themelor i pedagogjisë islame: të edukohet muslimani, që do të veprojë në pajtim me ajetin

kuranor: *`Dhe kështu ju bëmë ju një bashkësi të rrugës së mesme (ummeten vesaten)`* (2, 143), që do të thotë: të edukohet personaliteti i ri që t'i shmanget çdo teprimi në të gjitha sferat e jetës dhe të mbajë gjithmonë mesin. Në besim ai mes nënkupton që njeriu t'u përmbahet sharteve të definuara qartë të imanit, se do të largohet nga çdo risi dhe elemente të huaja në të, nga çdo mendim ekstravagant në lidhje me të; në veprimtari: që të mos tejkalohen kufijtë e së lejuarës që ka përcaktuar i Lartësuari në Librin e Tij; në bashkëpunimin dhe raportet me të tjerët dhe me shoqërinë - që qëllimet personale të mos vihen mbi ato shoqërore dhe anasjelltas: që për hir të interesave shoqërore të mos lihen pas dore interesat personale dhe familjare.

Edukimi i shpirtit (et-terbijetu'r-ruhuje)

Edukimi i shpirtit, ashtu si e sheh Kur'ani, është gurrthemel i edukimit në tërësi. Në qoftë se shpirti është i edukuar, të gjitha anët tjera të edukimit mund të jenë të kënaqura, dhe anasjelltas: shpirti i paedukuar apo lënia pas dore e edukimit të shpirtit, rrënon të gjitha përpjekjet e tjera në edukim.

Termi për shpirtin që përdoret në pedagogjinë islame, është *err-ruh* që do ta përkthejmë si: shpirti njerëzor, dhe këtu do t'i lëmë anash diskutimet e thella mbi shpirtin, dallimet ndërmjet ruhut dhe nefsit, `shpirtit` dhe `zembrës` etj. në Kur'an.

Edukimi do të jetë i suksesshëm vetëm nëse personi që edukohet, beson se njeriu e ka krijuar Zoti xh.sh. Në këtë rast, qënia e re njerëzore do të besojë edhe pavdekshmërinë e shpirtit, shpërblimin për veprat e mira dhe qëndrueshmërinë në rrugën e Zotit, ringjalljen, dhënien e llogarisë në Ditën e Gjykimit dhe jetën e amshuar.

Kur'ani thekson se All-llahu (xh. sh.) njeriun e ka krijuar në formën, konstruktin dhe proporcionet më të bukura (***Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur*** - *Et-Tin*, 4), dhe asnjë qenie, as fizike as shpirtërore nuk është krijuar sikur njeriu. Me pikëpamjen e këtillë, Islami e nderon njeriun dhe atij i jep një respekt të veçantë në botë.

Në të vërtetë, edhe qëniet e tjera kanë forma të harmonizuara fizike, por njeriu është i veçantë sipas asaj që Krijuesi frymëzoi tek ai ruhun e Vet:

"Dhe kur u tha Zoti yt engjëjve: 'Unë do të krijoj njeriun nga argjila, balta e tharë, dhe kur ta përsos atë (në formën e njeriut) dhe kur t'i jap ruhun Tim, atëherë ju bini atij në sexhde" (Hixhr, 28-29; si dhe disa ajete të tjera).

Ruhu është një aftësi (fuqi) tek njeriu, me të cilën ai njih gjajbin, botën më të lartë, e njih dhe e do All-llahun (xh. sh.), e njih ekzistencën melaqeve, Ahiretin, fatin e caktuar etj. Ruhu nuk është material (si trupi), prandaj nuk ka pengesa për të njohur botën më të lartë dhe nuk është i kufizuar në vend e në kohë (sikur mendja) që t'iu nënsh-trohej ndikimeve të mjedisit.

Njohja e All-llahut (xh.sh.) dhe e botës-gajb i është e dhënë ruhut; Kur'ani thekson që të gjithë shpirtërat, pasi janë krijuar, kanë dëshmuar në Ezel se i ka krijuar All-llahu (xh. sh.) (El-A'raf,172), prandaj, njohja e All-llahut (xh. sh.) është më e lehtë se njohja se uji është i lagët (Ibni Tejmije). Por, edhe shpënia e ruhut në rrugë të keqe, në lajthitje, në shirk, që e bën shejtani, gjithashtu është e lehtë, dhe për këtë arsye i Lartësuar, nga mëshira e Tij, ka përcaktuar disa ibadete, të cilat duhet të kryhen disa herë brenda çdo dite e nate, në mënyrë që njeriu ta ruajë ruhun e vet nga lajthitjet e shejtanit dhe që të mos braktisë edukimin e vet. Në pikënisjet themelore të pedagogjisë islame është që nuk mund të edukohet njeriu pa ibadete, që nuk ka edukim të ruhut, në qoftë se njeriu nuk i zbaton ibadetet e përcaktuara, e pa ruh të edukuar njeriu, deshi a s'deshi, do të futet në ndonjërin nga llojet e shirkut.

"Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për All-llahun! Ndërsa, ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër All-llahut, s'ka dyshim se All-llahu do të gjykojë mes tyre për shkak të kundërshtimeve të tyre. All-llahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë atë që është gënjeshtar dhe mohues i së Vërtetës; (Ez-Zumer)

"... përse nuk falënderojnë, por adhurojnë zota të tjerë në vend të All-llahut, me shpresë se ata do t'u vijnë në ndihmë; mirëpo, ata nuk mund t'u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e dëgjueshme e tyre" (Ja-sin, 73-75).

Si e edukon Islami ruhun

Ruhu nuk mund të edukohet nëse i ndërpritet lidhja e tij me Krijuesin, i Cili e ka frymëzuar atë tek ne dhe tek i Cili do të kthehet pas jetës së kësaj bote. Kjo lidhje ruhet vazhdimisht dhe përtëritet me anë të besimit në shartet e imanit dhe me zbatimin e sharteve të Islamit, dhe ky është mjeti më i mirë e i vetmi për edukimin e ruhut, mjet që nuk e ka asnjë pedagogji tjetër. Të gjitha këto sharte janë të shënuara dhe të shpjeguara në mënyra të ndryshme në Kur'ani - kerim. Besimi në All-llahun (xh. sh.) nënkupton vetëdijen mbi Atë të Padukshmin, por të Gjithëpranishmin (El-Muhit), i Cili është dëshmitar për çdo akt njerëzor dhe i Cili di ç'fshehim dhe çfarë shprehim publikisht e para të Cilit do të japim llogari në Ahiret për të gjitha veprat tona:

"Nga vërejtja jote do të përfitojë vetëm ai që ndjek Kur'anin dhe ka frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe pse nuk e sheh Atë". (Ja-sin, 11);

"Të All-llahut janë gjithçka ka në qiej dhe ç'ka në Tokë! E treguat ju atë që është në shpirtrat tuaj apo e fshehët, All-llahu do t'ju marrë në përgjegjësi për të..." (El-Bekare, 284).

Besimi në melaqet e edukon ruhun ashtu që me këtë shart të imanit, të forcojë vetëdijen mbi faktin që melaqet janë shoqëruesit dhe regjistruarit e veprave të njerëzve, që bota e dukurive është e banuar me to, gjë që te personi që edukohet, zhvillon ndjenjën e vetëkontrollit, seriozitetit dhe veprimin në pajtim me dispozitat e All-llahut (xh. sh.), pastaj shton dëshirën që të arrijë pastërtinë e tyre, bindshmërinë e tyre ndaj All-llahut (xh.sh.) dhe virtytet e tyre.

Besimi në të gjithë librat dhe të dërguarit e All-llahut tek ai që edukohet, zhvillon ndjenjën se i përket bashkësisë më të mirë të njerëzve - besimtarëve dhe bamirësve nëpër të gjitha gjeneratat, se që nga lashtësia deri në ditën e Kiametit, njerëzimi mund të bashkohet duke u lidhur për Litarin e Dritës së Librave dhe të pejgamberëve të All-llahut (xh. sh.) dhe duke i tejkaluar pengesat e veta racore, nacionale dhe klasore, ngre vetëdijen se kufinj të në mes besimeve të ndryshme monoteiste janë shumë të hollë, nëse pasuesit e tyre janë thellësisht besnikë ndaj këtij Litari Drite, se paqja dhe bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet monoteistëve mund të arrihen lehtë, se e Vërteta mbi kuptimin e të jetuarit gjendet në këta libra, se ajo është universale, e dërgu-

ar për të gjithë njerëzit, se e Vërteta e Shpalljes e mban të bashkuar njerëzimin sikurse forca, përkatësisht ligji i gravitacionit që e mban Tokën të ekuilibruar në orbitën e saj, etj.

Në këtë shart të besimit, pejgamberët bëhen shembuj për breznitë e reja, shembuj të sinqeritetit dhe besnikërisë ndaj Fjalës së All-llahut (xh. sh.), shembuj trimërie, shembuj të ndërgjegjes së thellë e të lidhjes shpirtërore me Krijuesin; ata janë revolucionarët më të mëdhenj në historinë njerëzore, bartës të së Vërtetës dhe çlirimtarë të njeriut nga çdo formë poshtërimi dhe eksploatimi të tij, kundërshtarët më të përbetuar të shirkut dhe jomoralit, edukuesit dhe edukatorët më të mirë dhe pishtarët e pamposhtur të pastërtisë morale e shpirtërore.

Besimi në ditën e Kiametit dhe jeta e amshuar në Ahiret, ruhun e edukon në atë mënyrë që njeriu të përgatitet për të duke e ditur se vetëm besimi dhe veprat e mira mund ta shpëtojnë nga pasojat e këqija. Vetëdija mbi kalueshmërinë e botës materiale dhe çdo gjëje që është në të, ndihmon shërimin e ruhut nga mendjemadhësia dhe makutëria.

Duke besuar në kada dhe kader, personi që edukohet nuk bie në fatalizëm (sikur komentohet shpesh gabimisht kjo shtyllë e besimit islam), por ka ndjenjen e lirisë, dhe njëkohësisht edhe të përgjegjësisë për veprat e veta. Mirëpo, ka gjëra që ndodhin jashtë mundësive njerëzore, po njeriu nuk do të përgjigjet për to. Ajo që ndikon pedagogjikisht në këtë besim, është pranimi me gjakftohtësi i çdo gjëje që ndodh duke besuar se çdo gjë ka një kuptim misterioz, i njohur vetëm për të Dashurin All-llah, dhe akumulimi i energjisë shpirtërore që të përballohen esëll të papriturat dhe vështirësitë e jetës, pastaj që t'i bëhet lutje All-llahut (xh. sh.) që t'i dhurojë `zgjidhje të drejtë` për çdo situatë dhe përfundim të mirë nga çdo ngjarje.

Besimi në ringjalljen pas vdekjes, e motivon të riun që të bëjë vepra të mira dhe të largohet nga të këqijat. Ky besim ngjall shpresën në kuptimin e jetës njerëzore dhe në përpjekjet e vështirësitë në rrugën e së Mirës. Përveç vetëdijes mbi të vetmin Zot, asgjë nuk i edukon më shumë njerëzit se të përkujtuarit e vdekjes dhe bota e amshuar në të cilën do të jepet llogari për veprat e bëra.

Të gjitha shartet e imanit edukojnë ruhun, e pastrojnë dhe e afrojnë te Krijuesi, ndërsa brezin e ri e edukojnë që të jenë të dëgjueshëm ndaj All-llahut (xh. sh.), që të kenë frikë e respekt para shikimit të Tij

dhe kjo jo vetëm në jetën publike, por edhe kur janë të vetëm, larg shikimit të njerëzve:

"Thuaj: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju përcaktoi Zoti juaj: (...) mos iu afroni mëkateve, qofshin ato publike apo të fshehta!'" (El-En'am, 151)

Për sa u përket sharteve të Islamit, qëllimi i tyre pedagogjik mund të përmbliidhet në një fjalë: *tuhur*, pastërtia e ruhut apo e `zemrës`. Me fjalë të tjera, çdo ibadet në Islam fillon me pastërtinë e trupit dhe pastërtinë e qëllimit, ndërsa rezulton me pastrimin e ruhut. Në këtë kuptim, Pejgamberi i All-llahut (s.a.v.s.), sipas transmetimit të Imam Muslimit nga Ebu Malik el- Esh'ariu, ka thënë: *`Et-Tuhuru shatru'l- iman* - pastërtia është pjesë e imanit!` Këtu pastërtia ka të dy faqet e medaljes, d.m.th. me të nënkuptohet edhe pastërtia fizike edhe pastërtia shpirtërore, pastërtia dhe paqëtimi.

Të gjitha shartet e islamit, një nga një dhe si tok ibadetesh, janë përcaktuar, përveç të tjerash- e All-llahu e di këtë më mirë – me qëllim që njeriu të shërohet nga sëmundjet e rënda shpirtërore sikurse janë: idhujtaria, dyfytirësia, agresiviteti, mendjemadhësia, koprracia, makutëria, egoizmi etj.

Për shkak të intensitetit të këtyre sëmundjeve i Lartësuari ka përcaktuar pesë namazet për çdo ditë, ndërsa në Librin e Tij famëlartë ka theksuar qëllimin e namazit, të asaj `shtylle të fesë`:

"Vërtet, namazi largon nga çdo gjë që është e irituar dhe e shëmtuar, e përmendja e All-llahut është më e madhja dëgjueshmëri!" (El- 'Ankebut, 45)

Mufesirët nënvizojnë pjesën e dytë të këtij ajeti: *Ve le dhikrullahi ekber* - përmendja e All-llahut ose kujtimi i Tij, që udhëzon për paqëtimin e ruhut, paqëtim që arrihet duke kërkuar falje nga gjynahet, me lutje dhe falënderime të singerta ndaj All-llahut (xh. sh). Pa këtë dimension të vetin, namazi është *nakis* - i mangët, i kryer në mënyrë jo të denjë, pa përqendrim shpirtëror, për çfarë nuk arrin qëllimin pedagogjik.

Për qëllimin e shartit të dytë, agjërimin, i Lartësuari ka treguar qartë me nocionin *et-takva*, që do të thotë ruajtja e kufijve të All-lahut, vetëdija e plotë mbi All-llahun (xh. sh.), devotshmëria dhe zbatimi i zellshëm i dispozitave të Tij:

"O besimtarë, ju është bërë obligim agjërimi sikurse që ishte obligim edhe për ata që ishin përpara jush, në mënyrë që ta keni gjithmonë All-llahun ndër mend" (El-Bekare, 183)

Et-Takva, pra, është dëgjueshmëri edhe publike edhe e fshehtë ndaj All-llahut (xh. sh). Agjërimi e edukon njeriun në mënyrë islame, veçanërisht në këtë formën e dytë më të vështirë të dëgjueshmërisë. Muslimani që agjëron, mund të jetë tërë ditën në livadhin e vet pranë ujrit të kulluar, i etur, larg, pa mundësinë ta shoh kushdo, por, megjithatë as që mendon ta prish agjërimin - sepse në agjërim nuk ka dyfytirësi, agjërimi forcon vetëdijen për gjithëpraninë e All-llahut (xh. sh.) dhe e stërvit njeriun që të largohet nga mekati edhe publik edhe i fshehtë. Pejgamberi i All-llahut (s.a.v.s.) e ka shprehur këtë në mënyrë koncize në hadithin e mirënjohur: *`Ihsan* (bamirësi) është t'i bësh ibadet All-llahut sikur ta shihje, mirëpo, edhe pse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty!

Përveç dëgjueshmërisë ndaj All-llahut (xh. sh.) në mënyrën e përshkruar, agjërimi, sipas disa thënieve të tjera të Pejgamberit, njeriun e edukon të mësohet, të bëhet i durueshëm në vështirësitë e jetës, të jetë sentimental dhe t'i kuptojë ata që janë të uritur e të etur, të jetë mendjempërhtë, i zhytur në meditime mbi çështjet më të thella të ekzistencës së vet, t'i frenojë kërkesat e trupit para nevojave të shpirtit, etj.

Me obligimin e tretë fetar, me zekatin dhe në kuptimin më të gjerë me sadakanë, ruhu kurohet nga sëmundjet e lakmisë e të koprracisë, dhe në të njëjtën kohë me zbatimin e kësaj detyre i shprehet falënderim Krijuesit për sofrën që shtroi mbi sipërfaqen e Tokës përplot me begati për krijesat e Tij.

Paqëtimi i ruhut, në Kur'an është shënuar si qëllim i zekatit dhe sadakasë:

"Merr prej pasurisë së tyre zekatin që t'i pastrosh me të dhe t'i bësh të bekuar `tutahirukum ve tuzekkihim`". (Et-Tevbe, 103).

Haxhi në vete sintetizon të gjitha ibadetet e mëparshme; ai është kulmi i vetëdijes për All-llahun (xh. sh.), kulmi i filantropisë; ai zhvillon tek njerëzit ndjenjën e varshmërisë nga Zoti (xh. sh.); pastaj ndjenjën e barazisë; ndjenjën e harmonisë në botë; ai shlyen dallimet klasore në mes njerëzve; forcon ndjenjën e vëllazërisë në mes muslimanëve të botës; ai është dita e gjykimit në miniaturë, krijon pamjen e

ringjalljes nga varret dhe dhënien e llogarisë në Ditën e Gjykimit; etj., dhe që të gjitha këto së bashku e pastrojnë dhe e edukojnë ruhun fuqishëm e në mënyrën më të mirë.

Përveç ibadeteve, Kur'ani, ajo `medrese e përkryer` e edukimit (M. Mahmud), ofron edhe dy fusha të mëdha me të cilat edukohet ruhu. Ato janë: tregimet mbi popujt e lashtë dhe pamjet nga Gjithësia.

Kur'ani është përplotë me tregime mbi `el-umemu'l-gabire`, mbi `popujt që i ka mbuluar pluhuri`, të cilët ishin shkatërruar për shkak se kishin braktisur ruhun e tyre e u kishin kthyer shpinën porosive të All-llahut (xh. sh.); për shkak se u treguan arrogantë dhe u bënë dhunë të tjerëve; për shkak se i kishin kaluar kufijtë që i kishte vendosur Krijuesi; për shkak se i shkelnin ligjet fetare; për shkak se qenë kryeneçë dhe të paarsyeshëm etj.

"Përse nuk udhëtojnë ata nëpër botë e të shikojnë si përfunduan (si e pësuan) ata që ishin më parë, të cilët ishin edhe më shumë se ata dhe më të fortë për nga forca e ndikimi në tokë, por ajo që fituan, nuk u ndihmoi asgjë". (Gafir, 82-85, Err-Rrum, si dhe Fatir, 44 etj.)

Ajetet që flasin për Gjithësinë, ndikojnë në mënyrë edukuese aso-dore që bota e krijuar dëshmon për Krijuesin, i Cili krijon me urtësi dhe bukur:

"... qoftë lartësuar All-llahu, më i miri Krijues!" (El-Mu'minun, 14).

Kur'ani i thërret të edukuarit tanë që ta hulumtojnë këtë botë - me qëllim që t'i njohin cilësitë e Krijuesit të saj, në mënyrë që ta përjetojnë këtë botë si më të mirën nga të gjitha botat tjera, si botë në të cilën nuk banojnë kurrfarë demonësh as forcash të tmerrshme (të këqija), dhe në mënyrë që ta ndiejnë se kjo botë është krijuar për njeriun, që t'i shërbejë atij, e jo që njeriu ta eksploatojë pa shpirt dhe pa përfillje, në kundërshtim me vullnetin e Krijuesit të tij. Një poet mistik ka thënë: `Të dua, oj botë, të dua për shkak se All-llahu të ka krijuar!`

"Ai është që për ju lëshoi nga qielli ujin, që prej tij të keni për të pirë dhe prej tij të keni bimë që në to do t'i kullotni (bagëtinë). Me atë (shiun) mbijnë, për të mirën tuaj, të lashtat, ullinjë, hurmat, rrushi dhe nga të gjitha frutat. Në këto (të mira) ka argumente për një popull që vështron. Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe

Diellin e Hënën. Edhe yjet janë të nënshtruara me urdhrin e Tij. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon. Edhe për atë që ju krijoi në tokë lloje të ndryshme (bagëti, bimë, pemë, minerale etj.): ka fakte për një popull që di të marrë përvojë. Ai është që nënshtrroi detin, prej të cilit të hani mish të freskët, e prej tij të nxirrni stoli që i bartni (i vishni), e i sheh anijet siç janë (lundrojnë) në të (ujin në detë e çajnë me ushtimë). Jua nënshtrroi që t'i shfrytëzoni begatitë e Tij dhe ashtu të falënderoni (Zotin). Dhe ai vuri kodra (të forta) në tokë, që ajo të mos lëkundet me ju, (bëri edhe lumenj e rrugë që të mund të orientoheni. Vuri edhe shenja të tjera (për orientim ditën), ndërsa (natën) e bëri që ata të orientohen me anë të yjeve." (En-Nahël, 1-16; dhe ajete të tjera, si p.sh. El-xhathije, 12-13; Kaf, 6-11; etj.):

"O turmë e xhinëve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra, por nuk do të mundeni, vetëm me ndonjë fuqi të madhe". (Err-Rrahman, 33)

Të vëzhguarit e kësaj bote e përgatit ruhun që të takohet me të vërtetën, me bamirësinë, me udhëzimin dhe bukurinë e Krijuesit të Gjithësisë dhe të falënderohet për begatitë me të cilat e ka mbuluar si dhe të sillet para Tij me dinjitet dhe modesti.

Rezultati i drejtpërdrejtë i këtij edukimi të ruhut është që ai të fillojë të ndiejë lidhje sa më të fuqishme me Krijuesin, me ekzistencën e Tij, që të jetë sa më i ndërgjegjshëm për shikimin dhe kontrollin e Tij për çdo vepër të njeriut. Vështrimi mbi botën e krijuar nxit dashurinë ndaj asaj bote dhe ndaj Krijuesit të saj.

Kjo nuk është dashuri vetëm ndaj kësaj bote, në dukje jo të gjallë, por edhe ndaj të gjitha qenieve të gjalla që jetojnë në të.

Ajetet që cituam si dhe shumë të tjera, njeriun e edukojnë që ai të bisedojë me botën e krijuar, të vendosë raporte të ngushta mirëkuptimi dhe bashkëpunimi e jo raporte lufte me atë botë, dhe ta njohë veten në atë botë si kurorë të krijesave të All-llahut (xh. sh.) dhe si qenien më të respektuar dhe më të vlefshme në këtë botë.

Po ashtu të vëzhguarit e Gjithësisë fut në zemrën e njeriut kërkesa estetike për rend, harmoni dhe kënaqësi.

Edukimi i karakterit - edukimi moral (Et-terbijetu' l- ahlakijje)

Ahlak është fjalë e përcjellur nga fjala *huluk*, që do të thotë veti, tipar, natyrë, karakter, moral etj. Me mëshirën e Vet, Krijuesi çdo qenie njerëzore e krijon në *fitren* e pastër, d.m.th. në natyrën që është e prirur për cilësi pozitive që quhen *es-sifatu'l ahlakijetu'l-fitrijje* dhe të cilat janë qëllim i edukimit. Prandaj, *huluk* është e pamundur të komentohet nëse nuk lidhet me ajetin e njohur mbi fitren:

"Ti drejtoje veten tënde, si besimtar i vërtetë, nga feja e pastër, nga ajo natyra e All-llahut (fitretullah), sipas së cilës Ai i krijon njerëzit". (Err-Rrum, 30)

Me fjalën *huluk* në aspektin gjuhësor kuptojmë atë që merr njeriu në edukimin e vet kur bëhet sikur ajo natyrë në bazë të së cilës është krijuar; edukimi i tillë arrihet me anë të vetëvëzhgimit dhe disiplinimit në pajtim me natyrën sipas së cilës All-llahu (xh. sh.) e krijoi njeriun.

Muhammedi (s.a.v.s.)- është shembull i pajtueshmërisë së përkryer të karakterit me *fitren*; ai evitoi nga vetja çdo cilësi të keqe dhe bashkoi në vetë të gjitha *es-sifatu' ahlakujtu'-fitrijje*, për ç'arsye në Kur'an u quajt *usveten hasene* (El-Ahzab, 21), *huluki* i tij u cilësua si më i larti (El-Kalem, 4), ndërsa ai vetë tha: "Më ka edukuar Krijuesi im me më të mirën edukatë kur ka thënë:

"Ji i mirë me secilin, kërko të bëhen vepra të mira dhe largohu nga injorantët!" (El-A'raf, 199)

Kur'ani nuk i ka të mbledhura në një vend `urdhërat e Zotit`, por ai i tëri është i gërshetuar me këshilla, ku përmenden dhe kërkohen cilësitë e mira e refuzohen dhe qortohen cilësitë e këqija në natyrën e njeriut. Ja disa nga ato cilësi, të cilat Kur'ani dëshiron t'i kultivojë tek njerëzit: besnikëria ndaj së vërtetës, të rekomanduarit e së vërtetës, singjeriteti, durimi, besnikëria, mëshira, dashamirësia, butësia, saktësia, kompromisi, maturia, këndshmëria, drejtësia, të ndihmuarit e të dobhtëve, të mbuluarit e veprave të këqija me vepra të mira, të qenit i kënaqur me atë që ka lejuar Krijuesi, respektimi i mendimit të huaj, pastrimi i trupit, rrobave dhe banesës, respektimi i të drejtave, pasurisë, nderit dhe jetës së të tjerëve etj.

Cilësitë që Kur'ani i flak në mënyrë kategorike, janë: shirku, gënjeshtria, dhuna, vrasja, cenimi i nderit të tjetrit, dyfytësia, mosbindja ndaj prindërve, mashtrimi, vjedhja, vjedhja gjatë matjes, shpërdorimi i pasurisë së jetimit, gjykimi i padrejtë, ndërprerja e lidhjeve farefisnore etj.

Ja një shembull ligjërimi kuranor mbi ahlakun:

"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse me prindërit. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria nën kujdesin tënd, atëherë mos u thuaj as "of-oh", as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, por thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe, në shenjë mëshire, ule para tyre krahun përulës e respektues dhe thuaju: "Zoti im! Mëshiroji ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël". Zoti juaj e di më së miri çfarë keni në shpirtin tuaj. Nëse keni qëllime të mira, vërtet Ai jua fal atyre që pendohen. Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfrit, edhe atij në kurbet, por mos shpenzo tepër e pa udhë. Sepse ata që shpenzojnë tepër (masrafxhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të tij. Nëse detyrohesh t'ua kthesh shpinën atyre (të afërmëve etj.), duke kërkuar mëshirën që e shpreson nga Zoti yt (furnizim për t'i ndihmuar ata), atëherë thuaju atyre fjalë të mira (të lehta).

Dhe mos e bëj dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bëj koprrac), dhe as mos e shtrij të tërën e të mbetesh i qortuar e duarthatë (nga shpenzimi i tepërt). S'ka dyshim se Zoti yt është Ai që furnizon me bollëk atë që do, dhe ia kufizon atij që do. Ai di hollësisht për robët e vet dhe i vështron ata. Mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne sigurojmë furnizim për ata dhe për ju, sepse mbytja e tyre është mëkat i madh. Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse është një rrugë shumë e keqe. Dhe mos mbytni njeriun, (mbytjen e të cilit) Allahu e ka ndaluar, përveç me drejtësi (që e kërkon Sheriati). E kush vritet pa të drejtë (pa faj), trashëgimtarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos e kalojë kufirin me mbytje sa i është dhënë kompetenca. Mos e përdorni pasurinë e jetimit ndryshe veçse në mënyrën më të mirë (për t'ia shtuar), derisa ai të arrijë pjekurinë e vet. Premtimin zbatojeni, sepse premtimi ka përgjegjësi. Masën mbusheni kur matni (me enë)

dhe peshoni me peshojë të drejtë. Kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë. Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, sepse të dëgjuarit, të pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi. Dhe mos ec nëpër tokë me kryelartësi, sepse ti as nuk mund ta çash tokën dhe as nuk mund të arrish lartësinë e maleve. E keqja e të gjitha këtyre është e urrejtur tek Zoti yt." (El-Isra, 23-38; gjithashtu shih psh.: El-En'am, 151-152; En-Nisa', 36-38; etj)

I Lartësuarit e ka quajtur veten në Kur'an me 99 emra/ cilësi të mira, të cilat (përfshijë vetëm disa prej tyre, të rezervuara vetëm për Dhatin- Qenësinë e Tij) përmbajnë cilësi pozitive, të cilat i edukuari duhet t'i "përfshijë në edukimin e vet". Të themi, kur i Lartësuarit e quan veten *El-Hakk* (i Vërteti), apo *El-Adil* (i Drejti), apo *El-Latif* (i Buti), atëherë edhe njeriu duhet të jetë dashës i së vërtetës, i drejtë, i butë... Ata emra edhe janë dhënë në Kur'an për përfshirjen e tyre në moral.

Përparësia e *es-sifatu; l-ahlakijetu' lfitrijje* në krahasim me vlerat që i rivendos cilado shoqëri tjetër joislame, një sistem juridik, filozofik ose ndonjë sistem tjetër, është se këto cilësi sjellin sukses edhe në këtë botë edhe në botën tjetër dhe se janë të lidhura me botën e gajbit, sepse nisen nga besimi apo e vërteta që Zoti njeriun dhe "*natyrën e tij të pastër*" e ka krijuar me mundësinë që t'i realizojë këto cilësi me ndihmën e Shpalljes dhe të Pejgamberit të All-llahut (s.a.v.s.), si shembull a model identifikimi.

Si e edukon karakterin Islami

Përveç besimit dhe ibadeteve me të cilat shërohet njeriu nga cilësitë e këqija, ka edhe mjete të tjera për edukimin e karakterit. Ato janë: marrja e Pejgamberit (s.a.v.s.) si shembull dhe vetëdija mbi kufirin e hallallit e haramit.

Një ashab me të drejtë ka thënë që muslimanët janë *eshrefu' l-eimme*, bashkësia më prestigjioze, dhe kjo për dy arsye: për shkak se të vetmit ata e kanë Librin autentik të Zotit dhe synetin e ruajtur të Pejgamberit të "tyre". Në synetin e Pejgamberit - Muhammedit (s.a.v.s.) e shënuar në përmbledhjet autentike, janë ruajtur thëniet, veprimet dhe sjellja e tij, me një fjalë: pedagogjia e tij profetike e cila duhet studiuar në mënyrë të veçantë edhe në "gjuhën shqipe" (shën. i përk.).

Kështu njerëzit duhet të njihen me edukatën e Pejgamberit (s.av.s.) për të folurit, për marrjen e ushqimit e pijes, por raportin ndaj All-lahut (xh. sh.), Kur'anit, ndaj prindërve të vdekur, bashkëshortëve dhe fëmijëve, miqve, jomuslimanëve, tregtisë, gjykimit, luftimit, fjetjes, të ngriturit nga shtrati, ecjes... thjesht: Pejgamberi (s.a.v.s.) është një konkretizim i përkryer i edukatës (terbije) islame, model që duhet ndjekur.

Vetëdija mbi hallallin dhe haramin në Islam i edukon njerëzit në atë mënyrë që ata të kuptojnë se hallall (e lejuar) është çdo gjë që është e mirë, e këndshme dhe e dobishme për shëndetin e tyre, ndërsa haram (e ndaluar) është vetëm ajo që është e keqe, e pakëndshme dhe e dëmshme për shëndetin. Rrethi i hallallit është i gjerë, ndërsa rrethi i haramit është i ngushtë, por, megjithatë shumë njerëz, të mashtuar nga nxitjet e shejtanit, bëjnë vepra haram dhe nuk përfillin hallallin:

"Thuaj: "Nuk është njësoj ajo që është e ndaluar (el-habith) dhe ajo që është e lejuar (et-tajjib), po, edhe nëse të mahnit sasia e madhe e asaj që është e ndaluar.." (El-Maide, 100)

Krijuesi e lejoi *tajjibat*-in, kurse e ndaloi *haba'ith*-in dhe ndonëse hallalli dhe harami kanë të bëjnë me ushqimin dhe pijen, në edukim (terbije) nuk duhet të kufizohemi vetëm në to, sepse i Lartësuar ka thënë:

"Thuaj: `Zoti im i ndaloi (Innma harr-rreme Rabbi) të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i bëni shok All-llahut pa pasur për të kurrfarë argumenti dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini". (El-E'araf, 33).

"O besimtarë, hani nga të mirat (tajjibat) që u kemi dhënë dhe falenderojeni All-llahun..." (El-Bekare, 172)

"... (Pejgamberi), i cili do t'jua lejojë çdo gjë të mirë (tajjibat) dhe do t'jua ndalojë çdo gjë të keqe (haba'ith)" (El-E'raf, 157)

Ka dijetarë që mendojnë se hadithi i njohur: "Kërkimi i ditorisë është obligim (farz) për çdo musliman` (e citon Ibni Maxhe duke e transmetuar nga Enes ibni Maliku), fjala "kërkimi i ditorisë", në të vërtetë do të thotë të kërkuarit dhe të pranuarit e kufijve në mes hallallit dhe haramit. Po ashtu transmetohet nga Ibni Mes'udi që Pejgamberi

(s.a.v.s.) ka thënë: "Kërkimi i hallallit është obligim i çdo muslimani!"

Të përmbajturit e hallallit dhe të mënjauarit e haramit e pastrojnë njeriun dhe e shpëton shoqërinë nga çdo dëm dhe e keqe. Islami është efikas në këtë qëllim për arsye se e ka shpallur haram edhe atë që shpie në haram, d.m.th. është efikas, sepse i ka ndërprerë të gjitha rrugët që çojnë nga harami.

Njerëzit do të qëndrojnë larg haramit në qoftë se do të pranojnë edhe një të vërtetë shtesë: që harami prodhon haram, që bërja e haramit para së gjithash është gjynah dhe që frika nga dënimi i Zotit për gjynahun e bërë, më shumë se frika për humbjen e shëndetit, në mënyrën më efikase i largon njerëzit nga ai (harami).

Edukimi i mendjes (et-terbijetu'l-'aklije)

Mendja (*akl*) në Islam trajtohet nga dhuntitë më të mëdha që i dhuroi Krijuesi qenies njerëzore. Me të njeriut i është mundësuar të vëzhgojë, të mendojë, të analizojë, konkludojë... shkurt: të rritet shpirtërisht, por edhe të besojë. Prandaj, mendja është kusht i të besuarit, sepse në Islam nuk ka besim pa arsyetim, kurse ata që janë të privuar nga kjo dhuratë, nuk janë përgjegjës për veprimet e tyre dhe obligimet fetare nuk u destinohen atyre.

Asnjë religjion nuk i ka dhënë dinjitet mendjes sikurse dini – Islami, në Shpalljen e të cilit fjalët e para i janë drejtuar pikërisht mendjes:

"Mëso, lexo, mendo, hulumto - në emër të Zotit tënd, i Cili krijon!" (El-'Alek,1)

Që me këtë ajet, me të cilin u ndërrua në mënyrë epokale rrjedha e historisë njerëzore dhe filloi `qytetërimi i Fjalës`, është përcaktuar, ashtu si e shih Islami, edhe thelbi i besimit dhe qëllimi edukues i të menduarit.

Islami, domethënë, kërkon që mendja në punën e vet t'i bjerë në sexhde Krijuesit të të gjitha botëve, që mendja të mos jetë e pakufizuar, jashtë Sheriatit, në mënyrë që frytet e saj të jenë të mira, sepse një mendje, që nuk bie në sexhde para All-llahut (xh.sh.), është mendje iblisi (prej djalli), është mendje pa prijës, shpesh pa kurrfarë qëllimesh apo me qëllime që i bien ndesh vullnetit të Krijuesit. Me fjalë të

tjera, Iblisi, në tregimet kuranore, është shumë inteligjent, por edhe mendjemadh; mendja e tij, në vend se ta zbulojë e ta çlirojë të Vërtetën, ajo e fsheh dhe e asfikson. Mendja prej iblisi është kryelartë, për arsye se mohon Krijuesin në Gjithësi dhe për shkak se çdo rezultat që ka, ia mvesh vetvetes; mendja e tillë nga më e madhja begati shndërron në të keqen më të madhe.

Meqenëse sipërfaqja e Tokës s'mund të kultivohet as mund të ndërrohet gjë në të pa përdorimin e mendjes, atëherë Islami kërkon që zbulimet e saj dhe ajo që planifikon e ndërton, të jenë në pajtim me Sheriatin - në mënyrë që të krijohet në tokë një qytetërim në frymën islame - të nënshtrimit ndaj të Vetmit Zot. Çdo qytetërim tjetër, si prodhim i mendjes, në Kur'an është cilësuar jostabil dhe i gjymtë.

***"A është më mirë ai që ndërtesën e vet e themeloi mbi frikën ndaj All-llahut dhe mbi kënaqësinë e Tij, apo ai që themelin e ndërtesës së vet e vendosi buzë bregut të shembur , që bashkë me të të bjerë në zjarrin e Xhehennemit? Allahu nuk i udhëzon njerëzit që i bëjnë padrejtësi vetvetes."* (Et-Tevbe, 10).**

Islami refuzon parullën, `besoj për shkak se kjo është absurde!` dhe kërkon besimin që është rezultat i punës së mendjes, i të medituarit mbi Universin e njeriun dhe i të kuptuarit të Librit të All-llahut (xh. sh.). Që të arrihet besimi i tillë, Islami kërkon që duke përdorur arsyen njeriu t'i evitojë mundësitë që e bëjnë të udhëhiqet nga mendjemadhësia, mashtrimet, tradita e keqe, falltarët, supozimet e të ngjashme.

***"E kur u thuhet: `Ndiqni Shpalljen e All-llahut!` Ata thonë: `Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!` Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugë të drejtë (edhe atëherë do t'i pasonit)?"* (El-Bekare, 170);**

***"Shumica e tyre mbështeten mbi supozime, mirëpo, supozimet aspak nuk i ndihmojnë së vërtetës. All-llahu e di mirë ç'bëjnë ata."* (Junus, 75-80).**

Kur'ani, së këndejmi, është plot me udhëzime që nxitin mendjen për të medituuar mbi botën dhe mesazhet kuranore. P.sh.:

"Është fakt se në krijimin e qiejve e të Tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det me ngarkesë të dobishme

për njerëzit, në shiun që e lëshon All-llahu prej së larti e me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të çdo lloj gjallese, në lëvizjen e erërave e të reve që rrinë pezull mes qiellit e toke, (në të gjitha këto), ka argumente për një popull që ka mend." (El-Bekare,164);

"A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin, apo kanë dryna në zemra!" (Muhammed, 24).

Si e edukon mendjen Islami

Kushti i parë dhe i pashmangshëm që mendja të jetë e edukuar është që ajo ta marrë besimin (*iman bil-lahi Te'ala*) për prijës të vetin; mendja pa besim është mendje iblisi, ndërsa prodhimet e saj janë të këqijat dhe mbrapshtitë.

Kushti i dytë është që mendja të jetë e vetëdijshme për aftësitë e veta për njohje. Islami i ka caktuar kufij mendjes në njohje; ajo mundet - dhe duhet ta njohë vetëm botën e dukshme dhe në të të zbulojë shenjat dhe kodet (ajetet) mbi ekzistencën e All-llahut (xh.sh.), por ajo nuk është e aftë ta kuptojë botën e gajbit; kjo i është lënë një burimi tjetër të njohjes, ruhut apo `zemrës` (*fu'ad*). Të medituarit mbi qenien e Zotit (xh. sh.), melaqet, dhe të ngjashme, në Islam konsiderohet si mungesë edukate, për ç'arsye Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: `Mendoni e meditoni mbi atë që krijoi All-llahu, e jo mbi atë si është All-lahu, sepse ju këtë nuk mund ta bëni!` Të qëndruarit brenda këtyre kufijve është cilësi e edukimit të robëve të mirë të All-llahut (xh.sh.).

Në të njëjtën mënyrë, Islami refuzon mendimin filozofik, që nuk nisët nga e Vërteta, po vetëm e kërkon vazhdimisht dhe asnjëherë nuk e gjen. All-llahu (xh. sh.) është e Vërteta dhe Ai, nga mëshira ndaj njerëzimit, e shpalli të Vërtetën, dhe detyra e njerëzve të urtë është që ta kërkojnë të Vërtetën dhe t'ua `rekomandojnë` edhe të tjerëve. (El-Asër)

Kushti i tretë për edukimin e mendjes është që gjatë diskutimit, të bindurit dhe të konkluduarit, të zbulojë dhe të shtrojë argumente dhe që me ata që nuk kanë besuar ende ose me ata që mendojnë ndryshe, të bisedohet në mënyrën më të mirë:

"Ti thuaju: "Sillni argumentin tuaj nëse është e vërtetë ajo që thoni". (El-Bekare, 119)

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata në mënyrën më të mirë! Zoti yt e di më mirë kush është i humbur nga Rruga e Tij dhe kush është në Rrugë të Drejtë." (En-Nahl, 125)

Kur flet Kur'ani për metodën e diskutimi dhe të argumentimit, domethënë ai kërkon që mendja të përdorë mjete të lejuara, të cilat shpjen tek e Vërteta, dhe e thërret mendjen për të gjetur e argumente shkencore, për të medituar mbi ligjshmëritë, të cilat i Lartësuari i ka vendosur në çdo shoqëri dhe në çdo krijesë, për të përsiatur mbi urtësinë e All-llahut (xh.sh.), e cila manifestohet në krijesat e Tij, në godinën e Gjithësisë dhe në Sheriatin e Tij të famshëm:

"Ne nuk krijuam qiellin, Tokën dhe çdo gjë që ka mes tyre shkel e shko pa qëllim të caktuar." (El-Enbija', 16)

"Zoti ynë, Ti këtë nuk e krijove kot.." (Ali-Imran, 191)

Edukimi i trupit (et- terbijetu'l-xhismijje)

Edukimi i trupit nuk mund të ndahet nga edukimi i ruhut, karakterit dhe mendjes. Ideali i Islamit është që të bëjë harmoni të kërkesave, që ruhu të mos e lë pas dore trupin, as trupi ruhun. Prandaj, Islami nuk mund ta pranojë parullën që e kanë theksuar të gjitha kulturat dhe qyetërimet ekstreme materialiste: Në trup të shëndoshë - mendja e shëndoshë. Me të njëjtën këmbëngulje, Islami i refuzon edhe ato religjione e kultura në të cilat nuk përfillen nevojat e trupit.

Trupi, gjithashtu është dhuratë e All-llahut (xh. sh.) për njeriun. Ai na e ka dhuruar duke i dhënë konstruktin, proporcionet dhe formën më të bukur (Et-Tinë, 4) dhe Ai i krjoi të gjitha kushtet në sipërfaqen e Tokës që ne të mund të jetojmë në të si qenie trupore, duke i plotësuar, nevojat e trupit tanë:

"All-llahu është Ai që jua bëri tokën vendbanim e qiellin kulm dhe Ai jua dha formën dhe formën tuaj e bëri më të mirën dhe ju furnizoi me të mira e begati..." (El-Mu'min, 64)

Në Kur'an i Lartësuari përmend edhe bimët e kafshët, edhe pemët, edhe perimet, edhe drithërat, edhe ajrin, ujin ... në mënyrë që njeriu

të gjejë kënaqësi në to si begatitë e All-llahut (xh. sh.) dhe që të dijë e të ndiejë që ai është qenie e veçantë, e shpërblyer dhe e nderuar:

"Ne, vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit, ua mundësuam të udhëtojnë në tokë e në det, i furnizuam me ushqime të mira, i vlerësuam mbi shumicën e krijesave që Ne krijuam." (El-Isra', 70)

Është pra e drejtë e njerëzve që të kënaqen me të mirat e kësaj bote e të kësaj jete, dhe i Lartësuar i dërgoi pejgamberët e Vet që ta udhëzojë njeriun tek ajo që është e dobishme.

Natyra e njeriut në Kur'an përshkruhet jashtëzakonisht qartë: njeriu gjakon t'i plotësojë nevojat e trupit të vet, i do kënaqësitë, dhe harron kur e ka jetën të lehtë, dhembjen e përballon vështirë, është i padurueshëm etj. Nevojat e trupit Kur'ani i emërton si *shehvat*, epshe, të cilat vetvetiu nuk janë të ndaluara, d.m.th. Krijuesi nuk ia dha njeriut ato epshe që t'ia ndalojë më pastaj, por kërkoi nga ai që t'i kënaqë *shehvatet* në mënyrën e përcaktuar me Sheriat, pa i tejkaluar kufijtë, me maturi, duke iu përmbajtur mesatares, duke menduar në All-llahun (xh. sh.).

"Njerëzve u duket se është e mirë (hubu'sh-shehvat) vetëm ajo pas së cilës ata pasionohen: gratë, djemtë, grumbujt e arit e të argjendit, kuajt e bukur, bagëtitë e të mbjellat. Këto janë kënaqësi të kësaj bote; por e ardhmja më e mirë është tek All-lahu". (Ali-Imran, 14).

Si e edukon trupin Islami

Nuk ka ndonjë religjion a kulturë që t'i ketë kushtuar aq shumë vëmendje e kujdes trupit sikurse e bënë këtë islami. Islami kërkon që njeriu t'i plotësojë nevojat e trupit të vet: ta ushqejë e ta veshë atë, e nevojën e vet seksuale ta plotësojë në martesë. Kujdesin ndaj trupit, pastrimin dhe mbrojtjen e tij Islami i ka bërë ibadete. Monakizmin (murgjërinë) e ka ndaluar në mënyrë rigoroze, edhe me Kur'an edhe me synet:

"Thuaj: `Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-lahu i krijoi për robët e Vet?" (El-E'araf, 32)

"Martoni të pamartuarat e të pamartuarit dhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-lahu i begaton nga mirësitë e Tij..." (En-Nur, 32)

Me rastin e plotësimit të nevojave trupore të ushqimit, pije e veshmbathjes, Islami e ka ndaluar vetëm të tepruarit (*israf*):

"O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani e pini, por mos e teproni, se Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprjnë." (El-E'araf, 31)

Namazi, lutja islame (*es-salah*), nuk mund të kryhet nëse trupi dhe rrobat nuk janë të pastra, as që do të pranohej ai pa këtë kusht. Për këtë arsye Islami ka përcaktuar abdesin, gusullin, synetin e djemve, higjienë të veçantë në banjo (tualet), higjienë të veçantë të grave në kohën e menstruacioneve dhe në periudhën pas lindjs,etj.:

"All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen shumë." (El-Bekare,222).

Shumica e haremeve, të cilat i solli në Kur'an i Lartësuar, kanë të bëjnë me trupin; kështu është ndaluar konsumimi i *hamrit*, i çdo gjëje që e `ngatërron mendjen`, mishi i derrit e disa lloje të tjera të mishit dhe të yndyrës, e të ngjashme, sepse Islami mbështet qëndrimin që me trupin e ndyrë do të ndyhet edhe ruhu, d.m.th. që haramet e shtëna në organizëm, e bëjnë të pamundur udhëzimin e drejtë dhe shpien në gabim e në humbje të lumturisë në Ahiret:

"O besimtarë, s'ka dyshim se el-hamër (çdo gjë që deh), bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta të shejtanit. Largohuni, pra që të jeni të shpëtuar." (El-Ma'ide, 90);

"`Ai jua ndaloi juve vetëm: të ngordhurën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që therret në emër të dikujt tjetër, e jo në emër të All-llahut." (El-Bekare, 173)

Kështu edukohet trupi duke e mbrojtur atë nga haramet, e mbrojtja e tij më e mirë është me ahlak të fortë, d.m.th. duke përqafuar moralin e mirë dhe duke braktisur moralin e qortuar.

Kur'ani i dënon në mënyrë të veçantë devijimet trupore seksuale, homoseksualizmin dhe të gjitha llojet e perversionit seksual, dhe flet për shumë popuj, të cilët janë shkatërruar me ndëshkime të dhembshme pikërisht për këtë lloj të mëkatit trupor. Në këtë kuptim janë tronditëse tregimet mbi popullin e Nuhut dhe Lutit (a.s.), tregime nga të cilat besimtarët marrin mësim se si mëkatet trupore, veçanërisht ato seksuale, shkaktojnë dëme të mëdha duke shkatërruar individë, fami-

lje e popuj dhe se ata që i bëjnë ato, bastardojnë vlerën (prestigjin) që ia dha Krijuesi qënies njeri dhe bukurinë që i dha trupit të tij:

"Dhe mos iu afroni prostitucionit (zinasë), sepse vërtet është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe." (El-Isra, 32);

"Dhe populli i tij, që më parë bënë punë të turpshme, erdhi me nguti tek ai (te Luti), e ai tha: 'O populli im, qe këto bijat e mia (gratë e atij vendi) janë më të pastra për ju, kini frikë All-llahun e mos më turpëroni me mysafirët e mi, a nuk ka ndër ju ndonjë njeri të mençur) e t'ju largojë (nga e keqja)?' Ata thanë: 'Po ti e di se ne nuk kemi fare lakmi për bijat e tua, ti e di me siguri se ç'dëshirojmë ne!' E kur erdhi urdhri ynë, ne përmbysëm të gjitha ato (fshatra) duke e kthyer çdo gjë nga lart poshtë dhe mbi ta reshëm gurë të fortë pa ndërprerje." (Hud, 78-82)

Islami përcaktoi dispozita të këtilla për kultivimin e trupit dhe sanksione kundër cenimit të dinjitetit të tij, në mënyrë që njeriu të mund t'i kryejë të gjitha obligimet e veta jetësore, që të mund të bëjë ibadet dhe ta rregullojë sipërfaqen e tokës në pajtim me vullnetin e All-llahut (xh.sh.), që t'u ndihmojë të tjerëve, ta përhapë të Vërtetën dhe durimin duke u përpjekur ta fitojë kënaqësinë e All-llahut (xh.sh.). Prandaj Pejgamberi (s.a.v.s.) tha që më shumë e do besimtarin e shëndoshë e të fuqishëm, ndonëse ka të mira edhe tek i forti edhe tek i dobëti.

Edukimi i prirjeve estetike (et-terbijetu'-xhemalijje)

Dijetarët klasikë islamë, duke përkufizuar të bukurën, theksuan që ekzistojnë dy lloje të bukurisë: bukuria fizike (*el-hissi*) dhe shpirtërore (*el-ma'nevi*).

Bukuria realizohet në formën, pamjen, strukturën dhe proporcionet e qenies, por edhe në moralin, intimitetin dhe veprën e saj.

Imam Muslimi në zinxhirin e tij të transmetuesve, përcjell nga Abdullah ibni Mes'udi që Pejgamberi i All-llahut (s.a.v.s.) ka thënë: 'Nuk do të hyjë në Xhennet ai person në zemrën e të cilit ka një fije mendjemadhësi!' Dikush e pyeti: - Po nëse dikush dëshiron të zbukurohet ose të mbajë rroba të bukura? - Pejgamberi (s.a.v.s.) u përgjigj: "Innallahe xhemilun juhibu'l-xhemale - 'All-llahu, vërtet, është i bu-

kur dhe e do të bukurën!` Kibri (mendjemadhësia) nuk përfillë të Vërtetën dhe i nënvlerëson njerëzit!"

All-llahu (xh. sh.) është i bukur (*El-Xhemal*), Ai e dërgoi Librin e vet në stilin dhe gjuhën mrekullisht e bukur, Pejgamberi i Tij (s.a.v.s.) ishte jashtëzakonisht i bukur, dhe çdo gjë që ka prekur Islami, e ka zbukuruar: ushqimin, të folurit, veshjen, banesën, arkitekturën, mjedisin, enët, veglat, muret, librat, ndërsa xhamitë janë vendtakimet e mjeshtërive më të bukura: ndërtime, dekorime, inkrustacione, muzikë vokale, lojëra drite, lojëra uji, krijim ambientesh të gjelbëruara etj.

Islami bëri (edhe) revolucion estetik në botë, fillimisht me estetikën e Fjalës së vet, e pastaj me çdo gjë me të cilën erdhi në kontakt:

"A nuk e ke kuptuar se si All-llahu e bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë rrënjët e së cilës janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo jep frytin e vet në çdo kohë. All-llahu, pra u paraqet njerëzve shembuj që ata të mendojnë. Ndërsa shembulli i fjalës së keqe është si një pemë e keqe që është e shkullur mbi tokë e që për të nuk ka ekzistencë. All-llahu do t'i forcojë besimtarët me fjalën e qëndrueshme në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër, ndërsa mizorët do t'i bëjë të humbur. All-llahu punon çfarë të dojë." (Ibrahim, 24-27)

Si e zhvillon Islami ndjenjën estetike

Së këndejmi, personat që edukohen duhet të mësohen si ta vërejnë bukurinë në botën e dukurive dhe në moral, me qëllim që të sillen në mënyrën më të mirë, që të kontribuojnë për të bukurën dhe të spikatin cilësinë e All-llahut (xh. sh.) të bukurisë në Gjithësi, në vetë njeriun, në fjalë dhe vepra, sepse, nëse njeriu jeton në pajtim me *fitretullah*-in (natyrën e vet), është më i miri ndër të gjitha krijesat e All-llahut (xh. sh.), të cilin Krijuesi, sikurse e pamë më herët, e nderoi në mënyrë të veçantë nga të gjitha krijesat.

Kur'ani e drejton shikimin e lexuesve, përkatësisht të dëgjuesve të tij nga bukuria fizike tek njeriu, Gjithësia dhe trupat qiellorë:

"Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast (mosharmoni), andaj, drejtoje shikimin nëse sheh ndonjë çarje? Pastaj, herë pas herë drejtoje shikimin, e shikimi yt do të kthehet tek ti i përvetur dhe

i lodhur. Ne, qiellin më të afërt e kemi zbukuruar me yje ndriçuse dhe ato i kemi bërë gjuajtës kundër djajve, për të cilët kemi përgatitur dënim me zjarr të madh". (El-Mulk, 3-5);

e pastaj edhe nga bukuria shpirtërore (ma'nevi), në të cilën theksohet bukuria e sjelljes:

"E robët e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe! Dhe që për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (falen). Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e Xhehennemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të është gjëja më e rëndë. Ai, vërtet është vendqëndrim e vendbanim i keq. Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë, e as nuk janë dorështrënguar, por janë mesatarë dhe janë të matur. Edhe ata që përveç All-llahut nuk i luten ndonjë zoti tjetër dhe nuk vrasin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, vetëm nëse e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i bën këto, ai e gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e Kiametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu ua shndërron të këqijat në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai fal shumë..." (El-Furkan, 63-70)

Kur'ani përdor një metodë të veçantë të kontrastit të nocioneve dhe pamjeve, me qëllim që të vërë në dukje të bukurën; edhe kur flet për të shëmtuarën, e ai, në të vërtetë, spikat të bukurën dhe estetikisht e kultivon atë. Kështu janë paraqitur në kontraste të forta Xhenneti e Xhehennemi, errësira e drita, liria e dhuna etj.

"A të ka ardhur lajmi për fatkeqësinë e madhe? - / kur disa fytyra të dëshpëruara/ të lodhura e të rraskapitura,/ do të digjen në zjarrin e përvëluar,/ do t'u jepet të pinë nga një krua i valë,/ kur ushqim tjetër nuk do të ketë pos barishte me ferra helmuese,/ që as fuqi nuk u jep as urinë nuk ua largon."

"Disa fytyra atë ditë do të jenë të gëzuara,/ të kënaqura nga veprimet e tyre-/ në Xhennet të shkallës së lartë,/ në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë të kota,/ aty ka burime uji që rrjedhin, shtretër të shtrenjtë,/ dhe gastare të vendosura pranë,/ dhe jastekë të radhitur,/ edhe qilima të shtruar..." (El-Gashije, 1-16).

Qëllimi i vështrimit të bukurisë që krijoi All-llahu (xh. sh.) është që, edhe me anë të saj, të bëhet edukimi, pastaj që njerëzit të meditojnë me gëzim mbi krijimet e All-llahut (xh. sh.) dhe cilësitë e Tij. Kështu bukuria bëhet e pandashme nga e Vërteta dhe mirësia.

Edukimi i personalitetit shoqëror (et-terbijetu'l - ixhtimaijje)

Kur Islami flet për shoqërinë në të cilën jeton njeriu i ri (*El-xhe-ma'ah*), ai nënkupton xhematin që mund të jetë i vogël - sikurse është familja, i madh - sikurse është shoqëria ku jeton, dhe më i madh – sikurse është njerëzimi.

Gjithashtu, Islami ka pikëpamjet e veta për mjedisin, përkatësisht shoqërinë dhe rrethin në të cilin jeton musliman, në këtë rast këtu mendohet për fenë, zakonet familjare, moralin shoqëror, ekonominë, kulturën, idetë filozofike, traditën, jetën e përditshme.

Edukimi shoqëror u nënshtrohet parimeve të sistemit shoqëror në kuptimin e përgjithshëm dhe ai nënkupton që ato parime të vendosen në shoqëri, që njerëzit t'i përvetësojnë dhe që nëpërmjet tyre t'i afrohen All-llahut (xh. sh.) dhe të realizojnë të mirën individuale dhe të përgjithshme në këtë botë dhe në tjetrën.

Edukimi islam i personalitetit shoqëror nuk bazohet mbi disa parime të jashtme, të cilat, në pajtim me këtë apo me atë periudhë, i vendosin qeveritë, sistemet juridike apo opinionin publik, të cilat paraqiten në funksion të mbikëqyrjes shoqërore, sipas së cilës orientohet edukimi i personalitetit të ri apo sipas asaj se çfarë synohet me atë edukim; jo, por edukimi islam bazohet në ndjenjat (*ihsas*) mbi ekzistencën e All-llahut (xh. sh.), në ndjenjat që posedon gjenetikisht qenia njerëzore dhe të cilat në mënyrë natyrore vihen nën mbikëqyrjen e Qenies Sublime, kështu që ato ndjenja luajnë rolin e kontrolluesit të brendshëm në shpirtin e qenies njerëzore, kontroll ky që nuk është rezultat i ndonjë frike nga psuhteti i jashtëm, i mishëruar në ligje, zakone, në sistemin gjyqësor a policor, e të ngjashme.

Ndërmjet edukimit shoqëror islam dhe shekullar, gjithashtu ekzistojnë dallime edhe në dimensionin e interesave të tyre, meqë edukimi islam nuk zhvillon tek personaliteti ndjenjën e përkatësisë dhe përfshirjes vetëm në familje, apo në ndonjë aleancë, parti politike, kombësi

a regjion, por ai në qeniet e reja zhvillon ndjenjën/ të kuptuarit që të gjithë muslimanët janë - një popull, një ymet, i cili i përket tevhidit dhe i cili i bën ibadet vetëm Krijuesit në pajtim me parimet e Tij, të cilat i ka vendosur në Librin e Vet, sikurse thotë i Lartësuari:

"Me të vërtetë, ky ymeti juaj është - një ymet, ndërsa Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua." (El-Enbija, 92)

Kjo për arsye se Islami është e vetmja fe e drejtë që kërkon nga muslimani t'i përmbahet asaj, ta ruajë, ta zhvillojë dhe ta forcojë, dhe ta ndiejnë veten të gjithë si një popull - sepse i Lartësuari dërgoi të gjithë pejgamberët e Tij me të njëjtën fe, porosi të vetme - me të njëjtin besim dhe parime, kështu që besimtarët janë një ymet në të gjitha kohët dhe në çdo vend.

Parimet e edukimit shoqëror që janë vendosur në Kur'an dhe sy-net, janë unike dhe ato e ruajnë shoqërinë islame nga devijimet dhe orientimi i gabuar. Ato devijime mund të vijnë nga eksperimentatorë, kreatorë të teorive dhe botëkuptimeve të ndryshme shoqërore, teoritë e të cilëve orientohen sipas frymës së kohës, mjedisit dhe sipas hamendjeve e pasioneve të tyre.

Sociologët në Perëndim arritën të bënin me sukses në mënyrë precize diagnostifikimin e problemeve me të cilat po ballafaqohen shoqëritë njerëzore, por ata nuk janë në gjendje të ofrojnë ilaç a zgjidhje nga kriza morale që ka kapluar shoqëritë bashkëkohore.

Islami zhvillon tek të edukuarit një ndjenjë edhe më të gjerë: ndjenjën se i takojnë gjinisë njerëzore dhe se të gjitha problemet shoqërore janë edhe problemet e tyre dhe se çdo anëtar i shoqërisë njerëzore ka obligimin e vet shoqëror të ndihmojë në zgjidhjen e krizave shoqërore.

Lidhur me këtë Islami ofron alternativën e përzetshme: që nevojat e shoqërisë njerëzore të jenë në pajtim me besimin në një të Vetmin Krijues të njerëzve dhe me adhurimin vetëm ndaj Tij, me botëkuptim më të gjerë për njeriun si *halife*, d.m.th. si përfaqësues i Zotit në tokë, pastaj me vetëdijen mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit reciprok të të gjithë njerëzve, me domosdoshmërinë e ndihmës dhe bashkëjetesës së ndërsjellë, me përhapjen e së Vërtetës, me zhvillimin e ndjenjës së durimit, punës për të Mirën dhe pengimit të së keqes si dhe të përpjekjes që Fjala e Zotit të jetë më e larta.

Vetëm duhet të shikohen thirrjet kuranore, adresimet e urdhëresat dhe tek ato të zbulohen dimensionin e tyre shoqëror, kujdesi dhe puna për gjininë njerëzore. Kur'ani, shpesh, u drejtohet : "*O njerëz (Ja ejjuhe'n-naas.), o besimtarë (Ja ejjuhel'ledhiine aamenuu...), Adhuronie vetëm Krijuesin tuaj! Bëni vepra të mira! Kryeni faljen! Jepni zekatin! Bëni mirësi!...*" Këto forma përsëriten shpesh, dhe kuptimi i tyre është që të kultivojnë te njeriu ndjenjën për shoqërinë ku jetojnë dhe për gjininë njerëzore si të tillë.

Si e edukon personalitetin shoqëror Islami

Kur'ani - kerim ka vendosur parime të përgjithshme, mbi të cilat duhet të bazohet shoqëria njerëzore, ku do të formohet një individ i shëndoshë, ku do të ketë mundësi t'i kryejë obligimet e veta, të jetojë me një jetë njerëzore në gjirin e familjes e të bashkësisë së vet, më tej: në gjirin e ymetit të tij musliman, e edhe më tej: në gjirin e gjinisë njerëzore, pavarësisht në cilën kohë dhe në cilin vend do të jetonte ai individ.

Bashkimi i parë dhe gurrthemeli ku mbështet shoqëria islame, është familja, së cilës Islami i kushtoi kujdesin dhe vëmendjen më të madhe. Familja, në këtë mësim, është përfshirë në sistemin shoqëror dhe nëpërmjet saj, njeriu plotëson nevojat e veta njerëzore dhe shoqërore, e në të njëjtën kohë, Islami i obligon të gjithë muslimanët me këtë sistem, pa i lejuar asnjë anëtar të bashkësisë muslimane të bëjë as edhe një hap jashtë parimit të atij sistemi.

E institucioni më i rëndësishëm (*nizam*) i familjes është martesja (*zevvaxh*) për ç'arsye edhe Islami e ka furnizuar këtë institucion me të gjithë faktorët e suksesit dhe vazhdimësisë, kënaqësisë dhe aftësimin të bashkëshortëve që t'i kryejnë obligimet e tyre shoqërore. Në radhë të parë, Islami vendosi kufizime për djaloshin dhe vajzën në zgjidhjen e bashkëshortit të vet dhe para tyre caktoi standarde të njëjta: secili duhet të gjejë tek pala tjetër atë që dëshiron, ndërsa që të dy duhet të synojnë që me martesën e tyre të bëjnë vepra të mira dhe t'i afrohen Zotit (xh. sh.).

Në themel të asaj zgjedhjeje qëndron besimi (feja) i bashkëshortëve - si bazë e familjes së lumtur, e cila mund të luajë atë rolin në shoqërinë muslimane që prej saj e kërkon i Lartësuar, lidhur me të

cilin Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: `Gruaja martohet në bazë të besimit të saj, pasurisë së saj dhe bukurisë së saj; merre atë që ka besim, se do t'i kesh të gjitha!` (transmeton Termidhiu me sened të Xhabirit, e ai nga i Dërguari); pastaj: `Nëse ju vjen dikush, me besimin dhe edukimin e të cilit jeni të kënaqur, martohuni me të, e nëse nuk e bëni këtë, në tokë do të krijohet përçarje(fitne) dhe rrëmujë (fesad)` (Tirmidhiu, me sened të Ebi Hatima el-Mudhnia, r.a.).

Kur'ani-kerim në lidhje me familjen ka vendosur dispozita universale, me qëllim që ajo të jetë e fortë dhe në të jeta të kalohet me kënaqësi; në këtë qëllim Kur'ani flet mbi të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve, pastaj sjell norma të rregulluara për mënyrën e shkurrezimit dhe të lëshimit të gruas, pastaj sjell arsye dhe dispozita për martesën me shumë gra (*te'addudu'z-zevxhat*) - të gjitha këto me qëllim që të bëjë të mundur kënaqësinë në jetën familjare, në mënyrë që ta mbrojë familjen dhe që të evitohen goditjet dhe shqetësimet në të, që në të fëmijët të zhvillohen pa vështirësi e trauma.

Duhet ditur se Islami e çliroi familjen nga shtypjet e xhahilijetit, nga përbuzja dhe poshtërimi i saj në të dhe në sisteme të tilla në çfarëdo forme që do të paraqitej xhahilijeti; që Islami familjes i dha pozitë të nderuar dhe që nëpërmjet familjes ai dëshiron të realizojë një jetë të lumtur dhe të këndshme edhe në këtë botë edhe në tjetrën, dhe e bëri gjynah çdo dalje nga rrethi i caktuar dhe meritë për dënim në të dy botët.

Në edukimin e personalitetit shoqëror, Islami nuk u ndal në kufirin që mbaron me familjen, por e kaloi atë kufi duke përfshirë në mënyrën më të gjerë, edhe bashkësinë ku jeton njeriu, bashkësi që duhet të jetë e lidhur me lidhje të veçanta të brendshme; Islami në këtë fushë mbështetet në pastërtinë e bashkësisë (*xhema'ah*) dhe pengimin e çdo forme të sëmundjeve dhe goditjeve shoqërore në pastërtinë e përmendur. Morali, që mbron Islami, sjellja ndërmjet njerëzve, veprat e tyre, traditat, ndalesat dhe urdhëresat ... të gjitha këto funksionojnë për të vendosur lidhjet më të mira mbi të cilat është e mundur të realizohet mëshira, ndihma, obligimet dhe bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet pjesëtarëve të bashkësisë.

Islami i edukon pjesëtarët e tij në frymën e vlerave të sipërpërmendura, me të cilat konkretizohet bindja (*ita'ah*) ndaj Zotit, dhe nga ana

tjetër, shpalli të qortuar çdo gjë që rrënon ato vlera, që shpien në përçarjen e bashkësisë, në mosunitetin e saj, mbylljen, frymën e urrejtjes dhe izolimin etj., gjë që vetvetiu është e mjerë dhe e përbuzur. Në suren *El-Huxhurat*, Kur'ani sulmoi me iritimin më të madh konfliktet brenda bashkësisë, kërkoi pajtimin e palëve të grindura, kërkoi përkrahjen e palës së drejtë, e pastaj sulmoi ashpër ata që spiunojnë të tjerët, ata që bartin fjalët e huaja, shpifin dhe përgojojnë, etiketojnë të tjerët me emra të këqij etj.; veprat e këtilla janë shkaqe të përçarjes dhe urrejtjes në shoqëri.

Sistemi shoqëror islam

Në një sure të Kur'anit, në suren *En-Nisa'*, është dhënë sistemi shoqëror, të cilin e kërkon Islami prej njerëzve; ky është një sistem që nuk e jep asnjë sistem tjetër juridik; sistem që është më universal se çdo sistem tjetër.

Ajo është surja e katërt në radhitjen e Kur'anit; e shpallur në Medine pasi qenë vendosur muslimanët në këtë qytet, e pastaj e ngritën bashkësinë e tyre, e cila dallohej nga bashkësia e shirkut, kufrit dhe xhahilijetit, e edhe nga bashkësia e hebrenjve dhe të krishterëve.

Nëse do ta ndjekim radhitjen e ajeteve lidhur me sistemin shoqëror që vendos, Kur'ani në këtë sure sjell si më poshtë:

- vërteton se të gjithë njerëzit, gjininë njerëzore si të tillë, e krijojnë një nëjëti Krijues "*min nefsini wahidetin* - prej një shpirti" dhe që marrëdhëniet midis njerëzve janë të bazuara në institucionin e familjes, nëpërmjet së cilës i lidh ndjenja e mëshirës;

- urdhëron kujdes të veçantë për jetimët dhe ua tërheq vërejtjen atyre që do ta shpërdoronin pasurinë e tyre, pastaj obligon që pasurinë e tyre ta mbrojnë anëtarët më seriozë dhe më të drejtë të shoqërisë muslimane;

- vendos të drejta për bashkëshortët në jetën e familjes së drejtë, e cila jeton në gjirin e mëshirës;

- kërkon nga bashkësia që pasurinë private të muslimanit ta konsiderojë si edhe pasurinë e bashkësisë dhe ua ndalon personave me të meta të kufizuar mendore të administrojnë pasurinë duke caktuar kujdestarë për pasurinë e tyre;

- vëndos standarde të drejta dhe obligime të rrepta për trashëgimi, në mënyrë që të mos jetë e mohuar as e cenuar e drejta dhe pjesa e asgjë në trashëgim; mendohet në trashëgiminë, që u takon pasardhësve meshkuj e femra, fëmijëve, pleqve...në lidhjen horizontale dhe vertikale farefisnore;

- mbron bashkësinë nga të këqijat e prostitucionit e homoseksualizmit dhe lavdëron vendosjen e lidhjeve martesore;

- forcon respektin ndaj gruas, e cila ruan pasurinë dhe nderin e familjes së vet;

- evidenton pengesat martesore (në aspektin e `breznive`, kush me kë s'mund të lidhë martesë e të ngjashme);

- konfirmon obligimet e njerëzve ndaj pasurisë së tyre;

- lavdëron bamirësinë ndaj prindërve;

- kritikon koprracinë dhe lavdëron dhënien e pasurisë në rrugën e Zotit (xh. sh.); ndalon alkoolin;

- urdhëron pastrimin fetar;

- urdhëron përbushjen e amanetit që i jep njeriu anëtarit tjetër të bashkësisë së vet;

- urdhëron gjykim të drejtë dhe drejtësi në çdo veprim;

- urdhëron bindje ndaj All-llahut (xh. sh.) dhe ndaj Pejgamberit (s.a.v.s.);

- analizon raportet e muslimanëve me hipokritët;

- ndalon gjakderdhjen dhe cakton pasoja juridike për vrasjen pa paramendim;

- i mëson muslimanët që t'i shmangen jetës në rrethana që janë poshtëruese për ta; urdhëron shpërnguljen kur të krijohen kushtet për të;

- flet mbi organizimin e luftës dhe faljen e namazit në luftë;

- thekson se ky sistem shoqëror është vetëm pjesë e sistemit apo *nizam-it*, të cilin e ka vendosur i Lartësuar i Gjithësi;

- shpjegon që marrëdhënie miqësore (*welaje*) mund të vendosen vetëm ndërmjet besimtarëve, e jo me të tjerët - për arsye se ata nuk mbështeten mbi bazën e përbashkët të tevhidit me besimtarët;

- i ndalon muslimanët t'i ndjekin ata që nuk besojnë dhe që dëshirojnë t'i largojnë nga Islami;

- thekson që pastërtia e bashkësisë muslimane arrihet me të evituarit e çdo *fahishe*-je, veprë të keqe: gënjeshtres, shpifjes, përgojimit;

- qorton debatet e panevojshme brenda bashkësisë muslimane;
- dënon veprimatrinë me kamatë që prish marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, shkakton smirë e urrejtje, poshtëron disa - të varfrit dhe të dobët, ndërsa të tjerët - të pasurit, i bën fodullë;
- thekson lidhjen e njëjtë të të gjithë të dërguarve - në mënyrë që besimtarët, muslimanët dhe pjesëtarët e Librit, hebrenjtë dhe të krishterët, të mund të bashkohen rreth Fjalës së përbashkët dhe në këtë bazë t'i ndërtojnë marrëdhënien ndërmjet bashkësive dhe individëve të tyre;
- sjell dispozita mbi *kelalen*, d.m.th. në rastin kur pas vdekjes së burrit apo gruas nuk mbeten as prindër as fëmijë dhe kur vllëzërve dhe/ apo motrave të tij/ të saj i takon një pjesë e trashëgimisë së tij/ të saj, gjë që Kur'ani e thekson me saktësi, etj.

Edukimi i personalitetit politik (et-terbijutu's-sijasijje)

Fakti kryesor që duhet të rrënjosin edukatorët në vetëdijen e atyre që edukojnë, është që Islami është mësim i plotë, i përkryer (El-Ma'ide, 3), prandaj çdo diskutim nëse Islami ka lidhje me aktivitetet politike apo jo, bie. Islami përfshin në mënyrë shumë të theksuar edhe këtë aktivitet njerëzor, ai është shprehimisht fe politike, d.m.th. ai ka dimensionin e vet të theksuar politik, ndërsa Muhammedi (s.a.v.s.), si shembull i besimtarëve, formoi edhe shoqërinë muslimane dhe bashkësinë politike muslimane në Medinë, e cila në Kur'an është karakterizuar si `bashkësia më e mirë që është paraqitur në Tokë.`

Islami, pra, ka sistemin e tij origjinal të plotë të jetës.

Në sferën politike, kjo fe refuzon veprimin jashtë rregullave dhe dispozitave të Kur'anit dhe synetit, refuzon sundimin e njerëzve dhe drejtimin e punëve e resurseve publike sipas hamendjes arbitrare dhe pasioneve, dhe në këtë kuptim i Lartësuarit këshillon:

"Pastaj, Ne të caktuam një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos paso dëshirat e atyre që nuk dinë,/ sepse ata nuk mund të të mbrojnë nga dënimi i All-llahut; zullumqarët janë miq të njeri-tjetrit, kurse All-llahu është mbrojtës i besimtarëve të devotshëm." (El-Xhathije, 18 - 19);

pastaj:

"Dhe gjyko në bazë të asaj që ta zbriti All-llahu, e mos ndiq tekat e tyre dhe ruaju prej atyre që të të mos shmangin nga një pjesë e asaj që të shpalli All-llahu..." (El-Ma'ide, 49)

Buhariu me senedin e vet transmeton që El-Hasen ka thënë: `All-llahu (xh. sh.) ua ndalon sundimtarëve: t'i ndjekin pasionet e tyre, t'ua kenë frikën njerëzit dhe që ajetet e Tij t'i shesin për gjëra që vlejnë pak`, e pastaj lexoi:

"O Davud, Ne të kemi bërë sundimtar në tokë, prandaj gjyko me drejtësi mes njerëzve dhe mos shko pas dëshirave, se ato të largojnë nga rruga e All-llahut. Ata që largohen prej rrugës së All-llahut i pret dënim i rëndë për shkak se harruan ditën e përgjegjësisë". (Sad, 26)

Ndërsa ata që si sundues marrin diçka që nuk u takon, të cilët përfitojnë nga rasti që të fitojnë diçka jashtë dispozitave të Sheriatit, Islami i akuzon, i kërcënon dhe i përgëzon me këto fjalë kur'anore:

"...sepse Zoti yt është, vërtet, në pritë". (El-Fexhr, 14) ;

" E kush respekton shenjtëritë e All-llahut, do t'i përjetojë të mirat e Zotit të vet." (El-Haxh, 30)

Sistemi politik islam, në të vërtetë, është i drejtë, ndërsa ligji i tij është i përkryer; edhe njëri edhe tjetri qëndrojnë mbi ato themele, të cilat nuk ndërrojnë sipas kohës dhe vendit, e në përgjithësi mund të thuhet që ky sistem mbështetet në themelet vijuese: në drejtësi (*el-adl*), në bamirësi (*el-ihsan*) dhe në marrëveshje reciproke (*esh-shura*).

Këto tri themele obligojnë edhe qeveritarin edhe shtetasin e tij, këto tri themele i realizuan të dërguarit e Zotit dhe për to janë dërguar, sikurse thotë i Lartësuari:

"Ne i dërguam të dërguarit tanë me argumente të qarta dhe përmes tyre zbritëm Librin dhe Terezinë që të veprojnë njerëzit me drejtësi (lijekume'n-nase bi'l-kist)" (El-Hadid, 25)"

Kështu, Islami për shtetin caktoi program dhe sistem, të cilët gërshetohen dhe bashkëveprojnë në mes vete dhe në bazë të kësaj realizohet bashkëpunimi mes shteteve, sikurse edhe për ata që nuk janë muslimanë, por janë shtetas të shtetit me rendin islam, i ka përku-fizuar të drejtat dhe obligimet e tyre.

Në një shtet të tillë çdo musliman e muslimane i di të drejtat dhe obligimet e veta sikurse i di edhe qeveria, të cilën e zgjedhin qytetarët me votën e lirë dhe e cila është e obliguar t'i zbatojë detyrimet e veta.

Në rendin e tillë çdo individ e di pozitën e vet, sikurse e di edhe qeveritari dhe të gjithë ata që marrin pjesë në qeveri.

Në dallim, të themi nga *akide-ja*, *ibadeti* dhe *ahlaku*, që nuk ndërronjë me ndryshimin e kohës e të vendit, jeta politike ndërron me ndryshimin e rrethanave, prandaj rendi, që vendos Islami, duhet patjetër t'i nënshtrohet reflektimit të lirë të dijetarëve dhe ekspertëve muslimanë, të a.q. muxhtehidë.

E meqë ekonomia është ndër profesionet më të rëndësishme në politikë, Islami i mëson pjesëtarët e vet me dispozitat vijuese:

- ndalimin e fajdesë (*ihlikar*);
- ndalimin e magazinimit të mallit në kohën e skamjes me qëllim të shantazhimit të konsumatorëve dhe të ngritjes së çmimit të lartë në mënyrë enorme;
- ndalimin e përtacërisë për cilindo që është në gjendje të punojë;
- urdhërimin që kapitali të qarkullojë ndër të gjithë anëtarët e shoqërisë, e jo vetëm ndër të pasurit;
- urdhërimin që kategoritë vijuese të popullit:

të varfrit, invalidët dhe të pastrehët, të ngarkuarit me borxhe, udhëtarët që kanë mbetur pa mjete, të burgosurit, mbledhësit shtetëror të zekatit si dhe çdo aksion në `rrugën e Zotit`, kanë pjesën e tyre vjetore në pasurinë e të pasurve, të paktën 2,5 % nga pasuria e tyre - dhe kjo në nivel të mbarë Ymetit, e kjo pjesë mund të rritet në rast nevojë të domosdoshme, kur autorizohet i pari i muslimanëve apo bamirësi më i mirë në mesin e tyre, ta shpërndajë në mënyrën më të mirë.

Qeveria e zgjedhur në mënyrë të lirë është e obliguar t'u përmbahet dispozitave juridike të Kur'anit dhe të syneit të Pejgamberit të All-llahut (s.a.v.s.), të punojë vazhdimisht për të mirën e përgjithshme të muslimanëve dhe të evitojë çdo formë të fesadit (rrëmujës) në shoqërinë e tyre.

Të gjithë janë të obliguar t'u përmbahen këtyre parimeve, si qeveria ashtu edhe individët.

Në këtë frymë, edukatorët do t'i edukojnë gjeneratat e reja dhe do t'ua mbjellin atyre të kuptuarit e këtyllë të politikës - me qëllim që të

jenë pjesëmarrës në ndërtimin e jetës, që do të ishte në harmoni me pozitën që i dhuroi qenies njerëzore i Lartësuari.

Si edukon Islami personalitetin politik

Muslimani duhet ta dijë se ai nuk është sikur njerëzit e tjerë dhe se nuk mund të jetojë i vetëm - pa familje, xhemat, shtet. Ai duhet të jetë gjithmonë i vetëdijshëm se i takon një bashkësie të madhe muslimane, Ymetit të Muhammedit (s.a.v.s.) - që është shumë i madh si dhe njerëzit të cilët jetojnë në një hapësirë shumë të madhe të planetit të Tokës.

Ai duhet të jetë gjithashtu i vetëdijshëm që edukimi i tij politik islam dallon prej çdo edukimi tjetër.

Ja cilat janë tri pikat e rëndësishme nga kuptohet esenca e edukimit politik islam:

- formimi i vetëdijes politike te muslimanët;
- aktivitetet më të rëndësishme që kërkohen nga muslimani në sferën politike;
- të drejtat dhe obligimet e sundimtarit dhe shtetasve - në përpjekjet që të arrihet vullneti i All-llahut dhe të meritohet ndihma e Tij.

Formimi i vetëdijës politike tek muslimanët

Kjo vetëdije nuk mund të formohet përderisa muslimanët të mos fillojnë të bëjnë pastrimin e vetëdijes së tyre nga mashtrimet dhe lajthitjet politike të kohës së tyre.

Aso mashtrimesh përmbajnë parullat e të kuptuarit perëndimor të demokracisë: të vëllazërimit, lirisë dhe barazisë; muslimanët duhet ta dinë se këto janë fjalë boshe që Ymetit musliman nuk i sollën asnjë nga vlerat e përmendura, dhe që po ato vende që i proklamuan ato parulla zhvilluan luftëra koloniale kundër popujve muslimanë, i eksploatuan e vazhdojnë edhe sot t'i eksploatojnë, dhe nuk lejuan standarde të njëjta për popujt muslimanë, si ato që i realizuan për qytetarët e tyre.

Të vërtetat politike dhe mashtrimet politike më të mëdha në rrethanat tona, në këto dhjetë dekada, janë, sipas mendimit tonë, si vijon: multietniciteti, sipas të cilit në Bosnjë do të ketë gjithnjë e më pak muslimanë, ndërsa ata që mbijetojnë do ta humbasin gjithnjë e më

shumë identitetin islam - nëse All-llahu (xh. sh.) nuk do të ngrejë në Bosnjë një gjeneratë të re me një mendim dhe veprim të ri politik, d.m.th. islam, dhe që nuk gjykon tjetërfare. i ashtuquajtur i 'plagjiat i historisë', sipas të cilit gjeneratat e këtij shteti nuk e dinë se Bosnja multietnike lindi falë ardhjes së Islamit aty dhe qëndrimit të tij tolerant ndaj *ehl-i kitabijve*, të krishterëve dhe hebrenjve, të cilët në besim janë më të afërt me muslimanët. Të kuptuarit komunist të multietnicitetit është i mundur vetëm në dëm të muslimanëve. Agresioni dhe gjenocidi ndaj popullit tonë ka qenë i mundur vetëm për shkak se jemi muslimanë. Edhe më tej bëhen plane kundër muslimanëve – me gjithë parullat e mëdha mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe Evropën e bashkuar. Politika e simetrisë nacionale shkon në atë drejtim që muslimanëve t'u imponojë fajin e paqenë të fundamentalizmit dhe korrupsionit - në mënyrë që revolucion i tyre popullor çlirimtar i fundit, i frymëzuar nga Islami dhe tradita boshnjake, ta humbë kapitalin e tij moral dhe me qëllim që të relativizohen apo të justifikohen krimet e fqinjëve tanë. Autoritetet morale të këtij populli bastardohen nga gazetaria mercenare, të padenjët avancohen, ndërsa të denjët dëbohen nga jeta politike e shoqërore - me qëllim që të dekurajohen muslimanët për t'u organizuar politikisht mbi baza nacionale e fetare, në mënyrë që ta kryejnë vetë punën e armiqve të tyre të fshehtë. Krimet ndaj muslimanëve relativizohen ose shlyhen nga kujtesa e gjeneratave të reja. Zbatimi i Islamit autentik në mediat sekulariste detektohet si rrezik për marrëdhëniet ndërnacionale e ndërfetare, ndërsa sipas kriterit të drejtuesve të rinj të Bosnjës, vetëm Islami si "çështje private" apo si intimitet i individit, vetë Islami i këtillë ka lejkalim shoqëror, etj.

Ideja kryesore politike, të cilën duhet ta kenë të edukuarit në vetëdijen e tyre, është që vetëm Islami qytetarit dhe popujve u sjell lirinë e vërtetë; që Islami është revolucion permanent, ndërsa *La ilahe il'la-llah* thirrja më revoluconare kundër çdo forme të robërisë dhe tiranisë në historinë njerëzore dhe që Islami mbron liritë dhe të drejtat e mëposhtme:

- të drejtën e lirisë së mendimit; të drejtën e lirisë së besimit; të drejtën e lirisë së punës; të drejtën e lirisë së shprehjes; të drejtën e

lirisë së pronës private dhe të administrimit të asaj prone; të drejtën për të fituar; të drejtën e lirisë së lëvizjes.

Obligimet e muslimanit në sferën politike janë:

- obligimet ndaj bashkësisë ku jeton, dhe puna për të mirën e saj, si dhe evitimi i çdo dëmi që do të mund t'i ndodhte asaj;

- obligimet ndaj gjithë Ymetit islam dhe puna në forcimin dhe rritjen e tij në të gjitha sferat;

- obligimet ndaj dini-islamit dhe puna në forcimin e këtij dini në jetën e njerëzve si dhe veprimi sipas parimeve të Sheriatit...

Lidhur me këtë, këto obligime çdo musliman do t'i kryejë aq sa ka mundësi, meqë i Lartësuar nuk e ngarkon askënd jashtë mundësive të tij, në pajtim me ajetin:

"Ai nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi". (El-Haxh, 78);

"All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësive të tij". (El-Bekare, 286)

Obligim i veçantë i muslimanit është që me njerëzit, si me ata që i ka të afërm, ashtu edhe me ata që nuk janë në faqet e tij, ose nuk janë pjesëtarë të bashkësisë së tij, të sillet në pajtim me dispozitat e *ihسانit* bamirësisë, sikur thotë i Lartësuar:

"...dhe bëni mirë, se me të vërtetë All-llahu i do bamirësit" (El-Bekar, 195);

"Dhe All-llahu, për atë që ka thënë, do t'i shpërblejë me xhenete, nën të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Ky është shpërblim për njerëzit bamirës." (El-Ma'ide, 85)

Obligimet të tjera:

- Të vepruarit me drejtësi dhe të udhëhequr nga e vërteta në çdo punë, sikurse thotë i Lartësuar:

"All-llahu ju urdhëron që punët me përgjegjësi (amanetet) t'ua jepni kompetentëve dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me drejtësi në mes njerëzve. Me të vërtetë, sa e shkëlqyeshme është këshilla e All-llahut. All-llahu dëgjon dhe sheh çdo gjë." (En-Nisa', 58).

Të vepruarit me drejtësi është obligim i individit, qeverisë dhe gjithë Ymetit, si ndaj të afërmeve edhe ndaj më të largëve, miqve edhe armiqve, besimtarëve dhe jobesimtarëve - për shkak se të vepruarit me

padrejtësi shkakton urrejtje dhe rrëmujë, gjakderdhje dhe luftëra, dhe për arsye se drejtësia është më afër devotshmërisë.

Të drejtat e sunduesit musliman janë:

- të sundojë; të kërkojë dëgjueshmëri për çdo gjë nga shtetasit e tij, përveç për të mëkatuar ndaj All-llahut (xh.sh.); të ofrojë ndihmë morale dhe materiale;

Ndërsa obligimet e tij janë:

- të gjykojë në bazë të asaj që e ka shpallur All-llahu (xh. sh.); të zbatojë drejtësinë; të bëjë konvokimin e shurës (këshillit) dhe të veprtojë sipas vendimmarrjes; t'i përmbahet *ihsanit* (bamirësisë); të punojë për të mirën e përgjithshme dhe të evitojë çdo formë të rrëmujës (*fesad-it*); të mbrojë sigurinë e shtetit dhe të njerëzve; të jetë në gati-shmëri me forcat ushtarake dhe me forca të tjera në rast të ndonjë sulmi armiqësor; të urdhërojë për të mirën e të luftojë kundër së keqes; dhe ta përhapë Islamin ndër njerëzit.

Nevoja për pedagogjinë kuranore në kohën tonë

Imamët dhe mësuesit fetarë janë *vverethetu'l-enbija'*, `trashëgimtarë të pejgamberëve të Zotit`, edukatorë të gjeneratave tona të reja bashkë me prindërit. Të gjithë të dërguarit, duke edukuar bashkësitë e tyre, përveç shpalljes së tewhidit, njëkohësisht duhej të njihnin shirkun e kohës së tyre dhe të bënin luftë kundër tij në mënyrë që Fjala All-llahut (xh.sh.) të ishte më e larta. (Et-Tevvbe, 40)

Cili është shirku i kohës sonë dhe si mund t'i shpëtojnë prej tij brezat boshnjakë - është çështje në vazhdim.

Sipas leksikografëve të Kur'anit (psh. Ragib Isfahani), shirk është “çdo gjë që të shmang nga Rruga e All-llahut”.

Në këtë kuptim, shirku i kohës sonë do të mund të përmbliidhej në katër nocione: (neo)komunizmi/ titoizmi, modernizmi, shekullarizmi dhe ateizmi vulgar.

Komunizmi si botëkuptim agresiv, ateist dhe titoizmi si konkretizim i tij në formë instrumenti të fshehur politik të shtypjes dhe i ateizmit të deridjeshëm të boshnjakëve dhe i manipulimit gati të pathyeshëm me vetëdijet e tyre, pasi u flak nga të gjithë popujt që jetuan në ish-Jugosollavinë, u imponohet gjeneratave të reja boshnjake me përpunime të reja, para së gjithash politike dhe në interpretimin e

shtrembëruar të historisë bashkëkohore. Me fjalë të tjera, për krimet e titoizmit mbi boshnjakët dhe gulçimin e vetëdijes së tyre fetare, e në mënyrë më drastike të asaj islame dhe nacionale dhe çrrënjësjes e kulturës e civilizimit islam, gjeneratat e reja gati nuk dinë asgjë. Josip Brozi edhe sot u servohet gjeneratave boshnjake si model identifikimi - në vend të Muhammedit (s.a.v.s.).

Modernizmi dhe shekullarizmi janë dy nocione semantikisht të ndëthurura. Edhe njëri edhe tjetri, historikisht lidhen me Krishterimin dhe Kishën e tij, e derivatet e tij stërpikën edhe boshnjakët me përmbajtjet e tyre primitive.

Modernizmi ka qenë emër për të tashmen e krishterë në shekullin e 5-të, pas rënies së Perandorisë Romake, në krahasim me të kaluarën romake pagane. Nga pikëpamja filozofike i dha kuptim I. Kanti me idenë e tij të subjektivizmit, sipas së cilës për çdo gjë që nuk është në mundësinë e të kuptuarit njerëzor, nuk mund të japësh gjykim. Kanti nuk e mohoi besimin(fenë), por kërkoi pajtueshmërinë e tij me arsyen (mendjen) moderne.

Me kohë modernizmi u bë, sipas Renanit, i pakufizuar; çdo gjë tek ai u bë e lejuar; shoqëria moderne u lirua nga të gjitha prangat e shoqërive dhe religjioneve të vjetra. Mendja, më herët, që me fillimin e renesansës, u bë arbitër suprem: e vërtetë është vetëm një gjë, ajo që e shpall Cogito, të vërtetë; ajo është e vërteta pozitiviste, ndërsa flaken çështjet metafizike.

Njësoj sikur në shekullarizëm, edhe në modernizëm fesë nuk i lejohet të përzihet në rregullimin e çështjeve shoqërore dhe politike.

Sipas Harvveyu Coxu, modernizmi perëndimor mbështetet në pesë shtylla, që janë: shteti bashkëkohor nacional; teknologjia shkencore e prodhimit; racionalizmi burokratik si parim i organizimit shoqëror; maksimalizimi i profitit dhe shekullarizimi i shoqërisë.

Shekullarizmi (lat. *Saeculum* - këtu dhe tani) si drejtim i të menduarit, fillimisht u përpoq të kuptimësojë `etikën universale jashtë teizmit dhe ateizmit`, por me kohë u shndërrua në lëvizje kryesisht antireligjioze, në çdo rast, në lëvizjen që ndalon kategorikisht hyrjen e religjionit në sferën e çështjeve dhe raporteve shoqërore e politike. Si botëkuptim, shekullarizmi refuzon çdo çështje mbi transhendentalen, propagandon agnosticizmin ose përfundon tek ai, pastaj deizmin si

pikëpamje religjioze, në bazë të cilës Zoti apo ndonjë Fuqi Supreme e ka krijuar botën, por Ai nuk mban parasysh jetën individuale a shoqërore, nuk ekziston jeta përtej varrit as përgjegjësi për veprat e bëra.

Në rrethanat tona, modernizmi imponohet në formë miti mbi shkencën, që e vetmja i bën të lumtur njerëzit dhe mund të zgjidhë çdo krizë, kurse shekullarizmi dhe ateizmi vulgar janë vërsulur mbi ne nga të gjithë ekranet, radio-programet dhe gati nga të gjitha mediat e shkruara. Propagandimi i jetës së këndshme, fitimit të lehtë, botës së qejfeve e të argëtiveve, udhëtimeve turistike, plazheve, trupave lakuriqë, lojërave, ushqimit të `shëndetshëm`, jetës së lirë jashtëmartesore, konsumimit...; `më lejo të jetoj, të tjerët le të vdesin`, obsesioni pas trupit, grumbullim i profiteve, indiferentizmi ndaj çdo çështjeje mbi Zotin, Ahiretin, hisab-in (dhënien e llogarisë Ditën e Gjykimit), Xhehennetin dhe Xhehennemin... - këta janë brithët e këtyre `religjioneve tokësore` që nga ora në orë, ditë e natë, pushtojnë vetëdijen e brezave të rinj boshnjakë dhe bëhen obsesioni tyre.

Kur e përdor Kur'ani termin *alihe*, hyjni, me këtë ai nënkupton çdo gjë që duhet, çdo gjë që bëhet obsesion i individit dhe shoqërisë. Disa hyjni bashkëkohore sapo u përmendën; kibra e tyre është - nëse këtë nocion e kuptojmë si sistem vlerash - diku në Perëndim, gjithësesi jo në Mekë.

Pedagogjia kuranore ka për qëllim që boshnjakët t'i `nxjerrë nga errësira në dritë`, nga idhujtaria e përshkruar në sferën e tevhidit, që para brezave boshnjakë të vendosë Kiblen e vërtetë.

Në këtë rrugë, *conditio sine qua non* është edukimi i ruhut; këtë nuk e bën asnjë pedagogji shekullariste.

Neve ky aspekt i edukimit na duket tepër i rëndësishëm edhe sepse imamët dhe mësuesit fetarë duhet t'ua prezantojnë brezave tanë pikëpamjen islame mbi njeriun, një nga çështjet kruciale të çdo filozofie dhe botëkuptimi.

Brezave tanë u ofrohen pikëpamjet vijuese mbi njeriun: pikëpamja komuniste *homo faber* - qenie e punës, ose Prometeu, figura mitike, revolucionari tokësor që kundërshtoi zotat në Olimp; shekullariste *homo ludens* - qenie e lojës, ngesë dhe argëtimit, e të tjera.

Në Islam, njeriu është *halfetullahi fi'l-erd*, përfaqësuesi ose mëkëmbësi i All-llahut në Tokë, qenie, e cila, po, është krijuar nga balta -

që asnjëherë të mos jetë mendjemadh dhe kokëfortë (inatçor) para Krijuesit, por edhe qenie, në të cilën banon ruhu, pjesa hyjnore - me qëllim që ta dijë se është qenia më e nderuar dhe më e respektuar në Gjithësi, në mënyrë që, për shkak të kësaj, të jetë krenare dhe në mënyrë që të zhdukë çdo formë të shtypjes dhe tiranisë, çdo formë idhujtarie si burim i jolirisë dhe robërisë së njeriut.

Në këtë rrugë, islami refuzon ato pikëpamjet (ashtu të pranishme), pak a shumë ekzistencialiste mbi botën e absurdit dhe pakuptimshmërinë e të jetuarit në këtë botë. Njeriu është `argjil me aromë`, kjo botë është më e bukura botë e krijuar, dhe kjo jetë ka kuptim dhe shpresëthotë Kur'ani.

Për breznitë boshnjakë është me rëndësi jetike që ta pastrojnë trupin e tyre nga harami - në mënyrë që të mund t'i përvetësojnë porositë e All-llahut (xh. sh.) dhe që të mbrojnë shëndetin e bashkësisë sonë nacionale. (Për shembull, hebrenjtë, një popull gjithashtu numerikisht i vogël, që ka përjetuar gjenocide mbi vete dhe pedagogët e të cilit shpëtojnë çdo anëtar të vetin, në kibucet izraelite, kur therin kafshën që e kanë të lejuar sipas ligjit të tyre fetare, mëlqinë e saj e marrin dhe i futin në ujë - që ta kuptojnë nëse ka qenë e shëndoshë kafsha e therur apo jo, dhe atë mish nga kafshët e sëmura e transportojnë, kurse brezat e tyre i ushqejnë me mish të shëndoshë). Pedagogët boshnjakë duhet të jenë të vetëdijshëm ç'do të thotë t'i shpëtosh brezat nga e keqja e alkoolit, e të të droguarit, pirjes së duhanit, mishit të dërrit dhe mishrave të tjera të ndaluara, nga devijime seksuale, prostitucioni (zinaja) etj. `Nganjëherë, shkruante M.Gazali, ndodh që të mëkatuarit bëhet traditë shoqërore, që më pastaj të legalizohet e të bëhet e zakonshme, dhe ata që nuk mëkatojnë bëhen objekt talljeje e përqeshjeje, ndërsa ata që i bëjnë ato mëkate, avancohen dhe popullarizohen; i këtuillë ishte qytetërimi në kohën e Lutit (a.s.) - mëkatarët e të cilit i dëbuan besimtarët nga qyteti; i tillë është edhe qytetërimi modern i Perëndimit, i cili në dukje i magjeps njerëzit, por në themelet e veta është i kalbur, me të gjitha të ligat`.

Detyra vijuese shumë e madhe e imamëve dhe mësuesve tanë fetarë është që ta shpëtojnë familjen boshnjake; ajo, me valën e madhe të idhujtarisë së përmendur, gjithashtu është në krizë dhe ka filluar të përmytet. Koncepti islam i familjes është plotësisht i ndryshëm nga

ai që po imponon Perëndimi i shekullarizuar. Familja jonë u rrënua nga gjenocidi, shumë fëmijë mbetën pakujdesje, shumë martesë dësh-tojnë, shumë muslimanë e muslimane martohen gabimisht, dhe shumica nuk i edukojnë fëmijët e tyre në islam!

Dhe së fundi dhe me rëndësi më të madhe: edukimi i ri duhet të ketë patjetër dimensionin politik - në mënyrë që boshnjakët, për shkak të manipulimeve dhe inkoshiençës politike, të mos jenë viktimë e një gjenocidi të ri, as mish për top për luftërat e huaja, e as debilë që punojnë në dobi të dëmit të vet dhe për llogari të armiqve të tyre të hapët e të fshehtë. Që të mos jenë të tillë, mendja e tyre duhet të bëjë sexhde para Krijuesit - në mënyrë që rezultatet e sakrificave tona intelektuale të mos hedhin Ymetin tanë në kurthat shejtanore, në shkatërrimin në këtë botë dhe në botën e ardhshme.

Literatura mbi pedagogjinë islame

Në gjuhën arabe:

- Ebu Hamid Muhammed el-Gazali, *Ihja' 'ulumi'd-din*, Kajro, 1969.
- Ebu Abdil'lah Muhammed ibni 'Alijji'l-Hakim et-Termidhi, *El-Emthal mine'l-Kirab we's-sunne*, Kajro, pa vit botimi.
- Ahmed Emin, *Kitabu'l-Akhlak*, Bejrut, 1969.
- Ahmed Zeki Salih, *Ilmu'n-nefsi't-terbewijeti*, Kajro, pa vit botimi.
- Ahmed Shelebi, *Et-Terbijetu'l-islamijje*, bot. 5, Kajro, 1978.
- Ahmed Fuad, el-Ehwani, *Et-Terbijetu fi'l-islam*, Kajro, 1967.
- Ahmed Muhammed Xhemal, *Din we devle*, Bejrut, 1393/ 1973.
- Esma' Hasen Fehmi, *Mebadiw u ' t-terbijeti'l-islamijje*, Kajro, 1366/ 1947.
- Et-Tehami Nefre, *Sikuluxhijjetu'l -kisati fi' l-Kur'an*, Algjeri, 1971.
- Enwer el-Xhundi, *Et-Terbijetu we bina ' u l-exhjali fi daw'i' l-islami*, Bejrut, 1975.
- Bukri Shejh Emin, *Edebu'l-hadithi'n-nebewijje*, Bejrut, 1395/ 1975.
- Hasan Ejjub, *Es-Suluku 'l-ixhtima'ijju fi'l-islam*, Kajro, 1399/ 1979.
- Seid Ismail Ali, *Usulu 't-terbijeti 'l-islamijje*, Kajro, 1974.
- Sejijf Kutb, *el-'Adaletu 'l-ixhtima'ijjetu fi'l-islam*, Bejrut, 1975.; *Nahwe muxhteme 'i islamijjin*, Bejrut, 1975.
- 'Abaz Muhammed 'Akad, *El-Insan fi 'l-Kur'an*, Kajro, 1978.

- Abdu 'l-Ganijj Abud, *Fi 't-Terbijeti 'l-islamijje*, Kajro, 1977.; *El-Usretu'l-muslimetu ëe 'l-usretu 'l-mua'sire*, Kajro, 1979.
- Ali el-Kadi, *Menhexhu 't-terbijeti 'l-islamijje*, Kajro, 1977.
- Fuad Sulejman Kalade dhe të tjerë, *El-Ehdafu 't-terbewijeti we tahtitu we tedrisu 'l-menahixh*, Aleksandria, 1979.
- Muhammed Ilmu 'd-din, *Et-Terbijetu 'l-islamijje*, Kajro, 1977.
- Muhammed Kutb, *Menhexhu 't-terbijeti 'l-islamijje*, Bejrut, 1980.
- Muhammed Muhammed Ridwan, *El-Wesailu we'l-gajatu fi 't-terbijeti we 't-ta'lim*, Aleksandria, 1957.
- Munir el-Mersi Serhan, *El-Hibrtu 'l-xhemalijjetu fi 't-terbije*, Kajro, 1973.

Në gjuhën angleze:

- Dewey, John, *Democracy and Education*; The Macmillan Comp., U.S.A., 1968.
- Hassan, Ibrahim Hassan, *Islam, A Religious, Political, Social and Economic Study*, Baghdat, 1967.
- Hutchison, John A., *Paths of Faith*, Mc Graw - Hill, U.S.A., 1975.
- Whitehead, A.N., *Aims of Education, and Other Essays*, London, 1966.

* * *

Ky punim është bërë kryesisht mbi bazën e dy burimeve të mëposhtme:

- 'Ali Abdu 'l-Halim Mahmud, *Terbijetu 'n-neshi 'i'l-muslimi*, bot. 3, Kajro, 1994.; dhe
- 'Abdu'l-Xhevad es-Sejjid Bikr, *Felsefetu 't-terbijeti 'l-islamijjeti fi 'l-hadithi 'sh-sherif*, Bejrut, pa vit botimi. Lista e literaturës selektive është marr nga burimi i fundit, ku jepet një literaturë shumë e gjerë mbi fushën e përmendur.

Përktheu: Muhidin Ahmeti

Dr. Sulejman Mashoviq

Qasje bashkëkohore edukimit islam

Ndryshimet e thella në botën bashkëkohore, sidomos përparimi i shkencës dhe i teknikës me industrializimin e qytetërimin e hovshëm ushtrojnë ndikim thelbësor në të tëra komponentet e jetës njerëzore, përfshirë edhe sistemin edukativ-arsimor. Së këndejmi, vjen edhe reforma e thellë në sistemin shkollor në botë dhe përhapja e zgjerimi i arsimimit të vazhdueshëm gjatë tërë jetës, d.m.th. sa të jetë njeriu gjallë.

Agjencia e specializuar e KB për edukim, shkencë dhe kulturë UNESCO, ka botuar shumë vepra lidhur me ndryshimet e sistemit edukativ-arsimor bashkëkohor në të tëra fushat, duke u mbështetur në hulumtime dhe përvojë të madhe praktike. Në studimin voluminoz të UNESCO-s, “Shvatiti i djelovati”, Zagreb 1979, janë parashtruar shkaqet dhe pasojat themelore të ndryshimeve që ndikojnë edhe në transformimin e të tëra fushave ku arrihen dije e aftësi të ndryshme.

Edukimi fetar, si pjesë e edukimit dhe e arsimimit, i cili shtrihet në të tëra moshat e njeriut, natyrisht u nënshtrohet disa ndryshimeve, sidomos në zgjedhjen e përmbajtjes, metodës dhe teknikës, nëse dëshirohet të ketë sukses. Kuptohet se kjo kërkon analizë të vazhdueshme, të përcillet dhe të përsoset arsimi i mual-limit, prindërve si edhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Me rasiin e mbledhjes së Kuvendit suprem dhe atyre republikane të Bashkësisë Islame në vend, si edhe shumë këshillimeve në nivele të ndryshme, vitet e fundit përmendet një përparim i dukshëm në fushën e edukimit fetar. Të gjitha kryesitë e Bashkësive Islame, myftinitë kryeimamët dhe këshillat e BI përpiqen të krijojnë kushte sa më të përshtatshme (kadrovike, materiale, sanitare etj.) për këtë qëllim.

Fakulteti Islam në Sarajevë, medreseja “G. H. Beg” me paralelet e tyre për meshkuj e për femra në Sarajevë dhe medresenë “Alauddin” e Prishtinës (tani edhe në Novi-Pazar, Prizren dhe në Gjilan e në Shkup – vërejtja e përkthyesit) vazhdimisht përsosin sistemin e edukimit, gjë që shihet edhe nga rezultatet e kuadrove të tyre në praktikë. Kryesitë, në bashkëpunim me shoqatat e nëpunësve fetare përpiqen që me seminare dhe forma të tjera të mundësojnë përsosjen profesionale të mual-limëve. Literaturë islame e shumtë, që po botohet, u shërben atyre si plotësim i mirëseardhur me ilmi-hale për shkollën fillore.

Cilësisë së edukimit i jep kontribut edhe mbikëqyrja profesionale dhe analiza nga shërbimi special ose këshilltarët përkatës për këtë lëmë. Veprimtaria në formë inspeksioni apo instruktori i tyre, si myftiu, kryeimami, sidomos referentët arsimor-fetarë, ndikon në pasurimin e përmbajtjeve dhe përmirësimin e metodave të punës. Natyrisht, merita kryesore u takon mual-limëve, shumica prej tyre, si entuziastë me ndihmën e prindërve, i kushtohen kësaj detyre.

Mirëpo, me gjithë rezultatet e cekura, në të gjitha tubimet e deritashme në kuadër të Bashkësisë Islame, është theksuar se, megjithatë, nuk jemi në nivel, po ngecim, në krahasim me mundësitë që ka; numri i fëmijëve që vijojnë këto mësimet është i vogël; nga ata që janë regjistruar, gjysma nuk janë të rregullt në mësimet, - madje edhe cilësia, vëllimi i planprogrameve që i ka caktuar Kryesia, është larg rezultateve të pritura. Shkaqet janë të shumta dhe fort ngadalë eliminohen, pavarësisht nga qëndrimet dhe rekomandimet e të gjitha organeve të Bashkësisë Islame, që konsiderojnë se edukimi është detyrë themelore e nëpunësve fetarë të Bashkësisë Islame.

Ndër arsyt e ngecjes, që janë cekur më shpesh, është edhe ndërriimi i ngadalshëm i metodave të edukimit, përshtatja e pamjaftueshme e mual-limit dhe prindërve ndaj ndryshimeve bashkëkohore; procesi formal i të mësuarit, në vend të atij përmbajtësor e të tjera. Është e

natyrshme që kuadrot e vjetra insistojnë pak si tepër në format tradicionale, por nga të rinjë pritet që të përshtaten më shpejt me kohën dhe mundësitë e nxënësve.

Dobësia e dytë që përmendet gjithashtu shpesh, është kalimi me hapa të ngadalshëm në organizimin e edukimit të pandërprerë tek moshë më e rritur, edhe pse në të gjitha konkluzionet e kuvendëve të Bashkësisë Islame kërkohet punë sistematike me të rriturit, jo vetëm me anë të mevludeve a të ngjashme me të, por si një formë e përhershme. Disa xhemate të mëdha të qytetit, të cilat kanë kushte më të mirë, kuadrosh dhe materiale, nuk kanë dhënë mundin dhe mjetet që duhet për realizimin e këtyre detyrave. Sipas shembullit të tyre do të mund të ecnin edhe të tjerët.

Duke u nisur nga pedagogjia si shkencë mbi edukatën, madje didaktika si pjesë e pedagogjisë që merret me probleme të përgjithshme të arsimit komplet, edukimi (veprimi i orientuar në vend të parë në ngritjen e ndërtimin e personalitetit), arsimimi (sistem i orientuar nga të njohurit dhe aftësitë e prirjet që lidhen me këtë) me anë të mësimit (si mjet themelor i edukimit e arsimit ku merr pjesë nxënësi dhe mësuesi) mbështetet në parimet bashkëkohore:

- orientimi nga faktet thelbësore në edukim;
- përshtatja ndaj moshës dhe gatishmërisë së fëmijës;
- sistematizimi (lidhja logjike e fakteve);
- qartësia;
- veprimtaria e vetëdijshme;
- lidhja e teorisë me praktikën;
- individualizimi (sipas njerëzve);
- përvetësimi i qëndrueshëm i fakteve.

Si faktorë psikologjikë thelbësorë dallohen:

- motivimi (të matet dëshira të nxënësi për të mësuar dhe për ta zbatuar atë që mëson në jetën e përditshme);
- përqendrimi i vëmendjes në mësim sistematik – të kuptuarit – hapi i fundit në procesin e mësim.

Ja edhe disa propozime për konkluzë:

- Në frymën e normave përkatëse këshillat e Bashkësisë Islame dhe kshillat e xhamive janë të obliguar që kujdes shumë më të madh

t'i kushtojnë formimit të klasave të gjera bashkëkohore, të ndritshme si dhe pajisjes së tyre me mjete ndihmëse ekzistuese. Këtë e presin fëmijët, të cilët i kanë ato kushte në shkollat e rregullta, sepse gjatë zhvillimit të hovshëm shkollor në vendin tonë krijohen kushte të mira jo vetëm në qytet, por edhe në fshat, që mund t'u shërbejnë si model këshillave të Bashkësisë Islame.

Janë pjekur kushtet që të zgjidhen grupe punuese nga punëtorë ekspertë prej të gjitha kryesive të cilat do të përgatitin planin dhe programin orientues të edukimit islam sipas shkallvëe, dhe të konstatojë normativat globale, si edhe të përcaktojë doracakët (ilmihallët) për ta, ashtu që pas miratimit të atij plani global kryesitë të kenë mundësi ta përpunojnë për nevojat e veta specifike. Si plan dhe program i ri, i cili duhet të jetë vazhdim i atyre të deritashëm, duhet punuar një tjetër për rininë (p.sh. pas moshës 15-vjeçare). Në këtë detyrë duhet të punojë një grup i veçantë punues, i cili të përpiqet të propozojë forma të punës edukative dhe të kujdeset për doracakët.

Meqë tash për tash nuk kemi tekste e doracakë për punë me rininë dhe të rriturit, do të duhej që me marrëveshjen e të gjitha kryesive dhe me pjesëmarrje në shpenzime, përmes konkurseve në shtypin e Bashkësisë Islame të thirren të interesuarit të punojnë për këtë qëllim, qoftë individualisht, qoftë në ekipe. Grupi punues nga pika paraprake duhet të hartojë teza për këto tekste, të cilat përfshijnë përmbajtjen e përshtatur për rininë e për të rriturit, me mbështetje sa më të madhe në fakte shkencore për fenë islame sot.

Në përgatitjen e planprogramit, e të teksteve për të rritur do të duhej të angazhohej një grup punues i veçantë përfshirë si anëtarë edhe femrat, që të verifikojë pjesën e veçantë të planprogramit për femra – nëna, eventualisht edhe tekste të veçanta për këtë qëllim.

Një apo më shumë kryesi do të duhej të iniconin hulumtime të disa çështjeve aktuale përbrenda programit edukativ, në mënyrë që përgjigjet të mundësojnë metoda të drejta, si p.sh.:

- cila nga përmbajtjet (që i kalojnë fëmijët me program) mbetet më fort në mendje, dhe cilat përmbajtje duhen përfshirë për grupe të caktuara fëmijësh;

- radha e ligjërimit të përmbajtjes dhe përparësisë (p.sh. ahlak, akaid, ibadat, shkrimi arab etj.), e cila do t'i duhet fëmijës më vonë;

- pasi mësimbesimi është një lëndë fakultative – vullnetare, dhe varet shumë nga angazhimi e vetëdija e prindërve, duhen përpiluar doracakë për punën me prindër se cili doracak do të përdorej në praktikë;

- botimet që janë dëshmuar në praktikë, vaz, artikuj të ndryshëm me interes për këtë formë të arsimit duhen përkthyer rregullisht në gjuhët e mualimëve;

- të gjitha gazetatat e revistat e Bashkësisë Islame duhet që t'u japin më shumë hapësirë çështjeve të mësimbesimit, sidomos shkrimeve të mualimëve, këmbimit të përvojave, popullarizimit të metodave etj.;

- pasi gazetatat dhe revistat e Bashkësisë Islame duhet të jenë në funksion të planeve të punës së organeve dhe shërbimeve të Bashkësisë Islame, redaksitë jo vetëm duhet të presin informata e artikuj, por duhet t'i porositin bashkëpunëtorët për tema aktuale dhe pastaj bashkëpunëtorët me përvojë të dëshmuar në praktikë, t'i përpunojnë dhe t'i shpërblejnë tekstet e sukseshme;

- mësimbesimi duhet të ketë vend qëndror në periodikun e Bashkësisë Islame dhe të gëzojë përparësi ndaj teksteve të tjera, sidomos tekstet që mund t'u shërbejnë si instruksione mualimëve;

- për të qenë më efektive hytбет dhe va'zet duhet prezantuar tema aktuale nga jeta fetare dhe të ushtrohet ndikim ndaj xhematit që të ecin nga e mbara e jo vetëm të vijnë e të dëgjojnë; duhet shqyrtuar mundësia që me anë të konkursit të kemi një zgjedhje të hytbeve me tema thelbësore fetare, me materie bashkëkohore, e cila t'u shërbente hatibëve si orientim;

- në të gjitha kryesitë duhet të kenë fonde për përparimin e jetës islame nga të cilat, në bazë të solidaritetit, do t'u ndihmohet këshillave që janë më pasivë, si edhe të shpërblehen mualimët më të zellshëm;

- këshillat e Bashkësisë Islame patjetër duhet të themelojnë fonde për mësimbesim, nga të cilët të mbuloheshin shpenzimet për adaptim, pajisje, shpërblime të mualimëve, gjegjësisht nxënësve etj. Në atë fond duhet detyrimisht të hyjë për çdo vit përqindja e tërë mjeteve buxhetore në bruto të Këshillit të Bashkësisë Islame, posaçërisht mbledhja e mjeteve vullnetare në Natën e Kadrit, si natë që i kushtohet mësimbesimit. Prej këtyre mjeteve do të shpërbleheshin nëpunësit

fetarë që kanë aritur sukses dhe kanë motivuar e tërhequr më shumë fëmijë për vijimin e rregullt të mesimbesimit.

- duhet shqyrtuar mundësia që të nxirret një rregullore orientuese për organizimin dhe funksionimin e mesimbesimit ose, secila kryesi të përgatitet për kuvendin e ardhshëm të Bashkësisë Islame dhe të dal me rregullore për mesimbesimin ose ndonjë akt të ngjashëm;

- këshillime të ngjashme për mesimbesimin duhet të organizohen doemos për çdo vit gjithnjë në një vend tjetër, me analizë për realizimin e konkluzave dhe miratimin e qëndrimeve konkrete për periudhën e ardhshme; këto konkluzione dhe qëndrime secila kryesi duhet t'i përpunojë në afat sa më të shkurtër sipas nevojave të veta, të caktojë bartësit, afatet dhe mjetet, si edhe ta informojë KSJ të paktën dy herë në vit, kurse kuvendin e vet për çdo mbledhje.

Përktheu nga boshnjakishtja:

Feti Mehdiu

Qemajl Morina

Historiku i gjuhës arabe deri në zbritjen e Kur'anit

Arabishtja në mesin e gjuhëve semite

Me termin Semit quhen popujt aramitë, fenikasit, hebrenjtë, arabët, jemenasit, babilonasit dhe asirianët, si dhe ata popuj që rrjedhin prej tyre. I pari që e përdori këtë emër për popujt e përmendur, ka qenë dijetari Shlocer (Schlozer) në fund të shekullit tetëmbëdhjetë. Këtë emërtim, ai e mori duke u mbështetur në Bibël (sipas kaptinës së Krijimit), në të cilën flitet për tre bijtë e pejgamberit Nuh, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të.¹

Gjuha arabe konsiderohet prej gjuhëve më të vjetra semite, edhe pse gjurmët gjuhësore, që janë gjetur deri më tash, janë të një periudhe të vonshme në krahasim me gjuhët e tjera.² Gjurmët më të vjetra

¹ Fqhe اللغة: د. عبد الواحد وافي، ص ٦٠، ط. دار تحفة مصر. و انظر: الكتاب المقدس: سفر التكوين، الاصحاح العاشر، آية ١ ص ١٦، ط. دار حلمي. و لمزيد من التفصيل راجع: دراسات في فقه اللغة د. صبحي الصالح، ص ٤٧ و ما بعدها ط. ١٠ - دار العلم للملايين بيروت سنة ١٩٨٣ م.

² محاضرات في اللهجات العربية: د. محمد أحمد خاطر، ص ٩٠، بدون طباعة سنة ١٩٧٨ م. وقارن ب: الثقافة العربية اسبق من ثقافة اليونان و العبريين: عباس محمود العقاد، ص ٩ و ما بعدها، ط. الهيئة المصرية العامة للكتاب (المكتبة الثقافية - ١) و اللغة العربية - ام اللغات و لغة البشرية:

të shkruara, të gjetura deri më tash, nuk e kalojnë shekullin e tretë. Kjo nuk do të thotë assesi se gjuha arabe nuk ka ekzistuar para Krishterimit, ose se gjuha arabe është më e re se gjuhët tjera motra të saj, si hebraishtja, për shembull. Një numër i konsiderueshëm i orientalistëve vërtetojnë se gjuha arabe e sotme ka ruajtur shumë elemente të gjuhës semite të vjetër, më shumë se çdo gjuhë tjetër semite. Mosgjetja e teksteve të shkruara të gjuhës arabe para paraqitjes së Krishterimit, mund të jetë pasojë e shkaqeve të ndryshme, si p.sh.: analfabetizmi në Gadishullin Arabik, sepse arabët para paraqitjes së Islamit nuk dinin shkrim dhe lexim.³

Shumica dërmuese e dijetarëve të gjuhëve semite janë të mendimit se Gadishulli Arabik është djepi i semitëve të parë dhe për këtë arsye gjuha arabe duhet të jetë gjuha më e vjetër e grupit të gjuhëve semite. Mirëpo, për fat të keq ajo që dihet për të kaluarën e kësaj gjuhe, është shumë pak, ekzistojnë periudha kohore shumë të gjata të panjohura.⁴

Nëse duam t'i bëjmë një përshkrim trungut të gjuhëve semite, për të parë se si është ndarë prej tyre gjuha arabe, do të shohim se ato gjuhë në zanafillën e tyre ndahen në:

a) *lindore*; gjuhët babilonase dhe asiriane.

b) *perëndimore*: të cilat ndahen në dy grupe:

1. *Veriore*, përfshin gjuhët kenanase dhe aramite

2. *Jugore*, përfshin dy pjesët e gjuhës arabe, që janë:

1. *Gjuha arabe e jugut*, të cilën disa dijetarë e quajnë “jemenase e vjetër” a gjuha “kahtanase”, e disa të tjerë e quajnë nganjëherë gjuha “sebeite”, duke e quajtur me emrin e njërit prej dialekteve të saj të njohura, që mbizotëroi mbi të gjitha dialektet. Ndërkaq, prej dialekteve më të njohura të arabishtes jugore janë katra: el-Meinije, Es-Sebeije, el-Hadremije dhe el-Kitbanije.

b) *Arabishtja veriore*: Na mungojnë të dhënat për zanafillën e saj si dhe periudhat e zhvillimit të saj në shekujt e parë. Ajo ndahet në dy grupe:

اسماعيل العري، ص ١٢ و ما بعدها، الطبعة الأولى - دار الفكر بدمشق سنة ١٤٠٦ هـ (١٣٩٥ و ر).

³ في اللهجات العربية: د. ابراهيم انيس، ص ٣٣، ط ٦ - الانجلو المصرية سنة ١٩٨٤ م.

⁴ محاضرات في اللهجات العربية: د. محمد احمد خاطر، ٩٠.

1. *Arabishtja e vdekur*: mbishkrimet më të vjetra të saj që janë gjetur deri më tash, nuk e kalojnë shekullin e parë para epokës së re. Ndër dialektet e saja më të njohura janë: themudit, safavit dhe lahj-anit.

2. *Arabishtja e mbetur (e gjallë)*: Gjurmët e saj nuk e kalojnë shekullin e pestë.⁵ Ekziston një numër i gjuhëtarëve,⁶ të cilët janë kundër ndarjes së gjuhëve semite në ato veriore dhe jugore, sepse kjo ndarje, sipas tyre, nuk mbështetet në baza të shëndosha, nuk është e lehtë ndarja e veriut nga jugu. Fiset arabe kanë jetuar në të gjitha pjesët e Gadishullit Arabik. Ato përziheshin dhe bashkëjetonin në mes veti, nuk kishte kufij të caktuar, dhe njësoj ndodhte edhe me dialektet e tyre. Kështu arabishtja e veriut mbisundoi në shekujt pak para paraqitjes së Islamit dhe arabishtja e mbetur është një përzierje e dialekteve të jugut e të veriut. Për këtë shkak ndarja më e mirë do të ishte në: arabishte e vdekur dhe arabishte e mbetur.⁷


Arabishtja e mbetur është ajo që e kanë përdorur arabët si gjuhë shkrimi, të poezisë e të letërsisë deri më sot. Ajo gjuhë arriti deri tek ne përmes poezisë së kohës së injorancës, Kur'anit fisnik dhe Synetit të Pejgamberit a.s. Kjo gjuhë përbëhet prej disa dialekteve të ndryshme, shumica prej të cilave janë të Veriut të Gadishullit Arabik, e disa prej tyre të Jugut të Gadishullit; ato dialekte janë përzier me njëritjetrin dhe janë kthyer në një gjuhë të njësuar.⁸

⁵ دراسات في فقه اللغة: د. صبحي الصالح، ص ٤٩-٥٨.

⁶ وهو: أ. ولفنسون.

⁷ محاضرات في اللهجات العربية: د. محمد احمد خاطر. ص ٩٠.

⁸ فقه اللغة: د. ابراهيم ابو سكين، ص ٧١، ط. الامانة سنة ١٤٠٤ هـ (١٣٩٣ و).



Zanafilla e gjuhës arabe dhe zhvillimi i saj

Sot nuk është e mundur për asnjë hulumtues që të njohë zhvillimin e gjuhës arabe në periudhën e hershme të saj, për arsye se historia atë e ka njohur vetëm në periudhën e pjekurisë së saj. Sa u përket mbishkrimeve të saj të gdhendura nëpër gurë, që janë nxjerrë nga brendia e Gadishullit Arabik, ato ende janë shumë të pakta.⁹

Kështu është pothuajse çështja e të gjitha gjuhëve, historia e gjuhëve është e lidhur me mistere, sepse ajo ka të bëjë me një kohë shumë të hershme, kështu që, pothuajse nuk ka asnjë gjuhë së cilës t'ia dimë sa duhet historinë e saj të hershme. Mirëpo, të dhënat historike tregojnë se folësit e gjuhës arabe janë pasardhës të Samit, djalit të Nuhut a.s., dhe ata janë populli ad, themud, xhurhumët e parë, populli vebar e të tjerë. Dhe ajo që mbeti prej tyre, kaloi tek populli beni Kahan. Prej saj u zhvillua gjuha emherite, gjuha e banorëve të Jemenit. Ajo pastaj kaloi prej jugut në veri, dhe atë e mësuan bijtë e Ismailit a.s., në Hixhaz.¹⁰

Një numër i studiuesve bashkëkohorë mendojnë se gjuha arabe ka filluar – si duket – si një gjuhë e kufizuar në fjalët dhe shprehjet e saj, për arsye se edhe vetë jeta në atë kohë ishte e tillë. Mirëpo, me kalimin e kohës, u rritën nevojat e atyre që flitnin këtë gjuhë si dhe lëvizjet e tyre në Gadishullin Arabik, nga një vend në tjetrin, bënë që ata të shpiknin fjalë dhe shprehje të tjera, me anë të të cilave t'i shprehnin dëshirat dhe nevojat e tyre.

Për këtë arsye u shumuan fjalët dhe shprehjet e reja të gjuhës dhe u shfaqën dialekte arabe në vende të ndryshme. Kështu gjuha arabe kishte hyrë në një fazë të re, që ishte faza e fëmijërisë.

Studiuesit po ashtu vërejnë se takimet e fiseve arabe në tregje dhe në vende të tjera qenë një faktor i rëndësishëm për përhapjen e fjalëve, shprehjeve dhe kombinimeve të reja gjuhësore.¹¹

⁹ تاريخ الادب للعربي: أحمد حسن الزيات، ص ١٣-١٤ ط ٢٥ دار نهضة مصر.
¹⁰ اللغة العربية: خصائصها وسماتها د. عبد الغفار حامد هلال ص ١٢١، مطبعة الحضارة العربية سنة ١٤٠٦ هـ (١٣٩٥ و).
¹¹ اللغة العربية: خصائصها وسماتها: د. عبد الغفار حامد هلال، ص ١٢١-١٢٢.

Takime të vazhdueshme të fiseve arabe dhe përhapja e shprehjeve të reja përbënin parapërgatitjen e një ambienti të stabilitetit dhe përsosmërisë gjuhësore, sepse populli arab arriti një nivel të caktuar të civilizimit dhe gjuha arabe u bë më e përgatitur për t'iu përmbajtur rregullave, ajo u bë gjuhë e shkrimit dhe e poezisë. Këtë periudhë të gjuhës arabe, shumë studiues e quajnë protoarabe.¹²

Kështu, duke u mbështetur në natyrën e zhvillimit të gjuhës, gjuha arabe para paraqitjes së Islamit përjetoi një zhvillim të madh. Ajo arriti kulmin e të shprehurit për kuptime të ndryshme, qofshin ato konkrete a abstrakte, me fjalë të lehta, me shprehje të forta dhe me fjalë të ëmbla. Si duket, kjo ishte parapërgatitje për zbritjen e Kur'anit fisnik në këtë gjuhë, që t'i sfidonte të gjithë ata që krenoheshin se i njihnin fshehtësitë e kësaj gjuhe, oratorinë dhe bukurinë e stilit të saj.¹³ Me këtë gjuhë arabe hyri në periudhën e rinisë së saj.¹⁴

Më pastaj gjuhës arabe iu mundësua që ajo të kishte dobi prej mrekullisë së përjetshme (Kur'anit fisnik), që e ndihmoi atë për një zhvillim të habitshëm në shprehjet, fjalët si dhe stilin e saj, kështu që ajo, me Kur'anin fisnik, arriti një shkallë të lartë të përparimit, pas të cilit nuk paramendohet përparim më i madh.¹⁵

Fazat e zhvillimit të gjuhës arabe

Nga ajo që u tha më lart, vërejmë se gjuha arabe lindi në vendin më të vjetër të popullit semit – në Hixhaz dhe Nexhd e rreth tyre – dhe se lindjen dhe zhvillimin e saj e përshkon një lloj mjegullie. Po ashtu vërejtëm se gjurmët më të vjetra që na kanë arritur deri më tash të arabishtes së vdekur, nuk kalojnë shekullin e parë para erës së re. Ndërsa ajo që ka arritur deri më sot prej dokumenteve të shkruara nga arabishtja e mbetur, nuk e kalon shekullin e pestë të erës së re.

¹² اللغة العربية: خصائصها وسماتها، ص ٢٢.

¹³ دفاع عن كتاب الله تعالى: " قضية الكلمات الاعجمية في القرآن الكريم " د. عبد العال سالم مكرم، مقال منشور بمجلة الوعي الاسلامي: العدد ٨٢، شوال ١٣٩١ هـ (١٣٨٠ و) ص ١٢.


¹⁴ اللغة العربية خصائصها وسماتها: ص ١٢٣.

¹⁵ دفاع عن كتاب الله تعالى: مجلة الوعي الاسلامي، العدد ٨٢ ص ١٢.

Duke u mbështetur në dritën e dokumenteve të shkruara që janë zbuluar deri më sot, gjuhën arabe mund ta ndajmë në dy grupe.¹⁶

a) *Arabishtja e vdekur apo "arabishtja e mbishkrimeve"*: ajo është arabishtja për historinë e së cilës nuk kemi të dhëna të sigurta përveç tregimeve të librave të shenjtë si dhe mbishkrimeve e gjurmëve të tjera që janë gjetur në Gadishullin Arabik.¹⁷


Prej mbishkrimeve më të njohura, për të cilat thuhet se përfaqësojnë gjuhën arabe para periudhës së letërsisë së injorancës, janë tri:



1. *Mbishkrimi i "En-nem-maretu"*: një pallat i vogël afër Damas-kut, që ishte pronë e Imrul Kajsit, njëri prej mbretërve të al-Hires. Mbishkrimi fillon me tekstin që vijon:


"تى نفسى مر القيسى بر عمر ملك العرب كله ذو اسر التتج..."

Studiuesit mendojnë se ky mbishkrim i përket vitit 328 të erës së re. Ata në të vënë re fjalën "بر" që do të thotë "ابن" (i biri). Fjala "بر", e cila është përdorur në shumicën e gjuhëve të tjera samite.



2. *Mbishkrimi "زيد"* - Zejd: këto janë gjurmë të mbetura afër Hale-bit. Në këtë mbishkrim bëhet fjalë për ndërtimin e një kishe në atë anë. Ky mbishkrim mban datën e vitit 512 të erës së re.

¹⁶ فقه اللغة: د. عبد الواحد وافي، ص ٩٧. دراسات في فقه اللغة ص ٥٤. فقه اللغة العربية: د. ابراهيم محمد نجا، ظ. اولى مطبعة السعادة سنة ١٩٦٥ م، ص ٣٩. اللغة العربية عبر القرون، د. محمود فهمي حجازي، ص ٣٧، دار الثقافة سنة ١٩٧٨ م.
¹⁷ فقه اللغة العربية، ص ٣٩.



3. *Mbishkrimi* "حاران" (Haran): Këtë e ka zbuluar Bakran el-Lixhafi në pjesën veriore të malit Duruz, në jug të Damaskut. Mbishkrimi "Haran" ka qenë i gdhendur në një gur mbi derën e një kishe. Teksti i mbishkrimit është si vijon:

"انا شرحييل بن ظلموا (ظالم) بنيت ذا المرطول سنت (سنة)

٤٦٣ بعد مفسد خبير بعم (بعم)..."

Vihet re se në këtë mbishkrim ekzistojnë disa fjalë, të cilat nuk i njeh gjuha arabe, si për shembull fjala "المرطول" që ka kuptimin kishë. Po ashtu edhe fjala "بر" aramite.¹⁸

Prej këtyre mbishkrimeve mund të konkludojmë se folësit e këtyre dialekteve ishin të izoluar prej arabëve të Hixhazit dhe Nexhdit dhe se ata i kishin humbur shumë elemente të arabishtes. Ata kishin rënë nën ndikimin e civilizimit aramit dhe nebatit. Kështu ata mbishkrimet e tyre i shënonin me luftën e Nebatit si dhe me luftën e persianëve dhe romakëve.¹⁹

b) *Arabishtja e mbetur (e gjallë)*: Është fjala për gjuhën e sotme arabe, e cila përdoret sot tek shumë popuj arab si gjuhë e letërsisë, e shkrimit dhe si gjuhë e folur.

Nuk dihet asgjë për zanafillën e saj, për arsye se dijetarët nuk kanë gjetur asnjë gjurmë të shkruar në periudhën e saj të parë në vendlindjen e saj në Hixhaz dhe në Nexhd.

¹⁸ تاريخ اللغات السامية: ص ١٨٩-١٩٢.

¹⁹ فقه اللغة، د. علي عبد الواحد وافي، ص ٩٩.

Gjurmët më të vjetra të arabishtes-letërsia e injorancës

Letërsia e injorancës ka të bëjë me disa gjurmë letrare, të cilat u përkasin disa poetëve të shekullit të injorancës (periudhës paraislame), njerëzve të mençur dhe oratorëve të mirë të asaj kohe. Mirëpo, ato poezi janë transmetuar vetëm gojarisht, dhe u shkruan e u tubuan vetëm në shekujt e parë të periudhës islame. Në bazë të të gjitha të dhënave, poezitë më të vjetra nuk e kalojnë shekullin e pestë të erës së re. Poezia në fjalë e pasqyron gjuhën arabe në periudhën e pjekurisë dhe përsosmërisë së saj, pasi kishte kaluar periudhat e shumta të rritës dhe zhvillimit të saj, dhe, më në fund, kishte mbizotëruar dialekti kurejshit ndaj dialekteve të tjera, si në aspektin e letërsisë, poezisë, oratorisë, edhe të prozës në mesin e fiseve të ndryshme arabe.²⁰

Dialekti kurejshit, për shkak se flitej në Mekë – qendra fetare, ekonomike dhe kulturore e arabëve, ishte në kontakt edhe me dialektet e tjera të fiseve arabe, dhe ndodhte një përzierje me dialektet e tjera, për shkak të ardhjes së njerëzve për tregti dhe haxh në Mekë.²¹ Arabët e vizitonin Mekën për çdo vit dhe Qabenë e vizitonin edhe në kohën e injorancës. Kurejshitët, dialektet e ndryshme i quanin “gjuhë arabe”, ato që i preferonin prej atyre gjuhëve i përdornin dhe ata u bënë oratorët më të mirë në mesin e arabëve dhe gjuha e tyre u bë gjuha më superiore. Ky është sekret i oratorisë së saj, po ashtu është një realitet, që e pranonin të gjitha fiset arabe, se ajo ishte më e pasura, më e rrjedhshmja dhe më e përshtatshmja për t’i shprehur ndjenjat më të thella dhe në mënyrën më të bukur.²² Kështu, siç thotë ibu Xhin-ni²³, gjuha e kurejshit ishte e nivelit më të lartë se “an’anetu” Temim, se “keshkesheti” Rebia, “keskeseti” Hevazin, se “tedexhxhei” Kajs, se “axhrefeti” Dub-be dhe “telteleti Behra”.²⁴ Kështu që në një periudhë të caktuar gjuha kurejshite u bë gjuhë e njësuar për të gjithë arabët. Prandaj nuk është për t’u habitur që Kur’ani zbriti në gjuhën më të për-

²⁰ المصدر السابق: ص ١٠٧، ١٠٨.

²¹ محاضرات في اللهجات العربية، د. محمد أحمد خاطر، ص ١٠٠.

²² راجع: دراسات في فقه اللغة، ص ٦٧.

²³ الخصائص: تحقيق محمد النجار: ١ / ٤١١، ط. ٣ عالم الكتب سنة ١٤٠٣ هـ.

²⁴ Të gjitha fjalët arabe në thojza kanë të bëjnë me veçoritë e dialekteve të secilit fis që i dallonte ato nga njëri-tjetri.

sosur të arabëve. Kjo bëri që dialekti kurejshit të arrinte nivelin më të lartë të përsosmërisë, edhe pse ishte një dialekt i kufizuar i një prej fiseve arabe.²⁵

²⁵ رسالة الجهاد، العدد ٩٠، السنة التاسعة ذو الحجة ١٣٩٩ ور يوليو ١٩٩٠ م، ص ٦٤ طرابلس، ليبيا.

Hysein Xhozo

Problemi i prapambetorisë së përgjithshme

Problemi i prapambetorisë së përgjithshme në tërë Botën Islame edhe më tutje është aktual. Nuk ka asgjë më të pabesueshme, sesa gjurmët e kësaj prapambetjeje të jenë të qarta dhe ngado në jetën e Botës Islame, me gjithë shenjat e forta të zgjimit në kohën më të re.

Është e pakontestueshme se muslimanët në të gjitha viset e botës jetojnë në të njëjtën gjendje, mbase një periudhë të gjatë të prapambetjes. Pas një përparimi gjigant dhe aktiv shumë të frytshëm e krijues, të inspiruar nga mësimet e Kur'anit, i cili në të gjitha fushat e aktiviteteve njerëzore la rezultate të rëndësishme, pasoi një ngecje dhe rënie të përpjetë, ecje prapa. Ajo rënie, për fat të keqë, mezi u ndal, por pasojat mbetën dhe vazhdojnë t'i ngulfatin muslimanët. Është fakt se vendet muslimane hyjnë ndër vendet më të prapambetura ekonomikisht dhe në pikëpamje shoqërore e kulturore. Prej disa qindra miliona arabëve, 70% janë analfabetë. Kjo përqindje është edhe më e madhe në Indonezi e Pakistan. A nuk është shumë karakteristike se edhe tek ne përqindja e analfabetëve është më e madhe në viset muslimane.

Në qoftë se i shtojmë kësaj edhe faktin se deri dje të gjitha vendet islame ishin të robëruara, se në disa prej tyre para pak viteve është heq zyrtarisht robëria, se në disa akoma sundojnë marrëdhëniet feudale, se në pjesën më të madhe të vendeve afrikane, ku muslimanët janë shumicë, sundojnë pakicat jomuslimane, se disa qindra miliona

arabë kanë humbur luftën kundër Izraelit vetëm prej disa milionave hebrenjve, - problemi i prapambetorisë së përgjithshme të muslimanëve do të na jdalë shumë më i qartë dhe më i dukshëm.

Problemi i vërtet është këtu. Këtë as që mundemi dhe as që bën ta mohojmë.

Para zgjidhjes së këtij problemi na shtrohen në rend të parë si çështje parimore shkaqet e prapambetorisë së muslimanëve. Në interes të zgjidhjes së drejtë është qenësore të zbulohen dhe të përcaktohen shkaqet e vërteta. Sëmundja nuk mund të shërohet me sukses në qoftë se nuk përcaktohet diagnoza e drejtë. Problemi i zgjimit të Botës Islame dhe gjetja e rrugës së vet në atë zgjim nuk mund të zgjidhet derisa të mos zbulohen saktësisht shkaqet e dekandencës së përgjithshme të anëtarëve të Fesë Islame.

Fakti se prapambeturia e përgjithshme ka përfshirë njësojë të gjitha pjesët e Botës Islame, bile edhe pakicat muslimane, i ka shtyrë disa autorë të konstatojnë se Feja islame është shkaku kryesor i kësaj prapambeturie dhe se ajo mban përgjegjësinë më të madhe për rënien totale të muslimanëve.

Pa marrë parasysh atë, ky pohim nuk mund të pranohet, po se këtu mund të hetohen elemente qëllimkëqia dhe tendenca të caktuara e armiqësi, apriori nuk mund të mohohet. Medoemos duhet ta pranojmë se ai, megjithatë ka një bazë. Mund të themi se ky pohim paraqet përgjigje të pyetjes ç'është ajo që është e përbashkët për të gjithë muslimanët dhe çfarë i bashkon ata? Edhe vëzhguesit më objektivë, shkencëtarët dhe historianët në studimet e veta të periudhës dekadente të muslimanëve nuk mund të injorojnë elementet e përbashkëta dhe në to të kërkojnë shkaqet e prapambetorisë së përgjithshme, e cila është, po ashtu e përbashkët për të gjithë muslimanët. Duke pasur parasysh se vetëm feja islame i bashkon të gjithë muslimanët, vetëm, kjo për shumë, jo pa bazë, do të ishte e mjaftueshme, që në të t'i kërkojnë shkaqet e prapambetorisë. Me plotë të drejtë del përfundimi se shkaqet e prapambetjes duhen kërkuar në atë që e kanë të përbashkët të gjithë ata, e që është feja islame.

Hulumtimet e reja të autorëve islamë në këtë lëmë nuk e mënjanojnë tezën për shkaktarin e përbashkët dhe për lidhshmërinë e saj me fenë islame.

Që të kuptohet kjo vërtet, duhet të thuhet menjëherë se gjatë një periudhe të gjatë të dekadencës së popujve islamë, është formuar një pasqyrë për fenë islame, një vizion i veçantë, i cili përbën shprehjen më të besueshme të prapambeturisë së përgjithshme. Me anë të ndikimeve të ndryshme, sikur janë filozofia e vjetër greke, ilmi kelami (apologjetika), mistika indiane, persiane, rendet e dervishëve, laicismi, mendimet bashkëkohore evropiane, - u krijua mistika islame, metafizika, fatalizmi, formalizmi, rezignimi, pasiviteti, durimi i pavend etj. Një shfaqje e tillë që moti rëndon vetëdijen e shumë gjeneratave. Ajo ende është e pranishme dhe ngulfat jo vetëm masat muslimane, po edhe një pjesë të mirë të ylemave.

Nuk mund të mohohet se pasqyra e këtillë e fesë islame nuk ka pasur lidhje me prapambeturinë e përgjithshme të muslimanëve dhe se në përpjekjet për një zgjim të ri, nuk kanë bërë dhe nuk bëjnë pengesa. Bile mund të thuhet që pikërisht nga ky fakt edhe nis lufta për progres dhe zgjim të muslimanëve. Porosia kryesore e pionierëve të ripërtëritjes islame-Xhemaludin Afgani, Muhamed Abduhu, Reshid Rida, Igballi etj.- ka qenë: kthimi në fenë burimore islame dhe luftë kundër gjithçkaje që ka hyrë në të dhe që është tërësisht e huaj. Në këtë drejtim vepruan më vonë Subaiu, Mevdudi, Nedeviu, Muhamed dhe Seid Kutbi e të tjerë.

Të gjithë ata janë unikë dhe kjo e bën edhe qëllimin kryesor të përpjekjes së tyre, se në periudhën e dekadencës janë formuar koncepte të gabuara për fenë islame dhe qëndrim tërësisht i gabuar ndaj saj. Feja islame mbeti tek ritet, e ritet tek një formalizëm i thjeshtë.

Më në fund u krijua një bindje e fortë se mbyllja e mendimeve islame brenda koncepteve të interpretimit të parë të saj dhe në format e zbatimit të parë praktik, ka qenë me rëndësi vendimtare për periudhën e dekadencës. E konsiderojmë të nevojshme dhe me këtë rast në veçanti e theksojmë dhe e përsërisim atë që shpesh e përmendim dhe e konsiderojmë fakt shumë të rëndësishëm: se koncepti islam ka përjetuar vetëm një përpunim, një interpretim dhe një zbatim praktik dhe këtë jo më pak se para një mijë e më shumë vjetve. Përpunimi i parë dhe i vetëm i koncepteve islame, siç është e ditur, është kryer kryesisht në shekullin II sipas hixhrit. Që nga ajo kohë koncepti islam qëndron i pranguar, i ngrirë dhe i mbyllur në format e para të përpunimit

dhe të zbatimit. Në harmoni me këtë ka qëndruar jeta e përgjithshme e muslimanëve e kallëpuar dhe tërësisht e shabllonizuar në format e përpunimit të parë dhe të zbatimit praktik. Përpunimi i parë i zbatimit të koncepteve islame ka dhënë rezultate madhështore historike. Ai ka mundësuar që të konstituohet bashkësia e parë e re arabe, e pastaj bashkësia e popujve islamë, e cila ka qenë thelbi i shoqërisë së re, i kulturës së re dhe i civilizimit të ri, që në shekujt e mëvonshëm shndriti me një dritë të tillë dhe ofroi mundësi të mëdha krijuese të pabesueshme. Ai i lëvizi përpara dhe dha impulse të rëndësishme në zhvillimin e mendimeve islame.

Ai ka qenë, për fat të keq, jetëshkurtër. Feja islame qiti në shesh forcën e vet krijuese në periudhën e caktuar duke lëvizur brenda kufijve të përpunimit dhe zbatimit, e cila gjithsesi nuk ka mundur dhe as që lejohej të pretendonte përhershmëri. Tentimi që zhvillimi i mëtejshëm dhe ecja përpara të frenoheshin në format e këtij zbatimi dhe që t'i jepeshin damkat e modelet e përhershmërisë, ka qenë fatalist për zhvillimin e mëtejshëm të misionit të fesë islame. Me mbylljen e ixhtihadit dhe proklamimin e funksionit të tij të shuar, është pamundësuar përpunimi i mëtejshëm i mendimeve islame dhe kërkimi i formave të reja të zbatimit praktik të saj. Me t'u ndal çdo zhvillim i mëtejshëm. Popujt muslimanë filluan të vendnumëronin, ta vazhdonin jetën me forcë në shabllonet e para që shkaktuan patjetër ngecjen.

Padyshim kjo ka qenë më tragjika në zhvillimin e muslimanëve. Këtu duhen kërkuar shkaqet e prapambeturisë së përgjithshme dhe të burimeve të të gjitha mashtimeve të mundshme, të njëjta brenda koncepteve tona, si dhe të atyre tendencioze në raport me konceptet laike evropiane.

Një nga mashtimet më të mëdha që autorët evropianë e përsërisin shpesh dhe i cili, padyshim, ka bazë në përpjekjet e ylemave të mëvonshëm që të qëndrohet brenda kornizave të modelit të parë të mendimeve islame, është pohimi se Kur'ani nuk ka qenë vetëm burim, por edhe rrjedhë e tërë civilizimit islam, sepse ka qenë i përhershëm dhe model i pandryshuar i gjithë atyre që ekzistojnë, shpirtërore dhe profane, ka fshehur transhendentën e historisë së vërtetë islame në meta-histori. E tillë është, pohojnë ata, kjo botë madhështore islame është

bërë vetëm rastësi e ndritur. Me prangimin dogmatik dhe mbylljen brenda kornizave të pandryshueshmërisë së Kur'anit dhe fesë islame mbeti e pandryshuar ajo vetë nga vetvetja. Janë historike rrjedhat e saj të pacenueshmërisë kuranore - megjithë interpretimet e shumta e të ndryshme të modelit kuranor - e injoruan dialektikën historike dhe format e saj synonin nga e kaluara e tij e përhershme, përmes të tashmes së vet të përhershme në ardhmërinë e përhershme. Kur'ani, më tej pohojnë këta autorë, duke i shndërruar beduinët nomadë në popull historik, dhe duke formësuar civilizimin e madh, përcaktoi edhe fatin e atij populli dhe të atij civilizimi. Duke dalë nga kërkesat shoqërore për revolucion dhe prosperitet, ai me pretencën hyjnore të përhershmërisë transhendentoi modelin që e ka hartuar për nevoja historike të asaj shoqërie dhe prosperitetit shoqëror, në sferat hyjnore johistorike, dhe me të hapi historinë e civilizimit islam në histori të papërsëritshme, gjithmonë madhështore e të njëjtë, e cila në rrjedhat e patundura të evolucionit botëror u shndërrua në mit.

Nëse është këtu esenca e mashtrimit? Para së gjithash, ne duhet të pranojmë se ai model është hartuar për nevoja historike të prosperitetit të sotëm shoqëror dhe shpirtëror, u shndërrua në sfera hyjnore johistorike dhe me të në civilizimin madhor historik islam. E shndërrroi në përsëritje johistorike gjithmonë të madhështisë së njëjtë, e cila më vonë u shndërrua në mit. Kjo është e vërtetë e pamohueshme. Modeli i parë i mendimeve islame, i cili u hartua në bazë të koncepteve islame për nevoja të prosperitetit shpirtëror e shoqëror të shoqërisë islame në fazën e parë të zhvillimit të tij, gjithnjë është përsëritur dhe në profilet e veta e ka gurëzuar e frenuar zhvillimin e mëtejshëm të mendimeve islame e pastaj edhe të shoqërisë islame.

Mirëpo, gabimi themelor i autorëve perëndimorë qëndron në faktin se ky model identifikohet me Kur'anin dhe i mvishet dimenzionit hyjnor e pretencave për përhershmëri. Ata është dashur të dinin patjetër, e këtë për fat të keq është dashur ta dinim edhe ne, se ky problem paraqet vetëm interpretimin tonë njerëzor të parë në hartimin e mendimeve kuranore, të kushtëzuar nga kërkesat e prosperitetit shoqëror e shpirtëror të shoqërisë së parë islame. Ai model, në të vërtetë është aplikim i parë praktik i fesë islame, i problemeve të bashkësisë islame. Ky përpunim dhe aplikim, që e quajmë model, nuk ka mundur,

dhe as që mund të ketë pretenca të përhershmerisë. Ai mund të kishte vlerë vetëm në kushtet e caktuara, të cilat si të tilla, edhe e kanë përcaktuar. Me ndryshimet e mëtejshme shoqërore dhe zhvillimore, duhej të ndryshohej edhe modeli.

Në këtë drejtim, feja islame ka porositur dhe institucionalizuar institucionin e ixhtihadit. Ky institucion i rëndësishëm ka për detyrë që, duke pasur parasysh dialektikën historike, të përpunojë pandërprerë mendimin islam, të hulumtojë forma të reja respektive, aplikim të tyre praktik dhe për secilin moment të dhënë historik të gjejë modelin respektiv. Ai patjetër duhet të jetë gjithmonë aktiv, të ndjekë me vëmendje zhvillimin e jetës, ta drejtojë e ta formësojë në frymën e parimeve islame.

Kur'ani, mbase nuk e pranon modelin e përhershëm në kuptimin e zbatimit praktik. Ai i ka shpallur parimet dhe konceptet e përgjithshme, të cilat në momentin e dhënë historik sipas kërkesave të jetës, zhvillimit dhe mundësisë së njohurive të atij momenti, ta rregullojë institucionin e ixhtihadit dhe të gjejë forma dhe modele të aplikimit. Është mjaft karakteristike pse Kur'ani nuk e ka precizuar, bile as mënyrën, as kohën, as numrin e namazeve, njësoj është edhe zekati. Ka porositur, formën e obligimit të rreptë, ndihmën materiale të bashkësisë, por nuk e ka përcaktuar sa dhe si. Kështu ka vepruar në të gjitha segmentet e jetës njerëzore dhe të shprehjes njerëzore. Çdokund ka proklamuar vetëm konceptet e përgjithshme, e aplikimin ua ka lënë njerëzve, që ata në harmoni me kërkesat e dhura dhe mundësitë, të kërkojnë format më të përshtatshme të aplikimit, duke pasur kujdes që mendimi islam nuk bën të mbyllet në asnjë moment në format e tejkaluara të aplikimit të vet praktik.

Në qoftë se, megjithatë, ndodh që ky mendim të jetë mbyllur vërtet në format e para të aplikimit të vet dhe që për këtë arsye ai të lëvizte përherë në rrethin e mbyllur dhe mahnitës "nga e kaluara e vet e përhershme përmes së sotshmës së përhershme në të ardhmen e përhershme", me këtë rast duhet të jemi absolutisht të qartë se kjo nuk është për shkak se ai nuk e pranon dialektikën dhe dinamikën historike. Përkundrazi, ai është esencialisht dialektik dhe dinamik. E kanë mbyllur e burgosur, për fat të keq, dijetarët e mëvonshëm, të cilët kanë pamundësuar funksionimin e institucionit të ixhtihadit.

Kështu u ndalua zhvillimi i mendimit islam. Kështu ndodhi përsëritja e përhershme e modelit të njëjtë dhe vendnumërimi e lëvizja vicioze. Sërish kështu, si pasojë e domosdoshme erdhi dekadencia e përgjithshme e Botës Islame.

Këtu duhen kërkuar shkaqet e përbashkëta të prapambeturisë së përgjithshme të muslimanëve, pa marrë parasysh ku jetojnë.

Më vonë, në periudhën e zgjimit të Evropës dhe zhvillimit të mendimeve e qytetërimit evropian, të pa aftë të ballafaqohen me situatën, muslimanët u tërhoqën dhe u mbyllën hermetikisht. Duke u ndier të rrezikuar nga bota e re që po vinte, ata tërhiqen tërësisht nga skena botërore dhe izolohehen duke kërkuar veten dhe manifestimet e veta në vetvete përmes meditimeve mistike metafizike në teqe dhe xhami. Është shumë karakteristike për këtë izolim dhe ikje nga jeta, sjellja e vetë Gazaliut. Pikërisht në momentin kur Bota Islame u ballafaqua me rrezikun më të madh dhe kur kaloi përmes sprovave më të rënda-luftërave kryqtare, Gazaliu tërhiqet në vetmi dhe shkruan "Elmunkidhu mined-Dalal"-in e vet, duke rënë kështu thellë në meditime mistike. Është interesant se askund në veprat e tij nuk ka asnjë fjali për rrezikun nga kryqtarët, që në periudhën e tij rrezikuan drejtpërsëdrejti fenë islame dhe muslimanët.

Në atë mbyllje dhe tërheqje në vete kur ndihen rreziqet dhe frika, mistika gjeti terren shumë të frytshëm. Ajo e formësoi perandorinë e vet: perandorinë e endrrave, iluzioneve, çudirave, kerameteve, kulteve të evliave, murshidëve, kutbave, yqlerëve, kërklerëve, mehdistëve etj. Në vend të punës, luftës dhe sakrificës, thanë se zgjidhja mund të arrihet me dua dhe lutje. Në vend të investimit të përpjekjeve më të mëdha në fushën e shkencës dhe të zbulimeve shkencore, shumë më lehtë mund të arrihen njohuritë me anë të keshfit-zbulimit të drejtpërdrejtë (ilhamit). Murshidi, edhe po të ishte injoranti dhe primitivi më i madh, i di të gjitha, sepse Zoti xh.sh. i jep atij drejtpërsëdrejti dituri dhe ia zbulon gjërat. Ai mund të bëjë çudira (keramete), madje të ringjallë të vdekurit.

Pa dyshim, në një klimë të tillë lindën lajthitjet më të rënda që u bënë frena të mëdha të zhvillimit tonë. Aty lindi raporti i gabuar ndaj shkollës, punës, sakrificës, të mirave materiale, etj. Aty lindi orientimi në vdekje, Ahiret, dua, lexim Kur'anit për të vdekurit, madje me anë

të ndërmjetësuesit, shkrimeve të hajmalive, shndërrimin e fesë islame në rite etj.

Pra, muslimani u orientua tërësisht në botën e mistikës dhe metafizikës. Jeton nën hijen e paraardhësve dhe u është drejtuar varreve të tyre. Edhe sot tyrbet e njerëzve të njohur janë përplot muslimanë, në to u drejtohen duke kërkuar nga ata ndihmë dhe plotësimin e dëshirave të veta.

Kur është nën presionin e madh të zhvillimit evropian, veçanërisht të lëvizjeve sociale, bota e mistikës, ëndrrave dhe iluzioneve ka filluar të rrënohet, por për Botën Islame lindën vështirësi të reja, vuajtje të reja dhe probleme të reja. Nga dhe çfarë tash? Forcat prodhuese kanë qenë në fazën e lindjes. Intelejencia e arsimuar evropiane ka qenë e gatshme që pa farë rezervash të pranonte mënyrën e re të jetës me të gjitha karakteristikat e saj. Megjithatë, masat i bënë rezistencë të fortë mendimit të ri. Kështu lindi distancimi në mes masave dhe udhëheqësve. Mendojmë se ky distancim paraqet vështirësinë më të madhe në zgjimin bashkëkohor të muslimanëve. Udhëheqjet politike nuk arritën të krijonin një platformë ideo-politike, që do ta pranonte masat dhe në të cilën ato do ta gjenin veten me vlerat e veta, me traditën dhe me historinë e vet. Ato në të gjitha platformat e improvizuara të derisotme shohin vetëm mohimin e vet dhe mohimin e të gjitha vlerave të veta shpirtërore. Që këtë vjen labiliteti politik në ato vende, që këtë të rënat e shpeshta, konfliktet reciproke, ndarjet dhe mossukseset. Shembull më i mirë për këtë janë vendet arabe dhe problemi palestinez. Copëtimi, ndarja e botës arabe, në rend të parë, e pastaj mosekzistimi i platformës unike ideor-politike, u ka mundësuar forcave botërore sionisto-kolonialiste që në Palestinë të vendosnin Izraelin sionist si bazë të vetën, të cilin më vonë e shtynë në rrugën e agresionit. Për shkak të jounitetit arab dhe dezorientimit ideor, Izraeli e zgjeroi territorin e vet dhe okupoi pjesë të tokave arabe. Dy milionë e gjysmë hebrenj, të cilët kurrë në historinë e gjatë nuk kishin treguar ndonjë aftësi ushtarake, fituan nga njëqind milionë arabë të konfliktuar dhe të copëtuar në mes veti.

Si të tejkalohen gjurmët e kësaj prapambeturie?

Në këtë rrugë ekzistojnë edhe shumë vështirësi. Problemi më i madh është udhëheqja e shëndoshë, e aftë që t'i përgjigjet momentit

vendimtar dhe të gjejë rrugën që do t'u përgjigjej synimeve themelore të masave. Problemi i udhëheqjes politike dhe fetare në Botën Islame në këtë moment përbën çështjen më të ndërlikuar e më të rëndësishme. Udhëheqjet politike janë të ngarkuara me marrëdhëniet politike ndaj opinionëve perëndimore dhe mënyrës së jetës perëndimore, e cila në vete, në masë të madhe, ngërthen mohimin e vlerave islame. Udhëheqësit fetarë i janë kthyer sërish së kaluarës, vdekjes, Ahiretit, të kufizuar në rezonim dhe arsimim, të ngarkuar me aversion ndaj gjithçkaje të re.

Megjithatë, nuk do të jetë vështirë të përballohen vështirësitë e theksuara. Është mjaft e përshtatshme dhe trimëruese që masat në të gjitha vendet, kryesisht, kanë mbetur të shëndosha, të bindura në vlerat e veta, traditat dhe trashëgimitë shpirtërore. Krahës kësaj, me gjithë vështirësitë, në të gjitha viset e Botës Islame po lind e po rritet një forcë e re islame, e cila ka gjetur veten, është çliruar nga komplekset e ndryshme dhe e cila e kupton problemin e çel një rrugë të re. Këto forca të reja, pamvarësisht nga pengesat e mëdha, hapin rrugën, kërkojnë dhe përpiqen të realizojnë:

1) të dalin nga shikimi symbyllur dhe i ngushët i ekzistencës, të thyejnë kornizat e modelit të përbotshëm, i cili përsëritet përherë. Të bëjnë hartimin e ri të koncepteve islame me anë të rigjallërimit të institucionit të ixhtihadit, i cili domosdo duhet të jetë i organizuar ashtu që t'u përgjigjet kërkesave të kohës, dhe i cili të ishte i aftë për të ndjekur zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore;

2) të lidhin të kaluarën dhe të tashmen dhe mbi të të ndërtojnë një të ardhme më të mirë, t'i lidhin vlerat e trashëgimisë shpirtërore me prosperitetin material e me të arriturat shkencore dhe teknike. Të rigjallërojnë komponentin shpirtëror dhe të kultivojnë e të zhvillojnë njësoj vlerat shpirtërore e materiale. Aktivisht të marrin pjesë në të gjitha ngjarjet dhe të kërkojnë vendin e vet në botën bashkëkohore. Të çlirohen nga kompleksi i vlerës më të ulët dhe të kultivojnë vetëbesimin;

3) të punojnë në forcimin e bashkëpunimit reciprok dhe unitetit mbi bazë të solidaritetit të përgjithshëm dhe të internacionalizmit islamik (innemel mu'minune ihvetun). Armiku, duke ndjek politikë kolonizuese-kryqtare ose nga motive sioniste, duke shfrytëzuar dobë-

simin e solidaritetit musliman dhe duke iu përmbajtur motos: "përçaj e sundo", e ka përçarë, sidomos botën arabe, në shumë shtete, emirate e shejhate, dhe ka arritur t'i sjellë në grindje në mes tyre;

4) të hartojnë platformën unike ideopolitike mbi bazë të vlerave unike, të traditës, të historisë dhe trashëgimisë shpirtërore. Të realizojnë unitetin e mendimeve që të arrihet uniteti i aksionit.

Për sa na takon neve, anëtarëve të bashkësisë islame, këtu në këtë pjesë të botës, duhet thënë se edhe ne jemi pjesë e botës së përgjithshme shpirtërore të bashkësisë islame. Krahas karakteristikave të përgjithshme të përbashkëta, ne në zhvillimin tonë kemi pasur dhe kemi situata tona specifike, nëpër të cilat kemi kaluar dhe nëpër të cilat po kalojmë tash. Nuk mendojmë këtu të bëjmë fjalë për ato situata. Për to kemi shkruar gjerësisht në artikujt "Rruga jonë", "Problemi i daljes nga shikimi i verbët i ekzistencës fetare", "Islami dhe muslimanët" etj. Me këtë rast e konsiderojmë të nevojshme të theksojmë veçanërisht rëndësinë e organizimit të fortë dhe bashkëkohorë të jetës fetare, e cila duhet të vihet patjetër mbi koncepte më të qarta dhe më të gjera dhe me një vështrim më të thukët të esencës së zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, e vendit të përgjegjësisë sonë në atë proces. Jeta fetare, patjetër duhet të marrë pjesë në zhvillimin e përgjithshëm dhe të ecë me të paralelisht. Organet e Bashkësisë islame patjetër duhet të kenë në duart e veta iniciativën e plotë dhe të drejtojnë e të trasojnë rrugën në frymën e koncepteve të qarta dhe të caktuara.

Duhet pranuar se deri më tash iniciativa e jetës fetare ka qenë në duar të masave, të cilat atë jetë e bartnin dhe e mbanin në mënyrë stihike. Nuk duhet të harrojmë se në shoqëri zhvillohen dhe rriten forca të reja progresive, të cilat nuk do të tolerojnë kurrfarë lloj primitivizmi. Në qoftë se brenda kornizave të jetës fetare mbeten akoma ca elemente të primitivizmit, në qoftë se brenda jetës fetare futen disa botëkuptime të tejkaluara, do të jetë shumë vështirë, të aktivizohen dhe të përfshihen në jetën e tillë të njeriut bashkëkohorë, i cili gjithnjë e më shumë shfaq interes për vlerat shpirtërore. Në qoftë se jemi të aftë të kontaktojmë me forcat e reja progresive, ato do të ecin më tutje edhe pa ne, veçanërisht tash kur kanë marrë një pamje të re e më të gjerë të ekzistimit dhe zhvillimit.

Kjo na tërheq vërejtjen edhe më shumë se kërkohet një organizim sa më bashkëkohor i jetës fetare dhe një kujdes më i madh për kuadrin. Këtu problemi i kuadrit paraqitet si çështja më akute dhe më e rëndësishmja, pastaj regjionalizimi dhe sistematizimi i xhematit, baza materiale dhe mënyra e vendosjes dhe e pagimit të nëpunësve fetarë. Praktika e deritashme, në këtë pikëpamje nuk u përgjigjet më interesave të jetës fetare.

Nuk mund të themi se edhe në jetën fetare nuk është ecur përpara. Po vjen kuadri me kualifikim të lartë nga universitetet e ndryshme islame, në të cilët ka një numër të konsiderueshëm studentësh. Është hapur fakulteti i studimeve islame, i cili në këtë drejtim do të na ofrojë ndihmë të madhe dhe do të plotësojë një kërkesë të kahmotshme.

Para kuadrit të ri fetar të kualifikuar qëndron një detyrë e madhe dhe delikate: harmonizimi i jetës fetare me kërkesat e kohës së re dhe të njeriut të ri bashkëkohor. Ky harmonizim paraqet një proces mjaft të ndërlikuar. Duhet ditur se këtu nuk kemi të bëjmë me përpjekjen për harmonizimin e mësimave islame me mënyrën e jetës dhe me botëkuptimet e njeriut bashkëkohor, në të vërtetë për revidimin e atyre mësimave. Fjala është për një qasje të re ndaj të vërtetave fetare dhe një interpretimi të ri të tyre, qasje shumë më shkencore ndaj problemeve fetare, imperativit të fesë, rolit dhe vendit në shoqërinë bashkëkohore. Për këtë duhet mjaft dituri nga të gjitha fushat e jetës dhe nga të gjitha disiplinat shkencore. Feja është fenomen i ndërlikuar, i thellë dhe i vjetër. Çdokund është e pranishme, njeriun e përcjellë që nga lindja. Depërton në këndet më intime, më të fshehura të psiqikës së tij. Ai që dëshiron të kuptojë dhe të interpretojë drejt fenë, misionin e saj, vendin e saj në jetën e njeriut dhe shoqërisë, patjetër duhet të jetë psikolog i mirë, sociolog, historian, filozof, shkencëtar etj. Fenë nuk mund ta interpretojnë njerëzit gjysmanalfabetë. Këtu qëndron tragjedia e fesë islame. Derisa fenë islame e interpretonin ylema me arsim universal, ajo përbënte forcën lëvizëse të zhvillimit të gjithanshëm. Kur dolën në skenë dhe kishim fjalën kryesore fukahe-njtë e gjysmarsimuar, me dituri mjaft të kufizuar e të njëanshme, feja islame pushoi të jetë faktor në jetën e muslimanëve. U shndërrua në formalizëm e mistikë dhe filloi të tërhiqte prapa.

Për ta kthyer fenë islame të vërtetë, për të luftuar kundër deformimeve, të cilat lindën gjatë periudhës së gjatë dekadente, për të nxitur përpjekjet për ripërtëritjen e zgjimin - si grupi më i madh i organizuar i myslimanëve evropianë, neve na takon roli i veçantë.

Është për të shpresuar se e kemi kuptuar këtë rol dhe se do ta realizojmë.

Marrë nga: "Glasnik", nr.11-12, 1970
*Nga boshnjakishtja: **Ismail REXHEPI***

Ahmed Davutoglu¹

Përplasja e interesave: Një sqarim i (jo)rendit botëror

Teoritë e pasluftës së ftohtë

Përderisa parametrat e luftës së ftohtë humbin, lidhja e re gjendet ndërmjet procesit të vendosjes politike në qendrat e fuqive të sistemit ndërkombëtar dhe teorive politike. Kjo reflektohet rishtaz në teoritë e Fukuyames në “Fundi i Historisë”² dhe në “Përplasja e Qytetërimeve” të Huntingtonit.³ Ndonëse kanë disa dallime terminologjike dhe eseniale, këto dy teza shprehin status quo-në e njëjtë orientuese të formulimit ideologjik në arsyetimin e masave dhe manovrave të politikës së jashtme.

Fukuyama versionin e parë të tezës së tij e ka shkruar në atmosferën më të lartë optimiste gjatë kolapsit të regjimeve socialiste, të simbolizuara në shkatërrimin e murit të Berlinit. Ai ka shpallur fitoren përfundimtare të demokracisë liberale dhe ka pohuar se ajo “ndoshta

¹ Dr. Ahmet Davutoglu është profesor inordinar i univerzitetit të Marmarasë në Stamboll. “The Clash of Interests: An Explanation of the World (Dis)order” në *Perceptions: Journal of International Studies* 2 (Dec.’97-Feb.’98), no.4, pp.92-122. Dhe *Intellectual Discourse* 2 (1994), no2: 107-30.

² Fukuyama, Francis (1992), *The End of History and the Last Man*, New York: The Free Press.

³ Huntington, Samuel (1993), “The Clash of Civilizations”. *Foreign Affairs* 72, Summer, pp. 22-49.

paraqet të arriturat më të fundit në evolucionin ideologjik njerëzor dhe formën përfundimtare të pushtetit të njeriut, që, si e tillë, paraqet fundin e historisë.”⁴ Simbas kësaj teorie, fosilizimi përfundimtar i kulturave dhe qytetërimeve të tjera, si barazpeshë e fundit të historisë, është e pashmangshme, sepse “kultura /në aspektin e kundërshtimit të transformimit të vlerave të caktuara tradicionale në demokratike/ mund të bëhet pengesë në demokratizimin.”⁵ Kjo qasje është bërë pararojë intelektuale dhe kredo e pagëzimit sekular të demokracisë universale të luftës kryqëtare në emër të Rendit të Ri Botëror. Krijuesit e politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara këtë teori e gjetën të pranueshme, sepse kjo gjatë Luftës së Gjirit siguroi retorikën e nevojshme politike, të domosdoshme për mobilizimin e tërë botës për arritjen e planeve të tyre strategjike në atë luftë.

“Bota e lirë” si parullë e luftës së ftohtë ka ndryshuar me “Bashkësinë Ndërkombëtare” në periudhën e pasluftës së ftohtë. Idetë e globalizmit dhe zhvillimit teknologjik përdoren /ose keqpërdoren/ për planifikim strategjik.

Teza e Fukuyames, e cila shenjtëron universalizimin e vlerave politike dhe strukturave të qytetërimit perëndimor, ka ofruar perspektivën themelore në vlerësimin e çështjeve politike në periudhën postsovjetike dhe paraboshnjake. Kriza e Bosnjës ka spikatur fundin e “fundit të historisë”. Ajo ka zbuluar mungesën e qytetërimit perëndimor si dhe çrregullimet në rendin ekzistues botëror. Kjo situatë e re kërkoi kornizë të re analitike. “Përplasja e qytetërimeve” e Huntingtonit tenton të ofrojë atë kornizë.

Në dallim nga Fukuyama, Huntingtoni nisët nga supozime të ndryshme. Ai nuk mbështetet në grupin e vlerave universale ose në rendin botëror. Ne vend të tyre, ai tenton të analizojë parregullsinë ekzistuese politike në tentim për t’i identifikuar zonat e konflikteve. Aty ku Fukuyama theksonte universalizimin e vlerave të pashmangshme dhe të pandaluara të Perëndimit, Huntingtoni tenton të sqarojë proceset alternative qytetëruese që mobilizojnë masën në aksion politik dhe konfrontim. Retorika ambicioze dhe idealistike e Fukuyames lë hapësirë për retorikë realistike e të kujdesshme të Huntingtonit.

⁴ Fukuyama, *End of History*, p. xi.

⁵ *Ibid.*, p. 215.

Retorika e ndryshuar reflekton ndryshimet e lindura në arenën e politikës ndërkombëtare në pesë vjet, që kanë treguar se shpallja e “fundit të historis” ishte e nxituar.

Përderisa Fukuyama për të përforcuar argumentimin e vet gjen mbështetje në filozofinë e Hegelit, Huntingtoni e kërkon këtë në historinë e qytetërimit, edhe pse të dy shfrytëzojnë të njëjtën metodologji selektive, kur citojnë filozofinë dhe historinë. Kjo qasje selektive duket se nuk paraqet gabim metodologjik. Më parë bëhet fjalë për preferencë teorike e që është e lidhur drejt me misionin që qëndronë pas tezës. Huntingtoni mohon karakterin hegjemonist të qytetërimit perëndimor në formimin e trendeve intelektuale/filozofike globale, kodeve të sjelljeve socio-kulturore dhe të rendit ndërkombëtar. Ky është shkas për të cilin ai fajëson qytetërimet joperëndimore për krizat dhe konfliktet ekzistuese. Ai shpërfill faktin se *Lebenstraumi* (hapësira e jetesës) i këtyre qytetërimeve ishte efektivisht i marginalizuar me paradigmen hegjemoniste të qytetërimit perëndimor.

Huntingtoni, gjithashtu shpërfill faktin se luftërat më shkatërruese globale të historisë njerëzore kanë qenë luftëra brendaqytetëruese ndërmjet fuqive sistematike evrocentrike të qytetërimit perëndimor, të cilat kanë qenë “luftëra të zhvilluara për të vendosur se kush do të jetë lider sistemor, rregullat e kujt do të sundojnë, politikat e kujt do t’i formojnë proceset sistematike dhe vizioni ose botëkuptimi i rendit të kujt do të mbizotërojë.”⁶ Thompsoni, duke shfrytëzuar informatat që kishte mbledhur J. Levy,⁷ konstaton se /luftërat globale që sollën më shumë se 280.000 të vdekur në fushëbeteja/ ndërmjet fuqive sistematike përgjegjëse për gati katër të pestat (4/5) e viktimave të luftës në luftërat ndërmjet Fuqive të Mëdha Perëndimore. Thëksimi i përlëshjeve rajonale ndërqtetëruese mund të lërë jashtë vështrimit disa faktorë shumë të rëndësishëm pas këtyre përlëshjeve, të cilat dalin prej garave ndërmjet qendrave të fuqisë mbrendasistimore.

Këto dy qasje të kundërta në lidhje me rolin e qytetërimit në punët politike /ai i Fukuyames që identifikon qytetërimin perëndimor me

⁶ Thompson, William (1988), *On Global War: Historical-Structural Approach to World Politics*, Columbia: University of South Carolina Press, p. 7.

⁷ Levy, Jack S. (1983), *War in the Modern Great Power System, 1945-1975*, Lexington: University Press of Kentucky, p. 96.

fatim e gjinisë njerëzore ose historinë njerëzore, spikat rolin e këtij qytetërimi, dhe i dyti, ai i Huntingtonit, i cili e liron qytetërimin perëndimor nga gjeneruesi i konflikteve dhe krizave/ realisht janë pjesë të së njëjtës fotografi. Huntingtoni kompletion fotografinë që e ka skicuar Fukuyamen duke u ofruar forcave hegjemoniste arsyetimin teorik për të gjitha strategjitë e domosdoshme politike dhe ushtarake për kontrollin dhe paraformimin e sistemit ndërkombëtar: vlerat perëndimore dhe struktura politike kanë universalitetin e lindur dhe të papërballueshëm (Fukuyama), ndërsa qytetërimet e tjera janë ato që janë përgjegjëse për kriza politike dhe konflikte (Huntingtoni). Polarizmi i Huntingtonit në “Perëndimi kundër të tjerëve” (the West versus the rest) është refleksion politik i kësaj fotografie. “Të tjerëve”, supozohet se do t’u duhen gjithmonë udhëzime perëndimore për të arritur deri në fundin e historisë dhe për të kapërcyer parregullsinë (jo rendin) e shkaktuar për shkak të konfliktit gjeokulturor. Kjo është krejtësisht e sigurt, ringjallja e shpirtit të kolonializmit fundamentalist të Rudyard Kiplingut, të shprehur në termat ‘detyrat e njeriut të bardhë’ që paraqet pasojën natyrore të asaj që Arnold Tynbee e përshkruan si “iluzion egocentrik.”

Ekzistimi i iluzionit të tillë është dukshëm në lidhje me Huntingtonin, i cili e vendos ndërmjet analizës së tij teorike të konfliktit qytetëruar dhe porosive të tij strategjike për politikanët perëndimorë. Mbështetja e tij tek vetëdija qytetëruese (civilisation consciousness)⁸ në analizimin e konfrontimeve politike dhe ushtarake është sqarim i saktë, por i pjesshëm. Nuk ka dyshim, kolapsi i sistemit sovjetik ka shkatërruar pseudoidentitetet si edhe frontet pseudopolitike të sistemit bipolar ndërkombëtar. Mirëpo, ky vakuum që plotësuar me identitete kulturore/historike që u bënë faktor mbizotërues i mobilizimeve politike dhe konfliktit ndërqytetëruar. Ky fakt nuk mund të bëjë t’i shpërfillim faktorët e tjerë siç janë gara strategjike ndërqytetëruese ndërmjet fuqive perëndimore, prioritetimi gjeopolitik, lufta tregtare për kontrollimin e politikës ekonomike ndërkombëtare etj.

Komponentet themelore të analizës alternative të jostabilitetit politik në periudhën e pasluftës së ftohtë janë këto: I) fundi i stabilitetit

⁸ Huntington, “Clash of Civilizations”, p. 26.

strategjik, II) vakuumi gjeopolitik dhe gjeoekonomik i fuqisë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikën ekonomike ndërkombëtare, III) paraqitja e identiteteve autentike pas shpërbërjes së pseudofronteve të bipolarizmit, IV) gara ndërqytetëruese dhe ndërsistimore.

Gjeopolitika dhe ekologjia e sistemit politik global

Ka një ndryshim të vazhdueshëm në strukturën e fuqisë të sistemit ndërkombëtar, duke përjashtuar parametrat e saj globalë gjeopolitikë. Bizmarku ka thënë me të drejtë se konsonanta e vetme në politikën e jashtme është gjeografia. Korrelacioni ndërmjet ekologjisë së sistemit politik global dhe marrëdhënieve ndërshtetërore është fakt. Gjeopolitika ka luajtur rol të mjaftueshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare si shkak fundamental i krizave dhe luftërave ndërkombëtare dhe si faktor vendimtar i përshtatshmërisë së re të sistemit ndërkombëtar. Faktorët gjeopolitikë të paraluftës, të cilët sollën luftërat në këtë periudhë të pasluftës shfrytëzohen nga fituesit për përshtatshmëri të re ndaj sistemit të ri botëror. Kjo ndodhi në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, sikurse edhe në periudhat para dhe pas luftës së ftohtë. Siç vëren me të drejtë Cohen: "Kjo botë është e organizuar politikisht në mënyrë racionale, e jo në mënyrë të paqëllimtë".⁹ Këtë argument do ta mbështetë analiza e shkurtër e teorive gjeopolitike.

Duke marrë parasysh se ekziston lidhja ndërmjet ekologjisë së sistemit të politikës globale dhe marrëdhënieve ndërshtetërore, marrëdhënie konsistente dhe kompatible ndërmjet teorive gjeopolitike dhe strategjive të fuqive hegjemoniste kanë ekzistuar gjithmonë. Sipas kësaj, gjeopolitika është faktori themelor dhe tregues i ndërrimit të fuqisë në politikën globale, posaçërisht gjatë momenteve kritike të historisë moderne. Vështrimet gjeopolitike dhe sugjestionet gjeostrategjike të admiralit Mahana¹⁰ në kapërcyellin e shekullit 20 janë bërë parime fundamentale, të shfrytëzuara nga ana e forcave detare anglo-amerikane (atlantike) për kontrollimin e lokacioneve strategjike për

⁹ Cohen, Saul B. (1973), *Geography and Politics in a World Devided*, New York: Oxford University Press, p.iv.

¹⁰ Shiqo Glassner, Martin Ira (1993), *Political Geography*, New York: John Wiley, p. 225.

hegemoninë globale. Sugjestionet e tjera të Mahanait, nga ana e kreatorëve të politikës janë pranuar si gurë shënues të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara: I) okupimi i Havajeve, II) kontrolli mbi Karaibet, III) ndërtimi i kanalit që do të lidhte oqeanin Atlantik me oqeanin Paqësor, IV) mbajtja e luftërave larg nga bregdeti i SHBA-së, V) zhvillimi i federatës për ndalimin e zhvillimit ndikues të ndonjë shteti (contionment). Tri sugjestionet e para janë zbatuar, kurse dy të fundit mbeten parime të përhershme gjeostrategjike të politikës së jashtme të SHBA-së. Disa parashikime të tjera të Mahanait, si ato që i përkasin luftës ndërmjet fuqisë tokësore ruse (Evroazisë) dhe fuqisë detare britaneze (Atlantikut), rëndësia e Singapurit si bazë kryesore detare dhe interesi i përbashkët i SHBA-së, Britanisë së Madhe, Gjermanisë dhe Japonisë për parandalimin e zgjërimit të Rusisë dhe kontrollimin e Kinës, gjithashtu janë treguar të sakta.

Teoria e Makinderit e 'Heartland'-it (Vendit qendror) ka qenë tentim i riformulimit të traditës britaneze të politikës së jashtme në përpjekjet për t'i aftësuar, për të tejkaluar nxitjet strategjike të Gjermanisë, e cila ka anuar kontrollin e vendit qendror të Evropës, si bërthamë e kontinentit evropaziatik dhe si vend i pakapur nga fuqia detare, do të mund të mbrojë fuqinë tokësore, e cila mund të zotërojë botën nga kulla e vet kontinentale. Ky vend qendror është i rrethuar me gjysmëhënën e brendshme të ishujve dhe kontinenteve mbrapa Evropës. Makinderi më 1919 Heartlandin e zgjeroi deri tek Azia Qendrore dhe e levizi në lindje te lumi Yenisei më 1943 duke e quajtur Lenaland.¹¹

Formula e tij e njohur gjeopolitike për dominim në politikën globale /"Kush sundon Evropën Lindore, sundon Heartlandin; kush sundon Heartlandin, sundon Ishullin botëror; kush sundon Ishullin botëror sundon botën"/ ishte shumë ndikuese në formimin e hartës së Evropës pas Luftës së Parë Botërore. Shtetet fitimtare krijuan shtetet-tampon që të ndanin Gjermaninë dhe Rusinë që Gjermaninë ta mbanin më largë Hertlandit të Evropës Lindore, që të parandalonin bashkimin e Evropës Lindore dhe Heartlandit në duart e njërës nga këto dy

¹¹ Mackinder, Halford J. (1943), "The Round World and the Winning of the Pace", Foreign Affairs 21, pp. 593-605.

fuqi kontinentale. Parashikimi i tij, i thënë më 1924,¹² që potenciali i Heartlandit në të ardhmen mund të bëhej i balansuar me Evropën Perëndimore dhe Amerikën Veriore (North Atlantic / Midland Ocean) mund të merret si inspirim i parë i politikës së luftës së ftohtë.

Lufta e Dytë Botërore ishte luftë gjeopolitike. Teoria e K. Haushofferit mbi bllokun transkontinental si aleancë Gjermani, Rusi dhe Japoni ishte aleanca më gjithëpërfshirëse e fuqive kontinentale kundër koalicionit të fuqive detare të themeluara në dominimin detar anglo-amerikan. Kjo gjeostrategji evroaziatike ishte themelim teorik i aleancës Gjermano-Ruse të vitit 1939. Haushofferi së fundi propozoi koalicionin panrajonar ndërmjet Evroazisë Gjermane dhe rajonit Japonezo Indo-pacifik. Krahas mossuksesit të idesë së Haushofferit për bllokun transkontinental, sidomos pas sulmit të Hitlerit kundër Bashkimit Sovjetik, parashikimi i tij i ndarjes panrajonale në tri zona të veçanta të fuqisë, në vështrim të gjeopolitikës dhe ekonomisë politike, secila me bërthamën e vet të veçantë. (Evropa, Japonia, dhe Anglo-Amerika) dhe periferitë (Afrika dhe India, Azia Lindore dhe Juglindore, dhe Amerika Latine) mbetet shumë me rëndësi në gjeopolitikën e tashme dhe politikën e ekonomisë ndërkombëtare.

Shkaku gjeopolitik për sulmin e Hitlerit mbi Bashkimit Sovjetik në qershor 1941 qe ambicia e tij që të vendoste kontroll të plotë mbi Heartlandin dhe Evroazinë. Plani i tij gjeostrategjik ishte që të dilte në Gjirin Persik nëpërmjet Kaukazit dhe të arrinte në Indi nëpër Azinë Qendrore dhe Afganistan. Ashtu do të materializohej lidhja historike B-7 e gjeostrategjisë Gjermane (Berlini, Budapesti, Bukureshti, Beogradi, Bosfori, Bagdadi dhe Bombai) kundër fuqive kolonialiste detare. Ky plan ambicioz mund të ishte realizuar me koalicion ndërmjet fuqisë kryesore detare (SHBA) dhe fuqisë tokësore Heartlandit (BRSS) në realitetin gjeopolitik të cilët shtynë në plan të dytë dallimet ideologjike.

Mirëpo realitetet e njëjta gjeopolitike, krijuan sistemin bipolar ndërkombëtar të arsyetuar me dallime ideologjike. Versioni i modifikuar i Spykmanit i teorisë së Makinderit për Heartlandin, u bë bazë gjeopolitike amerikane e mbylljes dhe izolimit të Bashkimit Sovjetik,

¹² Mackinder, Halford J. (1924), *The Nations of the Modern World*, London: George Philip & Sons, p. 251.

që ishte brengë permanente gjeopolitike e politikanëve në Uashington. Spykmani vërtetonte që potenciali i vërtetë i fuqisë së Evropës gjendej në atë që Mackinderi e ka quajtur Gjysmëhëna e Brendshme, ose Margjinale (Inner or Marginal Crescent), e jo në Heartland. Ai këtë sipërfaqe e quajti Rimland potencial (Toka e Skajit) dhe erdhi me formulë të re: Kush e kontrollon Rimlandin, e sundon Evropën; kush sundon Evropën, kontrollon fatin e Botës.¹³

Politika Amerikane e izolimit të Bashkimit Sovjetik kishte për qëllim kontrollin mbi këtë Rimland që të neutralizonte fuqitë e Heartlandit, që atëherë kontrollonin sovjetikët. Kjo politikë ishte e themeluar mbi një alancë: NATO (prej Norvegjisë deri në Turqi), CENTO (nga Turqia deri në Pakistan) dhe SEATO (prej Pakistanit deri në Filipine në lindje dhe në Zelandën e Re, në jug). Tentimet e Bashkimit Sovjetik që të shpërthente këtë rrethim në Rimland dhe tentimet e SHBA-së që të mbante BRSS-në në Heartland sollën shumë luftëra brendashtetërore dhe ndërshtetërore gjatë luftës së ftohtë. Por, të dy shtetet synonin t'i shmangeshin konfliktit direkt ushtarak. Mossuksesi i tentimit të fundit të BRSS-së, në Afganistan, për të vendosur një kontroll të vazhdueshëm mbi kalimet më rëndësi (Khuber, Gomal dhe Khojak) nga Heartlandi në Rimland, shkaktoi kolapsin e njohur gjeopolitik të sistemit sovjetik.

Alternativa tjetër, e cila duhej të balancoje pozicionin strategjik superior të BRSS-së në Evropë, është largimi i nuklear bërthamor (deterrence). Vendimmarrësit në SHBA shfrytëzuan këtë teori për të arsyetuar zhvillimin e projekteve bërthamore. Parametrat konvencionalë të strategjisë së garës vazhdojnë të jenë faktor me rëndësi për faktin se balancimi i njëjtë i kthimit bërthamor ka krijuar baraspeshën e frikës e cila, në një anë, i ka paraprirë luftës bërthamore ndërmjet superfuqive, e në anën tjetër ka eskaluar luftërat konvencionale rajonale pa rrezik të madh për konfrontime ndërmjet superfuqive. Rritja e numrit të konflikteve të intensitetit të ulët (Low Intensity Conflicts-LICs) të përkrahur nga ana e SHBA-së në këtë periudhë, është tregues me rëndësi ndikimi të vazhdueshëm të garës strategjike konvencionale, krahas ekzistimit të largimit nuklear global. Pesëdhjetë konfliktet të intensite-

¹³ Spykman, Nicholas (1944), *The Geography of Peace*, Harcourt, Brace, New York, p. 43.

tit të ulët në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, reflektojnë prioritetet gjeopolitike të SHBA-së: 60% të këtyre konflikteve janë zhvilluar rreth mosmarrëveshjeve në lidhje me Rimlandin e Evropës Lindore (24% në Lindjen e Afërt, 30% në Azinë Lindore dhe 6% në Evropën Lindore); 32% të tyre janë zhvilluar në Hinterlandin amerikan (brapa shpine) (12% në Amerikën Qendrore, 8% në Amerikën Jugore dhe 12% në Karaibe); 8% e tyre ishin në Afrikë, sidomos në Afrikën Veriore, e cila është më së afëri me Rimlandin e Evropës.¹⁴

Fundi i stabilitetit strategjik

Pas bipolaritetit të luftës së ftohtë ekzistonte një racionalitet gjeopolitik, i cili krijoi baraspeshë gjeopolitike ndërmjet 'Botës detare të varur nga tregtia' dhe 'Fuqisë kontinentale evropaziatike'.¹⁵ Krahas ekzistimit të tensioneve ndërmjet superfuqive, kjo baraspeshë prodhoi stabilitet strategjik dhe nuk la shpresë për ndonjë premi nga fillimi i konfliktit. Ky stabilitet ka siguruar një mekanizëm të kontrollit racional mbi vendet strategjike më të ndjeshme. Marrëdhëniet ndërmjet superfuqive ishin konfrontuese drejtpërdrejtë vetëm kur ky stabilitet

¹⁴ (I) Tridhjetë konflikte të këtuja të intensitetit të ulët kanë ndodhur në Ramlandin evropaziatik: dymbëdhjetë në Lindjen e Afërt (BRSS 1946, Palestinë 1948, Iran 1951-53, Liban 1958, Jordani 1970, Irak 1972-75, OPEC 1974-75, Iran 1979, Siri 1979, Afganistan 1980, Liban 1982-84, Gjiri Persik 1987-88); katërbëdhjetë në Lindjen e Largme (Filipine 1942-45, 1946-55, 1984, 1985-86, Birmani 1945, Kinë 1945-49, 1953-79, Indokinë 1946-54, Kore Veriore 1953, Vietnam 1955-65, Laos 1956-65, Tajlandë 1965-85, Kamboxhia 1975); gjashtë në Evropën Lindore dhe Mediteran (Greqi 1946-49, BRSS 1948, 1956, 1961, 1968 dhe Qipro 1974). (II) Gjashtëmbëdhjetë nga këta pesëdhjetë konflikte të intensitetit të ulët kanë ndodhur në Hinterlandin amerikan: gjashtë në Amerikën Qendrore (Guatemalë 1953-54, 1965-74, Nikaragua 1978-79, El Salvador 1979, Nikaragua 1981-90, dhe Panama 1987-90, gjashtë në Karaibe (Kuba 1960, Republika Dominikane 1960-62, 1965-66, BRSS 1962, Granada 1983, Haiti 1985-86) dhe katër në Amerikën Jugore (Brazil 1951-64, Qile 1970-73, Bolivi 1980-86, Ishujt Filklende 1982). (III) Katër konflikte të intensitetit të ultë janë zhvilluar në Afrikë (Afrika Jugore 1960, Zair 1960-64, Libi 1970 dhe Angolë 1986). Detajet për këto konflikte mund të gjenden në Collins, John M. (1991), *America's Small Wars*, Washington: Brasseys.

¹⁵ Këto dy koncepte i kam huazuar nga Cohen, *Geography and Politics*. Simbas definicionit të tij bota detare e bazuar në tregti duke përfshirë të dy Amerikat, tërë Evropën Perëndimore, tërë Afrikën përveç pjesës verilindore dhe tërë ujdhesën e Azisë dhe Oqeaninë. Fuqia kontinentale e Evropës përfshirë tërë Bashkimin Sovjetik, Evropën Lindore, Azinë Lindore dhe të Brendshme.

strategjik do të sillej në rrezik nga tentimet e njëres nga superfuqitë që të zotëronte pika strategjike. Kriza raketore kubaneze (rikujtoi sugjestionin e Mahanit në lidhje me kontrollin mbi Karaibet), lufta e Koresë dhe e Vietnamit dhe invazioni Sovjetik në Afganistan (simbas teorisë së Spykmanit mbi Rimlandin) qenë vetëm disa shembuj të këtyre marrëdhënieve konfrontuese gjatë luftës së ftohtë.

Pasoja e drejtpërdrejtë e fundit e kësaj baraspeshe strategjike ishte monopoli strategjik nën udhëheqjen e SHBA-së, që tentoi ta përshtaste mekanizmin kontrollues duke u mbështetur mbi parime obliguese të Kombeve të Bashkuara. Lufta e Gjirit (Irak-Kuvajt) që ndodhia e parë me rëndësi në këtë proces të përshtatjes gjeopolitike të Status quo-së. Mirëpo, të njëjtat parime u shkatërruan në Bosnjë. Kombet e Bashkuara nuk e ruajtën integritetin territorial të anëtarëve të saj, dhe as pranuan të drejtën e atij shteti për vetëmbrojtje. Konflikti brenda-sistemit ndërmjet SHBA-së e Evropës, dhe mungesa e konsensusit ndërmjet fuqive evropiane për Bosnjën, paralajmëruan fundin e parullës së parakohshme 'Rendi i Ri Botëror'. Parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare dështuan në Bosnjë nga pragmatizmi i papërgjegjshëm dhe paragjykimet mesjetare evropiane.

Kjo konsekuencë e krizës boshnjake koïncidonte me dy ndodhi të rëndësishme në udhëkryqin e gjeopolitikës dhe ekonomisë politike ndërkombëtare. E para, qeveria e Shteteve të Bashkuara e hetoi që monopoli strategjik nuk do të thotë doemos kontroll i plotë mbi ekonominë politike ndërkombëtare, e cila caktoi përfitimin ekonomik dhe pjesëmarrje në forcat sistematike që garojnë. Çmimi i udhëheqjes ishte ai që monopoli strategjik nuk ndaloi zvogëlimin relativ të pjesëmarrjes amerikane në politikën e ekonomisë globale në krahasim me Evropën dhe Japoninë. Kjo krijoi pavendosmëri në qeverinë e SHBA-së që të luante rolin e policit në Rendin e Ri Botëror. Tërheqja e forcave të SHBA-së nga Somalia që pasojë e dytë e kësaj pasigurie. Periudha e tashme është ajo e transicionit ndërmjet stabilitetit strategjik bipolar dhe strukturës multipolare të baraspeshës së forcave.

E dyta, shumë fuqi rajonale tentuan ta shfrytëzonin mospërcaktueshmërinë e kësaj periudhe kalimtare që të vepronin në pajtim me interesat e tyre politike dhe strategjike. Shtimi i konflikteve rajonale

në periudhën e pasbosnjës është pasojë e natyrshme e këtij vakuumi gjeopolitik dhe gjeoekonomik.

Vakuumi gjeopolitik dhe gjeoekonomik.

Një nga faktorët me më rëndësi të pasigurisë në periudhën e pasluftës së ftohtë është ky vakuum gjeostrategjik dhe gjeopolitik. Fundi i bipolaritetit në sistemin e aleancave zvogëloi tensionet ndër superfuqitë, por prodhoi një vakuum të madh në zonën gjeostrategjike shumë me rëndësi, ku takohen Heartlandi dhe Rimlandi.¹⁶ Një përqi-ndje e madhe e krizave ushtarake dhe politike në periudhën e pasluftës së ftohtë ndodhet në këtë zonë, ku janë të vendosura kalimet nga Heartlandi në Rimland (p.sh., Ballkani, Kaukazi dhe Azia Qendrore) dhe pikat kyçe të bregdetit të Rimlandit (p.sh., Gadishulli Persik dhe Babu-l-mendeb / Deti i Kuq).

Përshtatjet strategjike dhe mekanizmat kontrollues të bipolaritetit të luftës së ftohtë u bënë të pavlefshme para se të gjendej zëvendësim më i mirë. Pikat strategjike të para të luftës së ftohtë, të cilat lindën si pasojë e luftës për baraspeshën e fuqive, përsëri shpërthyen në plan të parë në mungesë të vullnetit politik ndërkombëtar. Kalimet strategjike nga stepat aziatike nga Evropa dhe rrugët kalimtare nëpër Mediteran dhe detin Baltik u bënë qendra të konflikteve. Drava – Sava boshti ndërmjet Kroacisë, Serbisë dhe Bosnjës; Morava-Vardari bosht ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë; Karpitet dhe Transilvania ndërmjet Rumanisë dhe Hungarisë; Besarabia ndërmjet Moldavisë, Rusisë dhe Rumanisë, dhe kalimi i detit Baltik nëpër vendet baltike, janë vende problematike bazë e strategjisë në Evropën Lindore dhe në Ballkan. Të njëjtat vende kanë pasur prioritet strategjik në vrapi-min brenda-sistemor të fuqive të mëdha në shekullin e 19-të dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Një vakuum i ngjashëm politik është paraqitur edhe në Kaukaz, një kalim tjetër me rëndësi nga Heartlandi tek Rimlandi dhe detet e ngrohta. Ky rajon është i lidhur strategjikisht me Turqinë Lindore,

¹⁶ Komonuvolti i Shteteve të Pavarura është më shumë një sferë gjeopolitike e ndikimit sesa entitet real politik. Për këtë arsye pushtetarët ushtarakë politikë rusë kanë shpallur se kufijtë rusë fillojnë me kufirin afganistanezo-taxhekistanas.

Iranin Verior, Irakun dhe Gjirin Persik. Kjo lidhje strategjike me kushtet bipolare të periudhës së luftës së ftohtë, ishte e ndërprerë. Transkaukazi ishte nën kontrollin e Bashkimit Sovjetik përderisa Turqia dhe Irani Verior (deri në Revolucionin iranian) ishin në sferën e ndikimit të Bllokut perëndimor, duke penguar fuqinë kontinentale evro-aziatike që të arrinte tek resurset gjeoekonomike të Lindjes së Afërt dhe potencialet gjeopolitike të Rimlandit. NATO plani në lidhje me barrierat turke bënte mbrojtjen e krahut jugor, Iraku, atëherë aleat i sovjetikëve, luante rol me rëndësi në ballansimin e këtij blloku perëndimor. Dy ngjarje me rëndësi politike kanë ndikuar në mënyrë radikale në baraspeshën e luftës së ftohtë në këtë lidhje strategjike. Goditja e parë në parametrat bipolarë strategjikë të këtij rajoni qe Revolucioni iranian në vitin 1979, më luftën e parë të Gjirit ndërmjet Irakut dhe Iranit si reaksion strategjik në këtë gjëndje të re. Fuqitë rivale të luftës së ftohtë përkrahën Irakun për të pamundësuar çfarëdo ndryshimi të status quo-së në strategjinë e rajonit dhe patën sukses në përkufizimin e kapacitetit ushtarak e diplomatik të Iranit.

Goditja e dytë qe kolapsi i sistemit sovjetik si palë balancuese e strategjisë bipolare. Kjo pozitë e re strategjike u ofroi rastin fuqive rajonale ta përmbushnin këtë vakuum. Iraku, i cili gëzoi përkrahje ushtarake të fuqive sistimore në Luftën e Parë të Gjirit, tentoi të krijonte bërthamën e strategjisë së re me potencialin e vet ushtarak. Fuqitë sistimore shfrytëzuan këto ambicie të Sadam Hyseinit që të përformonte status quo-në nën udhëheqjen e Perëndimit, duke u bashkuar efektivisht krejt fuqitë rajonale kundër Irakut. Kjo nxiti Luftën e dytë të Gjirit, e cila rezultoi me kontrollin strategjik unipolar të SHBA-së mbi Gadishullin. Mirëpo Lufta e dytë e Gjirit krijoi një rend shumë të papërcaktuar krahas parullës së Rendit të Ri Botëror.

Rajoni prej Kaukazit Verior në veri, deri te Kuvajti në jug është përplot probleme ndërmjet territoreve të pranura ndërkombëtarisht dhe realitetit de facto. Iraku i ndarë, është në një situatë kaotike. Integriteti territorial i Irakut nuk është i garantuar, as Republika Autonome Kurde nuk është e njohur. Çështja kurde po bëhet krizë kronike pa zgjidhje. Një e pesta e territorit të Azerbajxhanit është nën invazionin armen derisa republika e Abhazisë dhe Çeçenisë kërkojnë njohje ndërkombëtare. Nuk ekziston mekanizëm ndërkombëtar ose vullnet që të

gjendet zgjidhje gjithëpërfshirëse për shkak të faktit se secila fuqi e madhe ka vizionin e saj lidhur me ardhmërinë e këtij rajoni shumë të ndjeshëm dhe të pasur. Ky rajon nuk përbën shtyllën strategjike kurri-zore të Evropës, por as zonë të resurseve gjeoekonomike. Potencialet e naftës në Azerbajxhan, resurset ujore të Turqisë Lindore, fushat e naftës së Kirkukut në Irakun Verior, Iran dhe Kuvajt, janë të lidhura strategjikisht dhe me rëndësi esenciale për tentimet e dominimit rajonal dhe global.

Kjo është edhe arsyeja e intensifikimit të atmosferës kaotike në rajon pas paraqitjes së vakuumit gjeopolitik dhe gjeoekonomik. Kinse konfliktet e ashtuquajtura kulturore dhe qytetëruese janë vetëm shkaqe minore për këtë atmosferë kaotike, sepse ky rajon është pjesë integrale e një qytetërimi të njëjtë, në emër të qytetërimit islam, me përjashtim të Armenisë dhe pjesëve të krishtere të Gruzisë. Problemi i Karabakut dhe invazioni i territoreve azere nga ana e forcave armene, është i vetmi konflikt i vërtet kulturor/qytetërues.

Vakuumi i tretë gjeopolitik është paraqitur në krahun jugor të Azisë Qendrore, e cila është nga territoret më të rëndësishme të përp-lasjeve ndërmjet fuqive kontinentale evropaziatike dhe fuqive detare të mbështetura në tregti, si edhe ndërmjet fuqive rajonale, siç janë: Kina, India dhe Pakistani. Daljet dhe korridoret e Heartlandit Qendror Azia-tik në Rimlandin rrethues janë linja të përkufizimit të luftës globale për zotërim duke filluar me luftën anglo – ruse për hegjemoni mbi këtë rrip të rëndësishëm gjeopolitik në shekullin 19. Afganistani me kalimet e tij (Khojak, Gomal, Khyber) dhe me korridorin (Wakehan) në Azinë Qendrore në luginën e Indit është zonë tampon në këtë luftë. Kjo tokë, të cilën e kishte shfrytëzuar Aleksandri i Madh, ka luajtur rol më rëndësi në Lojën e Madhe të shekullit njëzet dhe në luftën e ftohtë të këtij shekulli. Sulmi i Bashkimit Sovjetik në këtë zonë tampon më 1979, paralajmëronte rikthimin në luftën e ftohtë dhe mossuksesin e saj solli shkatërrimin e mbështetësit strategjik sovjetik në Azi.

Nga kolapsi i Bashkimit Sovjetik, Rusia tenton ta përforcojë linjën e mëhershme të ndarjes në Taxhikistan. Për atë qëllim Rusia intervenoi në luftën qytetare në Taxhikistan dhe në të njëjtën kohë kufirin afganistanezo-taxhikistanas e ka shpallur si kufi rus. Ky nuk mund të jetë argument valid ndaj territoreve të njohura ndërkombëtarisht. Mir-

ëpo, kjo tregon vlerën dhe ndikimin absolut të faktorit gjeopolitik krahas ndryshimeve në territoret ndërkombëtare. Rusia nuk dëshiron të braktisë sferën gjeopolitike të ndikimit që kishte arritur në shekullin e 19. Konfliktet territoriale indo-kineze dhe indo-pakistaneze reflektojnë gjithashtu domethënien e këtij rajoni. Kina, e cila momentalisht kontrollon kalimin e Mintakës, dëshiron të shfrytëzojë magjistralin Karakaer si rrugë kryesore strategjike në këtë rajon, përderisa India tentonë të intensifikojë kontrollin mbi Kashmirin kontravers. Luftërat qytetare në Afganistan dhe Taxhikistan, edhe tensionet e torturat e shtuara në Kashmir dhe Sinkjang, janë pasoja të këtij vakuumi gjeopolitik në këtë zonë shumë të rëndësishme për të ardhmen e konflikteve të fuqive evroaziatike. Gara e shtuar ndërmjet Fuqive të Mëdha dhe rajonale rreth pjesëmarrjes në resurset gjeoeconomike të Azisë Qendrore edhe më tepër komplikuan situatën kaotike në rajon dhe pasqyrohet në marrëdhëniet ndërkombëtare në formë të luftërave qytetare, të tendencave rajonale dhe manovrave taktike për krijimin e pozicioneve strategjike në rajon.

Të gjitha këto pika të nxehta vërtetojnë se fundi i strategjisë së balancit të luftës së ftohtë, të themeluar në bipolaritet, krijoi vakuum shumë të madh gjeopolitik dhe gjeoeconomik në zonën ku kalohet prej veriut nga jugu duke u kryqëzuar me rripin 'lindje-perëndim' të Rimlandit. Ky është shkaku i vërtetë i krizave politike dhe jostabilitetit në periudhën e pasluftës së ftohtë. Dallimet kulturore dhe paragjykimet historike që u ringjallën pas kolapsit të identitetit ideologjik të luftës së ftohtë bipolare, shfrytëzohen si justifikim për këtë garë strategjike. Bota myslimane, e cila është bërë fushë e takimeve dhe kryqëzimeve të këtyre dy fenomeneve, ringjalljes qytetëruese dhe garës strategjike po bëhet pikë bërthamë e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Bota myslimane

Kërcënimi i antisistemit apo viktime e konflikteve gjeopolitike?

Një teori karakteristike e periudhës së pasluftës së ftohtë është edhe prezantimi prej tyre i Islamit si nxitje fundamentale e periudhës së re. Fukuyama Islamin e sheh si një rrezik të madh për vlerat universale të liberalizmit:

Është e saktë se Islami përbën ideologji sistematike dhe koherente, ashtu si liberalizmi e komunizmi, me kodin e vet personal të moralit dhe doktrinën e drejtësisë politike sociale. Joshja nga ana e Islamit është potencialisht universale. Ai u drejtohet të gjithë njerëzve si njerëz, dhe jo vetëm anëtarëve të caktuar etnikë ose grupimeve nacionale. Dhe në të vërtetë, Islami e ka mundur/tejkualuar demokracinë liberale në shumë pjesë të Botës Islame, duke paraqitur kërcënim serioz ndaj praktikës liberale edhe në ato vende ku nuk ka ardhur në pushtet drejtpërsëdrejti. Menjëherë pas përfundimit të luftës së ftohtë në Evropë, pasoi nxitja e Perëndimit nga ana e Irakut për se vërtetohet se Islami ishte faktor.¹⁷

Huntingtoni Islamin e paraqet njësoj si qytetërim që është fajtori kryesor për konflikte me linja të mëdha historike të ndarjes në një anë, dhe si partner i koalicionit nxitës, i kthyer kundër Perëndimit, në anën tjetër:

Në Evroazi linja e ndarjes së madhe historike ndërmjet qytetërimeve është përsëri në flakë. Kjo vlenë sidomos për kufijtë e formuar në formën e gjysmëhënës së bllokut të nacionaliteteve islame që nga Briri afrikan deri tek Azia Qendrore. Dhuna gjithashtu ndodh edhe ndërmjet myslimanëve, nga njëra anë, dhe serbëve ortodoksë në Ballkan, hebrenjëve në Izrael, hindusëve në Indi, budistëve në Birmani dhe katolikëve në Filipine. Islami i ka kufijtë të përgjakur.¹⁸

¹⁷ Fukuyama, *End of History*, p. 45-46.

¹⁸ Huntington, *“Clash of Civilizations”*, p. 35.

Në këtë mënyrë krijohet lidhja ushtarake konfuçiano-islamike, e disenjuar që të promovojë gjetjen e armëve dhe teknologjisë ushtarake nga ana e anëtarëve të saj të nevojshëm për afrimin e kundërpeshës ushtarake ndaj fuqisë perëndimore. Kështu paraqitet forma e re e vrapimit në armatim ndërmjet vendeve islamo-konfuçiane dhe Perëndimit.¹⁹

Këto vëzhgime dhe realitete ekzistuese politike kërkojnë një vlerësim të pozicioneve strategjike të Botës Islame në periudhën e pasluftës së ftohtë. Para së gjithash, më duhet të hulumtoj për shkaqet e fshehta dhe faktorët që inkurajojnë politikanët e Fuqive të mëdha sistimore që t'i intensifikojnë operacionet ushtarake dhe strategjike në Botën Islame dhe që i nxitë teorikët politik që Islamin ta paraqesin si kërcënim ndaj rendit botëror. A posedon vërtet bota myslimane kapacitet politik, ushtarak dhe ekonomik që të zhvillojë strategji të pavarur, ose disa qendra të fuqisë dëshirojnë të krijojnë një armik të ri për justifikimin e operacioneve të veta strategjike e taktike?²⁰

Në kornizën e parametrave të dhënë të sistemit ndërkombëtar, është vështirë të vërtetohet se Bota Islame mund të zhvillojë strategji të pavarur globale si fuqi antisistimore që gëzon një lloj fuqie të zgjidhjes për inkuadrimin e saj në sistemin botëror. Përgjithësisht vendet myslimane janë të ranguara në shkallën e parafundit të sistemit ndërkombëtar. Duke shfrytëzuar kategorizime të ndryshme, mund të themi se vetëm fuqitë qendrore hegjemoniste /globale/ mund të kenë diçka nga luksi zgjedhës në procesin e prioritetit të planifikimit strategjik. Vendet myslimane ose janë pjesë e kategorive johegjemoniste ose periferike, të cilat domosdo përcaktojnë hapat e tyre strategjikë dhe

¹⁹ Ibid., p. 47.

²⁰ Formimi i polit armiqësor gjatë luftës së ftohtë na sjell të mendojmë seriozisht për opcionin e dytë. Pikëpamja tjetër e Wallersteinit është shumë interesante nga kjo perspektivë: "Të gjithë ne supozojmë shumë të gatshëm sikur të ndodhte ndryshimi në politikën e SHBA-së ndaj BRSS-së nga përshtatja në kohën e Ruzveltit deri tek armiqësitë e luftës së ftohtë në kohën e Trumanit dhe trashëgimtarët e tij. Mua më duket se politika e SHBA-së ishte gjithmonë e njëjtë ndryshe nga retorika. SHBA-ja e dëshironte BRSS-në staliniste me miniimperi, me kusht që ajo të mbetej mbrenda kufijve të vet të vitit 1945-48. Stalinistët i shërbenin SHBA-së si arsyetim ideologjik dhe çimento për hegjemoninë e saj në sistemin botëror." Shih: Wallerstein, Immanuel, "Marx, Marxism-Leninism and Social Experiences in the Modern World System", Thesis Eleven, Vol. 27, p. 46.

taktikë brenda kufijve të dhënë nga ana e strategjisë së forcave hegje-moniste. Vendet myslimane që kanë status pak më të mirë në këtë renditje, janë ato që pretendojnë të bëhen fuqi rajonale. Edhe pse këto fuqi rajonale kanë fleksibilitet më të madh, sidomos në planifikimin taktik, ato gjithashtu duhet të kenë kujdes për parametrat strategjikë të vendosur nga ana e superfuqive të mëdha.

Pse para disa strategjë tentojnë të formulojnë strategji të bazuar në supozimin e kërcënimit mysliman ndaj rendit botëror? Arsyeja kryesore janë potencialet gjeopolitike, gjeoekonomike dhe gjeostrategjike të botës myslimane dhe nevoja për justifikimin ideologjik të operacioneve strategjike dhe taktike, të ndërmarra për vënien e kontrollit mbi ato potenciale. Duhet të krahasojmë situatën globale të pasluftës së ftohtë me këto potenciale, për të zbuluar pse ekzistojnë vende të konflikteve në vendet myslimane.

Karakteristika e parë dhe më e rëndësishme e gjeopolitikës së Botës myslimane është fakti se ajo përbëhet nga pjesët më të rëndësishme strategjike të Rimlandit dhe Heartlandit. Kjo karakteristikë bart me vete shumë përparësi dhe mundësi strategjike, por edhe rreziqe strategjike për Botën myslimane. Para së gjithash, ajo Botës myslimane i siguron lokalitet shumë të volitshëm gjeografik për zhvillimin e strategjisë kontinentale dhe detare në të njëjtën kohë. Dobësia themelore e fuqive hegje-moniste në dy shekujt e fundit ishte në pronësi vetëm të atyre kapaciteteve gjeografike që mundësuan zhvillimin e strategjisë kontinentale ose detare. Për shembull, Britania dhe SHBA-ja kanë aplikuar kryesisht strategji detare, ndërsa Gjermania dhe Rusia janë detyruar të orientohen në strategji kontinentale të bazuar tek fuqitë tokësore. Ky fakt ka krijuar një balancë gjeostrategjik dhe konflikte të brendshme ndërmjet fuqive hegje-moniste rreth Botës Islame.

Spykmani ka insistuar në supremacionin gjeostrategjik të Rimlandit, sepse ky territor është i plagosur nga ana edhe e fuqive tokësore edhe detare, prandaj duhet të operohet në të dy aspektet. Për këtë qëllim rekomandon që Fuqitë Aleate duhet të konstatojnë strategjinë e pasluftës për pengimin - pamundësinë e konsolidimit të Rimlandit.²¹ Aq më tepër, ai ka porositur që forcat kryesore tokësore dhe detare

²¹ Spykman, *Geography of Peace*, p. 43; Glassner, Martin Ira & de Blij, Harm J. (1989), *Systematic Political Geography*, New York: John Wiley & Sons, p. 228.

(SHBA-ja dhe BRSS-ja) të bashkëpunojnë në kontrollin e vendeve të panënshtuara të Rimlandit për potencialet e këtyre vendeve që t'i zhvillojnë strategjitë multinacionale. Sipas kësaj, bashkëpunimi i pashpallur kundër Iranit në luftën iraniano-irakiane dhe koalicioni i shpallur kundër Irakut në Luftën e Gjirit, nuk habit aspak. Të dy supërfuqitë ushtarakisht kanë ndihmuar Irakun që ta pengonin Iranin në konsolidimin e Rimlandit në valën e revolucioneve. Pastaj së bashku kanë shkatërruar kapacitetin ushtarak të Irakut, i cili nga perspektiva gjeopolitike dhe gjeoekonomike, Irakut i siguroi një pozicion strategjik superior në qendër të Rimlandit.

Ç'nënkupton konsolidimi në Rimland, i cili është aq i rrezikshëm për fuqitë hegjemoniste klasike tokësore dhe detare? Ajo praktikisht do të thotë kontrolli strategjik ose bashkëpunimi strategjik i vendeve myslimane, sepse ato kontrollojnë plotësisht bërthamën qendrore të Rimlandit që nga lindja deri në perëndim, si kalimet veri-jug, prej Heartlandi tek detet e ngrohta nëpër Kaukaz, nga rripi jugor i Azisë Qendrore dhe Afganistani. Kështu, vendet myslimane në tërësi (Anadoli dhe Gadishulli Arabik) ose pjesërisht (Nënkontinenti Indian dhe Indokina) kontrollojnë ujdhesat dhe siujdhesat e rëndësishme (Qipro, Sumatra, Java, Borneo, Mindano) të cilët rrethojnë pikat e përshtatshme të Heartlandit evropaziatik ndaj oqeanëve.

Lokacioni gjeografik i këtillë, Botës myslimane i ka sjellë përparësi të mëdha duke i mundësuar të kontrollojë grykat e ngushta (choke points) të cilat ndajnë detet e ngrohta të botës, duke përbërë në të njëjtën kohë rrezik të madh të konkurrencës garuese mbrendasistimore. Tetë nga gjashtëmbëdhjetë grykat më të rëndësishme strategjike /kanali i Suezit, Babu-l-mendeb (dalje prej Detit të Kuq), ngushtica e Harmusit (dalja nga Gjiri Persik), ngushtica e Malakas (Malajzia-Indonezia), ngushtica Sunda (ndërmjet Sumatres dhe Javës), ngushtica Lombok (ndërmjet Balias dhe Mataramës), dhe Bosfori e Dardaneli (dalje nga Deti i Zi)/ janë nën kontrollin e plotë të vendeve myslimane, derisa njërin prej tyre (Gjibraltari) e ndajnë një shtet mysliman (Maroka) dhe një shtet evropian (Spanja). Kjo do të thotë që gati të gjitha grykat e ngushta në Evropë (me përjashtim të kanalit anglez dhe ngushticës daneze), si çelësa të Rimlandit, janë nën kontrollin e vendeve myslimane. Të tjerat /Kepi i Shpresës së Mirë, ngushticat

Torres dhe Tasmania (ngushtica që çojnë nga veriu dhe jugu i Australisë), kalimi i Magelanit, kanali i Panamasë, daljet nga Gjiri i Meksikës dhe detit Karaib/ janë shumë larg nga Heartlandi dhe Rimlandi që të luajnë rol vendimtar në sipërinë përfundimtare gjeopolitike në tokën e Evropës Qendrore.

Këto përparësi gjeopolitike mbështeten mbi resurset gjeoekonomike. Për shembull, vlerësimi i rezervave të naftës në botë (me miliarda barela) duket kështu:²² Lindja e Afërt 397,5, Amerika Latine 84,3, ish-Bashkimi Sovjetik 81,4, Afrika 56,2, SHBA-ja 35,6, Evropa Perëndimore 26,4, Australia 18,8, Kanadaja 7,4. Po të shtojmë rezervat e naftës të ish-republikave të Bashkimit Sovjetik me shumicë myslimane, del se Bota myslimane kontrollon më së paku dy të tretat e rezervave të naftës në përgjithësi në botë. Kontrolli musliman mbi disa minerale të tjera strategjike dhe resurse energjetike, siç janë: kromi, ari, gazi natyror dhe uranumi, krijon përqendrime të gjeopolitikës dhe gjeoekonomisë, të cilat terheqin vëmendjen e Fuqive të Mëdha në luftën e tyre në kohën e paraformimit të parametrave të dominimit global.

Kolapsi i sistemit Sovjetik ka forcuar pozicionin strategjik të Botës myslimane nga perspektivat, si vijojnë: I) bërthama dhe pjesa jugore e Heartlandit (Azia Qendrore) është e përbërë nga shumica shtete myslimane, që janë bërë të pavarura; II) kontrolli dhe ndikimi i Botës myslimane në kalimet prej Heartlandit tek brigjet e Rimlandit janë forcuar (posaçërisht nëpër Kaukaz); III) lidhja gjeografike e bashkësive të myslimanëve të Ballkanit (Bosnja-Shqipëria-Kosova-Maqedonia-Trakia Perëndimore) është bërë hyrje/afim e rëndësishme rajonale e myslimanëve nga Evropa; IV) gjeoekonomia e Botës myslimane është e përforcuar me resurset e shteteve myslimane të mëvetësuar tani. Kjo përfshin naftën, kobaltin dhe mineralin e hekurit në Azerbajxhan; naftë, metalet e ngjyrosura, kadmium, bizmut, talium, zink, bakrin dhe gazin natyror në Kazakistan;²³ qymyr, naftë, metale me ngjyrë dhe të rralla në Taxhikistan; naftë, gaz, qymyr, squfur, kalium, barium, magnezium, brom dhe jod në Turkmenistan; metale me ngjyrë,

²² Farrington, Hugh (1989), *Strategic Geography*, London: Routledge, p. 8.

²³ Bizmuti, kadmiumi dhe taliumi përdoren në elektronikë, në prodhimin e energjisë bërthamore dhe në përpunimin e raketave.

ar, thëngjill dhe gaz në Uzbekistan; zhivë, antimon, aluminium dhe zink në Kirgistan. Makinderi në teorinë e vet gjeopolitike ka paraqitur mendimin se Heartlandi përmban truall dhe minerale të njëjta me ato të Amerikës Veriore dhe sygjeron që këto rajone të bashkohen kundër Gjermanisë. E fundit, V) një shtet/vend i pavarur mysliman (Kazakistan) ka kapacitete dhe fuqi bërthamore.

Këto elemente gjeopolitike dhe gjeoeconomike të periudhës pas-sovjetike kanë konsoliduar kapacitetin multidimensional të Botës myslimane dhe kanë nxitur garën brendasistimore rreth këtyre rajoneve qendrore gjeopolitike. Analiza e krizës momentale politike sqaron rolin e këtyre faktorëve strategjikë në konfrontimet politike dhe ushtarake të cilat provokojnë dallime qytetëruese që të krijojnë jostabilitet dhe konflikte. Pozicioni jostabil ndërkombëtar i Botës myslimane si viktimitë e këtij vrapimi strategjik, është shembull ndriques i këtij argumenti. Kufijtë islamë nuk janë të përgjakur vetëm për shkak të armiqësive historike dhe qërim i hesapeve qytetëruese; në të kundërtën, do të ishte e pamundur të sqarohej Lufta e Gjirit apo kriza në Somali, ku ndodhi shpërndarja më intensive e potencialit ushtarak në periudhën e pasluftës së ftohtë. Teoria e Huntingtonit mbi përplasjet e qytetërimeve në rastin më të mirë, është vetëm sqarim i pjesërishëm që nuk përfill konfliktet brendasistimore ndërmjet fuqive hegjemoniste, që është faktori vendimtar në marrëdhëniet e tanishme ndërkombëtare.

Prezantimi i këtillë i botës myslimane si armik potencial, ka rezultuar me tri dukuri të lidhura për Botën myslimane. Ato në të vërtetë janë tentime ex post facto e racionalizmit. E para, ajo trimëron tendencat opsive politike në vendet myslimane. Fuqitë Perëndimore, të cilat promovojnë vlerat demokratike dhe mekanizma në pjesët e tjera të botës, në Botën myslimane përkrahin regjimet jodemokratike. Racionalizmi është i thjeshtë: sistemi demokratik në Botën myslimane mund të krijojë regjime islame me ndjenja antiperëndimore. Racionalizmi i tillë tregon qartë se motiv themelor prapa këtij prezantimi janë interesat e tyre politikë e jo vlerat demokratike. Elita e korruptuar ushtarako - politike në disa vende myslimane eksploaton këtë frikë dhe bashkëpunon me fuqitë sistimore globale të Perëndimit demokratik ashtu që të shkatërronte proceset demokratike në Botën myslimane.

Disa ngjarje politike të paradokohshme kanë vërtetuar dyshimet se Perëndimi ka kritere të ndryshme vlerash për pjesë të ndryshme të 'botës së mbetur'. Ky fakt jepet që të konfirmojë paradoksin algjeriano-haitian. Intervenimi ushtarak kundër procesit demokratiko - politik në Algjeri ishte përkrahur nga ana e qendrave perëndimore të vendosjes, përderisa intervenimi i njëjtë në Haiti nxiti reaksion të fuqishëm në aspektin e sanksioneve ndërkombëtare dhe intervenimit të KB. Ideali i restaurimit të procesit demokratik, i cili ishte arsyetim për intervenim ndërkombëtar në Haiti, nuk pati kurrfarë vlerash në rastin e Algjerisë. Kufiri i mjegullt ndërmjet suverenitetit nacional dhe intervenimit ndërkombëtar, është një nga zonat kritike ku vlerat dhe interesat bashkohen/kryqëzohen. Paradoksi algjeriano-haitian ka vërtetuar faktin se është me rëndësi interesi strategjik, dhe jo vlerat universale. Interesat strategjikë perëndimorë në ruajtjen e sistemeve politike jodemokratike kanë nxitur keqësimin e stabilitetit politik dhe fuqive hegjemoniste u kanë dhënë rast të mirë që të manipulojnë me këto konflikte të brendshme në interes të caceve të veta strategjike.

E dyta, represioni ndaj pakicave myslimane tolerohet vetëm si çështje e brendshme e atyre vendeve. Pakicave myslimane në Kashmir, Sanxhak, Kosovë e tjetërkund u është bërë e pamundur të gëzojnë universalitetin e vlerave demokratike pas krijimit të kësaj atmosfere anuese kundër Islamit. Të menduarit e tillë shkon aq larg, sa që ushtarët serbë të arsyetojnë vrasjet të myslimanëve dhe fëmijëve myslimanë me pohimin se në të kundërtën dy milionë myslimanë boshnjakë do të pushtonin tërë Evropën. Ata ishin të gatshëm të pohonin se përmbushnin misionin historik të mbrojtjes së Evropës nga fundamentalizmi islam.

E treta, koalicionet e caktuara ndërkombëtare janë formuar kundër rrezikut të mundshëm islamik. Senatori i Kongresit të SHBA-së dhe anëtar i Partisë Republikane, Larry Pressler, gjatë vizitës së tij në Indi në vitin 1992, pati insistuar që në Azinë Qendrore dhe Juglindore mund të paraqitet konfederata islame gati prej nëntë shteteve, e armatosur me bomba bërthamore, e do të kërcënonin Indinë dhe stabilitetin botëror. Analistët e strategjive ende tentojnë të japin prova se rripi i vendeve islame prej Turqisë, Iranit, Afganistanit dhe Pakistanit nëpër pesë ish-republikat sovjetike, mund të fillojnë rrugën

e fundamentalizmit islamik. Është interesante që i njëjtë rrip islam ishte përkrahur nga ana e SHBA-së, gjatë luftës së ftohtë si garantues i interesave strategjikë të SHBA-së para ekspansionit të ish-BRSS-së.

* * *

Paralelisht me këtë dukuri, Serbia kërkon bashkëpunim të gjerë nga Greqia në Ballkan, kurse Armenia tenton t'i provokojë ndjenjat fetare të fuqive të mëdha krishtere si të përfitojë përkrahjen e tyre për ekspansionin e saj ushtarak në territorin e Azerbajxhanit. Në të njëjtën kohë Izraeli e ndihmon Indinë në represionin e saj mbi lëvizjet popullore në Kashmir dhe Penxhab. Para pak kohësh Vladimir Zhirinovski shpalli "luftën e shenjtë të krishterë" pansllaviste kundër vendeve myslimane në rripin jugor të Rusisë, nëpër Ballkan, Kaukaz dhe Azinë Qendrore. Simbas kësaj, paragjykimet gjithëpërfshirëse kundër Botës myslimane, janë përkrahur nga kapaciteti i parathjeshtësuar i fundamentalizmit, e mbulojnë fundamentalizmin qartë antiislam, i cili nxit vendet fqinje të Botës myslimane prej Marokut deri në Indonezi, prej Bosnjës deri në Azinë Qendrore. Ky fundamentalizëm antiislam është shkaku themelor pse Bashkimi Evropian nuk mund të ketë sukses të bëhet pluralist dhe tolerant i mjaftueshëm që të përmbushë premtimin e vjetër 35 vjet që Turqinë ta pranojë si anëtare e tij, (që simbas analizës së Huntingtonit është vend i ndarë).

Aventurizmi strategjik ose renditja e drejtë globale

Vendet më kritike të jorendit politik në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare janë gjeopolitika dhe ekonomia politike ndërkombëtare. Po të analizojmë vendet e nxehta/konfliktuoze të politikës botërore dhe vendet e konflikteve ushtarake, do të vërejmë intensifikimin e tyre në rajonet që janë të rëndësishme nga këto dy perspektiva. Vendet ku takohen dhe ndërpriten këta dy faktorë janë vendet më të ndjeshme për paraqitjen dhe nxitjen e konflikteve. Fundi i bipolaritetit ka krijuar rajone të ndjeshme atje ku ekzistojnë vakuumet e fuqive. Mirëpo, është e nevojshme fuqi që të kontrollohen kapacitetet strategjike të vendeve qendrore gjeopolitike si edhe resurset e mëdha, ashtu si edhe kapacitetet prodhuese e tregtare të politikës ekonomike ndër-

kombëtare. Gara ndërmjet fuqive hegjemoniste brendasisteme në kontrollimin e këtyre zonave është arsyeja themelore e konflikteve ushtarake e politike, përplasjeve dhe aksidenteve që ndodhin në zonën strategjikut të ndjeshme, e cila është e plagosur ndaj dominimit global.

Prandaj Huntingtoni tekstin-librin e tij, i cili fillon me analizën historike dhe qytetëruese, e përfundon me sygjërimin strategjik për lidhësit politikë perëndimorë. Ai nuk ka për qëllim të kërkoj zgjidhje me rrugë të paqes të konflikteve ndërqytetëruese. Përkundrazi, ai sugjeron që politikanët perëndimorë të manipulojnë dhe ndonjëherë të nxitin konflikte për t'i siguruar interesat strategjike të qytetërimit perëndimor:

“Është e qartë, që interesi afatshkurtër i Perëndimit është të promovojë bashkëpunim sa më të madh dhe bashkim brenda qytetërimit të tij... të ndërmjetësorë për zvogëlimin e kapaciteteve ushtarake perëndimore dhe të ruajë superioritetin ushtarak në Azinë Lindore dhe Juglindore; të shfrytëzojë dallimet dhe konfliktet ndërmjet vendeve islame dhe konfuçiane...”

Në të vërtetë, ky pragmatizëm strategjik është faktor kryesor i shfaqjes së konflikteve politike dhe ushtarake. Ne kemi shumë shembuj të bashkëpunimit të qetë e dinamik dhe interaksionit ndërmjet qytetërimeve.

Koekzistenca pluraliste e qytetëruese ishte e arritur për shekuj në Spanjë, në Evropën Lindore dhe në Indi derisa interesat strategjike perëndimorë nuk filluan të funksiononin. Konflikti nuk është e vetmja formë e marrëdhënieve ndërqytetëruese. Konflikti fillon kur dallimet qytetëruese shfrytëzohen për realizimin e ndonjë caku strategjik.

Ky shfrytëzim strategjik i përplasjeve qytetëruese paraqet nxitje të vërtetë për sistemin ndërkombëtar. SHBA-ja ka rol vendimtar në tejkalimin e këtij problemi. Mirëpo, paqartësia e strategjisë globale të SHBA-ve në kohën e pasluftës së ftohtë, ka krijuar vakuume të reja të fuqisë, që ka rezultuar me kriza rajonale.

SHBA-ja ka tri opsione kur është fajala për zhvillimin e strategjisë globale për periudhën e pasluftës së ftohtë: Opcioni i parë është të rikonstruktojë sistemin e sigurisë kolektive duke i dhënë konsistencë e cila t'i rivedinojë parimet aksiomatike të rendit të drejt ndërko-

mbëtar. Tentimi i tillë kërkon konsensus global mbi kornizën/rrethet aksiologjike të asaj renditjeje ndërkombëtare, të cilën e ndajnë kultura dhe qytetërime të ndryshme. Konsensusi përëndimor, i cili ka qëllim që të pezullojë qytetërimin islam (me një të katërtën e popullsisë në botë në rrinin strategjik më me rëndësi të globit botëror), qytetërimin kinez (me një të katërtën e popullsisë në botë në pjesën ekonomikisht më dinamike të botës), qytetërimin japonez (me pjesëmarrjen më të madhe në ekonominë botërore, e cila kontrollon sistemin arterier financiar të politikës ekonomike ndërkombëtare) dhe qytetërimet tradicionale (të cilat janë të shkapërderdhura ngado nëpër botë), - nuk mund të arrijë rend dhe paqe të vërtetë globale. Dialogu gjithëpërfshirës qytetëruës, e jo pragmatizmi strategjik, i cili shfrytëzon konfliktin qytetëruës, është i nevojshëm për vendosjen globale legjitime të renditjes ndërkombëtare politike. Fundi i luftës së ftohtë ka ofruar një rast të mirë për një tentim të tillë global. Mirëpo ky rast është lëshuar për shkak të krizës ndërsistimore.

Opcioni i dytë është që të mbijë rolin e tanishëm të liderit së bashku me pragmatizmin strategjik të bazuar në prioritetizimin e intereseve nacionalë në mënyrë që zvogëlon rreziqet strategjike dhe shton interesat ekonomike. Ky opcion mund të implementohet nëpërmjet adaptimeve ndërsistimore që t'u përgjigjet nxitësve kryesorë sistematikë të politikës ndërkombëtare dhe strukturës ekonomike të fuqisë. Kjo do të thotë ringjallje e politikës konvencionale të baraspeshës së fuqisë, të lidhur strategjikisht me procesin politik dhe ekonomik të bisedimeve, gjithashtu edhe garave dinamike e afatshkurtra të politikës së jashtme, e cila do t'u përgjigjej lëvizjeve afatshkurtra dhe jostabilitetit rajonal. Ky opcion i shtyn kreatorët e politikës së jashtme të SHBA-së që të aplikojnë politikë efektive të federatës për përshtatjen e strukturës së fuqisë ndaj atmosferës së ndryshueshme ndërkombëtare në vend të një sistemi të fiksuar të bashkimit të periudhës së luftës së ftohtë.

Opcioni i tretë është ringjallja e politikës neoizoluese, e cila nënkupton strategjinë ushtarake mbrojtëse me mbrojtje konvencionale të kontinentit amerikan, ekonominë politike proteksioniste me tregun e madh, gjithashtu edhe politikën e jashtme të profilit të ulët në Evropë, e cila do të duhej t'i përshpejtonte konfrontimet strategjike të pa-

dëshiruara, por ndoshta edhe të pashmangshme. Kjo do të thotë praktikisht fundi i rendit politik dhe ekonomik ndërkombëtar të pasluftës, që ishte themeluar mbi supozimin e udhëheqjes së Aleancës Atlantike dhe SHBA-së.

SHBA-ja si fuqi politike udhëheqëse e qytetërimit mbizotërues në periudhën moderne nuk ishte efikase në zhvillimin e strategjisë konsistente gjatë kësaj periudhe kaotike. Tri etapat e ndryshme mund të identifikohen në analizimin e politikës amerikane në periudhën e pasluftës së ftohtë. Etapa e parë, nga rënia e murit të Berlinit (nëntor 1989) deri tek Lufta e Gjirit (janar 1991), ishte bazuar në retorikën e ‘Rendit të Ri Botëror’ si simbol i opcionit të parë. Mirëpo, kjo retorikë, nuk ishte e mbështetur me hapat e domosdoshëm të nevojshëm për përsheptimin e procesit të risistematizimit të renditjes globale. Faza e dytë ishte periudha kalimtare nga Lufta e Gjirit deri te Kriza e Bosnjës (prill 1992). Është vënë re ndryshimi në përdorimin e konceptit të ‘Rendit të Ri Botëror’ gjatë periudhës kalimtare. Ai është shfrytëzuar më parë si arsyetim i manovrave strategjike sesa bazë për risistematizimin humanist të renditjes globale. Kështu, opcioni i parë në këtë periudhë kalimtare që zëvendësuar me opcionin e dytë. Ky ndryshim është bërë i dukshëm gjatë fazës së tretë, e cila mund të quhet si periudha pasboshnjake. Mossuksesi i vetë parimeve themelore të sistemit të sigurisë kolektive që të mbrojnë integritetin territorial të Bosnjë e Hercegovinës si anëtare e Kombeve të Bashkuara, ishte pasojë e kësaj shmangieje ndaj pragmatizmit strategjik të fuqisë politike. Pavendosmëria e SHBA-së që të përzihet në çështjet evropiane, krahas gjenocidit të vazhdueshëm dhe agresionit, ka krijuar situatën më të papërcaktuar që nga Lufta e Dytë Botërore, e cila pati trandur parimet e renditjes ndërkombëtare. Kjo pavendosmëri komentohet si indikator i një shmangieje tjetër nga politika e fuqisë nga izolacionizmi, posaçërisht në çështje evropiane. Ky status i posaçëm i Evropës në aplikimin e parimeve të KB mund të merret si fund i rolit udhëheqës të SHBA-së në sistemin e pasluftës të sigurisë kolektive. E ardhmja e

Bosnjës e Hercegovinës nuk do të jetë vetëm e ardhmja e një shteti nacional. Ajo më parë do të jetë testim për qendra të reja të fuqisë së sistemit ndërkombëtar në periudhën e pasluftës së ftohtë.

Çështje me rëndësinë më të madhe për strategjinë e SHBA-së në një të ardhme të papërcaktuar do të vazhdojë të jetë mbajtje e statusit të tanishëm si lojëtar kryesor i sistemit të sigurisë kolektive. Ky cak kërkon realizimin e dy kushteve: I) zhvillimi i grumbullimit të vlerave në sistemin ndërkombëtar, në të cilin do të merrnin pjesë krejt nacionalitetet e botës pa marrë parasysh kulturat dhe qytetërimet e tyre të ndryshme; II) lëshimi pe dhe manipulimi i tensioneve të nxitura nga garat brendasistimore rreth zonave kritike të gjeopolitikës dhe ekonomisë ndërkombëtare.

Supozimi i parë dhe më i rëndësishëm i kushtit të parë është pranimi i së drejtës së ekzistimit të shumë identiteteve të ndryshme kulturore në atmosferën e bashkezistencës. Kriza e tanishme qytetëruese mund të jetë e tejkaluar vetëm me dialog dhe me shkëmbimin e lirë të vlerave. Monopolizimi njëkulturore është dilema themelore e qytetërimet perëndimor modern dhe ka sjellë shkatërrimin e qytetërimeve tradicionale. Ringjallja momentale e qytetërimeve tradicionale është reaksion ndaj këtij monopolizmi njëkulturore. SHBA-ja me dy krahët e saj /njërin në Atlantik me trashëgimi evropian dhe të dytin në Paqësor me sintezën aziatiko-amerikane/ duhet të preferojnë promovimin e dialogut të vërtetë qytetërues në vend të ofrimit të përkrahjes së kotë të luftës kryqtare të Perëndimit evropian kundër qytetërimeve tradicionale. Alternativa e fundit mundet, dhe madje nxit pasiguri vendore për shkak të krizës së identitetit amerikan ashtu sikur Amerika po bëhet shpejt shoqëri multikulturore. Për shembull, myslimanët tash po bëhen grupacioni i dytë fetar me madhësi në SHBA, përderisa amerikanët me prejardhje aziatike me prapavijë konfuçiane po forcojnë edhe më rolin e tyre në shoqërinë amerikane.

Bashkezistencat konfrontuese të bazuara në provokimin e dallimeve qytetëruese, siç janë Perëndimi kundër Islamit ose Perëndimi

kundër botës tjetër, nuk mund të kontribuojnë asgjë për paqen dhe sigurinë globale, dhe as në procesin e përshtatjes së sistemit ndërkombëtar. Gabimet në llogaritjet strategjike të bazuara në kategorizimet konfrontuese, do të vazhdojnë të jenë pengesa kryesore e paqes globale. Ambiciet kolonialiste dhe sentimentet antikolonialiste të shekullit të fundit, përsëri mund të paraqiten nga ky keqpërdorim strategjik i dallimeve qytetëruese dhe kjo së fundi do të jetë kundër interesave të Perëndimit, përgjithësisht, dhe SHBA-së posaçërisht.

Hegjemonia amerikane në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore është legjitimuar nëpërmjet menaxhmentit ndërkombëtar të periudhës së poskolonializmit, e formuluar me parimet e Wilsonit dhe e aktualizuar me Rezolutën e KB. Ringjallja e këtyre kategorizimeve kolonialiste do të paraqiste një goditje më të rëndë për hegjemoninë amerikane, e cila mbështetej mbi menaxhmentin e mbizotërimit global nëpërmjet organizatës ndërkombëtare, siç është OKB. Kjo për revansh parakupton pjesëmarrjen në të vërtetë jodemokratike dhe jo të barabartë, të kolonizuesit dhe vendeve të kolonizuara të periudhës kolonialiste. Treguesi i parë i kësaj vërsuljeje mund të jetë ndarja e një shteti suveren i pranuar nga KB në Bosnje, e cila praktikisht do të thotë kolaps i vetë parimit të këtij menaxhmenti ndërkombëtar.

Caku i dytë mund të arrihet vetëm nëse sistemi ekzistues i sigurisë kolektive përpunohet që të formulohet një mekanizëm i përkufizuar drejt dhe mirë për minimizimin e aventurizmit strategjik global dhe konfliktet ndërmjet fuqive brendasistimore. Fundi i balancit strategjik i luftës së ftohtë shoqërohej me një aventurizëm strategjik të limituar në disa rajone, siç është invazioni i Kuvajtit nga ana e Irakut për krijimin e Irakut të Madh dhe pastrimi etnik nga ana e agresorit serb për krijimin e Serbisë së Madhe. Ky aventurizëm i profilit të ulët mund të eskalojë lehtë deri në përmasa globale, nëse kjo tendencë do të ndiqet nga ana e një nga Fuqitë e Mëdha me potencial të madh ushtarak. Paaftësia e sistemit të sigurisë kolektive që të pengojë pastrimin etnik në Bosnjë (dhe në Kosovë, shënim i përkthyesit) shpërfaq

paaftësinë e SHBA-së dhe KB që të veprojnë në mbrojtjen e parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare kundër një aventurizmi të kurdisur strategjik në Evropë.

Konflikti brendasistemor ndërmjet Fuqive të Mëdha në Bosnjë ka pamundësuar çfarëdo aksioni kolektiv ose individual në Bosnjë për mbrojtjen e krenarisë së njeriut, karakteristika të respektuara në të gjitha qytetërimet njerëzore. Ringjallja e luftës globale gjeopolitike nuk mund të pengohet nëse është ushtarakisht fuqi e aftë e trimëruar nga kjo dobësi. SHBA-ja ndoshta duhet të bashkëpunojnë patjetër me vende joperëndimore, sidomos me shtetet myslimane dhe konfuçiane, të cilat tash kontrollojnë zonën e ndjeshme gjeopolitike - Rimlandin, kundrejt trendeve ultranacionaliste në Evropë dhe në Rusi, të cilat kanë ambicie strategjike të një blloku kontinental evroaziatik. Duhet të vihet në dukje se ky ishte shkaku i dy luftërave botërore vetëm në këtë shekull (fjala është për shek. 20, - shënim i përkthyesit.). SHBA-ja izoluar nën mbrojtjen bërthamore në kontinentin e Amerikës, nuk mund të jetë e sigurt nëse aventurizmi i tillë ri nisë në Evroazi, siç mund të parandihet nga personaliteti dhe deklarata e Vladimir Zhirinovskit.

Marrë nga “Znakovi Vremena” revistë për filozofi, religjion, shkencë dhe praktikë shoqërore, Sarajevë, pranverë 2001.

*Vol.4 numër 11, boton: Instituti shkencorokërkimor
“Ibn Sina” Sarajevë. Faqe 122-147.*

*Përktheu:
Nail Halimi*

Dr. Muhamet Pirraku

Lidhja e Dytë e Prizrenit sipas shkrimeve autentike të pjesëmarrësve

Mbështetur në frymën politike të shkrimeve autentike të pjesëmarrësve në *Kuvendin themelues*, më 16-19 shtator 1943, *Lidhja e Dytë e Prizrenit* është organizatë politiko-ushtarake kombëtare demokratike shqiptare. Sipas *Tahir Zajmit*, *Kuvendi themelues* punoi edhe më 20 shtator¹. Që këtej kjo datë ka hyrë gabimisht në historiografi².

Nuk qëndron as mendimi i shumë publicistëve se “*iniciativën për Lidhjen e Prizrenit e mori Xhafer Deva pas kapitullimit të Italisë fashiste*”³. Kjo ka një si mbështetje në konstatimet e *Ali Hadrit* se “*person kryesor në grupin inisiativ për thirrjen e Kuvendit themelues të Lidhjes së dytë të Prizrenit ishte Xhafer Deva, mbështetje e madhe e shërbimit informativ gjerman*”⁴.

¹ Lidhja e II e Prizrenit dhe Lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, 12, 44.

² Shih, Dr. M u h a m e t P i r r a k u, Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951, Prishtinë, 1995, 51; Dr. D a u r B i s l i m i, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë 1997, 102.

³ Kjo u theksua nga shumë autorë në Sesionin Shkencor të Lidhjes Kombëtare Shqiptare, Prizren, 21-22 shtator 2001.

⁴ Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945, Prishtinë, 1971, 333.

Në fille të qarta të *Lidhjes së Dytë të Prizrenit* na vë aktiviteti politik i veteranit të *Pavarësisë së Shqipërisë Rexhep Mitrovica*, nga fundi i korrikut 1943. Organi i Komitetit të Kosovës shënonte qartë këto fille të pakontestueshme: “Mbassi pat një shkëmbim të gjanë pikëpamjesh me një varg personalitetesh kosovare në Kryeqytet, nisej bashkë me disa shokë, për Prizrend ku, në lidhje me shumë atdhetarë të tjerë, do t’organizonte lëvizjen e mbrojtjes së Kosovës kundra çdo vale imperialiste...”⁵

Këta shokë të Mitrovicës ishin: *Qazim Bllaca dhe Muhamet Fra-shëri, ish-nënprefekt i Therandës (ish-Suharekë)*. Ishte koha kur pushtetit fashist italian po i trandej trualli nën këmbë në tokat shqiptare, pas largimit të *Benito Musolinit* nga posti i kryeqeveritarit të Italisë (25 korrik 1943). *Rexhep Mitrovica* me shokët u arrestuan më 2 gusht 1943, sapo arriti në “*Post blok*” të karabinierisë së Prizrenit. Një kohë u mbajtën në *Burgun Ushtarak* dhe në *Burgun e Qarkut* të Prizrenit. Të lidhur keq i dërguan në “*Komanda tapa*” në Shkodër e prej andej në *Burgun Ushtarak* të Tiranës dhe në Kampin e përqendrimit “*Porto-Romano*” afër Durrësit. Në birucat e këtij kampi do të pësonin edhe më keqe sikur të mos u qeshej fati nga ndihma që u ofronin të burgosurit më të hershëm: drenicasi *Idriz Ajet Gashi* dhe ferizajasi *Abdullah Musliu*, antifashistë të shquar. *Qazimi* do të lirohej në prag të kapitullimit të Italisë, me ndihmën e *Fejzi Alizotit*, kurse *Rexhepi* dhe *Muhameti* vetëm pas kapitullimit të Italisë fashiste, më 8 shtator 1943.

Në këto rrethana, ngritja e *Lidhjes së Dytë të Prizrenit*, për të marrë shqiptarët vendës në duar të veta mbrojtjen e kufijve etnikë të Kosovës dhe të *Shqipërisë* u shty deri në ditët e para të okupimit të plotë të *Shqipërisë Etnike* nga ushtria hitleriane. Realisht, më 9 shtator 1943, kryeministri i *Mbretnisë Shqiptare*, *Ekrem Libohova* i drejtoi kombit një *Thirrje* ku theksohej se qeveritë shqiptare nën okupimin italian ishin përpjekur “për rregull dhe bashkim vëllazëror”, në mënyrë që populli shqiptar “të dalë i pagjymtuar fizikisht dhe ekonomikisht nga ky konflikt i përbotshëm” - *Lufta e Dytë Botërore*⁶. Më 11 shtator 1943 *Këshilli Ministror i Shqipërisë* nën kryesinë e *Iljaz Agushit*, *Nënkryeministër* dhe *Ministër i Punëve Botore*, shpalli “*Pavarësinë e*

⁵ Dërgata e Tiranës në gji të Kuvendit, Kosova, nr.51-52-53, Tetor 1943.

⁶ Shih gjerësisht gazetën *Tomorri*, Tiranë, 10 shtator 1943.

plotë të Shqipërisë (...) me kufijtë që i caktojnë gjuha e gjaku". Në *Proklamatë*, midis të tjerash, saktësohej: "Qeveria merr të gjitha pushtetet sovrane deri sa të zgjidhet Asambleja e re..."⁷

Pikërisht në këtë ditë, më 11 shtator 1943, prefekti i Prizrenit, juristi *Asllan Isa Boletini*⁸, me anë të korrierit solli *Qazim Ramë Bllacën* nga Bllaca në Prizren, për të marrë pjesë në *Mbledhjen e Këshillit organizues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit*⁹. Sipas *Tahir Zajmit*, grupin iniciativ e përbënin: *Xhafer Deva, Musa Sheh Zade, Sheh Hasani, Tahir Zajmi, Lukë S. Mjeda, Qazim Bllaca e Pjetër Vuçaj*¹⁰. Sipas *Qazim Bllacës*, *Mbledhjen themeluese të Këshillit organizues* e kryesoi *Asllan Boletini*¹¹. Në të dhënat autentike të pjesëmarrësve në *Kuvendin themelues* ky *Këshill* quhet *Grup nisjatur i Kongresit të Prizrenit*. Në ditën e parë këtë *Këshill* e përbënin patriotët: *Sheh Musa Shehzade (kryetar), Shefqet Shkupi, Sheh Hasani, Asllan Boletini, Qazim Bllaca, Pjetër Vuçaj, Tahir Zajmi, Hevzi Meraku, Luk Simoni, Qemal Balila, Haxhi Fahriu dhe Sokol Dobroshti* (anëtarë)¹².

Rëndësia e ngjarjes shtyri që përgatitjet për mbajtjen e *Kuvendit themelues* të zhvilloheshin me shpejtësi. Më 14 shtator 1943 u ngrit, në Tiranë, *Komiteti Ekzekutiv i Përgjithshëm* me detyrën e *Qeverisë së Përkohshme* - të thirrte *Kuvendin Kombëtar të Shqipërisë* në shtrirje të tokave shqiptare etnike. Dhe, dy ditë më vonë në Prizren do të fillojnë punimet *Kongresi i Prizrenit* në rrethana të një atmosfere feste gjithëkosovare¹³. Ndërkaq, të dhënat e para për themelimin e *Lidhjes së Dytë të Prizrenit* i botoi "*Kombi*", më 23 shtatorit 1943¹⁴.

⁷ AQSH, F. 249/ Par. 39. D.l./542, f.1/1943.

⁸ U lind në Mitrovicë, më 1912. Mbaroi fakultetin e drejtësisë në Beograd. Veterani i NDSH-së, Zenel Kabashi, më 21 shtator 2001, në Sesionin për Lidhjen II të Prizrenit, e quajti "Diamanti i Boletinëve". Partizanët jugosllav e arrestuan në Drenicë, më 30 janar 1945, dhe e likuiduan mizorisht në Burgun e Prishtinës. Për jetën dhe veprën e tij, gjerësisht, M. P i r r a k u, Kallja e Çarshisë së Pejës nga italianët më 21/22 mars 1943, Gjurmime Albanologjike, SSHH 27-1997, Prishtinë 2000, 199-219.

⁹ Q a z i m B l l a c a, Informatë, Prizren, 22 dhjetor 1995.

¹⁰ Lidhja e II e Prizrenit dhe Lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, 35.

¹¹ Informatë, Prizren, 22 dhjetor 1995.

¹² Shih gjerësisht, Hapja e Kongresit, Kosova, nr.51-52-53, Tiranë, Tetor 1943, 3.

¹³ Në këtë kumtesë përdoret koncepti kombëtar për Kosovën në vitet e Luftës së Dytë botërore. Ky koncept mbulonte viset shqiptare jashtë Shqipërisë londinezo-versajase, për-

Informatori ishte pjesëmarrës në Kuvendin themelues, dhe ai saktesonte: *“Patriotë të njohur Kosovarë muerën inisiativën për të mbledhur një (Kongres të) Kosovës, Dibrës e të Strugës ku të çfaqej vullneti i përgjithshëm i banorëve të këtyne krahinave për bashkimin e përhershëm me Nanën Shqipni, dhe për sigurimin e këtyre krahinave prej çdo sulmi armik”*¹⁵.

Prandaj, *Lidhja e Dytë e Prizrenit* as u nis dhe as do të përfundonte si *Lidhje gjithëshqiptare*, as kopje e *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*. Plotësisht në pajtim me politikën antishqiptare kominterniste ishte edhe konstatim: *“Formimi i kësaj organizate është vepër e përbashkët e kuislingëve shqiptarë dhe shërbimit informativ gjerman”*¹⁶.

Korrespondenti i gazetës *“Kombi”*, pjesëmarrës në Kuvendin themelues, informonte lexuesit: *“Pika e parë e programit të bisedimeve përmban kërkesën e bashkimit të përhershëm dhe të pazgjidhshëm të të gjithë krahinave të banueme qysh prej mija vjetsh prej popullsinash shqiptare”*;

Pika e dytë e Programit “përmban bashkimin me Shqipni të krahinave të Mitrovicës, Vuçiternës, të Pazarit të Ri dhe të Senicës – toka shqiptare të kërcënueme nga shumë anë nga bota sllave”;

“Pika e katërt e bisedimit përmban formimin e një Komiteti Qendruer në Prizren me degzat e saj në të gjitha Prefekturat, Nënprefekturat dhe komunat e krahinave të Kosovës, Dibrës dhe Strugës, të cilat do të marrin përsipër organizimin ushtarak e politik të Kosovës”;

*“Pika e pestë e programit përmban mbledhjen e të gjitha dokumenteve historike, politike dhe diplomatike që forcojnë qënien shqiptare të tokave të lirueme, ashtu dhe ngjarjet dhe vuajtjet e pafund të banorëve të këtyne viseve në kohën e sundimit jugosllav si dokument në rasën e një paqie të arthme”*¹⁷.

katësisht *“Tokat shqiptare të shliueme nga Jugosllavia versajase”*, siç pretendonte administrata e Mbretnisë Shqiptare.

¹⁴ Organ i Komitetit Ekzekutiv të Përgjithshëm.

¹⁵ Rroftë Kosova Shqiptare, Kombi, Tiranë, 23 shtator 1943, l.

¹⁶ Dr. A l i H a d r i, Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945, Prishtinë, 1971, 333.

¹⁷ Rroftë Kosova Shqiptare, Kombi, Tiranë, 23 shtator 1943, l.

Një paraqitje të plotë dhe shumë besnike zhvillimeve në Kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit u bëri gazeta “Kosova” e Tetorit 1943. Ajo informonte opinionin: “Dita e lumnueshme e 16 Shtatorit 1943 gëdhinë tue gjetun Prizrendin të zbukuruem në një mënyrë të jashtëzakonshme me flamure kombëtare, me harqe ngadhënjimi, mbi të cilët zotnojnë figurat e të gjithë martirëvet dhe luftëtarvet ma të shquem të përpjekjevet kombëtare të popullit shqiptar”¹⁸.

Kuvendi themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit i zhvilloi punimet në Shkollën “Bajram Curri”. Atë e hapi kryetari i Këshillit organizues, Sheh Musa Shehzade, dijetar i madh dhe eminencë kryesore e Lidhjes së Dytë të Prizrenit¹⁹. Ai fuqimisht e sfidoi dhunën e pushtuesit italian dhe pasqyroi kundërvënien politike e të armatosur shqiptare kundër robëruesit italian: “Mbas shpartallimit t’ushtresë italjane, e cila, për katër vjet rresht, vrau, preu, rrenoi dhe shkrettoi, dogj e shkrumoi ndër vendet t’ona, tue zhvillue një veprimtari me të vërtetë shtypëse të njëj shtypësi pa farë skrupulli, problemi i jetës së Kombit t’onë, i së ardhshemes s’onë, paraqitet ma i ndërlikuem. Shkaku dihet prej të gjithëvet: Italkanët, siç e dini ju të gjithë, me gjithë përpjekjet t’ona të përbashkëta, nuk na lanë, tue na eliminue, tue na internue dhe tue na burgosun, asnjë mundësi organizimi për mbrenda, për të qenë gati, në mos tjetër, me i bamë ballë sulmevet tinzare t’imperialistavet sërbë, malazezë dhe grekë”.

Urtaku i madh Musa Shehzade rravijzoi qëndrimin politik shqiptar edhe ndaj pushtuesit gjerman. Atë e paraqiti qartë si pushtet të huaj, të imponuar dhe kalimtar dhe kërkoi që të shfrytëzohej për përfitimet e kombi shqiptar. Theksoi mençurisht: “Tash që kemi të gjitha mundësinat e njëj organizimi të përgjithshëm të fuqinave kombëtare, duhet që ta fitojmë, mbrenda njëj kohe të shkurtën, gjithë periudhën qi hum-

¹⁸ Hapja e Kongresit, Kosova, nr.51-52-53, Tiranë, Tetor 1943, 3.

¹⁹ Sipas Qazim Bllacës, më 22 dhjetor 1995: “Musa Shehzade në kohën e Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishte rreth 70 vjeç. Ai mori pjesë në Ngritjen e Flamurit në Kuvendin e Vlorës, më 28 nëntor 1912. Ishte patriot i madh. Partizanët e pushkatuan, midis të të parëve në Prizren, nga fundi i vitit 1944 ose në fillim të vitit 1945. Shoqërohej me një serb farmacist dhe në fillim e strehoi, por duket se tani e denoncoi. Nuk e nxorën në gjyq. Thonë se e pushkatuan në Gurorë në krye të Lumbardhit (ish Bistricë), ku pushkatuan shumë veta. La një vajzë dhe një djalë, Hysenin, farmacist dhe punëtor arsimit. Hyseni vdiq para 4-5 vjete dhe nuk la trashëgimtar”.

bëm gjatë së shkuemes së afërt (...). Duhet të mendojmë, pra, masat dhe mënyrat e mprojës s'onë për çdo gjasë dhe për çdo rrethanë. Qëllimi që do të frymëzojë përpjekjen t'onë, një përpjekje jete a vdekje, do të jetë një i vetëm; Sigurimi i njisisë s'onë ethnike”.

Kryetari i Këshillit organizues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Sheh Musa Shehzade, u dërgoi një mesazh të fuqishëm pushtuesve e copëtuesve të Shqipërisë Etnike më 1878, 1913, 1919 dhe 1941, duke theksuar: “Na po e shpallim haptas, nuk kemi as ma të voglin pretendim mbi asnjë copë tokë që nuk asht e jona. Duem, pra, vetëm gjithëçka asht tokë arbënore, e banueme prej njëj popullsije shqiptare. Prandaj, fqinjët t'onë nuk kanë shka druejnë prej nesh ...”²⁰

Anëtarët e tjerë të *Grupit organizues* para delegatëve do të spikatnin kërkesat për *programin* dhe për *statutin* e *Lidhjes së Dytë të Prizrenit*, që do të viheshin në rendin e ditës në ditën e dytë dhe të tretë të punimeve të *Kuvendit themelues*. Veterani i luftës për lirinë e Kosovës historike, *Shefqet Shkupi*, do të saktësonte: “Qëllimet janë ato që përmendi vetë Kryetari i jonë dhe që kanë lidhje të ngushtë me vullnetin e përbashkët të krejt Popullit të Kosovës, Dibrës, Strugës dhe Tetovës; don me thanë, pikë së pari, sigurimi i bashkimit të së gjitha këtyne Vendeve me Shqipërinë e Vjetër²¹, së cilës i përkasin nga çdo pikëpamje: nga ajo historike, nga ajo gjeografike dhe nga ajo etnografike; së dyti, për të sigurue plotësimin e njisisë s'onë ethnike tue përfshimë në rrethin e Votrës s'onë kombëtare, të Shtetit të Lirë, të pavarun, Shqiptar, të gjitha ato Vise që, për një arsye a për një tjetër, fshajnë ende nën robni; së treti, tue u frymëzue nga vepra atdhetare e paharrueshme e Lidhjes së Prizrendit, me hedhun, qysh tashti, themelet e njëj organizimi mprojtjeje politike, diplomatike dhe ushtarake të këtyne të drejtave të pamohueshme dhe, si të tilla, të paprekëshme para çdo të drejte, edhe para asaj ma fillestare”²².

Oratori, personalitet shumë i rëndësishëm i historisë shqiptare, do të angazhohej për bashkimin me *Mbretnin Shqiptare* edhe të viseve të tjera shqiptare të cilat ende mbaheshin nën okupimin bullgar dhe

²⁰ Flet Zotni Shehu, Kosova, nr. 51-52-53, Tiranë, 1943,3.

²¹ Koncepti “Shqipëri e Vjetër” nënkuptonte shtetin shqiptar të formuar me Traktatin e Londrës.

²² Fjala e Z. Shkupi, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943, 3.

administrimin e tërthortë të Mbretërisë së Malit të Zi dhe të Serbisë së Nediqit. Shefqet Shkupi theksoi para delegatëve: “Vendi i jonë asht i synuem nga lakmina të pangishme imperialiste, pse, ndër fqinj, ka ba pak, ase aspak hapa kuptimi i drejtësisë së vërtetë, si edhe pse, drejtuesat e klikave të ndryshme të përparshme ushtarake, si Mihajloviçi, vazhdojnë t’andrronjë krijime artificiale, kryekëput tashma të pamundëshme, si Jugosllavia e përparshme, që shkretoi, rrenoi, për tridhete vjet rresht, Fisin Arbënuer në Kosovën t’onë”.

Qëllimi i ngritjes së Lidhjes së Dytë të Prizrenit pasqyrohej në një fjali të thjeshtë: “Gjithçka për Liri!” të dr. Rexhep Krasniqit, historiani shqiptar i parë, më i thelli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878, e cila, siç konstatonte: “do të mbetet, heret e vonë, e pashlyeshme ndër mendje dhe ndër shpirtna të gjithë Shqiptarve, pse i detyrohet asaj Lidhje qenja dhe shpëtimi i Fisit t’onë nga gënjeshttrat e këlyshvet të Rusisë”²³.

Kërkesës për bashkimin shqiptar për të realizuar aspiratën e bashkimit të Shqipërisë Etnike i dha kuptimin e amanetit patrioti Tahir Zajmi. Ai theksoi: “Vullneti i krejt popullit që kemi nderin të përfaqësojmë në gjë të kësaj mbledhjeje asht aj i realizimit të bashkimit të persosun ndërmjet Kosovës, Dibrës dhe Strugës me Shqipninë e Vjetër. Prandaj, na, tue interpretue këtë vullnet besnikisht, duhet që, njizani, ta shpallim këtë bashkim në trajtë plebishitare(...), për realizimin e Njisisë s’onë etnike”.

Personalitet politik, Zajmi, i zoti për pushkë dhe për penë, konceptoi platformën politike - “Vullneti paqësor Kosovar”, në të cilën, midis të tjerave, saktësoi: “Kuvendi i tashëm i Prizrendit asht mbledhja e madhe e krejt popullit shqiptar që, padrejtësinat e Europës imperijaliste, kishin lanë, për dy herë rresht, nën zgjedhë t’imperjalistavet të Ballkanit” dhe konstatoi: Porsa të sigurohen këto të drejta, që nuk mund t’i mohojë as kriteri i drejtësisë ma fillestare, populli shqiptar do t’a frymëzojë politikën e mbrendshme dhe të jashtëme nga drejtime që do të përbajnë gjith’ aq norma themelore të pacënueshme, kundrejt fqinjve të vet(...)”²⁴.

²³ Fjala e Z. Krasniqi, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

²⁴ Fjala e Z. Zajmi, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

Atmosferë patriotike entuziaste bashkimtare në Kongresin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit solli fjala e mësuesit mitrovicas Bedri Gjinaj: “Dërgata e Mitrovicës merr pjesë në këtë mbledhje historike, e bindun se, nga bisedat dhe punimet e saja do të dalë ajo që pret krejt populli shqiptar: vendimi për t’a krijue, me të drejtë e me gjakë, Shqipninë e andrrueme prej të gjithë Martirvet t’onë: Shqipnija Ethnike”²⁵.

Më 17 shtator 1943 Këshilli Ekzekutiv i Përgjithshëm i Tiranës informonte popullin se kishte shpallur “pavarësinë e Shqipërisë” dhe e ftonte “për domosdoshmërinë e mbrojtjes së Shqipërisë Etnike”²⁶. Në këtë ditë, pikërisht më 17 shtator 1943, i zhvilloi punimet Seanca e dytë e Kuvendit themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kryetari i Këshillit nisjatuër, Musa Shehzade në këtë seancë Kuvendit themelues së Lidhjes ia propozoi Kryesinë e Kongresit në përbërje: Një Kryetar, Dy Nënkryetarë, Një Sekretar, për të “kryesue mbledhjet dhe me drejtue zhvillimin e bisedimeve t’interesantshme të mbledhjes historike”²⁷.

Sipas Tahir Zajmit, në Kuvendin themelues morën pjesë 42 delegatë²⁸. Me vota të fshehta Kuvendi për Kryetar zgjodhi dijetarin Sheh Musa Shehzade me 38 vota, kurse për nënkryetarë: Aqif Blutën dhe dr. Rexhep Mitrovicën, me nga 17 vota. “Me propozim të Kryetarit (Musa Shehzades), mbledhja pranon, me aklamim, si Sekretar të Kongresit Z. Bedri Gjinaj”²⁹. Me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit, punimet e të gjitha seancave do t’i drejtonte dr. Rexhep Krasniqi³⁰.

Organi i Komitetit të Kosovës - “Kosova”, iu kushtua edhe biografi të personaliteteve drejtuese të Kuvendit themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Aty theksohej: “Z. Musa Shehu, prej Prizrendi, asht një nga figurat ma të lashta, pra veteran i mirënjoftun kudo nëpër botën shqiptare, si përpjekjes i palodhun, në çdo kohë dhe për çdo rrethanë, i përmbushjes së aspiratave të shejta të Kombit shqiptar;

²⁵ Fjala e Z. Gjinaj, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

²⁶ Gjerësisht, Kombi, Tiranë, 19 nëntor 1943.

²⁷ Shih, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

²⁸ Lidhja e II e Prizrenit dhe Lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, 44.

²⁹ U kap me ligështi në Drenicë, në fillim të janarit 1945, dhe pas disa muajve të burgut në Mitrovicë e në Prishtinë, pas shumë mizorinave, u likuidua pa nishan.

³⁰ Shih, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

burrë qind për qind i ndershëm, guximtar dhe i patundëshëm në ndjekjen e parimevet themelore që kanë frymëzue, herët e vonë, lëvizjet kombëtare të Vendit t'onë e, si i tillë, edhe shok i pandarshëm i Plakut të maleve, Bajram Currit të paharrueshëm. Zgjedhja e tij në krye të Kongresit, pra, difton haptas udhën që mendon të ndjekë vetë Kongresi(...)".

Dhe, duke folur për *Aqif Blutën*, përfaqësuesin e Sanxhakut, Kosova, midis të tjerash, shkruante: "*Ky burrë gjakovar*³¹, *nji nga oficerat ma të shquem të dalun nga Shkolla turke, asht figura ma përfaqësuese e Sanxhakut; asi Burri që, në çdo kohë, nën çdo pushtim, nuk ka pushue kurrë së luftuemi për realizimin e vullnetit të popullit kosovar për të qenë nji dhe i pandashëm kundra çdo vale shkatërrimtare; asht Burri që, klika ushtarake imperijaliste e Belgradit, i ndeu, ma se nji herë, kurthe mbi kurthe, për t'a shdukun nga qarkullimi, për ta vra, që të pushonte, në gji të Skupçinës, zani i tij i fuqishëm, kundra tiranisë, kundra terrorizmit, kundra masakrave dhe kundra luftës së shkombëtarizimit që zhvillonte Serbia imperijaliste mbi popullin shqiptar të Visevet thjesht shqiptare të Kosovës(...); asht Burri, ma në fund, që ka vendos, për çka i përket sektorit të vet, m'e bashkue, me çdo mënyrë dhe me çdo therori, Tregun e Ri, vend thjesht shqiptar, si ç'e ka diftue me gjakun e derdhun bujarisht në çdo rasë rreziku, me At dheun e përbashkët shqiptar*".

Duke folur për historianin *dr. Rexhep Krasniqi*, gazeta Kosova, saktësonte: "*...ma i riu në Kryesi, asht djaloshi që asht rritë e burrnue me aspiratat dhe me idealet e Plakut të pavdekshëm të Maleve (Bajram Currit), djalë atdhetar që, për Shqipni, mendon dhe jeton e që, si të gjithë të rijt e Kosovës Kreshnike, asht i frymëzuem nga vullneti i patundun që të kryhet, këtë herë, nji herë e përgjithëmonë, Porosia e të Parve: krijimi i Shqipnisë Ethnike...*"³²

³¹ Ka prejardhje gjakovare. U lind në Tregun e Ri, më 1890. Është i biri i Emin Ahmet Blytës. Nga Gjakova në Tregun e Ri erdhi Ahmeti. Aqifi mbaroi Shkollën Ushtarake në Manastiri, më 1911, së bashku me Kemail Ataturkun. Personalitet shqiptar i viteve '20-30-ta përkrah Ferat be Dragës. Më 1941 nëntoka italiane e konsideroi "Grand Ufficiale"(zyrtar i lartë) i lagjes së Iljaz Agushit (Shih AQSH – F- 161, Viti 1941, K-18, Dok. 462).

³² Dita e Dytë e Kuvendit, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943, 4.

Në punimet e *Seancës së Dytë*, hapësirën kohore më të madhe e zuri: “*Bisedim mbi Bashkimin e Kosovës, të Dibrës dhe të Strugës me Shqipni*”. Kuvendi themelues vendosi: “*Këto Vise t’i bashkohen Nanës s’onë të përbashkët; Nanës Shqipni*”³³. Juristi Esad Berisha, përfaqësues i nënprefekturës së Gjilanit pasqyroj dimensionet e dhunës bullgare në viset shqiptare të okupuara nga Bullgaria dhe konstatoi: “*Detyrat që na presin për realizimin e vullnetit të të gjithë Shqiptarëve: krijimin e Shqipnisë Ethnike, janë të shumta dhe tepër të randa. Për t’i dalë në krye kësaj pune, ka vetëm një udhë; të ndjekim porosinë që na ka lanë Bilbili i gjuhës Shqipe, Naim Frashëri: “Punë, punë, natë e ditë, që të shofim pakëz dritë”*”³⁴.

Në kohën derisa po i zhvillonte punimet *Seanca e Dytë e Kongresit të Prizrenit*, arritën përfaqësuesit e Komitetit Ekzekutiv të Përgjithshëm të Tiranës: *Bedri be Pejani, Rexhep Mitrovica dhe Xhafer Deva*, të shoqëruar nga *Rrok Maloku* dhe “*shumë delegatë të tjerë*”³⁵. Sipas *Tahir Zajmit*, me këta ishin edhe publicistët shqiptarë më të shquar të kohës: *dr. Xhelal Mitrovica* dhe *Maz’har Sopoti*, i vetmi delegat i arealit të Shqipërisë londineze pjesëmarrës në Kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit³⁶. I pari ishte redaktor i organit “*Kombi*” kurse i dyti drejtor i organit “*Kosova*”, prandaj informatat në këto organe janë burime autentike, të dorës së parë, nga stenogramet e kuvendit. I tërë Kuvendi Dërgatën nga Tirana e priti me brohoritje: “*Rroftë Bashkimi Kombëtar!*”, kurse *Bedri be Pejani*, duke përshëndetur delegatët, midis të tjerash, theksoi: “*Mbas kapitullimit t’Italisë, në Kryeqytetin t’onë, në Tiranë, asht formue një Komitet Ekzekutiv i Përgjithshëm, prej gjashtë vetësh, i cili kryen përkohësisht, detyrat e Qeverisë, në pritje të mbledhjes së njëj Kuvendi Kombëtar, nga gjini i të cilit do të dalë Qeverija e përherëshme dhe caktimi i trajtës së regjimit që do t’i epet Shtetit*”.

Dhe, këtu duhet të nënvizohet fuqimisht konstatimi i *Bedri be Pejani* në përmbyllje të fjalës, një si amanet për brezat shqiptarë:

³³ Kosova shpallë vetvetiu bashkim me Shqipni, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

³⁴ Flet delegati i Gjilanit, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943, 4.

³⁵ Dërgata e Tiranës në gji të Kuvendit, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

³⁶ Lidhja e II e Prizrenit dhe Lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, 43-44.

“Italijs, ajo që perdhunoi lirinë dhe pavarësinë shqiptare në vitin 1939, pësoi dënimin që meritonte. Çdo i huaj që vjen për t’a nënsh-true Kombin Shqiptar e ka fatin të caktuem: del me këpucë të kuqe. Kështu duel edhe Italijs!” Kjo nënkuptonte betimin, se fatin e Italisë do ta pësojë akëcili okupator që mund të synojë okupimin e tokave shqiptare³⁷.

Ndërkaq *Fjala e Rexhep Mitrovicës* do të shestonte platformën politike, diplomatike e luftarake të *Qeverisë së Shqipërisë* në formim e sipër. *“Të drejtat t’ona kombëtare do të mprohen, me të gjitha fuqinat. Kombi Shqiptar, këtë herë, nuk do të lejojë ma të kryhen mbi kur-riz të tij padrejtësinat e së shkuemes. Shqiptarët, të bashkuem të gjithë me një dëshirë dhe për një qëllim, pa marrë para syshë asnjë dallim krahinuer, besimi ase ideologjije, do të jenë, nesër, po të gjin-demi para një gjase përtrimi të padrejtësisë, një blok i vetëm kundra çdo dredhije imperijaliste”.*

Burrështeti *Rexhep Mitrovica* nga foltorja e *Kuvendit themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit* i vuri në spikamë kombit shqiptar se fundi i pushtimit gjerman-hitlerian ishte afër dhe e ftonte atë të përgatitej për epilogun e e pashmangshëm të *Luftës së Dytë Botërore*. Theksoi: *“Na duhet t’i përgatitemi, të gjithë së bashku, edhe njëj përpjekjeje tjetër: asaj politike dhe diplomatike. Nesër, kur të shtrohet tryeza e paqës, duhet që Kombi Shqiptar të dalë para saja me të tana dokumentat që do të provojnë të drejtat e tij nga çdo pikëpamje. Duhet që kombi i jonë të jetë në gjendje, me një herë, porsa të fillojë bisedimi mbi fatin e popujve, për t’i dalë zot vetvetes edhe në këtë fushë, madje kryesisht në këtë fushë”.*

Si masë preventive për të pritur fundin e *Luftës së Dytë botërore* propozoi këto aktivitete të ngutshme: Regjistrimi i banorëve në të gjitha viset shqiptare jashtë *Shqipërisë londioneze* dhe mbledhja e dokumenteve që do të provonin autoktoninë dhe të drejtën etnike e historike të shqiptarëve në ato toka të copëtuara me *Traktare diplomatike*: më 1878, 1913, 1919, 1941. Mitrovica saktësoi qartë: *“Dokumentet që të provojnë të tana shpërnguljet e përdhunëshme, kolonizimet e padr-ejta, grabitjet e tokave dhe të pasunive, ndjekjet, vrasjet, presjet,*

³⁷ Dërgata e Tiranës në gji të Kuvendit, Kosova nr. 51-52-53, Tetor 1943.

djegiet, torturimet, terrorizmat dhe masakrimet. Me këto dokumenta në dorë, Kombi Shqiptar mundet të dalë, krejt i vllazënuem, kryenaltë përpara Konferencës së ardhëshme të paqës dhe të kërkojë të gjitha ato të drejta që, të dokumentueme dhe të provueme, të studjueme dhe të konstatueme nga një drejtësi e vertetë, nga e cila urojmë të jetë e frymëzueme nesër mbledhja e paqës së botës, nuk mund t'i mohohen, nuk do t'i mohohen”³⁸.

Kuvendi themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit Seancën e tretë e mbajti më 18 shtator 1943, me këtë rend të ditës: “Bashkimi i Mitrovicës me Shqipni”, përkatësisht “Bisedim mbi çashtjen e bashkimit të Mitrovicës, Podujevës, Vuçiternës, Pazarit të Ri, Senicës e Zonës Neutrale me Shqipni”³⁹. Përfaqësuesi i Besianës (ish-Podjeva), patrioti Jahja Fusha, konfirmoi fuqimisht dëshirën dhe kërkesën e visit të Llapit për t’u bashkuar me Mëmën Shqipëri: “Un jam Delegat i Llapit, të atij Vendi që, ndonëse vuejti shekuj nën zgjedhën e Perandorisë Ottomane, ndonëse hoq një mij e një të zeza nën shkelmin e Klikës Ushtarake imperjaliste të Belgradit, nuk flet, as nuk din të flasë, prej një skaje në tjetrën të gjanësisë së vet, tjetër gjuhë veç gjuhës s’onë amtare; Shqipes së pavdekëshme; jam delegat i Llapit, i atij vendi qind për qind shqiptar, që padrejtësinat e Fuqivet imperjaliste t’Evropës kishin dënue, si shumë vende të tjera thjesht shqiptare, me një padrejtësi të randë”.

Në fund, martiri i kombit, Fusha, e ftoi “Kuvendin, që të vendosë marrjen e të tana atyne masave që do të gjykohen të përshtatëshme për të sigurue lidhjen e bashkimit të Mitrovicës, të Vuçiternës, të Podujevës, të Tregut të Ri dhe të Senicës me Shqipni”⁴⁰.

Dhe, veçanërisht mesazhet e Fjalimit të delegatit nga Tregu i Ri Aqif Bluta, janë historike edhe për jetë të jetës së Shqipërisë Etnike: “Jam shumë i gëzuem që kam fatin e bardhë, mbas tridhetë e sa vjetve përpjekjesh të vazhdueshme, të ndodhemi, për herë të parë, si përfaqësues i Tregut të Ri dhe i Senicës, në gjë të një Kuvendi Kombëtar si ai i tashmi (...) me Atdheun e përbashkët të të gjithë Shqiptarëve: me Shqipninë Nanë”.

³⁸ Fjala e Z. Rexhep Mitrovica, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 5.

³⁹ Mbledhja e tretë e Kuvëndit të burrave, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 6.

⁴⁰ Flet Jahja Fusha, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 6.

Patrioti zjarr vullkanik i pashuar për lirinë e *Shqipërisë Etnike*, *Açif Bluta*, do të konstatonte, guximshëm e qartë: “*Tregu i Ri, ose Jeni Pazari, si quhej deri dje, si dhe Senica me krahinat e tyre, janë vise thjesht shqiptare, pse popullsija që i banon asht krejt shqiptare; çdo njeri, ndër ato ana, din të thotë se prej ç’far fisi shqiptar rrjedh*”, ndaj me kërkesën këmbëngulëse të popullit “*po bashkohemi me Shqipërinë, me Nanën t’onë të përbashkët, për të cilën jemi djeg e shkrumue, jemi vra e shkretue deri në ditë të sodit*”⁴¹.

Këtu sikur e kërkon momenti historik të sjellim edhe një fragment nga *Fjala e Blutës*, për faktin se qysh nga periudha e monizmit socialist-komunist “*shkenca shqiptare*”⁴² dhe politika shqiptare legale kanë hequr dorë qartë nga një pjesë e *Shqipërisë historike* e etnike, pikërisht nga *Sanxhaku i Vilajetit të Kosovës*: “*Gjatë këtyne dy vjetve e gjysë këto krahina, që kam nderin të përfaqësoj në gji të kësaj mbledhjeje, kanë provue, me gjakun e derdhun bujarisht, se sa e duen dhe se si e mprojnë individualitetin e tyre kombëtar, bashkimin e tyre me Shqipni dhe lirinë e mëvehtësinë kombëtare; qindra dhe mija të flijuem në fushë të nderës, në ndeshje me fuqina shumë herë ma të shumta, shumë herë ma të mëdhaja dhe shumë herë ma të pajosuna*

⁴¹ Kjo ishte e mjaftueshme për t’i dhënë dënimin me vdekje nga nacionalçlirimtarët kominternistë. Realisht, sapo u ripushtua Kosova nga partizançetnikët, e zbuloi dhe e denoncoi në komandën partizane në Gjakovë veprimtareja komuniste Bija Beqir Vokshi. Nga Gjakova e dërguan në Tregun e Ri dhe atje e martirizuan, më 21 janar 1945 - “në emër të idealeve të vëllazërim-bashkimit shqiptaro-serb”!

⁴² Më 20 – 21 janar 1994 Akademia e Arteve dhe e Shkencave të Kosovës mbajti Simpoziumin: Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje (Me vështrim të veçantë mbi burimet serbe të fakteve). Kryetar i Këshillit Organizuet ishte Akad. Gazmend Zajmi dhe sekretar dr. Zekeria Cana. I fundit ishte edhe redaktor, së bashku me akad. Pajazit Nushin. Me këmbëngulejn e Z. Canës nuk do të lejohej të hynte në program kumtesa: Masakra serbo-malazeze e Bihorit e 5/6 janarit 1943, me shpjegimin “Bihori dhe Sanxhaku më nuk mund të konsiderohen tokë shqiptare...!”. Cana nuk lejoi as botimin e kumtesës: Masakra e Tivarit e 1 prillit 1945, as një kombinim të të dy problemeve në nën një titull, sipas propozimit të akad. G. Zajmit, ndonëse vlerësimi i recensuesve: dr. F. Pushkolli – dr. H. Bajrami ishte në supërlativ. Kumtesa e parë do të botohej Gjurmime albanologjike – SSHH nr. 23 - 1993, Prishtinë 1995, 149-159 dhe kumtesa e dytë do të botohet botim i veçantë i autorit dhe i Institutit Albanologjik me titull: Kalvari i shqiptarësisë së Kosovës TIVARI 1945, Prishtinë, 1993, 1994.

me mjete moderne, janë zmbrapun kreshnikisht nga popullsinat t'ona trime"⁴³.

Dhe, duhet të theksohet se në mbështetje të kërkesave të Aqif Blutës do të ngrihej fuqimisht përfaqësuesi i Rugovës, patrioti Salih Rama, i cili do të theksonte: "Edhe un, si malësuer, due me fol në kët Kuvend, me folë për të mirën e Vendit, me fol, poh, për t'i u lutun Qeverisë s'onë në Tiranë qi të mundohet me na i shpëtue qato tokë krejt shqyptare qi janë andej ç'prej Mitrovicet, në Pazar e në Senicë. Ato janë toka t'ona pse atje populli asht shqyphtar, me zemër e me adete, si na kësaj ane. Un i njof njato vend, pse kam konë me luftue, bashkë me shok't e mij, kundra shkjetet, qi dojshin me hie atje me vra e me therë gjinden, veç se janë e duen me metë shqyphtarë sikur na këndejna"⁴⁴.

Po kështu, për bashkimin me Mbretinë e Shqipnisë të ish-Zonës së interesave gjermane në veri të Shqipërisë Etnike do të angazhohet me dinjitet përfaqësuesi i Nënprefekturës së Vushtrrisë, martiri Adem Voca: "Tash detyra e jonë asht e qartë: duhet që, të bashkuem në një Besë të papërdhunueme, t'i përmbledhim të tana fuqinat t'ona për përmbushjen e aspiratavet dhe të kërkimevet t'ona te shejta për krijimin e Shqipnisë Etnike. Nuk duem asgja që nuk asht e jona; por, çka ashte jona, duhet pa tjetër të na këthehet. Edhe Mitrovica, Tregu i Ri e Senica janë shqiptare. Pra, na përkasin neve. Qeverija e Tiranës, prandaj, duhet të ftohet që t'i përvishet punës, për sot e për nesër, që të na i sigurojë, me çdo mënyrë dhe mjet, të drejtat t'ona. Ajo do të ketë, në këtë përpjekje, krejt Kombin Shqiptar mbas vedit e në vi të parë, po t'a lypë nevoja, tanë Kosovën"⁴⁵.

Ndërkaq, përfaqësuesi i Gjakovës, Sulejman Kryeziu, bëri një krahasim mbi rëndësinë që pati Lidhja Shqiptare e Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë së Shqipërisë Etnike dhe të Lidhjes së Dytë të Prizrenit që po ngrihej, për bashkimin e tërësisë së asaj që ishte ruajtur nga tërësia e Shqipërisë historike dhe etnike. Patrioti, midis të tjerash, theksoi: "Lidhja e atëherëshme e Prizrenit vendosi dhe e shpëtoi Vëndin. Lidhja e sotshme duhet gjithashtu, t'i dalë zot njisisë s'onë ethn-

⁴³ Fjala e z. Aqif Bluta, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 6.

⁴⁴ Flet Rugova kreshnike, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 6.

⁴⁵ Flet Adem Voca, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 6.

ike: t'a plotësojë dhe t'a mprojë. Nji hap drejtë plotësimit të njisisë s'onë ethnike do të jetë, pa tjetër, edhe bashkimi i Mitrovicës, i Pazarit të Ri dhe i Senicës me Shqipni”⁴⁶.

Pas një debatimi të gjithanshëm të delegatëve, Kuvendi themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit formuloi dhe aprovoi këto konkluzat:

“Kuvendi i dytë i Prizrenit, i mbledhun me 16 të Shtatuer-it 1943, si bisedoi, në mbledhjen e tij të tretë, ditën e 18 Shtatuerit 1943, gjatë e gjanë problemin e Prefekturës së Mitrovicës, tue e shqyrtue nga të gjitha pikëpamjet: nga ajo historike, gjeografike dhe ethnografike, bisedim në të cilin muerën pjesë nxehtësisht të gjitha Dërgatat e viseve të përfaqësue me në Kongres;

D e k l a r o n:

Të gjitha vendet që përshinë rrethi i Prefekturës së Mitrovicës, don me thanë; Mitrovica, Vuçiterna, Pazari i Ri dhe Podujeva, janë vise të banueme ku krejtësisht prej popullsije me gjak, gjuhe e zakone thjesht shqiptare dhe ku me nji përqindje dërmuese, gjithënji shqiptare, që kapet deri në 95 dhe 99% dhe, si të tilla, i përkasin krejt Shqipnisë;

F t o n:

Të gjithë Shqiptarët, mbrenda ase jashta Shqipnisë, ku do që janë dhe ku do që ndodhen, që, ndër përpjekje të tyne atdhetare, të kenë, si nji ndër caqe themelore të luftës së shejtë për Liri, pavarësi dhe bashkim të të gjithë bijve të Nanës së përbashkët: të Nanës Shqipni, edhe Prefekturën e Mitrovicës, populli i së cilës, si ç'e ka bamë të njoftun në gji të kësaj mbledhjeje, asht gati m'u shkri për t'a pamë të konkretuem në realitet andrrën e vet të bashkimit me Shqipni” etj.

Vendimin për bashkimin e viseve të ish-Zonës së interesave gjermane me Mbretinë e Shqipnisë e nënshkruan përfaqësuesit: “Delegatë të Mitrovicës, Vuçiternës, Pazarit të Ri dhe Podujevës (Llap)”⁴⁷.

Kuvendin themelues i cili nxori në dritë Lidhjen e Dytë të Prizrenit i përshëndeti publicisti Maz'har Sopoti, siç u tha: veteran i përpjekjeve për tërësinë dhe pavarësinë shtetërore të Shqipërisë Etnike,

⁴⁶ Fjala e z. Sulejman Kryeziu, Kosova nr. 51-52-53, Tetuer 1943, 6.

⁴⁷ Vendimi i Bashkimit të Mitrovicës me Shqipni, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943.

drejtor i organit “Kosova” i cili saktësoi: “Nuk duem as Shqipni të vogël as të madhe: duem Shqipninë që asht, si nga pikëpamja historike ashtu dhe nga ajo ethnografike, me popull, me zakone, me tradita, me doke dhe gjuhë vend shqiptar dhe, si i tillë, kryekëput pjesë plotësuese e Shqipnisë Tanësore; duem, shkurt, vetëm gjithëçka asht krejt e jona”.

Fjala e Sopotit ishte më e gjata e mbajtur në Kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Ai, midis të tjerash, konstatoi burrërisht: “Sigurimi i njisisë s’onë ethnike në një Shtet kryekëput të lirë, në një Shtet kryekëput të pavarun, në një Shtet që të jetë kryekëput i Kombit Shqiptar(...). Njisi ethnike a vdekje(...). T’i përmbledhim, pra, të tana energjinat t’ona dhe, si një blok i pathyeshëm, andej dhe këndej kufijve të vitit 1913, të synojmë një cak të vetëm: sigurimin e Lirisë s’onë brenda kufijve që përshinë vetë njësija e jonë ethnike...”⁴⁸

Në vazhdim të Seancën së tretë, në pasditën e 18 shtatorit 1943, Kuvendi Themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit diskutoi për mënyrat e “Organizimit politik e ushtarak të Vendit”. Për këto çështje i pari foli arsimtari prizrenas, Sylejman Aliu – Drini⁴⁹, dhe e ftoi kombin të hidhej në përpjekje për të evituar mundësitë e përsëritjes së Londrës (1913) dhe Versailles (1919) në dëm të Shqipërisë Etnike. Theksoi, fuqimisht, se “Sot duhet të mendojmë për organizimin e një mprojtjeje që të jetë e aftë me i përmbledhë të gjithë burrat nën flamurët e luftës në rasë rreziku(...). Për t’i arrijtun këtij qëllimi lypet që, në krye të këtij organizimi, të vehen burra të ndërshëm, atdhetarë të sprovuem në çdo rasë dhe elemente që të jenë t’afta t’i përmbledhin rreth kësaj organizate të gjitha kategorinat e popullit, pa asnjë dallim”⁵⁰.

Opcionin politik luftarak të Sylejman Aliut - Drinit e përkrahu fuqimisht Tahir Zajmi, i cili, midis të tjerash, konstatoi: “Për çka i përket mprojtjes, jemi të bindun se do të mendojë krejt Kombi Shqip-

⁴⁸ Flet z. Masar, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943, 8.

⁴⁹ Sipas kujtesës historike Sylejman Drini, këso kohe, ishte sekretar teknik i Komitetit Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ndërkaq detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm e kreu Tahir Zajmi. Sipas procesverbalit të Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme, më 17-20 qershor 1944, Sylejman Aliu, deri në këtë Mbledhje, ishte anëtar i Komitetit Qendruer, i shënuar nën Nr. Rend. 7, kurse T. Zajmi i shënuar në Nr. Rend. 3. Shih, Mbledhja e III-të e Kuvendit të Lidhjes (16), Zëri, nr. 1434, Prishtinë, 11 janar 1992,51.

⁵⁰ Mbledhja e fundit e Kuvendit, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943, 8.

tar, pse Kosova, Dibra dhe Struga nuk janë veç se krahina thjesht shqiptare dhe, si të tilla, pjesë të pandarëshme të Shqipnisë. Mproja, pra e këtyne vendeve, nuk asht një nevojë e domosdoshme vetëm për to, por për krejt Kombin(...).Me gjithë këtë, na, Kosova, Dibra dhe Struga, që jemi ma t'eksponueme kundrejt rreziqeve t'ardhëshme, duhet të mendojmë, ma përpara dhe ma fort se viset tjera të Shqipnisë, për çdo të papritun që mund të na riej koha. Një përgatitje e tillë ishte mendue, edhe ma përpara; por mjerisht, rrethanat ndër të cilat jemi ndodhun, nuk na e kanë lejuë. Prandaj tash që këto pengime janë shdukun, duhet t'i kushtohemi, me gjithë fuqi, kësaj përgatitjeje”.

Në vazhdim, veterani i luftës për Shqipërinë Etnike, vuri në pah dëmet si pasojë e mosvigjilencës shqiptare në janar 1943, në Bihor, kur çetnikët serbo-malazez therën dhe dogjën, në shtëpitë e tyre, “një sasi të tmerrshme viktimash prej katër mij e shtatëqind vetësh, ma shumë gra, fëmij, pleq dhe plaka”⁵¹ dhe, me forcë të argumenteve, vuri në spikamë:

“Rreziqet priten vetëm me gatësi përballimi të çdo të papritune. Pra, duhet t'armatosemi, t'armatosemi deri ndër dhambë; të forcohemi për çdo gjasë, me çdo mënyrë dhe me çdo mjet. Organizimi i plotë politik dhe ushtarak, duhet të mbështetet kryesisht mbi fuqinat t'ona, due me thanë të popullit; burimet, nga të cilat do të dalë kjo përgatitje, si nga pikëpamja financiare ashtu dhe nga të gjitha të tjerat, duhet të jemi na vetë: qytetarë dhe katundarë; gjithë pasunija e jonë, e tundshme, duhet vënë në dispozitë të organizatës që do të lejë prej kësaj mbledhjeje. T'organizuem në këtë mënyrë, na do të mundemi të mprohem, të shpëtojmë dhe të fitojmë davanë t'onë”⁵².

Pasoi fjala e shkurtër, por plotësisht me mesazh testamenti, e Be-dri be Pejani, i lagjes së madhorëve të kombit: “Pika që asht në bis-edim tash në gjë të këtij Kuvendi, ka randësi themelore: asht mproja e Vëndit e, si mproje, prej saj do të varet e nesërmja e jonë: humbja ase fitimi. Prandaj, kësaj pike, si gjithë të tjeravet, duhet t'i kushtojmë kujdesin t'onë ma të madh. Asht një e vërtetë e pabisedueshme se, çdo lëvizje, për të mund me shkue përpara, për t'i arrijtun caqevet të

⁵¹ Shih gjerësisht, M. P i r r a k u, Masakra serbo-malazeze e Bihorit (5/6 janar 1943), Gjurmime Albanologjike SSHH 23-1994, Prishtinë, 1995, 149-159.

⁵² Fjala e Z. Zajmi, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943.

veta, ka nevojë për organizim, pse, pa organizim, nuk i dilet asgjaje në krye. Por, edhe me organizim, duhet të kemi njerëz, njerëz që punojnë ditë e natë, me të gjitha fuqinat e tyne, drejt qëllimit të caktuem. Pra, edhe neve, na duhen, kryesisht, për t'arrijtun qëllimin t'onë të përbashkët, burra, burra si ata që u dalluen për të mirë të Shqipnisë 65 vjet përpara, në Lidhjen e Prizrendit”.

Më tutje, Pejani, konstatoi dhe përfundoi qartë e me përplotni: “Si mbas mendimit t'em, organizimi që paraqitet në rasën t'onë si ma i përshtatëshëm asht ai që të ketë, në Prizrend, një Komitet Qendruer, i cili, mandej, të ketë degët e veta në të gjitha Prefekturat, Nënprefekturat dhe Komunat e të gjitha Viseve të Kosovës, Dibrës dhe Strugës e mundësisht, edhe në të gjitha viset e Shqipnisë”⁵³.

Në vazhdim të Seancës së tretë drejtuesi i punimeve Kongresit ia paraqiti propozimin e Kryesisë së Kuvendit për anëtarët e Komitetit Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, pikërisht burrat që me veprimtari politike të gjatë kishin dhënë provimin para Atdheut: Rexhep Mitrovica (kryetar), Sheh Musa Shehzade dhe profesor Kolë Margjini (nënkryetarë), Sheh Hasani, Asllan Boletini, Tahir Zajmi dhe Qazim Bllaca. Në vazhdim vuri në pah se “Komiteti Qendruer do t'i ketë bashkëpunëtorët e vet në çdo qendër Prefekturë, Nënprefekturë dhe komune (...) dhe do të ketë fuqina të plota; do të bisedojë dhe do të vendosë me shumicë votash (...), shkurt mund të themi se, prej tij, duhet të rrjedhë gjithëshka e, degat, në bashkëpunim me te, do të ngarkohen me zbatimin e masave të marruna”⁵⁴.

Kongresi aprovoi me aklamacion propozimin e Kryesisë dhe miratoi propozimin e delegatit të Pejës Qerim Begollit, që prefekturat, nënprefekturat dhe komunat të përcaktoheshin vetë për kryetarët e Degëve të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kryesuesi i seancave, dr. Rexhep Krasniqi, e shpalli të mbyllur Kuvendit Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, me këtë konstatim: “Gjatë këtyne bisedimeve janë hedhun themelet e një organizimi që, dal nga dalë, do të jetë organizata drejtuese e gjithë mprojtës dhe e rregullimit t'onë ndër të gjitha fushat. Urojmë që, vepra e jonë, të ketë suksese të shkëlqyeshme”⁵⁵.

⁵³ Fjala e Bedri be Pejanit, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943.

⁵⁴ Flet z. Krasniqi, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943, 9.

⁵⁵ Shih, gjerësisht, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943.

Këtu duhet të konstatohet se, për rëndësinë simbolike dhe për të treguar vazhdimësinë e përpjekjeve shqiptare për *Shqipërinë Etnike, Vendimet e Kuvendit themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit* do të nënshkruheshin më 19 shtator 1943, pas orës nëntë, në *Ndërtesën e Selisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*⁵⁶.

Realisht, gjatë natës së 18/19 shtatorit 1943 në Prizren kishin arritur mijëra patriotë nga të gjitha viset e Kosovës në kuptimin e *konceptit kombëtar* të viteve 1941-1944, por edhe nga ish-areali i *Shqipërisë londineze*. Së këndejmi, *mëngjesi i 19 shtatorit 1943 ishte ngjarja më madhështore që njohu historia e Prizrenit*.

Dhe, kronisti besnik i kësaj ngjarjeje historike, do të konstatojë se, derisa masa me ndërgjegje kombëtare, të fisnikëruar me këtë ngjarje, thërriste: “*Rroftë Shqipnija e Lirë!*”, “*Rroftë Kosova Shqiptare!*”, “*Rroftë Besa e Burrave!*”, “*Rroftë Bashkimi Kombëtar!*”(…), *Dërgatat e ndryshme, të cilat, t’udhëhequna nga Kryetarët e tyne, hyjnë, njana mbas tjetrës, në sallën e ndërtesës, ku nënshkruajnë procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit*”.

Në vazhdim, *Kronisti i organit të Komitetit të Kosovës*, do të konstatonte edhe këtë fakt që flet për rëndësisnë e *ngjarjes* për kohën dhe për historinë: “*Ndërsa vazhdon nënshkrimi i procesverbaleve, del në balkon të ndërtesës Z. Bedri Pejani, i cili mban një fjalim tue i shpjegue popullit randësinë dhe kuptimin e vendimevet të marruna. Mbas Z. Pejani marrin fjalën, njani pas tjetrit, edhe Z. Tahir Zajmi e Z. Ibrahim Fehmiu, të cilët, shkurtas, deklarojnë se, mbas vendimevet të marruna, mehlemi i plagëvet t’ona asht një i vetëm; bashkimi. Bashkim ndër mendje dhe ndër zemra të të gjithëve*”⁵⁷.

Në këtë mënyrë madhështore i kurorëzoi qëllimet historike *Kuvendi themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit*. Delegatët, me këngë e valle, vizituan të gjitha pjesët më atraktive të Prizrenit, dhe në fund arritën së bashku në *Sheshin e “Përmendorës së Abdyl Frashërit”* - një si *Dodonë* për të konfirmuar betimin e *Besa-besës* se kanë për të

⁵⁶ Nuk mund të mbështetet konstatimi i dr. Daut Bislimit kinse Kuvendi themelues i zhvilloi punimet deri “më 21 shtator 1943”, kur delegatët u thirrën t’i “nënshkruanin vendimet” (Shih, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë 1997, 103).

⁵⁷ Nënshkrimi madhështuer i Vendimeve, Kosova nr.51-52-53, Tetuer 1943, 9.

siguruar tërësisht idealet për të cilat u përpoqën dhe sakrifikuan udhëheqësit dhe luftëtarët e *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* të viteve 1878-1881⁵⁸.

Veprimtarët e *Lidhjes* dolën në terren dhe deri nga fundi i tetorit 1943 formuan komitetet e qarqeve, të rretheve e të komunave në arealin e Kosovës sipas konceptit kombëtar të kohës – *viset jashtë arealit të Shqipërisë londineze*. Fryma e *Lidhjes* do të përcillej në *Asamblenë Kombëtare* të mbledhur nga mesi i tetorit 1943, në Tiranë⁵⁹.

Më lart u tha se gjatë përgatitjes për thirrjen e *Asamblesë Kombëtare të Mbretnisë Shqiptare* u bënë ndryshime në *Komitetin Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit*. Realisht, një numër i anëtarëve të *Kuvendit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit* dhe të anëtarëve të *Këshillit Qendruer* të saj u zgjodhën përfaqësues të rretheve në *Kuvendin Kombëtar*.

Më 16 tetor 1943 fillonte punën *Asamblea*, përkatësisht *Kuvendi Kombëtar*. Kryetari i *Komitetit Qendruer të Lidhjes*, *Rexhep Mitrovica* fillimisht do të zgjidhej *Nënkryetar i Kuvendit* dhe më 8 nëntor 1943 - *Kryeministër i Shqipërisë*⁶⁰. Në postin e kryetarit të *Komitetit Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit* do të vinte veterani i *Pavarësisë së Shqipërisë*, *Bedri be Pejani - Babushi*⁶¹. Tashti *Kuvendin e Përgjithshëm* e përbënin 33 personalitete të shquara: *Musa Shehu, Bedri Pejani, Tahir Zajmi, Kolë Margjini, Sheh Hasani, Esat Berisha, Sylejman Aliu dhe Ahmet Lusha* (anëtarë të *Komitetit Qendruar*), *Qemal Karahoda* dhe *Luk Simoni* - përfaqësues të Prefekturës së Prizrenit, *Nuredin H. Halili* - përfaqësues i nënprefekturës së Therandës (Suharekës), *Bejtullah Haxhiu* - përfaqësues i nënprefekturës së Rahovecit, *Hasan Dashi* – përfaqësues i nënprefekturës së Gjakovës, *Eshref Arifi* – përfaqësues i nënprefekturës së Sharrit (Dragashit), *Jusuf Agushi* – përfaqësues i Prishtinës, *Halim Shuku* – përfaqësues i

⁵⁸ Shih, Po aty.

⁵⁹ Gjerësisht, Dr. M u h a m e t P i r r a k u, Programet e qeverive shqiptare në periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe çështja e bashkimit të Shqipërisë, Zëri, nr. 16, Prishtinë, 23 dhjetor 1995, 48-49, nr. 1, Prishtinë, 20 janar 1996, 48-49.

⁶⁰ Shih, Bisedimet e Kuvendit Kombëtar (16.X – 10.XI. 1943), Tiranë, 1944, 9,14,93.

⁶¹ Dr. M u h a m e t P i r r a k u, Programet e qeverive shqiptare në periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe çështja e bashkimit të Shqipërisë, Zëri, nr. 16, Prishtinë, 23 dhjetor 1995, 48-49, nr. 1, Prishtinë, 20 janar 1996, 48-49.

nënprefekturës së Ferizajt, *Mehmet Devaja* – përfaqësues i nënprefekturës së Gjilanit, *Nexhib Basha* – përfaqësues i prefekturës së Pejës, *Bedri Pejani* - përfaqësues i nënprefekturës së Skënderajt, *Bajram Gashi* – përfaqësues i nënprefekturës së Burimit (Istok), *Shemsi Ferri* – përfaqësues i Plavës-Gucisë, *Vehbi Hamzaga* – përfaqësues i nënprefekturës së Tutinit, *Adem Kurtaga* – përfaqësues i nënprefekturës së Rozhajës, *Musa Boletini* dhe *Bedri Gjin* – përfaqësues të prefekturës së Mitrovicës, *Ekrem Jegeni* – përfaqësues i prefekturës së Dibrës, *Mentor Çoku* – përfaqësues i nënprefekturës së Strugës, Av. *Adem Sadriu* – përfaqësues i nënprefekturës së Kërçovës, *Remzi Ragipi* – përfaqësues i nënprefekturës së Gostivarit, *Ahmet Lusha* – përfaqësues i nënprefekturës së Tetovës, *Esat Berisha* – përfaqësues i prefekturës së Shkupit, *Haxhi Xheladini* – përfaqësues i nënprefekturës së Kaçanikut, *Sylejman Ashkiu* – përfaqësues i nënprefekturës Kumanovë-Presevë, *Hasan Agë Zvezdiu* - përfaqësues i Zonës neutrale të Senicës, *Tahir Zajmi* – përfaqësues i Kukësit, *Zenun Gashi* – përfaqësues i nënprefekturës së Tropojës, *Lutfi Spahiu* – përfaqësues i nënprefekturës Bicaj⁶²

Nga sa u pa më lartë, *Komiteti Qendruer i Lidhjes*, në vijimësi të aktivitetit, numrin e anëtarëve të *Komitetit Qendruer* nga shtatë sa u zgjodhën në *Kuvendin themelues*, më 18 shtator 1943, e shtoi në katërmbëdhjetë, të zgjedhur në *Mbledhjen e Dytë të Përgjithshme*, më 17 – 20 janar 1944. Në këtë mbledhje, sa shihet nga mungesa e nënshkrimit në procesverbalin: “*Delegatët e Kongresit të krahinave të ndryshme*”, të nënshkruar më 20 janar 1944 nga *Bedri Gjinaj* (sekretar) dhe *Bedri Pejani* (kryetar), nuk ishin të pranishëm delegatët: *Bajram Gashi*, Av. *Adem Sabriu*, *Haxhi Xheladini* dhe *Lutfi Spahiu*.

Ky dokument është mbyllur me konstatimin:

“Na, ish *Komitetit Qendruer dhe Delegatët e krahinave të ndryshme*, të tokave të lirueme dhe jo të lirueme, të Kosovës e të Dibrës që, tue qenë të zgjedhur nga ana e popullit, muerrëm pjesë në të gjitha seancat e mbledhjeve prej datës 17-I-1944 e deri më 20-I-1944, ku u shqyrtuen e u votuen projekti i Statutit dhe i rregullorës së mbrendshme t’ *Organizatës “Lidhja e Iltë e Prizrenit. Për me zbatue*

⁶² Shih, Zëri nr. 1434, 11 janar 1992, 51.

e vue në veprim Statutin dhe të gjitha vendimet e Kuvendit në lidhje me mbrojtjen e visevet të Kosovës dhe rivendikimin e tokave Shqiptare Etnike, që ende ndodhen jashtë kufive të sotshëm t'Atdheut i napim Mandatin Komitetit Qendruer t'Organizatës, i cili zgjidhet një zanit prej. Z.Z. të posht shenuemëve:

Për Prefekturën e Prizrenit Musa Shehu e Kolë Margjini,
 për " Prishtinës Sulejman Ashkiu e Mahmut Beg Pasha,
 për " Mitrovicës Arslan Boletini,
 për " Pejës Bedri Pejani e Xhevat Begolli,
 për " Shkupit Esat Berisha,
 për " Senicës (Zona Neutrale) Nexhip Basha,

Për krahinat: Ulqin, Triepsh, Hot e Grudë, një që do të dërgohet prej atjehit,

për Malet e Kosovës zavendëson Rexh Meta, për deri sa ata dergojnë një ose pranojnë Rexh Metën,

për Malet e Didrës një që do të dërgojnë ata;

Na, me zane të përbashkëta zgjodhëm për Kryesinë e Kom. Qendruer

Kryetar: Bedri Pejanin

N-Kryetar – Musa Shehun dhe Kolë Margjinin.

V e r t e t o h e t:

Sekretar:

Bedri Gjinaj

Prizren, me 20-I-1944”⁶³

Kryetari:

Bedri Pejani

Kryetari i Komitetit Qendruer, Bedri Pejani, tekstin e Statutit të Lidhjes II të Prizrenit ua paraqiti për miratim, me urgjencë, Qeverisë dhe Këshillit të Naltë të Shqipërisë, më 21 janar 1944. Këtë dokument Këshilli Ministror e miratoi më 12 shkurt dhe atë ia parashtrroi për miratim Këshillit të Naltë, më 14 shkurt 1944⁶⁴.

Këshilli i Naltë – Regjenca e Shqipërisë e miratoi Statutin e Organizatës “Lidhja II e Prizrenit pas një muaji, më 14 mars 1944, dhe urdhëroi “zbatimin e tij”. Dekretin e nënshkruan: Rexhep Mitrovica

⁶³ Faksimilin me nënshkrime të delegatëve dhe të eprorëve e botoi Javorja Zëri, nr. 1434, Prishtinë, 11 janar 1992, fq. 51.

⁶⁴ Te D. Bislimi, vepra e cituar fq. 110, ka dalur gabim teknik: “12.11. 1944” dhe “14.11.1944”, që të lexohet “12 e 14 nëntor”.

(Kryeministër) dhe Mehdi Frashëri (Kryetar), Patër Anton Harapi dhe Lef Nosi, anëtarë të Këshillit të Naltë⁶⁵.

Për të zbardhur shumë hamendje, tendenca e glorifikime publicistike e pseudoshkencore të dëmshme për mendimin politik, juridik e luftarak të *Lidhjes së Dytë të Prizrenit*, detyrohem të sjellë të plotë tekstin e *Statutit*, i cili qartë e paekuivoke fletë për detyrat, për rolin dhe për rëndësinë e *Lidhjes* si organizatë *gjithëkosovare kombëtare* participuese në aktivitetin propagandistik, politik, diplomatik, ushtarak e çlirimtar të *Këshillit Ekzekutiv të Përgjithshëm*, të *Qeverisë* dhe të *Regjencës së Mbretnisë së Shqipërisë*. Nuk i përkiste asnjë tarafi politik antifashist të kohës: *LANÇ-së*, *Ballit Kombëtar* as *Legalitetit* dhe qartë, e saktë, *Lidhja e Dytë e Prizrenit* ishte një mekanizëm *lo-gjistik* i gjithanshëm i instancave qeveritare e pushtetore të *Mbretnisë Shqiptare* ekzistuese:

“S T A T U T I i Organizatës ‘Lidhja e II-të e Prizrenit’

I

TEMELIMI

Në bazë të vendimevet që mori Kongresi i Prizrenit me 16-19 Shtatuer 1943, ku u përfaqësuen tokat e lirueme si dhe tokat tjera Shqiptare t’ish Mbretnis Jugosllave, themelohet “Organizata e Lidhjes II-të e Prizrenit”.

II

QELLIMI

Kjo organizatë ka për qëllim mbrojtjen e tokave të lirueme si edhe të tokave të tjera Shqiptare t’ish Jugosllavis. Si mjet për këtë qëllim do të përpiqet të mbledhi dokumenta për Shqiptarsinë e viseve në fjalë dhe t’organizojë popullsinë fizikisht dhe moralisht për mbrojtjen e këtij thezi.

⁶⁵ Dekret i Këshillit të Naltë, datë 14-3-1944, Nr.70, Fleta Zyrtare nr. 12, Tiranë, 17 Mars 1944, 3.

III

KOMPETENCA TOKËSORE

Kompetenca toksore e kësaj Organizate shtrihet mbi të gjitha tokat e sipërshënueme, d.m.th. mbi Kosovën e lirueme, mbi çarkun e Dibrës si edhe mbi viset e tjera Shqiptare t'ish Jugosllavisë.

Malsinat mbrenda kufivet të 1913-tës që ma parë vareshin prej qyteteve të Gjakovës, Prizrenit dhe Dibrës së Madhe, me qenë se ekonomikisht dhe gjeografikisht janë fare ngushtas të lidhuna me qytetët në fjalë, munt të përfaqësohen në Kuvend vullnetarisht dhe munt të marrin pjesë në Organizatën e Lidhjes së II-të të Prizrenit.

IV

ORGANIZIMI KOMPETENCA DHE FUNKSIONIMI

Organizimi i Lidhjes së Prizrenit përfshin:

1) Kuvendi i Lidhjes, me qendër në Prizren, përbahet prej antarvet nga një delegat për çdo rreth administrativ (Qendra e Prefekturavet dhe N/Prefekturavet).

2) Komiteti Qendruer, me seli në Prizren, përbahet prej katërmbëdhjetë (14) antarësh.

Kryetari, dy N/Kryetarët dhe gjithë antarët tjerë të Komitetit Qendrruer zgjidhen prej Kuvendit.

Kryetari dekretohet prej Këshillit të Naltë mbi propozimin e Kryeministrit.

3) Komiteti Qarkuer, me seli në kryevendin e çdo Prefekture, përbahet prej shtatë (7) vetvet, të cilët zgjidhen si mbas procedurës së caktueme prej qarkores së Komitetit Ekzekutiv të Tiranës me datë 24-IX-1943 mbi rregullimin e zgjedhjes s' Asemlistevet.

Po kjo procedurë ndiqet edhe për zgjedhjen e antarve të Komitetit Rrethuer. Antarët e Komitetit Komunal zgjidhen prej Kryepleqsisve të katundeve të Komunës me seli – qendra e Komunës; kurse Kryetari caktohet prej Komitetit Qendruer në mes t'antarve të zgjedhun si ma sipër.

4) Komiteti Rrethuer, me seli në kryevendin e çdo N/Prefekture, përbahet prej pesë (5) vetvet, të cilët zgjidhen si ma sipër, kurse Kryetari caktohet prej Komitetit Qarkuer.

5) Komiteti Komunal, me seli në kryevendin e çdo Komune, përbahet prej tre (3) vetvet, të cilët zgjidhen si ma sipër, kurse Kryetari caktohet prej Komitetit Rrethuer.

6) Komiteti Katunduer, me qendër katundin, përbahet prej pleqsisë së katundit.

V

Nëpunësat në shërbim t'organizatës, emnohen prej Komitetit Qendruer mbi propozimin e Komitetit përkatës. Në qoftë se nuk gjinden nëpunësa në numer të mjaftueshëm për kryemjen e shërbimeve t'organizatës me lejën e Kryetarit t' Administratës së vendit, mund të ngarkohen me detyrat përkatëse Sekretarët Bashkijak ose komunal, kundrejt një shpërblimi prej arkës s'organizatës.

VI

Në marrëveshje me Komandën e Përgjithëshme të Mbrojtjes Kombëtare, Organizata merr në shërbim si Instruktorë dhe N/Oficerë, të cilët si mbas gradës, vehen në dispozitë të Komiteteve të ndryshme.

Instruktorët pranë Komitetit Qendruer përbajnë Shtabin e Komitetit.

VII

Funksjonet e kësaj organizate dhe kompetenca e organeve të sajë, rregullohen si mbas dispozitavet që pasojnë:

1) Kuvendi i Lidhjes, i zgjedhun prej popullit, përfaqëson vullnetin e këtij dhe mbliidhet tri herë në mot. Jashtëzakonisht Kuvendi mbliidhet, kur thirret prej Komitetit Qendruer, në rasë nevojë për me marrë vendime me randësi ase mbi kërkesën e shumicës s'antarve të Kuvendit.

2) Komitetit Qendruer i zgjedhun prej Kuvendit si ma sipër asht auktoriteti ma i naltë ekzekutiv i kësaj organizate; përfaqëson organizaten, komunikon vendimet e Kuvendit, jep udhëzime dhe urdhna Komiteteve të shdryshëm gjerarhikisht, kontrollon Komitetët ase urdhnnon gjerarhikisht kontrollimin e tyne; plotson organizimin e Lidhjes; organizon stërvitjet, emnon funksjonarë të çdo natyre dhe çdo kategori t'organizatës. Merr masa disiplinore dhe ndeshkimore kundër këtyne dhe harton buxhetin e organizatës.

3) Komitetet janë autoritete t'organizatës; këto përfaqësojnë në vendin e vet Komitetin Qendruer dhe veprojnë si mbas udhëzimeve dhe urdhnave të tij, që jepen e transmetohen gjerarhikisht.

Komitetet eprorë kanë të drejtë inspektimi e kontrolli mbi Komitetet inferiorë. Gjerarkija e Komiteteve asht analoge me çdo t'auktoriteteve civile të Shtetit. Kompetenca toksore e tyne koincidon me ate t'auktoriteteve civile të Shtetit.

VIII

Funksjonet e mbrendëshme të Kuvendit të "Lidhjes" dhe zgjedhja e Parisë së tij rregullohen me vendimet e këtij Kuvendi.

IX

Funksjonet e mbrendëshme të Komitetit Qendruer e të Komiteteve të tjera të varuna prej këtij, zgjedhje e antarvet zevëndës t'atyne, që për arsye të randa largohen prej Komitetit, themelimi i Komiteteve ku ende s'janë themelue, plotsimi i organizimit mbas këtij Statuti, rregullohen me vendimet e Komitetit Qendruer.

X

Emnimi, transferimi, gradimi dhe pushimi i nëpunsave të kësaj organizate kryen me vendimet e Komitetit Qendruer si mbas normave ligjore në fuqi për nëpunësat e Shtetit.

Dënimet disiplinore kundër nëpunsave t'organizatës zbatohen prej Komitetit Qendruer simbas ligjëve të Shtetit, mbi procesin e Komitetit Qendruer ose Komiteteve të ndryshme, si mbas ligjeve të Shtetit.

Në rast se nëpunësat në fjalë kryejnë një faj që hyn në rrethin e ndeshkimeve penale, me proces-verbalin përkatës çeshtja i referohet Gjyqit përkatës për veprim.

XI

Organizata e "Lidhjes së II-të të Prizrenit ka tagër:

1) Me organizue propagandë intensive me qellim të pregatisë shpirtnisht, materialisht edhe fizikisht popullin për mbrojtjen e tokës së vetë.

2) M'u pregatitë për luftën diplomatike në konferencën e paqes, tue organizue, mbledhjen e dokumentave provuese të karakterit Shqiptar t'atyne visevet.

3) Me organizue aparatin e vet administrativ, si mbas këtij Statuti, ndër të gjitha viset e kompetencës së sajë toksore me organe të çdo Prefekturë, Komune e Bashki dhe katund.

4) Me organizue stërvitjen paraushtarake të djelmoshave ende të parekrutuem, në konformitet me ligjën rreth organizimit të paraushtarakëve qi asht në fuqi me datë...

5) Me iu përveshë organizimit për stërvitjen e të gjithë mashkujvet deri më 60 vjeç, veç atyne nën armë, tue i inkuadrue si mbas organizimit të përshtatshëm. Pjestarët e këtyne grupeve nuk mbahen në stërvitje të vazhdueshme, por rregjistrohen, betohen dhe qendrojnë ndër shtëpijat e veta dhe thërriten herë pas herë ushtrime ase veprime të tjera.

6) M'u kujdesë për sigurimin e mjeteve të transportit, t'ushqimit dhe të tjera pajime të nevojshme për veprimin e organizatës.

7) Me kërkue prej autoriteteve shtetnore e parashtetnore ndihmen dhe përkrahjen e tyne, të cilët për sa të jet e mundun jua akordojnë.

8) Me kërkue dhe me marrë në dispozitë oficerë e nenoficerë prej ushtrisë e Gjindarmerisë dhe rrogat e këtyne do të vazhdojnë të paguhen prej Arkës së Shtetit.

XII

FINANCAT

T'ardhunat e kësaj organizate, për me u-ba ballë shpenzimeve të sajë janë:

1) T'ardhuna nga ndihma të ndryshme të dhurueme prej patriotve, emnat e të cilëvet do të regjistrohen e do të shpallen. Këta shënohen edhe si Antar nderi, kur dhurata e tyne asht e konsiderueshme.

2) T'ardhunat nga shitja e pullavet "fakultative", të cilat do të jenë Postare prej pesë(5) qind, dhe për lutje zyrtare prej njizet (20) qindarka.

3) T'ardhunat nga fushata të hapuna herë mbas herë, me vendim të Komitetit Qendruer.

4) T'ardhunat nga pasunija e ish organizatës Serbe "Sokol".

5) T'ardhunat nga kontributi i Bashkivet dhe i Komunave të tokave të lirueme, i cili kontribut do të jetë dhetë për qind (10%) mbi të gjitha t'ardhunat e çdo vjeti financjar kur pregatisin buxhetin e tyne, janë të detyrueme me caktue, në pjesën e shpenzimeve përqindjen e

ma sipërme të sajume në favorin e kësaj organizate dhe shuma që do të rezultojë do të derdhet n' Arkën ma të afërme të Financës së Shtetit, në llogari të arkës së Komitetit Qendruer, si mbas ligjën autorizuese.

6) T'ardhunat nga shitja e shejevet (distingtive) t'organizatës.

XIII

DISPOZITA TË POSAÇME

Shka nuk parashifet në kët Statut dhe që nuk asht në kundërshtim me dispozitat e tij as me qellimin dhe misjonin e kësaj organizate, rregullohet me vendimet e Komitetit Qendruer.

XIV

Marrëdhhanjet e kësaj organizate me Qeverinë, kryen nepërmjet Kryesisë së Këshillit Ministruer.

XV

Organizata ka vulen e vet, ku shenjojen fjalët: "Lidhja e II e Prizrenit" dhe emni i Zyrës. Po ashtu ka edhe shenjen (distikiven) dhe pullat e veta, ku shenohen fjalët "Lidhja e II të Prizrenit".

XVI

Organizata ka zyrat e veta në qendër ashtu edhe nepër Krahinat, ku janë themelue Komitetet. Këto gëzojnë përjashtimin nga taksat Postare, Telegrafike dhe Telefonike, si mbas ligjës autorizuese.

XVII

Organizata asht person juridik dhe i gëzon të gjitha të drejtast përkatëse ligjore.

XVIII

Vendimet, rregulloret, qarkoret, dhe urdhnat e kësaj organizate, të daluna prej Komiteteve e organeve të sajë kompetente, dhe në konformitet me kët statut, kanë fuqi obliguese si për organet e veta dhe antarët e vetë.

XIX

Kur e lyp nevoja, Komiteti Qendruer i Organizatës ka tager me i tërheq vrejtnen e Qeverisë mbi sjelljet e nëpunësave të Shtetit për të cilët kujton se u nxjerrin pengime aktivitetit t'organizatës.

XX

Mos-marrëveshjet eventuale midis autoriteteve lokale shtetnore dhe kësaj organizate, zgjidhjen në marrëveshtje midis tyre, dhe, në

rasë dështimi, në marrëveshje midis Kryetarit të Këshillit Ministruer dhe të Kryetarit të Komitetit Qendruer.

Organizata e nalt-përmendun vazhdon deri në kryemjen e plotë të aprovimit të saj. Në mbarimin e këtij qellimi organizata suprimohet me Dekret të Pushtetit Sovran dhe pasunitë e saja destinohen në favorin e Shtetit.

XXII

Ky Staut i paraqitet Qeverisë për aprovim dhe hyn në fuqi prej ditës së shpalljes të Dekretit aprovues.

Prizren, me 21 Kallnuer 1944⁶⁶.

Teksti i dokumentit të mësipërm pasqyron mekanizmat e Lidhjes së Dytë të Prizrenit të rëndësishëm në udhëheqjen permanente të organizimit dhe të komandimit të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës, si pjesë e pandashme e Shqipërisë Etnike⁶⁷. Mirëpo, këtu e tutje, për shkak të vendit për botim, detyrohem të mjaftohemi vetëm me ndriçimin e disa momenteve organizative dhe të pak aktiviteteve diplomatike, politike e ushtarake të Lidhjes. Më 14 mars 1944, Komiteti Qendruer i Lidhjes do t'i drejtohej popullit shqiptar me një Proklamatë,

⁶⁶ Statuti i Organizatës "Lidhja e II-të e Prizrenit", Fleta Zyrtare nr. 12, Tiranë, 17 Mars 1944, 3-5.

⁶⁷ Disa tendenca të partisë politike aktuale "Balli Kombëtar", i përtëritur, për t'a paraqitur "Lidhjen e Dytë të Prizrenit" si fëmijë dhe mekanizëm të Ballit Kombëtar të Mit'hat Frashërit, nuk ka asnjë mbështetje materiale. Organizata "Balli Kombëtar" së paku deri më 14 shtator 1943, kur u vra komandanti Hysni Lepenica, synonte aleancë antifashiste nacionalçlirimtare me LANÇSH-në kominterniste.

Veprimtarët politikë e ushtarakë të Organizatës "Balli Kombëtar", së paku deri në këtë kohë, përdhosën, njësoj si komunistat, ideatorët, drejtuesit e përkrahësit e Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare të cilën do drejtojë Lidhja e Dytë e Prizrenit nga formimi i saj. Realisht, organizata politiko-ushtarake "Balli Kombëtar" do ta ndihmojë të thuash simbolikisht, me pak njësite luftarake, mbrojtjen e kufijve etnikë të Shqipërisë në kufijtë verioripërendimorë të Kosovës vetëm nga vera e vitit 1944.

Dhe, duhet të konstatohet se: vazhdimësi natyrore e organizatës politiko-ushtarake "Lidhja e Dytë e Prizrenit" mund të konsiderohet vetëm Organizata Nacionale Demokratike Shqiptare e formuar në fund të janarit 1945 në Shkup dhe e transformuar në Lëvizja për Lirimin e Tokave Shqiptare, më 15 gusht 1945 në Tanushë të Kopilakës. Vazhduese e Lidhjes së Dytë të Prizrenit nuk është asnjë parti politike "demokratike" e viteve '90-ta të shek. XX. Shih gjerësisht Dr. Muhamed Piraku, Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951, Prishtinë, 1995; Enver Memisha (Lepenica), Hysni Lepenica komandant i përgjithshëm i fuqive të Ballit Kombëtar (Dokumenta, këngë, kujtime dhe rrëfime), Tiranë, 2000.

me të cilën e informonte për rrezikun permanent nga serbo-malazeztë albanofobë shekullorë, të maskuar me lëkurën kominterniste “Antifashiste”. Thirrja spikaste faktin: “Populli Shqiptar i Kosovës nga eksperiencia e idhtë 30 vjeçare e sundimit Serbo-Malazezë i njef tash ma të gjitha dredhitë djallzore të këtyne”.

Në vazhdim, duke çjerrë maskat antishqiptare të komunistëve dhe të nacionalistëve sllavë, përfundonte: “Në të vërtetë të gjitha këto drejtime Sllave: Komuniste, Drazhiste, Nediçiste e çfarë do qofshin kanë vetëm një qëllim; grabitjen e tokave Shqiptare dhe së fundi imperializmin sllavë në Ballkan. Shqiptarët nuk mund të mashtrohen ma nga këto intriga e dallavera të Serbëve të Malazezëve dhe janë përgatitë për të mbrojtë tokën e tyre në dijeni të plotë se e drejta asht me ta”⁶⁸.

Realisht, ky opinion politik i thekshëm i Lidhjes së Dytë të Prizrenit vinte pas bërjes publike të Rezolutës së Konferencës së Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar për Kosovë e Dukagjin në Bujanit, të 2 janarit 1944, kur strukturat kominterniste jugosllave antifashiste i hoqën maskat dhe e zbuluan fytyrën sllave antishqiptare të përjetshme. Ato nuk mund të pranonin zgjidhjen e çështjes shqiptare me anë të vetëvendosjes së Kosovës, ndaj u hodhën në aktivitet të thuash të hapur njëkohësisht kundër Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës dhe kundër masivizimit të LANÇ në trojet shqiptare jashtë Shqipërisë londineze⁶⁹. Më 15 – 17 mars 1944, në Rogovë të Hasit mbajti një mbledhje me përfaqësuesit e prefekturave: të Pejës, të Prizrenit dhe të Prishtinës, me komandantë të vullnetarëve dhe me përfaqësues të komandës së regjimentit të Ushtrisë së Mbretërisë Shqiptare në Pejë, ku u morën vendime për veprim preventiv kundër rrezikut çetnik e komunist në kufijtë me Serbinë dhe Malin e Zi⁷⁰.

Dhe, për të qenë të aftë për realizimin e plotë të synimeve, Kryetari i KQ të L.II.P., Bedri be Pejani, më 29 mars 1944, kërkoi nga Adolf Hitleri përkrahje - ndihmë materiale e ushtarake për të ngritur shkallën e Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare të Kosovës në nivelin që

⁶⁸ Dallavera Serbo-Malazeze, Bashkimi i Kombit, Tiranë, 15 Mars 1944.

⁶⁹ Shih, Dr. M u h a m e t P i r r a k u, Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945, Prishtinë, 1992, 19 – 36.

⁷⁰ Shih, Dr. H a k i f B a j r a m i, Bedri Pejani – një jetë e një vdekje për Shqipërinë Etnike, Prishtinë, 1994, 81 - 83; D. B i s l i m i, Formacionet politiko-ushtarake, 114-115.

shtronte rreziku nga mësymjet çetniko-komuniste serbe, malaziasë, bullgare e maqedonase në arealin e *Shqipërisë Etnike*⁷¹.

Nga prilli i vitit 1944 në të gjitha pjesët e kufirit të *Shqipërisë Etnike* me sllavët u rrit kërcënimi partizan kominternist serbo-malazias në aleancë me forcat drazhiste e çetnike. Njëkohësisht në aleancë antishqiptare me serbo-malazieztë do të viheshin bullgarët fashistë e kominternistë⁷². Për të qenë sa më të suksesshëm, nga fillimi i majit 1944, erdhën nga *Tirana* në *Prizren* personalitetet e rëndësishme kosovare: *Xhafer Deva*, *Rexhep Mitrovica*, dr. *Rexhep Krasniqi*, *Qazim Bllaca* dhe dr. *Xhelal Mitrovica*. Ata synuan që me praninë e tyre të ndikonin më me forcë në militarizimin e plotë të popullit dhe të *Lidhjes së Dytë të Prizrenit* si organizatë ushtarake, që fati i lirisë së Kosovës të mbështetej mbi shpatullat e vetë kosovarëve⁷³.

Fuqizimi organizativ, logjistik e ushtarak i *Lidhjes së Dytë të Prizrenit* për mbrojtjen vullnetare kosovare kombëtare të tërësisë së *Shqipërisë Etnike* do të ndikonte në rritjen e përkrahjes së kësaj lufte nga vullnetarët e *Kryeqytetit të Mbretnisë Shqiptare, Tiranës*. Këtij manifestimi patriotik i bëri jehonë *Kryetari i Komitetit Qendruer të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Bedri be Pejani* me *Letërfalënderimin* që i drejtoi, më 13 qershor 1944, prefektit të Tiranës, patriotit *Qazim Mulleti*: “*Të prekun thellësisht nga manifestimi patriotik i popullit të Kryeqytetit, në emën të popullit të Kosovës lutemi të baheni interpret i falënderimeve me të perzemrta pranë vllaznisë s’onë të Kryeqytetit. Kosova në luftë kundër Shkqjevet sulmuesa është e sigurtë në solidaritetin e krejt popullit Shqiptar. Armet t’ona vazhdojnë të jenë gjithnjë fituese*”⁷⁴.

⁷¹ Shih, Dr. A l i H a d r i, *Lëvizja nacionalçlirimtare*, 334-335.

⁷² Gjerësisht, T a h i r Z a j m i, *Lidhja e II e Prizrenit dhe Lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruxelles, 1964, 52- 60; Dr. H a k i f B a j r a m i, *Bedri Pejani – një jetë e një vdekje për Shqipërinë Etnike*, Prishtinë, 1994; Dr. M u h a m e t P i r r a k u, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë, 1992, 28—36; M. P i r r a k u, *Vetëvendosja e Kosovës në dritën e Lëvizjes antifashiste*, Gjurmime albanologjike, SSHH 21-1991, Prishtinë, 1993, 7-38.

⁷³ Shih, *Lidhja e Prizrenit*, Prizren, 10 Shtator 1944; Dr. M u h a m e t P i r r a k u, *Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941- 1951*, Prishtinë, 1995, 33- 146.

⁷⁴ *Lidhja e Prizrendit falënderon nxehtësisht Parinë e Kryeqytetit, Bashkimi i Kombit, Tiranë, 16 qershor 1944.*

Realisht, sulmet e ngjeshura dhe të pareshtura partizano-çetnike në kufijtë e Kosovës, *Komitetin Qendror* e detyruan të ftonte kuvendin e *Lidhjes së Dytë të Prizrenit*. Kuvendi do të mbahej më 17-20 qershor 1944, në lokalet ku ishte mbajtur Kuvendi themelues i 16-19 shtatorit 1943. *Komitetin Qendror* të dalë nga ky kuvend, e përbënin: Ing. *Xhafer Deva* (kryetar), dr. *Rexhep Krasniqi* e prof. *Kolë Margjini* (nënkryetarë), *Sheh Musa Shehzade*, *Sheh Hasani*, *Asllan Boletini*, *Mahmut Shaban Pasha*, *Rexhë Meta*, *Qazim Bllaca*, *Esat Berisha* (anëtarë) dhe *Tahir Zajmi* (sekretar i përgjithshëm)⁷⁵.

Trupi ekzekutiv i *Lidhjes - Komiteti Qendror* riorganizoi komitetet e prefekturave, të nënprefekturave, të komunave dhe të fshatrave kurse në fund të shtatorit 1944 ngriti edhe *Komitetin "Rinija Nacionaliste për Mbrojtjen e Kosovës"* me agronomin *Adem Selim Gllavica* në krye, me seli të komandës në Prishtinë. Këtë Komitet e përbënin katër seksione: *Ushtarak*, *Financiar*, *Propagandistik* dhe *i Transportit*. Në këtë mënyrë, roli i *Ushtrisë së Mbretnisë Shqiptare për Mbrojtjen e Kosovës* po spostohej vetëm mbi supet e rinisë dhe të popullsisë shqiptare jashtë *Shqipërisë londineze*. Kjo aq më parë pasi forcat politike dhe luftarake kominterniste antifashiste në arealin e *Shqipërisë londineze* po i afroreshin fitores, për të kaluar edhe në arealin shqiptar kosovar, si aleate të kominternizmit antifashist jugosllav⁷⁶.

Nga mesi i nëntorit 1944 forcat kominterniste antifashiste shqiptare, të mbështetura fuqimisht në *Bllokun antifashist ruso-anglo-amerikan*, korrën fitoren e pritur dhe kjo pati për pasojë shpërndarjen e *Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit*, më 17 nëntor 1944, kështu pra edhe shthurjen e *Lidhjes së Dytë të Prizrenit*⁷⁷.

Në përmbyllje, megjithatë, nuk është tepër të silllet përmbledhur konstatimi i publicistit *Maz'har Sopoti* në *Hylli i Dritës* - si burim dhe si vlerësim për *Kuvendin themelues* dhe për rëndësinë e *Lidhjes së*

⁷⁵ Shi gjerësisht, *Tahir Zajmi*, *Lidhja e II e Prizrenit dhe Lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruxelles, 1964, 56.

⁷⁶ Shih gjerësisht, Dr. *Izber Hoti*, *Lëvizja nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe rrethinë*, Prishtinë 1986, 105-107; Dr. *M u h a m e t P i r r a k u*, *Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941- 1951*, Prishtinë, 1995, 95 – 130.

⁷⁷ Shih, Dr. *Ali Hadri*, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 1971, 336; Dr. *D a u r B i s l i m i*, *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë 1997, 118.

Dytë të Prizrenit për kohën dhe për historinë, përvojë dhe mësim për brezat:

“Populli shqiptar, shprehje fenomenale gjallnive të pashterrshme, mund të krenohet, për çka i përket së shkuemes, ma fort se të tjerët, ma shumë se të tjerët: krejt jeta e Pinjujve të Shqypes asht një jetë çastesh të mëdhaja: të mëdhaja për guxim, të mëdhaja për qindresë, të mëdhaja për ngadhnjim” dhe konstatoi:

“Ndër çastet vendimtare që përshkon fati i krejt Kombit, atje në Prizrendin kreshnik, prej kah shkrepi drita e parë dhe ma e sigurtë e Rilindjes s’onë, një grusht atdhetarë, Lajmëtarë të rij të njëj të vërtete të vjetër, pleq dhe të rij, që pajtojshin harmoninë e mendimit me ate të veprimi: sprovimin me dinamizmin, matuninë me hovin, gjykimin me pasjonin, lëshojshin një thirrje: ate të mbledhjes së një Kuvendi të krenve për pleqnim. Zani i leshuem kumonte anë m’anë: kapërcente, si në Kuvendin e Lezhës, si në atë të Vlonës dhe si në Kongresin e Lushnjës, fusha e male, lume e thepa, dhe mbërrinte, i mirë pritun, derë në derë: si sihariq kombëtar. Krenët, Burra pushke e Burra mendjeje, n’ at thirrje shifshin shenjin e zakonshëm të traditës së Fisit: ardhjen e çasteve vendimtare për Shqipni e, për këtë, nevojën e bashkimit për vendime”.

Ky zë, sipas Sopotit ishte *“Zani i Kosovës, i dlirtë, i sinqertë, i frymëzuem vetëm nga ndiesinat ma të natyrshme të çdo populli vetëdijtës të misionit të vet kombëtar: vëllazënim, bashkim dhe përparim, gjenë, andej dhe këndej kufijve t’onë te tashëm, jehin e vet të natyrshëm: kuptim, pohim dhe aderim detyrues”*⁷⁸.

Këto aspirata mund dhe duhet të konsiderohen edhe synim i brezave shqiptar deri në realizimin e tyre.

⁷⁸ Mazar Sopot, Rilindja e Lidhjes së Prizrenit, Hylli i Dritës, nr. 2, Shkodër, 1944, 51, 52, 58.

LIDHJA E DYTË E PRIZRENIT **sipas shkrimeve autentike të pjesëmarrësve** **(REZYME)**

Mbështetur në frymën politike të shkrimeve autentike të pjesëmarrësve në *Kuvendin themelues, Lidhja e Dytë e Prizrenit* është organizatë politiko-ushtarake kombëtare demokratike shqiptare. Nuk qëndron mendimi historiografik komunist se “*iniciativën për Lidhjen e Prizrenit e mori Xhafer Deva pas kapitullimit të Italisë fashiste*”. Në fille të qarta të *Lidhjes së Dytë të Prizrenit* na vë aktiviteti politik i veteranit të *Pavarësisë së Shqipërisë, Rexhep Mitrovicës*, nga fundi i korrikut 1943.

Lidhja e Dytë e Prizrenit u ngrit në *Kuvendin themelues*, më 16-19 shtator 1943, në Prizren. Struktura organizative e *Lidhjes* dhe detyrat e saj u përligjësuan me aktin themelor: “*Statuti i Organizatës ‘Lidhja e II-të e Prizrenit’*”, i aprovuar nga *Regjenca e Shqipërisë*, më 14 mars 1944. Në nenin II të këtij dokumenti u përcaktua qartë qellimi i *Lidhjes*: “*Kjo organizatë ka për qellim mbrojtjen e tokave të lirueme si edhe të tokave të tjera Shqiptare t’ish Jugosllavis. Si mjet për këtë qëllim do të përpiqet të mbledhi dokumenta për Shqiptarsinë e viseve në fjalë dhe t’organizojë popullsinë fizikisht dhe moralisht për mbrojtjen e këtij thezi*”.

Kjo Lidhje u “shpërnda”, formalisht, më 17 nëntor 1944, si pasojë e fitorës së *LANÇ-së kominterniste* në *Shqipërinë londineze* dhe në *Kosovë*, kurse idetë dhe programi i saj përvijuan në të gjitha programet e organizatave ilegale nacionalçlirimtare shqiptare në periudhën e robërisë jugosllave kominterniste (nëntor 1944 - qershor 1999).

Prishtinë, shtator 2001

Një qasje Shahnamesë dhe tregimit për Rrustemin e Suhrabin

Gjuha persiane është gnosticizëm i pastër iranien, që ngjallë gjithë atë që është harruar në këtë vend.

Letërsia, në çfarëdo forme qoftë, paraqet jetën dhe shpreh vlerat, kriteret e tiparet në bazë të të cilave është vendosur jeta individuale dhe shoqërore.

Shahnameja, e cila në kohën e vet, mbase edhe më vonë, ishte vepër shumë e rëndësishme dhe me vlerë, përshkruan jetën e njerëzve, të cilët ndër shekuj janë zhdukur në pluhurin e kohës. Është e sigurt se kriteret tona dhe vlerat shoqërore e kulturore nuk mund të jenë identike me të njerëzve të asaj kohe, prandaj lexuesi doemos duhet të përpiqet t'i bashkojë ndjenjat e veta me ato të shkrimtarit dhe veten ta imagjinojë në rrjedhat e ngjarjeve, sepse shpirti dhe mendimet e njeriut nuk mund të jenë indiferentë.

Veprat e mëdha të letërsisë, siç është *Shahnameja*, janë pasqyrë që reflektojnë jetën shoqërore të kohës së vet me të gjitha komplikimet dhe dilemat e saj, prandaj për këtë arsye historia duhet lidhur domosdo me veprat e letërsisë; në to patjetër duhet t'i zbulojmë porositë dhe mendimet e fshehura, t'i analizojmë simbolet e tregimet, sepse ato janë mjete për ta kuptuar shpirtin e tekstit të atyre veprave, porositë e të cilave kanë për qëllim edukimin e njeriut të lartësuar.

Është shumë vështirë të flitet për *Shahnamenë* para se të njihemi me *Firdusin*, poetin e madh persian, përkatësisht para se të përkufizojmë

het: ç'është në përgjithësi poezia epike dhe ç'është miti e legjenda. Për këtë qëllim, në vazhdim, do të themi diçka për personalitetin e Firdusit.

Kush është Firdusi?

Firdusi ka lindur në vitin 950 në fshatin Bazh, në rajonin e Taberanit, në Tus. Ka qenë mysliman dhe dashamirës i familjes së ndritshme të Pejgamberit a.s. dhe të Aliut r.a.

Atë e quanin *Dehkan*. Në periudhën parakuranore ky termin kishte të bënte me feudalët, ndërsa në periudhën kuranore *dehkanët* i quanin të pasurit iraniane.

Dehkanët i donin zakonet, traditat dhe kallëzimet e lashta iraniane, i ruanin ato dhe një pjesë të madhe ua përcjellnin gjeneratave të mëvonshme. Kështu, Firdusi disa tregime të Shahnamesë i transmeton ashtu siç ia kanë kallëzuar dehkanët.

Firdusi nga fëmijëria ka qenë i interesuar për shkencë dhe ka zotëruar kalërimin, hedhjen e shtizës, dhe disa shkathtësi ushtarake. Siç mund të përfundohet nga fillimi i tregimit për Bizhanin dhe Manizhin, edhe gruaja e tij ka ditur shkrim-lexim dhe merrej me art. Ai veprën e vet të madhe e filloi duke i shfrytëzuar kallëzimet e lashta pa farë ndryshimi dhe atë e quajti *Shahname*, që kishte gjashtëdhjetë mijë vargje.

Si datë e vdekjes së Firdusit merret viti 1032, d.m.th. kur ai qe 82 vjeç.

Ç'është Shahnameja?

Tema e Shahnamesë është historia e Iranit të lashtë që nga fillimi i qytetërimit të racës iraniane deri në shkatërrimin e pushtetit me ardhjen e arabëve. Shahnameja përmban tri pjesë të ndara:

1. mitologjike
2. heroike
3. historike

1. *Mitologjike* - kjo pjesë flet për zbulimin e pushtetit, të zjarrit, të ushqimeve, të veshjeve dhe të vendbanimeve, si dhe për atë se si njeriu mësoi të merrej me bujqësi. Kjo pjesë e Shahnamesë është karaktere-

ristike edhe për luftërat në mes njerëzve dhe tiranëve, që rezultuan me çrrënjosjen e së keqes.

2. *Heroike* - fillon lufta në mes së mirës dhe së keqes. Në këtë pjesë më së shpeshti ndodhin luftëra dhe beteja në mes iranianeve dhe turqve. Këtu, po ashtu, flitet edhe për unitetin e mendimeve dhe të veprave iraniane.

3. *Historike* - në këtë pjesë Firdusi i kthehet realitetit. Mendimet për heronjtë, për njerëzit e jashtëzakonshëm dhe të veçantë, zhduken, dhe Firdusi, me zgjedhjen e kallëzimeve tërheqëse historike e udhëzuese, deri në fund të Shahnamesë, ngjarjeve u jep një atmosferë dhe freski të re.

Shahnameja është vepra më e madhe e Iranit dhe e botës, përmbajtja e së cilës është e bazuar në dokumente të shkruara nacionale dhe tregime gojore. Ky koleksion në vise të ndryshme të Iranit ka krijuar frymën luftarake, heroike dhe hakmarrëse.

Ngjarjet e epit ngërthejnë çështje fetare, historike dhe nacionale, të cilat janë kënduar në mënyrën më të mirë të mundshme. Duke u nisur nga fakti se heronjtë gjithmonë me vetëmohim kanë ndryshuar rrjedhjen e ngjarjeve në dobi të popujve, poezinë epike e quajnë poezi heroike.

Të gjithë heronjtë e tregimeve epike gabojnë dhe posedojnë tipare mbinjerëzore njëkohësisht, si p.sh. vendosmërinë, inteligjencën, aftësinë për t'u ballafaquar me fatin dhe mosshprehjen e urrejtjes, dashurinë, të padëshiruarat dhe humbjet.

Më në fund, të gjithë ata janë personalitete, që janë burim imagjinal i shumë njerëzve, prej të cilëve kanë ndërtuar mitin e vet.

Përmbajtja e shkurtër e tregimit për Rustemin dhe Suhrabin

Samangani ka qenë një vend në kufirin ndërmjet Iranit dhe Turanit. Lokacioni i saktë i atij është në lindje të Horasanit dhe në bregun verior të lumit Xhejhun e mbi Balhanë e Tageristanin.

Rustemi, për shkak të gjuetisë, nga Sistani kishte shkuar në afërsi të atij vendi, në të cilin disa njerëz ia kishin plaçkitur kalin. Ai duke ndjekur gjurmët e kalit të vet, kishte arritur në Samangan. Mbreti i atij vendi i premtoi se do t'ia gjente kalin dhe e ftoi atë në aheng, derisa i

kishin përgatitur vendin për fjetje. Gjatë natës, një vajzë, kishte hyrë në dhomën, ku pushonte ai (Rrustemi) dhe i pati thënë: "Unë jam Tahmina, e bija e mbretit të Samanganit, u dashurova në ty kur dëgjova tregimin për ty. Dëshiroj të më marrësh për grua, që të lind fëmijën tënd!"

Ata vetë kurorëzohen. Të nesërmen ia gjejnë edhe kalin dhe Rrustemi kthehet në Iran.

Suhrabi, i biri i Rrustemit, që kishte 12 apo 14 vjet, me ushtrinë e vet e sulmoi Iranin. Afrasijabi, i cili e dinte se Suhrabi ishte i biri i Rrustemit, i ndihmoi atij (Suhrabit) të vritej nga dora e t'et, që pas vrasjes së të birit, të lirohej nga ky hero (Rrustemi).

Mirëpo, me këtë tregim shtrohet pyetja: Si nuk dinte Suhrabi për të atin, të cilin, për shkak të shkathtësive dhe vetive të jashtëzakonshme e unike, e njihte e gjithë bota? Po ashtu, si nuk e kishte njohur Rrustemi të birin, i cili që nga fëmijëria kishte qenë pa konkurrencë dhe vetitë e të cilit veçoheshin nga të tjerëve, madje edhe nga të të rriturve, d.m.th. të birin që posedonte ushtri të vetën? Këtë dilemë Firdusi e zgjidh kështu:

Kur bëhet e qartë se yt bir është armik i atdheut, atëherë është vështirë të zgjedhësh në mes birit dhe atdheut.

Mirëpo, kjo nuk është hera e parë që njerëzit gjithë pasurinë e tyre, familjen, madje edhe jetën ta flijojnë për detyrën dhe besimin e vet. Ky mentalitet është i pranishëm edhe sot e kësaj dite dhe shembuj të tillë ka shumë.

Kjo nuk qe luftë në mes të babait dhe të birit, ky qe konflikt në mes të kaluarës dhe të ardhmes, si dhe respekt ndaj fesë dhe shuarjes së traditave. Kjo është ajo që Firdusi synoi ta transmetonte në shumicën e tregimeve të veta.

Përgatiti: Sadik MEHMETI

Marrë nga:

"NUR", nr. 18, Boegrad, 1988, f. 33 - 34

PËRMBAJTJA

<i>Qemajl Morina</i> <i>Arsimimi kosovar në udhëkryq.....</i>	<i>5</i>
<i>Tri dekada të revistës “Edukatës Islame”</i>	<i>9</i>
<i>Edukata Islame e kreu me sukses misionin e saj.....</i>	<i>11</i>
<i>Qemajl Morina</i> <i>Rrita dhe zhvillimi i revistës Edukata Islame 1971-2001</i>	<i>13</i>
<i>Akad. Jashar Rexhepagiq</i> <i>Vlera arsimore dhe edukative e revistës “Edukata Islame”</i>	<i>21</i>
<i>Prof. dr. Pajazit Nushi</i> <i>Tekstologjia islame në gjuhën shqipe</i> <i>dhe revista “Edukata Islame”</i>	<i>27</i>
<i>Hajrullah Hoxha</i> <i>Roli i “Edukatës Islame” në aspektin fetar</i>	<i>37</i>
<i>Dr. Abdullah Hamiti</i> <i>Nezim Frakulla - jeta dhe divanet e tij</i>	<i>41</i>
<i>Dr. Qazim Qazimi</i> <i>Një vepër e pabotuar e Muhamed Çamit.....</i>	<i>65</i>
<i>Mr. Iljas Rexha</i> <i>Koxha Sinan pasha dhe monumentet e tij në Kosovë</i> <i>gjatë shekullit XVI.....</i>	<i>73</i>

Sadik Mehmeti

Një dokument i vitit 1935 për nëpunësit fetarë islamë që nuk kishin kualifikime të duhura shkollëre..... 83

Dr. Xhemaludin Latif

Bazat e pedagogjisë kuranore 93

Dr. Sulejman Mashoviq

Qasje bashkëkohore edukimit islam 135

Qemajl Morina

Historiku i gjuhës arabe deri në zbritjen e Kur'anit..... 141

Hysein Xhozo

Problemi i prapambeturisë së përgjithshme 151

Ahmed Davutoglu

Përplasja e interesave: Një sqarim i (jo)rendit botëror..... 163

Dr. Muhamet Pirraku

Lidhja e Dytë e Prizrenit sipas shkrimeve autentike të pjesëmarrësve 191

Një qasje Shahnamesë dhe tregimit

për Rrustemin e Suhrabin 225

Përmbajtja 229